بسم الله الرحمن الرحیم

Muhamed Xhevàd Mugnijeh

FIKHU I IMAM

XHA'FERR SADIKUT

(Pagja goftë mbi të!)

IX

Titulli: **Fikhu i Imam Xha`ferr Sadikut** *(Paqja qoftë mbi të!)* **IX**

Autori: **Muhamed Xhevàd Mugnijeh**

Përktheu: **H. Selim Stafa** *(Allahu e mëshiroftë!)*

Recensent: **H. Vullnet Merja**

Redaktoi: **Jerida Kulla**

Perkujdesja garfike: **Sabrie Feza**

Kapaku: **Sabrie Feza**

Botoi: **Shoqata FLLADI**

بسم الله الرحـــمن الرحيم

UZURPIMI

Ç'do të thotë fjala "uzurpim"?

Fukahatë e kanë zgjeruar shumë fjalën në lidhje me përkufizimin e fjalës "uzurpim", madje shumë fukaha janë përpjekur ta fusin në klishe të shumta këtë fjalë. Disa herë kemi shpjeguar se përkufizimet juridike nuk janë gjë tjetër veçse vizatime e shenja të sendit dhe të disa veçantive dhe ndikimeve të tij. Pavarësisht nga të gjitha këto, ne konstatojmë që kuptimi i fjalës "uzurpim" është i njëjtë nga ana gjuhësore, nga ana e traditës dhe nga ana ligjore, që do të thotë se uzurpimi është pushtimi i pasurisë së tjetrit, pa lejen e pronarit të asaj pasurie.

Kjo është e barabartë, qoftë kur pasuria është send konkret, si për shembull, dikush pushton shtëpinë tënde, me qëllim që ta bëjë atë pronë të tij, ose një pasuri prej së cilës përfitohet.

Edhe vjedhja është një prej llojeve të uzurpimit, pavarësisht se është më e rëndë se grabitja sheshit. Ky është shkaku që për

vjedhësin bëhet i detyrueshëm zbatimi i dënimit sipas ligjit të fesë dhe nuk bëhet i detyrueshëm zbatimi i ligjit për atë që rrëmben sheshit.

Fukahatë kanë një fjalë të përbashkët se uzurpimi, ashtu siç realizohet në sendet e lëvizshme, realizohet edhe në sendet e palëvizshme, si për shembull, toka, shtëpia, kopshti. Edhe për këtë, disa imamë të medh'hebeve kanë kundërshtime mes tyre dhe mohojnë uzurpimin për tokat e trojet, me arsyetimin se për ato nuk vërtetohet marrja me dorë.

Rrëmbimi është haram

Islami e ka konsideruar haram vënien dorë mbi pasuritë e njerëzve, duke e konsideruar uzurpimin e pasurisë të njëjtë me sulmin mbi jetën e njeriut e mbi nderin e tij.

Nisur nga ky fakt, fukahatë e kanë bërë detyrim të jenë të rezervuar në lidhje me uzurpimin dhe e kanë konsideruar haram veprimin në fshehtësi dhe pa leje ligjore me pasurinë. Për këtë çështje kemi fjalën e Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*: "Nuk është hallall asnjë pasuri, veçse atë që e ka bërë hallall Allahu."

Tekstet prej Librit të Allahut dhe prej Sunetit, në lidhje më këtë çështje, janë të gërshetuara.

Allahu i Lartësuar thotë:

" وَلاَ تَأْكُلُوا أَمْوَالَكُمْ بَيْنَكُمْ بِالْبَاطِلِ "

“dhe mos hani pasurinë e njëri-tjetrit në rrugë të palejuar...” (Sure “El Bekare”, ajeti 188)

”وَيْلٌ لِّلْمُطَفِّفِيْنَ. اَلَّذِيْنَ إِذَا اكْتَالُوا عَلَى النَّاسِ يَسْتَوْفُونَ. وَإِذَا كَالُوهُمْ أَوْ وَّزَنُوهُمْ يُخْسِرُونَ“

“Mjerim i madh për ata që masin e peshojnë mangët. Ata, kur marrin prej njerëzve për vete, masin e peshojnë në dëm të njerëzve. Dhe kur masin për të tjerët, masin e peshojnë mangët për ata.” (Sure “El Mutaf’fifijn”, ajetet 1-3)

I Dërguari më i madh *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)* ka thënë: “Gjaku juaj dhe pasuritë tuaja janë haram t’i prekni. Nuk është hallall të derdhet gjaku i një myslimani, nuk është hallall të preket as pasuria e tij, përveçse me miratimin e tij.”

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!), ka thënë: “Ndalimi për të vepruar në shtëpinë e rrëmbyer, është peng për shkatërrimin e saj.”

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* tregon se i Dërguari i Allahut *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)* ka thënë: “Kur i merr pabesisht komshiut tënd një pëllëmbë tokë, Allahu do të bëjë me atë tokë, prej dheut të shtatë tokave, një rreth në qafën e rrëmbyesit. Në Ditën e Gjykimit ai do të takohet me Allahun me atë rreth toke në qafë, përveçse kur ai pendohet dhe e kthen tokën që mori.”

Për këtë çështje ka shumë ajete të Kur'anit, si dhe shumë hadithe e transmetime.

Shkaqet e garantimit

Uzurpuesi e ka haram të veprojë me sendin e rrëmbyer dhe ka detyrim ta kthejë sendin e uzurpuar ashtu siç e mori, nëse sendi vazhdon të jetë, ose i kthen një zëvendësues, nëse sendi është asgjësuar ose është prishur, qoftë edhe kur është prishur prej elementeve qiellore. Në lidhje me garantimin nga ana e uzurpuesit, fukahatë, në kapitullin "Uzurpimi", kanë folur për veprimet që e bëjnë detyrim garantimin, ngado që ato të jenë dhe, pavarësisht nga uzurpimi, ata i kanë reduktuar veprimet që bëjnë detyrim garantimin në tri: prishja e drejtpërdrejtë e sendit, bërja e shkakut për prishjen e sendit dhe vënia dorë mbi sendin e uzurpuar.

Por ka edhe shkaqe të tjera, prej të cilave rreshtojmë:

a) Dëmi, ai hap kafazin dhe bëhet shkak që pronari të humbë zogun që ishte në kafaz.

b) Rregulli i mashtrimit, si për shembull, ai shet mallin e tjetrit, duke thënë se ai është pronari, kështu që blerësi vepron me sendin që bleu me nijetin që shitja ishte e vlefshme, mirëpo më pas del në shesh mashtrimi i shitësit.

c) Respektimi i pasurisë së myslimanit për të cilën tregon hadithi: "Paprekshmëria e pasurisë së myslimanit është si paprekshmëria e jetës së tij."

d) Garantimi i sendit që mbahet, duke mos e dhënë. Kjo do të thotë se, që ta marrësh atë send, duhet të presësh, me qëllim që ta blesh, ndërkaq sendi prishet në dorën e shitësit para se të bëhet shitja.

e) Sendi i marrë në dorë me një kontratë të prishur, për sendin që merr blerësi me këtë kontratë, garantues për atë send është shitësi, kurse për çmimin që mori shitësi, garantues është blerësi.

f) Kreditimi i parave flori e argjend, si dhe kreditimi i parave të llojeve të tjera, jo flori e argjend, krahas kushtit të garantimit, që të garantojë krediituesi, edhe kur nuk ka vënie dore ose shkujdesje.

Në shikimin e parë, mbase do të mendohet se këto shkaqe, përveç tri shkaqeve që kanë përmendur fukahatë, nëse do të mendohet mbi to, bëhet e qartë se disa janë për garantimin dhe për shkaqet e garantimit, sepse rregulli i dëmtimit të pasurisë së tjetrit dhe rregulli i respektimit të pasurisë së tjetrit, tregojnë se është haram të veprohet me pasurinë e tjetrit, pa lejen e tij.

Vetëkuptohet se ndalimi i prerë për të mos vepruar me pasurinë e tjetrit është një gjë dhe garantimi është një gjë tjetër, sidomos kur s'ka dëmtim, sepse ato shkaqe mohojnë dispozitat dëmsjellëse që ka vënë Islami, kurse vërtetimi i garantimit, ose mohimi i garantimit, është krejtësisht çështje e huaj në këndvështrimin e ligjit islam.

Disa prej këtyre rregullave tregojnë për garantimin, por nuk i numërojnë tri shkaqet që kanë përmendur fukahatë, që do të thotë se kreditimi pa kushte, sendi i marrë në dorë me kontratë të prishur dhe me blerje, janë prej miratimeve të garantimit për shkak të dorës, domethënë që sendi është në dorën e atij që e ka (shitësit), ose në dorën e atij që e merr (blerësit), kurse mashtrimi hyn në garantimin e bërjes së shkakut.

Me fjalë më të shkurtra, këto rregulla ose nuk tregojnë se në ato ka garantim, ose te ato përputhet njëri prej tri shkaqeve. Për secilin prej këtyre tri shkaqeve do të flasim në një paragraf të veçantë.

Garantimi për prishjen e sendit

Shkaku i parë për garantimin është që prishësi fillon ta prishë vetë mallin, si për shembull, ai pret pemën e tjetrit, ose thyen enën e tjetrit, ose djeg librin apo rrobën e tjetrit, etj.

Detyra për të garantuar nuk ka dallim që prishësi të ketë pasur qëllim prishjen, as që prishësi të jetë i mençur e në moshë madhore dhe mes prishësit në moshë të vogël dhe jo të mençur, sepse thëniet pozitiviste i përfshijnë të gjithë, si për shembull, ai që lëshon një shigjetë mbi gjahun dhe gabimisht qëllon një kafshë, pronë e dikujt, ose ai që është në gjumë, përmbys enën e tjetrit dhe e thyen, ai ka detyrim të garantojë dëmin. Kështu është edhe kur fëmija e i çmenduri prishin mallin e tjetrit, kujdestari i të çendurit dhe i fëmijës, nëse kanë pasuri, janë të detyruar t'i zëvendësojnë pronarit sendin e prishur. Nëse ata nuk kanë pasuri, pronari duhet të presë, derisa ata të jenë në gjendje të mirë. Dallimi mes të madhit të mençur që vepron me qëllim dhe mes të tjerëve, qëndron në faktin se, kur i pari prish, ai, krahas mëkatit, është i detyruar të bëjë zhdëmtimin, kurse i dyti bën zhdëmtimin, por nuk ka mëkatuar.

Me këtë shpjegim bëhet e qartë se prishësi garantues mund të jetë rrëmbyes mëkatar, siç ishte i mençuri që prish me qëllim, por mund të jetë jo mëkatar, si ai që prish gabimisht, ose si prishësi që është me mangësi.

Garantimi për bërjen e shkakut

Shkaku i dytë i garantimit ishte bërja e shkakut, domethënë, kur njeriu bën një punë, e cila sjell prishjen, qoftë edhe me një punë shtesë së bashku me punën e parë, si për shembull, gropa që mund të sjellë vdekjen, kur kalohet sipër saj, domethënë, sikur të mos ishte gropa, ai që ec sipër saj, do të kalonte pa pësuar asgjë.

Burimet e bërjes së shkaqeve janë të shumta dhe është e pamundur të numërohen. Pavarësisht kësaj, le të përmendim disa prej burimeve të bërjes së shkaqeve: buri hap një gropë, jo në pronën e tij dhe në atë gropë rrëzohet një njeri ose një kafshë, ose burri hedh në rrugë materiale rrëshqitëse, si lëkurë shalqiri, ose lëkurë bananesh, ose ngul gozhdë në rrugë, të cilat dëmtojnë kalimtarët dhe mallrat e tyre, ose në rrugë ai vë një siluetë nga e cila trembet kafsha dhe merr arratinë me gjithë kalorësin ose barrën që ka mbi shpinë, ose burri lë një fëmijë ose një kafshë në një vend ku ka insekte dëmtuese dhe bisha, të cilat e vrasin fëmijën ose kafshën, ose burri zgjidh litarin me të cilin është lidhur kafsha, ose ai zgjidh pengojcën që i vihet kafshës te këmbët, për pasojë, kafsha merr arratinë, ose burri hap kafazin dhe shpendi që ishte në kafaz, largohet, ose ai zbërthen mbyllësen e një mbajtëseje vaji, për pasojë derdhet vaji që ishte në atë mbajtëse, të gjitha këto, si dhe të tjera të ngjashme, përfshihen në garantimin e bërjes së shkakut, domethënë që vepruesi shkaktar ka detyrim t'i paguajë pronarit një të ngjashëm me mallin e prishur, ose vlerën e sendit.

Në lidhje më këtë çështje, ka shumë transmetime të ardhura prej Ehli Bejtit *(Paqja e Allahut qoftë mbi ta!)*.

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "Çdo send që sjell dëm në rrugën e myslimanëve, ai që e ka vënë atë send është garantues për dëmin që shkakton ai send."

Zerare tregon: "Pyeta Imam Sadikun *(Paqja qoftë mbi të!)* për një burrë që ka hapur një pus jo në pronën e tij, ndërkaq dikush kalon mbi pusin dhe bie brenda në të. Çfarë detyrimi ka ky burrë?

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* u përgjigj: "Ai ka detyrim të bëjë garantimin."

Autori i librit "E Xheuahir" ka thënë: "Përveç këtij transmetimi, tekstet prej të cilave mund të merret mësim janë të shumta."

Kalimi i zjarrit në pronën e fqinjit

Fukahatë kanë një fjalë të përbashkët me dëshminë e autorit të librit "El Mesalik", i cili thotë se ai që çon në pronën e tij ujë, ose ndez një zjarr për interesat e veta, ndërkaq uji që ai futi në pronën e tij, ose zjarri që ai ndezi në atë pronë, kalon në pronën e tjetrit dhe shkakton dëme e prishje, personi që solli ujin, ose që ndezi zjarrin, nuk garanton asnjë send nga ato që u prishën, nëse plotësohen këto dy kushte: Kushti i parë: Uji dhe zjarri të mos jenë më shumë nga sa ai kishte nevojë për ujin e për zjarrin.

Kushti i dytë: Ai nuk ka menduar që puna e tij do të jetë dëmtuese për tjetrin, sepse, në këtë gjendje, ai është i lejuar ligjërisht të veprojë në pronën e tij, sipas hadithit "Njerëzit janë zotërues të pasurive të tyre", prandaj atë nuk e ndalon askush të veprojë në pronën e tij.

Kur të dy kushtet plotësohen, fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët dhe thonë se, nëse tjetri dëmtohet, vepruesi nuk garanton, pasi kjo punë është e ngjashme me punën e atij që hap një pus në pronën e tij, larg rrugës publike, ndërkaq një kafshë që ka marrë arratinë, bie në atë pus.

Kur të dy kushtet nuk janë së bashku, si për shembull, zjarri që ai ndezi ishte më i madh nga nevoja që ai kishte për atë zjarr dhe koha ishte me erë të fuqishme, në atë mënyrë që mund të mendohet që zjarri do të kalonte kufijtë e pronës së tij, nëse çështja qëndron kështu siç u përshkrua, me fjalën e përbashkët të fukahave, ai garanton, sepse, në këtë rast, ka vend të flitet për atakim të pronës dhe për shkujdesje.

Kur nuk është njëri prej dy kushteve, por është kushti tjetër, si për shembull, kur zjarri e uji janë më shumë se nevoja, por ai nuk ka menduar ta dëmtojë tjetrin, ose zjarri e uji ishin më pak se nevoja e tij, por ai ka menduar ta dëmtojë tjetrin, për këtë gjendje, fukahatë kanë dy thënie. Më e sakta prej dy thënieve të fukahave është thënia që flet për garantimin, sepse, në të vërtetë, ai bëri një punë, e cila, sikur të mos ishte bërë, nuk do të kishte ndodhur prishja.

Përveç kësaj edhe tekstet ligjore pozitiviste, nuk e kushtëzojnë garantimin as me pasjen dijeni, as me mospasjen dijeni, as kur dëmi është bërë me qëllim, as kur dëmi është bërë gabimisht. Për sa i përket lejimit ligjor për të vepruar, ai nuk bie në kundërshtim me dispozitën e caktuar nga Allahu. Cili është ndaluesi, kur ligjvënësi thotë: "Ti je zotërues i pronës tënde, prandaj bëj me atë si të dëshirosh. Por kur tjetri dëmtohet prej

veprimit tënd, atëherë je i detyruar të garantosh dëmin që shkaktove.”?

Ai që ndalon pronarin prej pronës së tij

Kur mizori nuk e pushton sendin, por ai e ndalon pronarin të veprojë me pronën e tij, madje edhe e ruan atë pronë që pronari të mos veprojë me pronën e tij, si për shembull, e ndalon pronarin të kapë kafshën e tij të lëshuar dhe kafsha ngordh, ose ndalon dikë që të marrë portofolin e tij dhe portofoli vidhet, ose ndalon pronarin e banesës të mos hyjë në banesën e tij dhe banesa shembet, në këtë gjendje, ky mizor a është mëkatar garantues, apo është vetëm mëkatar që nuk garanton?

Fukahatë më të dëgjuar kanë shkuar me dëshminë e autorit të librit “El Mesalik”, i cili thotë: “Mizori është mëkatar dhe nuk paguan, sepse dora e tij nuk është vënë mbi sendin, prandaj ai nuk është uzurpues.”

Konstatohet se shkaku i garantimit nuk reduktohet vetëm me uzurpimin, por mjafton të vërtetohet që puna e rrëmbyesit ka një lloj ndikimi në prishjen dhe në asgjësimin e sendit, në mënyrë që, sikur të mos ishte ajo punë, sendi do të shpëtonte.

Më pak se vlera e tregut

Mizori e ndalon burrin të shesë mallin e tij dhe vlera e tregut për sendin në fjalë pakësohet, pa ndryshuar asgjë në cilësitë e sendit të vënë në shitje. Në këtë gjendje, mizori është mëkatar

dhe nuk paguan, sepse as sendi nuk ka humbur dhe as cilësitë nuk kanë pësuar ndonjë humbje, por me këtë pakësim të vlerës së tregut, ka humbur vetëm fitimi. Mirëpo mosfitimi është për shkak të cilësive negative të sendit, të cilat i përfshin garantimi.

Natyrisht që tradita e shikon mizorin shkaktar për këtë humbje, por jo të gjitha ato që tradita i sheh si shkak, janë prej shkaqeve, që në ligjin e fesë bëjnë detyrim garantimin, sepse fjala shkak nuk ka ardhur në tekst që të jetë pikë referimi për njohjen që ka tradita për shkakun, duke ditur që tradita nuk është e përpiktë në njohjen e shkakut.

Tërheqja prej dëshmisë

Dy vetë dëshmojnë se Zejdi i ka para borxh një tjetri dhe gjykatësi gjykon në bazë të dëshmisë së dy dëshmitarëve, ndërkaq dy dëshmitarët tërhiqen prej dëshmisë dhe kështu ata përgënjeshtrojnë vetveten. Në këtë gjendje, ata të dy i paguajnë personit kundër të cilit dëshmuan dhe i kompensojnë atij shumën që i dëmtuari, për shkak të dëshmisë së tyre, i pagoi personit për të cilin ata dëshmuan në favor të tij.

E njëjta gjë është edhe kur dy dëshmitarët dëshmojnë për divorc dhe gjykatësi, bazuar në dëshminë e atyre të dyve, merr vendimin përkatës, mirëpo më pas, të dy dëshmitarët tërhiqen prej dëshmisë. Në këtë gjendje, ata të dy i paguajnë burrit shumën e parave të kurorës që ai ka paguar për martesën e tij.

Bashkimi i shkakut dhe i prishjes së drejtpërdrejtë

Më sipër u shpjegua se prishja e drejtpërdrejtë dhe bërja e shkakut ishin prej veprimeve që e bëjnë detyrim garantimin. Nëse njëri prej dy veprimeve vepron i veçuar dhe ndikimi i njërit s'ka efekt mbi tjetrin dhe, kur ndodh që prishja e drejtpërdrejtë dhe bërja e shkakut bashkohen së bashku, atëherë shikohet, nëse veprimi i drejtpërdrejtë është më i fuqishëm, atëherë ai ka detyrim garantimin.

Le të shikojmë një shembull për rastin në fjalë: Një burrë hap një gropë në rrugë, ose në pronën e tjetrit, ndërkaq vjen dikush dhe shtyn në atë gropë një njeri ose një kafshë dhe kafsha mbytet në ujin e gropës. Në këtë rast, garantimi është detyrim për shtytësin dhe jo për atë që hapi gropën, sepse është plotësisht sikur ai të kishte shtyrë njeriun ose kafshën në ujë dhe ai të mbytej, ose sikur ta kishte shtyrë, që të rrëzohej prej një lartësie dhe të vdiste prej këtij rrëzimi.

Nëse bërësi i shkakut është më i fuqishëm, atëherë garantimi është detyrim mbi të dhe jo për atë që prishi drejtpërdrejt. Në lidhje me këtë çështje fukahatë, kanë përmendur dy shembuj:

Shembulli i parë: Ekspozim para njerëzve për dënim, si ai që vjedh pasuritë e njerëzve. Sendi jepet sadaka në adresë të tij dhe prej tij, pastaj mbi sendin veprohet duke e marrë për interesin e tij, duke pasur besimin se kështu është gjetur zgjidhja dhe plotësimi për dhënësin. Në këtë rast, garantues është bërësi i shkakut dhe jo ai që veproi drejtpërdrejt, sepse ky i fundit nuk do të vepronte sikur të mos ishte mashtrimi dhe bërja e shkakut për

prishjen. Por për pronarin lejohet të kërkojë pagesën prej cilit të dëshirojë prej atyre të dyve, duke shikuar se rrëmbyesi e pushtoi pasurinë dhe marrja e asgjësoi atë pasuri. Në qoftë se pronari kërkon prej uzurpuesit, uzurpuesi, nga ana e tij, nuk kërkon prej marrësit. Nëse pronari kërkon prej marrësit, marrësi, nga ana e tij, kërkon prej uzurpuesit, sepse i mashtruari kërkon prej atij që ka mashtruar. Gjithashtu, prej rregullave të fik'hut është që garantimi, në fund të fundit, i mbetet atij në dorën e të cilit është prishur ose është asgjësuar sendi, përveçse kur dora marrëse është e mashtruar.

Shkaku i dytë: Imponimi për të asgjësuar pasurinë. Kush imponon një njeri që të asgjësojë pasurinë, garantimi është detyrë për imponuesin dhe jo e atij që e prishi drejtpërdrejt, sepse, në këtë rast, ky i fundit është më i pafuqishëm se bërësi i shkakut. Në qoftë se imponuesi e detyron atë të vrasë një njeri të pafajshëm, për të imponuarin nuk lejohet të vrasë njeriun që ai e urdhëron dhe, nëse e vret, ai do të ekzekutohet si vrasës, ndërsa bërësi i shkakut dënohet me burgim të përjetshëm. Këtu sekreti, ashtu si e mendoj unë, qëndron në faktin se për pasurinë ka zëvendësues, kurse për njeriun nuk mund të ketë zëvendësues.

Sqarim më të hollësishëm për këtë çështje do të jepen në kapitullin "Dëshmitë".

Ndodh që dy shkaqe bashkohen në një send të vetëm, si për shembull, kur një person hap një gropë jo në pronën e tij dhe një tjetër afër gropës vë një gur, ndërkaq në atë gur pengohet një njeri, ose kafshë dhe për pasojë bie brenda në gropë, ku edhe gjen vdekjen.

Dëshmori i dytë, në librin "El Mesalik", thotë: "Nëse ekzistenca e gropës dhe vënia e gurit rastisin në të njëjtën kohë, garantimi është detyrim mbi të dy, domethënë mbi hapësin e gropës dhe mbi vënësin e gurit, për arsye të barazimit dhe të mosanimit të fajit në asnjë krah. Por nëse gropa ose vënia e gurit kanë ndodhur më pas, njëri pas tjetrit, atëherë garantimi është mbi të parin, domethënë mbi hapësin e gropës, sepse ai është bërësi i shkakut."

Çështje

1- Një person hap një portë në pronën e tjetrit dhe atë portë e merr vjedhësi. Në këtë gjendje, bërësi i shkakut është ai që hapi portën, kurse vjedhësi është ai që kreu drejtpërdrejt vjedhjen, prandaj garantimi është detyrim për vjedhësin dhe jo për bërësin e shkakut, sepse vjedhësi është më i fuqishëm se bërësi i shkakut, prandaj për atë që hapi portën nuk rëndon asgjë tjetër përveç mëkatit.

2- Një person çon fjalë te një mizor për një tjetër dhe mizori i merr atij pasurinë. Në këtë rast, ai që çoi fjalën, po e quajmë raportuesi, është bërësi i shkakut, kurse marrësi i pasurisë me dhunë është bërësi i drejtpërdrejtë, prandaj garantimi është mbi këtë të fundit, sepse ai është më i fuqishëm se raportuesi, i cili meriton zemërimin e Allahut dhe dënimin e Tij për mëkatin e rëndë të çuarjes e të prurjes së fjalëve.

3- Një person ka kapur një tjetër, të cilin e vret një i tretë. Në këtë rast, ekzekutohet vrasësi, sepse ai është më i fuqishëm se kapësi, i cili dënohet me burgim të përjetshëm.

Sqarim më të hollësishëm për këtë çështje, me lejen e Allahut të Lartësuar, do të jepet në kapitullin "Dënimet".

Garantimi për vënien dorë

Shkaku i tretë prej shkaqeve që bëjnë detyrim garantimin, është garantimi me dorën. Kushdo që merr në zotërim pasurinë e tjetrit, pa lejen e pronarit, domethënë e merr në atë mënyrë që i jep mundësi të sillet arbitrarisht në atë pronë, qoftë edhe kur ajo humb, ose hyn gradualisht nën garancinë e tij dhe ai bëhet përgjegjës për atë pronë, rrëmbyesi ka detyrim t'ia kthejë sendin e rrëmbyer pronarit, duke qëndruar sendi ashtu siç ishte, ose i kthen kompensimin kur sendi i pushtuar është prishur. Kjo është e barabartë, nëse kishte qëllim ose nuk kishte qëllim marrjen e atij sendi si vjedhësi, si për shembull, atij që i ngjason portofoli i tjetrit me portofolin e tij dhe e merr atë portofol gabimisht.

Gjithashtu, kjo është e barabartë, qoftë kur sendi prishet në dorën e pushtuesit për shkaqe të ardhura prej tij, qoftë kur sendi prishet prej ndonjë sëmundjeje qiellore. Në të gjitha këto raste, dora e tij është dorë garantimi, me përjashtim të sendeve që dalin jashtë këtij përshkrimi me argument dhe veprohet kështu në bazë të rregullit: "Dora ka detyrim atë që ka marrë", madje ajo çon deri aty sa ajo, me argument të veçantë, del prej dorës së kujdestarit, testametmabajtësit, dhënësit të garancisë, depozituesit, krediituesit dhe qeramarrësit. Të tjerat, përveç këtyre që u përmendën, mbeten të përfshira në garantimin me dorën.

Bazuar mbi sa u tha, garantimi me dorën nuk është i posaçëm vetëm për rrëmbyesin, por ai përfshin edhe vënien dorë

mbi sendin gabimisht, ngaqë ngjason sendi i tij me sendin e tjetrit dhe kështu atë e merr rrëmbyesi me besimin se ai me të vërtetë është pronari atij sendi. Në këtë kategori është edhe sendi i marrë me detyrim me një kontratë të prishur, për të cilat ne kemi folur në paragrafin "Shkaqet e garantimit" të këtij kapitulli, madje për këtë të fundit kemi vënë një nënkapitull më vete, në pjesën e tretë të këtij libri, me titull "E marra në dorë me kontratë të prishur".

Fukahatë kanë thënë se prej vënies dorë që bën detyrim garantimin, është edhe kur hip mbi kafshën e tjetrit, edhe kur nuk ke lëvizur fare me kafshën, ose kur ulesh me forcë në shtrojat e tjetrit.

Autori i librit "El Mesalik" ka thënë: "S'ka asnjë komplikim në vërtetimin e uzurpimit, krahas uljes mbi qilim dhe hipjes së kafshës. Kjo është e barabartë, kishe apo nuk kishe qëllim të uleshe mbi qilimin apo të hipje mbi kafshën. Gjithashtu, kjo është e barabartë, ishte ose nuk ishte i pranishëm pronari, apo e shqetësoi ose jo pronarin, që ti të vërtetosh se ai send u mor në zotërim me dhunë."

Dobitë e njeriut të lirë

Fukahatë kanë thënë se, kush merr peng një njeri të lirë, me dhunë dhe e mban të arrestuar në mënyrë arbitrare, pengmarrësi nuk garanton asgjë për dobinë që ka prej këtij njeriu, sepse njeriu nuk është si pasuritë që futen në dorë. Me fjalë të tjera, njeriu garantohet vetëm kur asgjësohet dhe jo ngaqë është rrëmbyer.

Vetëkuptohet se ai që vë në shërbimin e tij një njeri në mënyrë të dhunshme, dhunuesi ka detyrim t'i paguajë atij njeriu pagën e zakonshme për punën e kryer, sepse puna e njeriut është e respektuar ashtu si është e respektuar jeta dhe pasuritë e tij.

Kur njeriu i marrë peng vdes, ose dëmtohet gjatë kohës që është peng, atëherë shikohet: në qoftë se dëmi ka ardhur për shkak të pengmarrësit, pengmarrësi është mëkatar dhe paguan, por në qoftë se dëmtimi është prej ndonjë shkaku tjetër, ai është vetëm mëkatar dhe nuk paguan.

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Këtë unë e gjej pa asnjë kundërshtim të vërtetuar.", në kuptimin që pengmarrja e njeriut nuk është si rrëmbimi i pasurive që bën detyrim garantimin, madje edhe në rastin kur njeriu vdes prej vdekjes së natyrshme gjatë kohës që është peng. Është e qartë se njeriu nuk është mall, që për atë të vërtetohet detyrimi për garantimin. Në vijim ai tha: "Në të vërtetë, nuk ka asnjë dallim mes njeriut të madh e njeriut të vogël, mes të çmendurit e të mençurit."

Por autori i librit "Miftaul Kerameh", në kapitullin "Uzurpimi", ka cituar prej Mukad'des El Erdebilij dhe prej mësuesit të tij, sej'jid Bahrul Ulum, që të dy këta dijetarë e kanë përforcuar shumë garantimin dhe kanë thënë: "Kush merr peng një profesionist dhe nuk ka përfituar prej tij, uzurpuesi garanton punën e tij, sepse në mosgarantimin ka dëmtim të madh, sepse mund të vdesë nga uria ai vetë dhe njerëzit e familjes së tij. Në këtë gjendje, pengmarrësi që e mban të burgosur me dhunë, është agresor dhe mizor, por dënimi i së keqes për uzurpuesin është: Me një të keqe si e keqja që ai ka bërë, ose ekzekutimin e tij, ose dënime të tjera."

Dy dijetarët e lartpërmendur i miraton për këtë çështje edhe autori i librit "Err Rrijàd", i cili ka cituar prej autorit të librit "El Xheuahir" prirjen për këtë çështje.

Për rezultatin përfundimtar të kësaj çështjeje ne mbështetemi mbi opinionin e mësipërm dhe mendojmë se ai që merr peng një punëtor prodhues, të cilin e ndalon të bëjë punën e tij, pengmarrësi garanton dobinë e tij, kurse ai që merr peng një dembel parazit, të atillë që vetëm konsumon dhe nuk prodhon, pengmarrësi nuk ka asnjë detyrim, përveç faktit që ka mëkatuar.

Kush uzurpon një kafshë, ai ka detyrim të garantojë dobitë që vijnë prej kafshës, edhe nëse për vete nuk përfiton asgjë prej asaj kafshe, pra, është plotësisht si ai që uzurpon një shtëpi dhe nuk banon në të, por si uzurpues, ai garanton zëvendësuesin e dobisë gjatë kohës së uzurpimit, sepse dobia është pasuri që futet në dorë në formën e garantimit.

Qarkullimi në disa duar

Në pjesën e tretë, në kapitullin "Kthimi dhe dispozitat e kthimit", kemi folur në mënyrë të detajuar në lidhje me rastin kur sendi i rrëmbyer qarkullon nëpër disa duar. Gjithashtu, kemi folur në lidhje me dispozitën e pronarit të sendit të uzurpuar me ata që e kanë pasur në dorë atë send. Më pas kemi folur për dispozitën që trajton marrëdhëniet e atyre që e kishin në dorë sendin e uzurpuar ndaj njëri-tjetrit, prandaj nuk kemi ndonjë gjë tjetër për të shtuar më shumë nga sa kemi thënë më sipër në lidhje me qarkullimin e sendit të uzurpuar nëpër disa duar.

Kthimi i sendit të uzurpuar

Uzurpuesi e ka haram të veprojë me pasurinë e uzurpuar, madje ai e ka haram të mbajë pasurinë e uzurpuar, edhe nëse nuk vepron me atë pasuri, prandaj është detyrim t'ia kthejë menjëherë të zotit, madje ai ka detyrim të paguajë edhe shpenzimet e kthimit, sado që të jenë. Për këtë ai imponohet (me ligj), edhe kur kthimi sjell dëm për uzurpuesin, por merret në konsideratë që ai vetë e futi këtë dëm mbi veten e tij dhe është vetë ai që rrezikoi me keqpërzgjedhjen e tij. Kur uzurpuesi uzurpon një gur dhe mbi atë gur ka bërë ndërtim, shembet ndërtimi, kur për kthimin e gurit duhet të bëhet shembja, gjithashtu hiqet dërrasa e uzurpuar prej anijes, edhe nëse heqja e asaj dërrase çon në prishjen e anijes, përveçse kur heqja e asaj dërrase detyrimisht sjell vdekjen e një njeriu, ose asgjësimin e pasurisë së një tjetri, por jo asgjësimin e pasurisë së uzurpuesit, sepse kthimi i sendit të rrëmbyer te pronari i vet është detyrim që duhet të plotësohet në çast. Kur detyrimi plotësohet vetëm me atë send, atëherë pikërisht ai veprim është detyrim që duhet të plotësohet patjetër.

Uzurpuesi e ndryshon cilësinë e sendit të uzurpuar, si për shembull, bluan grurin, ose miellin e bën brumë, ose copën e stofit e pret, megjithëkëtë uzurpuesi, pavarësisht nga veprimi që bëri mbi sendin e uzurpuar, nuk e merr atë send në pronësi, pasi ka detyrim ta kthejë sendin e uzurpuar së bashku me kompensimin, kur vlera e sendit të rrëmbyer është pakësuar. Nëse vlera e sendit është shtuar, uzurpuesi nuk ka ndonjë detyrim, sepse puna e uzurpuesit nuk respektohet.

Kur ai uzurpon një vezë dhe veza bëhet zog, zogu i takon të zotit të vezës dhe jo uzurpuesit. Në qoftë se ai uzurpon një

damáz[1] të cilin e bashkon me një femër (lopë, dele, dhi pelë), i vogli që lind, i takon të zotit të femrës dhe, kur i zoti i femrës është vetë rrëmbyesi, atëherë ai i paguan të zotit të damazit pagën e zakonshme.

Autori i librit "El Xhevahir" ka thënë: "Tradita e vijueshme, në të gjitha kohët e në të gjitha vendet, është: I linduri ndjek nënën e tij, me përjashtim të njeriut, pa bërë ndonjë dallim mes rrëmbyesit e një tjetri që nuk është rrëmbyes."

Disa fukaha kanë përmendur dallime mes spermatozoidit dhe mes vezës dhe kanë thënë se sperma e damazit nuk ka vlerë, sepse nuk merret në pronësi, kurse veza është e kundërta, sepse ajo merret në pronësi.

Dispozita e farës dhe e vezës është e njëjtë, prandaj, kur ai rrëmben një farë, të cilën e mbjell, e mbjella i takon të zotit të farës, sepse pasuria ndjek llojin konkret, ashtu siç është, pavarësisht nga forma. Përveç kësaj, duhet të shtohet edhe rregulli i shoqërimit për mosprishjen e për mosasgjësimin e pronës.

Kur në sendin e uzurpuar ndodh një e metë, si për shembull, farën e ha krimbi, ose fara kalbet, ose rroba bëhet rreckë, monedhat prej floriri e prej argjendi shkrihen e derdhen në kallëpe, kafsha dobësohet ose sëmuret, ose kafsha humb njërën prej gjymtyrëve të saj, pema thahet, ose i priten disa degë, shtëpia shembet ose ngjitja në atë shtëpi është bërë e vështirë, të gjitha këto, si dhe të tjera si këto, nuk e pengojnë kthimin, prandaj uzurpuesi ka detyrim ta kthejë sendin e uzurpuar ashtu siç është,

[1] Damazi është kafshë mashkull e zgjedhur për ndërzim.

me të metën që ka pësuar, krahas kompensimit për të metën e shkaktuar.

Pra, uzurpuesi i paguan pronarit diferencën mes çmimit të sendit të uzurpuar në kohën e uzurpimit dhe çmimit të atij sendi në kohën e kthimit. Kjo është e barabartë, qoftë kur mangësia ose e meta ka ndodhur për shkak të rrëmbyesit, qoftë kur ka ndodhur prej ndonjë shkaku tjetër.

Kur sendi i uzurpuar asgjësohet, ose prishet, uzurpuesi i kthen pronarit një zëvendësues të ngjashëm, ose çmimin e atij sendi, madje edhe kur asgjësimi ka ndodhur prej ndonjë faktori atmosferik.

Humbja e sendit të uzurpuar

Sendi i uzurpuar humb, ose ai vidhet në dorën e uzurpuesit, ose është i pamundur kthimi i tij te pronari, kur ai të kërkojë sendin e vet. Si do të veprohet?

Përgjigje: Pronari i sendit hyn në bisedime për kompensimin dhe për blerjen e sendit prej tij. Nëse ata bien në marrëveshje, sendi kalon në pronësi të uzurpuesit dhe kështu merr fund me kaq, ndryshe uzurpuesi ka detyrim t'ia zëvendësojë sendin e uzurpuar me një të ngjashëm, ose i paguan çmimin e atij sendi. Nëse pas kësaj gjendet sendi dhe uzurpuesi ka fuqi ta marrë, në këtë gjendje, uzurpuesi ka detyrim t'ia kthejë sendin të zotit, gjithashtu edhe pronari i sendit ka detyrim t'i kthejë uzurpuesit zëvendësuesin.

Në të gjitha rastet, uzurpuesi ka detyrim t'i paguajë pronarit edhe qeranë për sendin e uzurpuar, duke filluar pagesën që prej kohës kur sendi është uzurpuar, deri në kohën kur uzurpuesi ka paguar zëvendësuesin, ashtu siç u tha më sipër për garantimin e çdo sendi që humb në dorën e rrëmbyesit, qoftë edhe prej ndonjë faktori atmosferik, sepse dobitë janë pasuri dhe si pasuri konkrete edhe ato garantohen.

Dobitë e sendit të uzurpuar

Dobitë e lejuara i takojnë të gjitha pronarit, sepse ato janë shtuar mbi pronën e tij, për rrjedhojë, uzurpuesi garanton për humbjen e dobive. Gjithashtu, uzurpuesi paguan edhe humbjen e pësuar për shkak të dobive. Kjo është e barabartë, qoftë kur dobia është send që konsumohet konkretisht, si: qumështi, qimet e kafshës, leshi, frutat, fëmija, qoftë kur dobia e përfituar vjen prej një sendi që konkretisht nuk konsumohet, por konsumohet vetëm dobia e sendit, si për shembull: banesa, rrobat dhe hipja mbi mjet.

Gjithashtu, kjo është e barabartë, qoftë kur uzurpuesi ka përfituar, qoftë kur nuk ka përfituar ndonjë gjë prej dobive, madje edhe nëse dobia ka shkuar kot, përsëri uzurpuesi është garantues.

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Për këtë çështje fukahatë kanë një fjalë të përbashkët, madje nuk bëjnë asnjë dallim, nëse dobitë kanë humbur pa përfituar gjë prej tyre, apo prej dobive të sendit është përfituar."

Kur uzurpuesi uzurpon një kafshë të dobët dhe për këtë shkak e mban lidhur, derisa kafsha shëndoshet, është plotësisht

sikur kafshën ta kishte uzurpuar të shëndoshë dhe ajo të dobësohej në dorën e uzurpuesit. E njëjta gjë është kur uzurpuesi rrëmben një pemë që ka filluar të zverdhë gjethet dhe ai e vadit pemën e i kryen shërbimet, ndërkaq pema rigjallërohet dhe më pas, në kohën e uzurpimit, pema kthehet në gjendjen që ishte, këtë pemë uzurpuesi e garanton të zhvilluar e të njomë, sepse cilësitë ndjekin sendin. Kjo është e barabartë, qoftë kur pema është rigjallëruar në dorën e pronarit, qoftë kur ajo është rigjallëruar në dorën e uzurpuesit. Çdo dobi që ka humbur prej pemës, kur ajo është në dorën e uzurpuesit, uzurpuesi ka detyrim garantimin për humbjen e pësuar.

Kur uzurpuesi uzurpon një parcelë toke, të cilën e mbjell me bimë bujqësore, ose në atë tokë ai mbjell pemë, ose bën një ndërtim. Në këtë rast, i gjithë prodhimi i të mbjellave dhe frutat i takojnë uzurpuesit. Kur fara, pemët e materialet e ndërtimit janë të uzurpuesit, por uzurpuesi ka detyrim t'i paguajë pronarit të tokës qeranë e zakonshme dhe të zhdukë gjithçka është shkaktuar mbi atë parcelë toke për shkak të punimit, të mbjelljes së pemëve, ose për shkak të ndërtimit të bërë.

Kur pronari i tokës i kërkon uzurpuesit që ai t'i shesë atij të mbjellat ose pemët, rrëmbyesi nuk mund të detyrohet të pranojë.

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* është pyetur për një burrë që ka punuar, ka mbjellë tokën e një tjetri pa lejen e tij dhe, kur prodhimi është pjekur, vjen pronari i tokës dhe i thotë: "Ti punove e mbolle tokën time pa më marrë leje mua, prandaj prodhimi më takon mua. Unë kam detyrim për të paguar shpenzimet që ke bërë." A i takon atij kjo apo nuk i takon?

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* është përgjigjur: "Ai që punoi tokën, merr prodhimin, kurse pronarit të tokës i takon qeraja për tokën e tij."

Duhet të theksohet se pronari ka të drejtë të detyrojë uzurpuesin që ai të asgjësojë të mbjellat para se ato të piqen, edhe nëse me këtë kërkesë shkaktohet një dëm i madh, sepse është vetë rrëmbyesi ai që i shkaktoi dëm vetes dhe, ashtu siç theksuam, mbetet detyrim paga e zakonshme për kohën që të mbjellat qëndrojnë në parcelën në fjalë.

Uzurpuesi, në këtë tokë hap një pus dhe, kur pronari kërkon kthimin e tokës, uzurpuesi i vë qëllim vetes ta mbyllë pusin dhe t'i kthejë atij tokën, ashtu siç ishte më përpara. A ka të drejtë pronari të ndalojë uzurpuesin që të mos e mbyllë pusin dhe ta lërë pusin ashtu siç është?

Përgjigje: Është e kuptueshme që pronari i tokës e ka këtë të drejtë, sepse mbyllja e pusit kërkon që të veprohet mbi pronën e tjetrit, mirëpo askujt nuk i lejohet të veprojë mbi pronën e tjetrit pa lejen e të zotit të asaj prone. Gjithashtu, është e kuptueshme se, kur dëmtohet një njeri për shkak të pusit, në këtë gjendje, rrëmbyesi që hapi pusin, nuk mban më asnjë përgjegjësi.

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Pronari i tokës ka të drejtë ta ndalojë uzurpuesin që ai ta mbyllë pusin, megjithëkëtë garantimi mbetet detyrim mbi uzurpuesin, në rast se ndodh ndonjë gjë për shkak të hapjes së pusit, sepse hapja e pusit ishte sulm nga ana e uzurpuesit mbi pronën e tjetrit. Mirëpo sulmi mbi pronën e tjetrit është shkaku për garantimin."

Konstatohet se ky "sulm" mbi pronën mund të hiqet, kur merret miratimi i pronarit që pusi të qëndrojë ashtu siç është. Bazuar mbi këtë miratim, nga ana e pronarit, hiqet edhe përgjegjësia prej uzurpuesit. Kjo është plotësisht sikur pronari e ka hapur vetë pusin. Personalisht, në asnjë rast nuk e mendoj bashkimin ndërmjet ndalimit të uzurpuesit për mbylljen e pusit, si masë ruajtëse për mos të humbur garantimin dhe mes mbetjes së garantimit.

I ngjashmi dhe i vlerësuari me çmim

Në radhë të parë dhe para çdo gjëje, është detyrim kthimi i sendit të rrëmbyer, nëse është i pamundur të bëhet kthimi i sendit, sepse është asgjësuar ose është prishur, ose për shkak se ka humbur, atëherë është detyrim të kthehet një i ngjashëm. Nëse nuk gjendet një i ngjashëm me sendin e uzurpuar, ose ishte, por është ndërprerë dhe të ngjashëm nuk gjendet deri në afatin e mbajtjes së besës, atëherë është detyrim kthimi i çmimit. Në radhë të parë, synohet kthimi i vetë sendit, patjetër brenda mundësisë, ndryshe kthehet një i ngjashëm me sendin e uzurpuar, patjetër brenda mundësisë, ndryshe kthehet çmimi.

Me fjalën e përbashkët të fukahave, kjo renditje është detyrim. Për sa i përket detyrimit për t'i kthyer pronarit vetë sendin, siç u tha, brenda mundësisë, ai detyrim është parësor, sepse sendi është pronë e pronarit, prandaj edhe çështja matet me këtë rregull, kurse detyrimi për kthimin e një të ngjashmi, kur nuk është mundësia për kthimin e vetë sendit, mbetet detyrim, sepse i ngjashmi është i barabartë me sendin në lloj e në cilësi, por edhe

kompensimi me para është veprimi më i drejtë, sepse e largon dëmtimin sa më shumë.

Pikërisht për këtë tregon fjala e Allahut të Lartësuar:

"فَمَنِ اعْتَدَى عَلَيْكُمْ فَاعْتَدُوا عَلَيْهِ بِمِثْلِ مَا اعْتَدَى عَلَيْكُمْ"

"...dhe kush ndërmerr sulm kundër jush, edhe ju t'i përgjigjeni sulmit të tyre me të njëjtën masë..." (Sure "El Bekare", ajeti 194)

"وَجَزَآءُ سَيِّئَةٍ سَيِّئَةٌ مِّثْلُهَا"

"Dënimi i së keqes është me një të keqe të ngjashme..." (Sure "Esh Shurà", ajeti 40)

"وَإِنْ عَاقَبْتُمْ فَعَاقِبُوا بِمِثْلِ مَا عُوقِبْتُم بِهِ ۖ"

"Në qoftë se dënoni, dënoni me të njëjtën masë që jeni dënuar edhe ju..." (Sure "En Nahl", ajeti 126)

Për sa i përket detyrimit për dhënien e çmimit, kur është mundësia për të kthyer një të ngjashëm, duhet të thuhet se kjo është rruga e vetme për të mbajtur besën për sendin që ke detyrim të kthesh, si dhe për të shpëtuar prej përgjegjësisë.

Tani ka mbetur të njohim se ç'do të thotë i ngjashëm dhe i vlerësuar me çmim.

I ngjashëm është kur pjesët e sendit janë të barabarta me llojin, cilësitë, efektet dhe çmimin, në atë mënyrë që, kur pjesët përzihen, është e pamundur të dallohen njëra nga tjetra, si për shembull, kokrrat e të lashtave dhe monedhat e të njëjtës prerje.

I vlerësuari me çmim, janë sendet që nuk mund të futen në grupin e ngjashëm, siç janë: toka, pema, shtëpia, kafsha e të tjera që nuk ka të ngjashëm si ai send në asnjërën anë.

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Qëllimi i përdorimit të fjalës "i ngjashëm", në fjalën e fukahave, është të tregojë sendin për të cilin ka të ngjashëm, në kuptimin që ai send është i barabartë në të gjithë pasurinë e tij dhe që hyn në pronësi të tij, domethënë është i ngjashëm me sendin e tij, me cilësitë e qenësishme dhe me cilësitë e ardhura, kurse sendet e tjera, jo i ngjashëm, është send i vlerësuar me çmim."

Duhet të theksohet se, kur gjendet i ngjashëm, për uzurpuesin është detyrim të kthejë të ngjashmin, sado i lartë të jetë çmimi i këtij të ngjashmi, madje edhe sikur të jetë disa herë më shumë nga sa ishte sendi ditën kur ai e uzurpoi. Gjithashtu, edhe pronari është i detyruar të pranojë të ngjashmin dhe nuk ka të drejtë të kërkojë çmimin, edhe sikur çmimi i atij sendi të ketë rënë disa herë më pak.

Kur është e pamundur të gjendet i ngjashëm, megjithëse në kohën e uzurpimit e të prishjes, sendi i ngjashëm gjendej, por më pas është ndërprerë dhe uzurpuesi nuk ka fuqi të gjejë të ngjashëm në kohën kur ia kërkon pronari, nëse çështja shtrohet kështu, atëherë detyrimi për të ngjashmin bie për uzurpuesin dhe për atë mbetet detyrim të paguajë çmimin, sepse, në këtë gjendje, ai detyrohet me një detyrim që nuk ka mundësi të kryejë, përveç faktit që në këtë rast janë së bashku dy të drejta., Por, a merret në konsideratë çmimi me të cilin vlerësohet i ngjashmi ditën e uzurpimit, apo vlerësohet me çmimin që sendi kishte ditën, kur është prishur ose është asgjësuar, ose me çmimin që ai send kishte

ditën, kur është marrë në dorë, apo sendi do të vlerësohet me çmimin më të lartë?

Fukahatë ndajnë një mendim të përbashkët me dëshminë e autorit të librit "El Xheuahir", i cili thotë se ai paguan me çmimin e zakonshëm të tregut në kohën e marrjes në dorë dhe të shlyerjes, kur sendi i ngjashëm është në mirëbesim. Në këtë gjendje, merret në konsideratë çmimi në çastin e mbajtjes së besës dhe të shkarkimit prej përgjegjësisë, plotësisht ashtu sikur ai të kërkonte borxh një send të ngjashëm, por më pas i ngjashmi humb, atëherë ai paguan çmimin që ka sendi në kohën e shlyerjes.

Kur i ngjashmi si pasuri bie që në bazë, pasi më parë, në kohën e uzurpimit, ishte prej pasurive, në këtë gjendje, uzurpuesi nuk ka të drejtë ta detyrojë pronarin të marrë të ngjashmin. Në të kundërt, pronari ka të drejtë ta detyrojë uzurpuesin të paguajë çmimin, plotësisht sikur të ishte e pamundur të gjendej i ngjashmi, por uzurpuesi e paguan me çmimin që i ngjashmi bie si detyrim pasuror dhe jo ditën e marrjes në dorë e të mbajtjes së besës për shlyerjen, sepse sendi i marrë në mirëbesim vlerësohet me çmim pikërisht ditën kur bie si detyrim, ashtu siç veprohej edhe në rastin, kur sendi prishet, ose asgjësohet.

Kjo është zgjidhja e çështjes, kur sendi i rrëmbyer ishte i ngjashëm, por, kur është send që vlerësohet me çmim, si për shembull, kafshë e të ngjashme me kafshën, uzurpuesi ka detyrim të paguajë me çmimin që kishte sendi i uzurpuar ditën e prishjes dhe me çmimin që ai send mund të ketë pas kësaj dite, edhe nëse koha zgjatet, sepse dita e prishjes, ose dita e asgjësimit dhe koha në të cilën përgjegjësia shkarkohet, është me pagimin e çmimit.

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Më e fuqishme është detyrimi për pagimin e çmimit në kohën e prishjes ose në kohën e asgjësimit të sendit, ashtu siç janë shprehur edhe Fadili, Esh Shehijd, Es Seburiu, El Kerkij dhe El Erdebilij. Madje kjo tregohet edhe prej El Kadijit, si dhe në "Ed Durrus" dhe në librin "Err Reeudah", duke e atashuar këtë thënie në shumicën e fukahave, sepse kjo është koha e transferimit të çmimit, ndryshe, me fjalën e përbashkët të fukahave, para kësaj kohe ai është i detyruar ta kthejë vetë sendin pa garantim, për shkak se sendi i mungon tregut."

Një grup fukahash kanë thënë se uzurpuesi paguan çmimin më të lartë që prej kohës së uzurpimit, si dënim për sulmin që ai bëri mbi pasurinë e tjetrit.

Konstatohet se këtu nuk kemi të bëjmë fare me miratim, sepse Allahu i Lartësuar, më parë ka bërë dënimin e rëndë për kriminelët dhe nuk janë njerëzit ata që e kanë vënë këtë dënim.

Përveç kësaj që u tha, këtu duhet të shtohet edhe fakti se fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se çmimi i tregut nuk garantohet, kur ekziston sendi, pavarësisht sa i lartë mund të jetë çmimi. Fjala e përbashkët e fukahave për këtë çështje është që garantimi të mos bëhet me çmimin më të lartë nga sa ishte çmimi i atij sendi në kohën e uzurpimit, në atë mënyrë që sendi i rrëmbyer ka mbetur ashtu siç ishte në gjendjen e tij para uzurpimit.

Kur sendi i uzurpuar gjendet, pasi më parë kishte humbur dhe për këtë pronari ka marrë kompensim prej uzurpuesit, sendi i uzurpuar i kthehet pronarit dhe pronari i kthen uzurpuesit kompensimin.

Çështje

1- Kur ai uzurpon një vakëf publik, si: xhami, varrezë ose rrugë, uzurpuesi duhet të heqë dorë menjëherë prej atij vakëfi. Por nëse vakëfi i uzurpuar asgjësohet në dorën e uzurpuesit, për këtë vakëf të uzurpuar ai nuk garanton, gjithashtu, ai nuk garanton as kur përvetëson dobinë e ardhur prej vakëfit të uzurpuar, sepse vakëfi publik s'ka pronar dhe, si i tillë, ai s'ka të drejtë tjetër veç të drejtës publike.

Për rrjedhojë, dënimi për këtë të drejtë është dënim moral dhe jo dënim material. Nëse vakëfi është në formë private, si për shembull, mesxhidet, librat e Kuranit dhe të tjera të ngjashme, dispozita për vakëfin e formës private është si dispozita e pronës private, domethënë që garantohet sendi i uzurpuar dhe dobia e dalë prej sendit.

2- Kur sendi i uzurpuar përzihet me një send tjetër, i cili mundëson ndarjen e sendit të uzurpuar, si për shembull, gruri që ai ka uzurpuar e përzien me elb. Në këtë gjendje, uzurpuesi ka detyrim të ndajë grurin prej elbit dhe pastaj t'ia kthejë pronarit, edhe sikur kjo ndarje të kërkojë shpenzim të madh, sepse ishte uzurpuesi ai që riskoi me përzgjedhjen e tij të kryejë uzurpimin.

Kur uzurpuesi e përzien sendin e uzurpuar me një send tjetër nga i cili është e pamundur ndarja, si për shembull, ai përzien vajin e rrëmbyer me vaj tjetër, ose vajin e përzien me një yndyrë të shkrirë që ka çmim, në atë mënyrë që këto dy përzierje bëhen një, ata janë të dy pronarë të këtyre. Në qoftë se i uzurpuari dhe i përzieri kanë çmim të barabartë, vlerësimi bëhet me anë të sasisë dhe numërimit, sipas raportit që ka secili prej dy

elementeve. Nëse kanë diferencë në çmim, vlerësimi bëhet për secilin element, në bazë të cilësive ashtu siç janë si total.

3- Kur sendi i uzurpuar në vendin ku ka ndodhur uzurpimi, kushton dhjetë lira dhe më pas uzurpuesi udhëton në një send tjetër, ku sendi i uzurpuar kushton njëzet lira, por në këtë vend, ai send prishet dhe nuk prishet në vendin ku u uzurpua, në këtë gjendje, mbi uzurpuesin është detyrim të paguajë dhjetë apo njëzet?

Përgjigje: Ai paguan njëzet, sepse vendi i prishjes dhe koha e prishjes i japin të drejtë opsionit për njëzet.

4- Kush thyen një mjet jo të respektuar, si për shembull, mjete bixhozi e mjete të lokaleve për argëtim, ose ai thyen enë prej floriri e prej argjendi, në atë mënyrë që forma është asgjësuar, por mbetet lënda, për këtë thyerësi nuk ka detyrim të bëjë garantimin, sepse supozohet që ai send nuk është i respektuar, me përjashtim të rastit kur ai send është pronë e dikujt që i takon një grupi njerëzish, të cilët këto sende i kanë të lejuara. Nëse lënda asgjësohet tërësisht, në këtë gjendje, prishësi ose asgjësuesi ka detyrim të paguajë kompensimin, në qoftë se për atë send sipas zakonit ka çmim.

5- Kur uzurpuesi uzurpon tekun e një gjëje që është plotësues për tekun tjetër, si për shembull, këpucët, por më pas teku i uzurpuar prishet në dorën e uzurpuesit. Në këtë gjendje, uzurpuesi garanton jo vetëm për tekun që u prish në dorën e tij, por paguan edhe për tekun tjetër. Në qoftë se supozohet që pala e këpucëve kushton dhjetë lira dhe teku kushton vetëm dy lira, uzurpuesi ka detyrim të paguajë tetë lira.

6- Kur muri rrëzohet mbi rrugë, ose në pronën e komshiut dhe gjatë shembjes vret një njeri, ose prish një mall, në këtë

gjendje, shikohet: Në qoftë se i zoti i murit është prej atyre që lënë punën mangët, si për shembull, ka ndërtuar murin pa themel, ose ka lënë mangët materialet e duhura të ndërtimit, ose e ka parë që muri është anuar dhe është çarë, megjithëkëtë nuk i ka kushtuar kujdes që ta riparojë, domethënë kur tradita e zakoni e shikojnë atë si shkak për atë çka ndodhi, ai ka detyrim të bëjë garantimin. Nëse tradita nuk e shikon si shkak e as prej atyre që lënë mangët me qëllim, në këtë gjendjen e dytë, ai nuk ka asnjë detyrim, sepse mbase muri është rrëzuar menjëherë, në atë mënyrë që nuk llogaritet se do të rrëzohej. Në këtë gjendje, mbi të zotin e murit nuk rëndon asnjë detyrim.

Konflikti

1- Nëse uzurpuesi thotë: "Sendi i uzurpuar, që u prish, kushton pesë." Pronari thotë: "Jo, kushton dhjetë." Merret në konsideratë fjala e uzurpuesit, krahas betimit që ai bën, sepse origjina është të mos ketë shtesë. Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Kjo është e ngjashme me bazat e medh'hebit e me rregullat e tij, ndër të cilat është baza e përgjegjësisë, duke vënë në konsideratë se ai ka detyrim të paguajë."

2- Nëse uzurpuesi thotë se sendi i uzurpuar u prish dhe unë kam detyrim kompensimin për atë send dhe jo kthimin e sendit. Pronari thotë: "Jo, sendi vazhdon të jetë dhe ti ke detyrim të më kthesh sendin tim." Në këtë gjendje, merret në konsideratë fjala e uzurpuesit, krahas betimit që ai bën, kurse pronari ka detyrë të sjellë argumentin.

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Në këtë unë nuk gjej asnjë kundërshtim, duke ditur që fjala e tij është në kundërshtim me

bazën e ekzistencës së sendit, sepse, nëse nuk do të pranohej fjala e tij, do të duhej që ai të mbahej në burgim të përjetshëm, bazuar mbi supozimin se ai thotë të vërtetën, por për atë nuk ka argument."

3- Nëse uzurpuesi thotë: "E ktheva sendin e uzurpuar.", ose "Ktheva një zëvendësues të atij sendi." Pronari e mohon fjalën e uzurpuesit. Në këtë gjendje, merret në konsideratë fjala e pronarit, krahas betimit të tij, sepse baza është moskthimi i sendit, derisa të vërtetohet e kundërta.

Pyetje: Nëse këtu do t'i jepej përparësi pronarit, prej tij do të bëhej e detyrueshme burgimi i përjetshëm për uzurpuesin, bazuar në supozimin e sinqeritetit të tij, megjithëse ai nuk ka argument, pra, jemi në një gjendje të njëjtë me gjendjen kur ai pretendon prishjen ose asgjësimin e sendit.

Autori i librit "Miftahul Kerameh" është përgjigjur se uzurpuesi, në pretendimin e tij për prishjen e sendit, vërteton detyrimin e tij për të sjellë zëvendësuesin, kurse pretendimi për kthimin e sendit do të thotë rrëzim i të drejtës që ai pretendon për veten e tij. Këtu qëndron edhe dallimi mes dy burimeve.

4- Nëse uzurpuesi pretendon se sendi i uzurpuar është me të meta, si për shembull, kafsha nuk ka njërin sy, etj. Pronari e mohon. Në këtë gjendje, merret në konsideratë fjala e pronarit, krahas betimit të tij, kurse uzurpuesi është i detyruar të sjellë argument, sepse baza është që sendi të mos ketë asgjë prej të metave natyrale, derisa të vërtetohet e kundërta.

* * *

PREMTIMI (nedhr), BETIMI DHE BESËDHËNIA

Premtimi

Fjala "premtim", në tekstin arabisht është "nedhr" dhe do të thotë premtim, e taksur për t'U bërë, ose për të mos e bërë një punë. Në ligjin e fesë, ka kuptimin kur njeriu vendos të bëjë, ose të lërë një punë tjetër për hir të Allahut. Bazë për ligjërimin e premtimit është fjala e përbashkët e fukahave, Libri i Allahut dhe Suneti (praktika e Profetit).

Prej Librit të Allahut kemi ajetet:

" إِذْ قَالَتِ امْرَأَةُ عِمْرَانَ رَبِّ إِنِّي نَذَرْتُ لَكَ مَا فِي بَطْنِي مُحَرَّراً"

"Dhe kur gruaja e Imranit tha: 'O Zoti im, këtë që kam në barkun tim vendosa ta kushtoj në shërbimin Tënd..." (Sure "Al Imran", ajeti 35)

" فَقُولِي إِنِّي نَذَرْتُ لِلرَّحْمَنِ صَوْماً"

"...dhe u thuaj atyre: "Kam vendosur të hesht për hir të Mëshirëmadhit..." (Sure "Merjem", ajeti 26)

"وَمَآ أَنْفَقْتُم مِّن نَّفَقَةٍ أَوْ نَذَرْتُم مِّن نَّذْرٍ فَإِنَّ اللَّهَ يَعْلَمُهُ"

"Ç'keni dhënë prej pasurisë ose premtimin që keni mbajtur, Allahu ka dijeni për ato..." (Sure "El Bekare", ajeti 270)

"وَلْيُوفُوا نُذُورَهُمْ"

"...dhe le të zbatojnë premtimet e tyre..." (Sure "El Haxh'xh", ajeti 29)

Prej të Dërguarit të Allahut *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)* transmetohet: "Kush premton se do të jetë i bindur ndaj Allahut, le t'i bindet Atij dhe, kur premton se do të kundërshtojë urdhrin e Tij, le të mos e kundërshtojë."

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* është pyetur për një burrë që e ka taksur të shkojë në Haxh, në Shtëpinë e Allahut, duke ecur pa këpucë. Si duhet të veprojë ky burrë? Ai *(Paqja qoftë mbi të!)* është përgjigjur: "Le të ecë dhe, kur të lodhet, le të hipë."

Kushtet

Kushtet për vlefshmërinë e premtimit, për taksjen e një veprimi, janë:

1- Me fjalën e përbashkët të fukahave dhe me tekst, premtimi i shprehur me fjalë për taksjen duhet të jetë së bashku me përmendjen e Allahut të Gjithëpushtetshëm, në atë mënyrë që

premtimi për të taksurën, të jetë sinqerisht vetëm për hir të Allahut, si për shembull, ai thotë: "Është detyrim për mua për hir të Allahut.", ose "E taksa për hir të Allahut."

Nuk mjafton vetëm kushti, pa përmendur edhe formulën, por nuk mjafton as formula, pa përmendur Allahun, ose njërin prej emrave të Tij të bukur, si për shembull, ai thotë: "Unë e kam taksur, nëse ata kthehen, patjetër unë do të bëj atë punë."

Prej teksteve kemi fjalën e Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*: "Premtimi nuk është asgjë, derisa ai të emërtojë me fjalën e tij se ai, për hir të Allahut, do të agjërojë, ose do të japë sadaka, ose do të presë kurban, ose do të shkojë në Haxh."

Është pyetur Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* për një burrë që betohet dhe ka taksur të bëjë një punë. Ai u betua me nijetin që të japë sadaka një dirhem ose më pak. A është i drejtë betimi i tij? Ai *(Paqja qoftë mbi të!)* është përgjigjur: "Në qoftë se ai nuk e bën për hir të Allahut, nuk është asgjë."

Nuk është domosdoshmëri të thuhet vetëm fjala "Allah", por është e mjaftueshme të përmendet çdo njëri prej emrave të bukur të Allahut, ose çdo njëra prej cilësive të Tij të larta, si për shembull: Krijuesi, Furnizuesi, Jetëdhënësi, Jetëmarrësi, etj. Gjithashtu, premtimi për të kryer një punë bëhet edhe me shkrim, krahas qëllimit, bëhet edhe me shenjë, kur ai nuk flet.

2- Premtuesi, ai që e taks të bëjë një punë, të jetë në moshë madhore, domethënë ka arritur moshën, kur obligohet me adhurimet e fesë, të jetë i mençur, di të zgjedhë dhe veprimin e bën me qëllim. Nuk ka premtim për kryerjen e një pune as prej

fëmijës, as prej të çmendurit dhe as prej atij që nuk vë qëllim premtimin, si humoristi.

Gjithashtu, nuk ka premtim për kryerjen e një pune as prej të zemëruarit, me kusht që zemërimi të ketë arritur deri në atë kufi sa nuk mund të flitet më për qëllim.

3- Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se premtimi për të kryer një punë nuk është i vlefshëm e as nuk bëhet, kur puna që ai ka taksur të kryejë, është punë e ndaluar ose ndonjë punë e papëlqyeshme (mekruh). Në kohën e të Dërguarit të Allahut *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)* dikush e kishte taksur të qëndronte më këmbë, të mos të rrinte ndenjur, të mos futej në hije, të mos fliste dhe të agjëronte.

I Dërguari i Allahut *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)* tha: "Urdhërojeni atë të flasë, të futet në hije, të qëndrojë ulur dhe le të plotësojë agjërimin e tij."

Kur premtimi për të kryer një punë nuk është lidhur që në themel, atëherë për atë që bën nijet premtimin dhe nuk e mban premtimin për të taksurën që tha, nuk ka detyrim të bëjë as shlyerjen për mosplotësimin e premtimit. Gjithashtu, fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se premtimi për të kryer një punë është i vlefshëm, kur bëhet për ndonjë punë që është detyrë të bëhet, ose është punë e preferuar të kryhet.

Por fukahatë kanë kundërshtime mes tyre, në lidhjen me punën e barabartë nga të dyja anët, nëse bëhet premtim për një punë të tillë. Fukahatë më në zë kanë shkuar me dëshminë e autorit të librit "El Xheuahir" dhe të librit "El Mesalik" për mosbërjen e premtimit, bazuar në transmetimin e mësipërm:

"Premtimi për kryerjen e një pune, nuk është asgjë, derisa ai të thotë se atë punë e bëj për hir të Allahut."

4- Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët për vlefshmërinë e premtimit për kryerjen e një pune, kur formula e premtimit është së bashku me kryerjen e asaj pune, ose me lënien e saj, si për shembull, ai thotë: "Nëse ti i jep ushqim, për hir të Allahut, unë kam taksur të bëj atë punë, ose të lë atë punë."

Fukahatë kanë kundërshtim ndërmjet tyre, kur formula e premtimit nuk është e puqur, nuk është së bashku me ndonjë send, si për shembull, ai thotë: "Premtoj, për hir të Allahut, të bëj këtë."

Këtë premtim fukahatë e kanë emërtuar Premtim bamirësie. Fukahatë më të dëgjuar kanë shkuar me dëshminë e autorit të librit "El Xheuahir" për vlefshmërinë e këtij premtimi, sepse edhe argumentet e premtimit janë të pakushtëzuara, ashtu siç ishte fjala e Allahut të Lartësuar: "… këtë që kam në barkun tim, vendosa ta kushtoj në shërbimin Tënd…"

Siç shihet, këtu premtimi nuk është kushtëzuar me ndonjë send.

Pyetje: Ç'kuptim ka që njeriu të premtojë bërjen e një pune, të cilën ai e ka detyrë ta bëjë, edhe pa bërë premtimin?

Përgjigje: Rezultati del në shesh, sikur ai të mos e kryente detyrën, për rrjedhojë, ai do të duhej të bënte shlyerjen për moskryerjen e premtimit, duke shtuar edhe ndikimet e tjera që renditen për heqjen dorë nga kryerja e detyrimit që ai ka lënë.

5- Është mjaft e përhapur në mesin e fukahave të mëvonshëm, të mbështetur në dëshminë e autorit të librit "El

Mesalik", që gruaja nuk mund të bëjë premtim për të taksur ndonjë punë që nuk është detyrim pa lejen e burrit të saj, madje edhe kur ajo e ka taksur të japë sadaka prej pasurisë së saj. Nëse gruaja e ka bërë premtimin pa lejen e burrit, burri ka të drejtë të anulojë premtimin e gruas.

Për këtë çështje kemi fjalën e Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*: "Kur gruaja është me burrin, pa lejen e burrit, ajo s'ka të drejtë, që me pasurinë e saj, të lirojë një rob, ose të japë sadaka, ose të planifikojë ndonjë punë, as të dhurojë, ose të taksë të kryejë ndonjë veprim, me përjashtim kur me pasurinë e saj do të kryejë Haxh, ose për të dhënë zekatin, ose për t'i bërë ndonjë të mirë prindërve të saj, ose të afërmeve të saj."

Kur burri i jep leje gruas të premtojë kryerjen e ndonjë pune dhe ajo e bën premtimin, ky premtim është i vlefshëm dhe burri, pas lejimit, nuk ka të drejtë të tërhiqet nga lejimi që bëri.

Nj grup fukahash kanë thënë se s'ka premtim për djalin, kur është së bashku me babain e tij. Ata kanë pohuar se teksti është i posaçëm vetëm për betimin e djalit dhe jo për premtimin e tij, megjithëkëtë fukahatë edhe premtimin për të taksur bërjen e një veprimi, e kanë atashuar me betimin.

Vërehet se betimi, edhe nëse është krahas premtimit, ai e kundërshton premtimin në disa efekte dhe ndahet prej premtimit në më shumë se një anë. Prej këtyre anëve kemi nijetin për afrim te Allahu i Plotpushtetshëm, që është kusht për premtimin, por nuk është kusht për betimin. Kur themi kusht, kemi parasysh se, pa atë kusht, veprimi nuk është i vlefshëm. Dihet se Ehli Bejti *(Paqja e Allahut qoftë mbi ta!)*, në disa burime, e ka përdorur betimin për

premtimin, por përdorimi është më gjithëpërfshirës se e vërteta dhe alegoria.

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Betimi për premtimin që të kryhet një punë, nuk është si në shembullin e fjalës së Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*: "Tavafi në Shtëpinë e Allahut (në Qabe) është namaz, sepse në tekste s'ka asgjë që të tregojë se premtimi është betim, ashtu siç është e qartë."

Shlyerja për shkeljen e premtimit

Premtimi për kryerjen e një pune është i vlefshëm dhe më pas atë e shkel vetë ai që bëri premtimin. Si duhet të veprojë ky person?

Ai ka detyrim të bëjë shlyerjen për shkeljen e premtimit, por, nëse premtimi për kryerjen e asaj pune nuk është lidhur që në themel, si për shembull, ai premton të bëjë një veprim të cilin është më mirë të mos e bëjë, ose premton të heqë dorë prej një pune që është mirë të mos bëhet, në këtë gjendje, nuk ka premtim. Për rrjedhojë, ai s'ka as detyrë të bëjë shlyerje për shkeljen e premtimit që bëri.

Fukahatë kanë kundërshtim mes tyre në lidhje me llojin e shlyerjes për shkeljen e premtimit. Vetëkuptohet se ky kundërshtim i fukahave e ka bazën në transmetimet e ndryshme, ku ata janë mbështetur, prandaj një grup fukahash të dëgjuar, ndër të cilët edhe sej'jid El Hakijm në librin "Minàxhu Sàlihijn", janë shprehur se shlyerja për shkeljen e premtimit është e njëjtë me shlyerjen për thyerjen e betimit, domethënë është: lirimi i një

robi, ushqimi i dhjetë të varfërve, ose veshja e dhjetë të varfërve. Nëse nuk ka fuqi e mundësi për këto, agjëron tri ditë rresht.

Fukahatë më të dëgjuar kanë shkuar me dëshminë e autorit të librit "El Xheuahir", i cili është vetë njëri prej fukahave të shquar dhe kanë thënë se shlyerja për shkeljen e premtimit është si shlyerja për prishjen e agjërimit në Muajin e Ramazanit.

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* është pyetur për një burrë që e taks të mos ecë kaluar, kur është me ihram, mirëpo ai hipën mbi kafshë. Çfarë duhet të bëjë ky burrë? A duhet ta shlyejë shkeljen e premtimit? Ai *(Paqja qoftë mbi të!)* është përgjigjur: "Ai i jep lirinë një robi, ose agjëron dy muaj rresht, ose ushqen gjashtëdhjetë të varfër."

Betimi

Fjala "betim", nga ana gjuhësore, do të thotë që betuesi të betohet për cilin të dëshirojë, kurse në ligjin e fesë betimi bëhet vetëm në Allah e në emrat e Tij të bukur, për të bërë një punë, ose për të mos bërë një punë tjetër, në kohën e tashme, ose në të ardhmen, ose në njërën prej dy kohëve. Betimi është më mirë të mos bëhet, qoftë edhe kur është për një gjë të vërtetë, domethënë që betimi të bëhet vetëm në raste të domosdoshme. Është haram betimi i rremë, madje është haram i gradës më të rëndë dhe quhet Betim i rremë, ose Betim i mbytur, në kuptimin që betimi i rremë e zhyt në mëkate atë që betohet për gënjeshtrën.

Për fukahatë, betimi ka qenë objekt studimi në kapitullin e gjykimit dhe në ndarjen e armiqësive.

Betimi është i ligjëruar me fjalën e përbashkët të dijetarëve të fesë dhe me tekst. Në shumë ajete të Kuranit Famëlartë, Allahu i Lartësuar e urdhëron Profetin e tij të nderur *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)* të betohet.

Nga këto ajete të Kuranit kemi ajetin 53 të sures "Junus":

"وَيَسْتَنبِئُونَكَ أَحَقٌّ هُوَ ۖ قُلْ إِيْ وَرَبِّي إِنَّهُ لَحَقٌّ"

"Të kërkojnë të shpjegosh për ata, a është i vërtetë ai (dënimi), **thuaj: "Betohem në Zotim tim, po, patjetër që është i vërtetë..."**

Edhe ajeti 89 i sures "El Maide", që e nxit të ruajë besimin, qoftë edhe kundër atyre që thyejnë betimin dhe duke kundërshtuar mohuesit:

"لاَ يُؤَاخِذُكُمُ اللَّهُ بِاللَّغْوِ فِي أَيْمَانِكُمْ وَلَكِنْ يُؤَاخِذُكُمْ بِمَا عَقَّدتُّمُ الْأَيْمَانَ ۖ فَكَفَّارَتُهُ إِطْعَامُ عَشَرَةِ مَسَاكِينَ مِنْ أَوْسَطِ مَا تُطْعِمُونَ أَهْلِيكُمْ أَوْ كِسْوَتُهُمْ أَوْ تَحْرِيرُ رَقَبَةٍ ۖ فَمَن لَّمْ يَجِدْ فَصِيَامُ ثَلَاثَةِ أَيَّامٍ ۚ ذَٰلِكَ كَفَّارَةُ أَيْمَانِكُمْ إِذَا حَلَفْتُمْ ۚ وَاحْفَظُوا أَيْمَانَكُمْ ۚ"

"Allahu nuk ju dënon për betimet tuaja të paqëllimta, por ju dënon për betimet e qëllimta. Shlyerja për betimin (e shkelur) **është të ushqeni dhjetë të varfër me ushqim mesatar siç ushqeni familjet tuaja, ose duke i veshur ata, ose duke liruar një rob dhe, kush nuk ka mundësi për këto, le të agjërojë tri ditë; kjo është shlyerja kur ju thyeni betimet, prandaj ruani betimet tuaja..."**

Kushtet

Për betimin është kusht:

1- Betimi të jetë vetëm për Allahun e për emrat e Tij të bukur. Allahu nuk ka shok e ortak. Shembull emrash të Allahut: Mëshirëmadhi, Krijuesi, Furnizuesi, etj, (Err Rrahmànu, El Khàliku, Err Rrez'zàku).

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "Unë mendoj se burri betohet vetëm për Allahun."

Baba i tij, Imam Bakiri *(Paqja qoftë mbi të!)*, ka thënë: "Allahut i takon të betohet për kë të dëshiroje prej krijesave të Tij, kurse krijesat e Tij betohen vetëm për Allahun e Lartësuar."

Kjo nuk do të thotë se betimi në të tjera fjalë, përveç fjalës Allah është betim haram, por duhet të jetë e qartë se betimi me fjalë të tjera nuk mundëson renditjen e qartë të efekteve ligjore për të cilat flet ligji i fesë dhe plotësohet vetëm atëherë kur betimi bëhet me fjalën Allah.

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Rruga e formës së prerë, bazuar në origjinën e në ekzistencën e teksteve, tregon për lejimin e betimit jo vetëm me fjalën Allah."

Ky autor tregon për disa transmetime të cituara prej Imamëve të pastër, të cilët betoheshin për gjyshin e tyre, të Dërguarin më të madh *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)* nga lidhja që ata kishin me të.

2- Ai që betohet, duhet të ketë arritur moshën në të cilën detyrohet për kryerjen e adhurimeve të fesë, të ketë qëllim betimin

dhe të betohet me zgjedhjen e tij, plotësisht ashtu siç ishte edhe për zotimin për të plotësuar një punë që ai vetë e kishte marrë përsipër.

3- Merret në konsideratë vlefshmëria e betimit të djalit, kur ai betohet me lejen e babait të tij, ashtu siç merret në konsideratë vlefshmëria e gruas, kur është me lejen e burrit të saj dhe, kur leja që ai dha, nuk është në rivaliet me të drejtën e tij. Për këtë çështje kemi fjalën e Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*: "S'ka betim të djalit, kur është me babain e tij dhe as betim të gruas, kur është me burrin e saj."

Ky rregull vlen, kur betimi është për kryerjen e një pune që është detyrë të kryhet, ose për heqjen dorë prej një pune haram. Zotimi për kryerjen e një pune të marrë vullnetarisht mbi vete, ajo punë është e vlefshme, edhe kur burri e ndalon gruan e tij ta bëjë atë punë.

4- Betimi është i vlefshëm, kur bëhet për kryerjen e një pune farz, ose të një pune mustehab dhe nuk është i vlefshëm, kur bëhet për kryerjen një pune haram, ose të një pune mekruh, të papëlqyeshme.

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "Nuk lejohet betimi që bën hallall haramin ose betimi që bën haram hallallin, as betimi për të shkëputur lidhjet me njerëzit e gjakut."

Babai i Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*, Imam Bakiri *(Paqja qoftë mbi të!)*, është pyetur për një burrë që betohet me të madhe se nuk do të blejë asgjë për njerëzit e familjes së vet. A është i drejtë betimi i tij? Ai *(Paqja qoftë mbi të!)* është përgjigjur:

"Ai le të blejë për ata dhe mbi të nuk rëndon ndonjë detyrim për betimin që ka bërë."

Gjithashtu, është i vlefshëm betimi për kryerjen e një pune ose për heqjen dorë prej asaj pune, kur të dyja anët, domethënë, kryerja e asaj pune dhe heqja dorë prej saj janë të barabarta, ose kur nuk ka anim të peshores as prej heqjes dorë e as prej kryerjes se asaj pune. Po japim një shembull: Ai betohet për të mos ngrënë një lloj të caktuar zarzavati, por betimi i tij nuk është më i vlefshëm, kur mbi dy anët e peshores, domethënë në mos ngrënien dhe në ngrënien, ndodh një ndryshim, atëherë ai e ka të lejuar të hajë prej atij lloji dhe për këtë nuk ka detyrim të bëjë shlyerje për thyerjen e betimit, madje ai shpërblehet për mosmbajtjen e atij betimi.

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "S'ka kundërshtim e komplikim për mospasjen mëkat dhe për mospasjen detyrim shlyerjen, kur e kundërta e punës, për të cilën është bërë betimi, është më e mirë." Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* është pyetur për një burë që betohet, por e shikon se heqja dorë prej betimit është me e mirë. Si duhet të veprojë ky burrë? Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* është përgjigjur: "A nuk e ke dëgjuar fjalën e të Dërguarit të Allahut *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)*: "Kur shikon më të mirë se betimi yt, hiq dorë prej betimit."?"

Gjithashtu, ai ka thënë: "Kush betohet dhe shikon një punë më të mirë se puna për të cilën ai u betua dhe ai bën punën që është më e mirë, puna më e mirë që ai bëri, jo vetëm që është shlyerje për betimin, por është edhe një mirësi që i shkruhet bërësit."

Ka edhe shumë tekste të tjera që flasin për këtë çështje.

5- Burri, pas betimit, thotë: "Me lejen e Allahut!".

Po japim një shembull: "Betohem te Allahu se unë do ta kryej atë punë, me lejen e Allahut." Në këtë gjendje shikohet: Nëse ai ka qëllim lidhjen e vërtetë, domethënë që ka dashur mirësinë, duke përmendur Allahun, ashtu siç është në fjalën e Allahut të Lartësuar:

"وَلاَ تَقُولَنَّ لِشَيءٍ إِنِّي فَاعِلٌ ذَلِكَ غَداً إِلاَّ أَنْ يَشَاءَ اللَّهُ ۚ"

"Dhe kurrë mos thuaj për një punë se këtë unë do ta bëj nesër; vetëm (nëse shton) **në dashtë Allahu…"** (Sure "El Kehf", ajetet 23-24)

Kur çështja qëndron kështu, betimi është bërë dhe është detyrim plotësimi i betimit. Nëse betimi thyhet, atëherë bëhet detyrim shlyerja për thyerjen e betimit. Në qoftë se ai ka pasur qëllim varësinë e vërtetë, por jo mirësinë, ai betim nuk është bërë, për rrjedhojë, nuk ka vend të flitet as për thyerje betimi e as për shlyerje, duke u bazuar te hadithi: "Kush betohet dhe thotë: "Dashtë Allahu!", ai nuk e ka thyer betimin."

Autori i librit "El-Xhevahir" ka thënë: "Për këtë është fjala e përbashkët e fukahave."

Kur të gjitha këto kushte plotësohen, betimi është i vlefshëm. Kjo është e barabartë, qoftë kur ai, me betimin, kishte qëllim afrimin te Allahu, qoftë kur ka pasur ndonjë qëllim tjetër. Pikërisht këtu konstatohet edhe dallimi i veçantë, nga tërësia e dallimeve që e dallon betimin prej premtimit për të kryer një

punë, pasi premtimi për kryerjen e një pune, patjetër duhet të bëhet vetëm me nijetin për afrim te Allahu.

Është vendi të theksohet se betimi nuk bëhet për të divorcuar gruan, ose për të mos u martuar kurrë, ose për të mos marrë një grua të dytë, të tretë e të katërt, në një kohë kur është më mirë lënia e atij betimi. Kur të dy anët e veprimit, bërja e mosbërja e veprimit për të cilin u krye betimi, janë të barabarta, atëherë nuk ka më betim dhe lejohet të veprohet në kundërshtim me betimin e bërë. Nëse betohet dhe thotë: "Në të vërtetë, nuk kisha qëllim të betohem, atëherë merret për bazë fjala e tij, sepse thënia e tij është e veçantë vetëm për atë dhe nuk ka lidhje me të drejtën e ndonjë tjetri."

Betimi i pavlerë

Betimi që qarkullon në gjuhët e njerëzve dhe me të cilin ata e kanë zakon ta thonë në bisedat dhe në diskutimet e tyre, për këtë betim, në mënyrë absolute, nuk ka asnjë efekt. Autori i librit "Mexhmeul Bejan", në komentin e fjalës së Allahut të Lartësuar: "Allahu nuk ju dënon për betimet tuaja të paqëllimta…", ka thënë: "Qëllimi i përdorimit të fjalës "të paqëllimta" është të tregojë për betimet që zakonisht bëhen mes njerëzve, si për shembull, dikush thotë: "Jo, pasha Zotin!" Patjetër që ky nuk është betim për Allahun, derisa nuk ka të bëjë me prekjen e pasurisë së dikujt, ose me padrejtësinë që i bëhet një tjetri. Këto transmetime kanë ardhur prej dy imamëve, Imam Bakirit dhe Imam Sadikut (*Paqja Allahut qoftë për të dy!).*

Betimi i pafajësisë

Betimi i pafajësisë është kur personi që bën betimin, thotë se ai është i pafajshëm ndaj Allahut, ose ndaj të Dërguarit të Tij, ose ndaj familjes së të Dërguarit, ose ndaj fesë islame, nëse ai bën atë punë, ose nëse ai e ka bërë atë punë. Betimi nuk mund të bëhet me asnjërën prej këtyre fjalëve, madje është prej veprimeve haram të shkallës më të rëndë, domethënë është prej mëkateve më të rënda.

I Dërguari i Allahut dhe familja e tij kanë ngulmuar shumë për ndalimin e këtyre lloje betimesh. Në një hadith thuhet: "Kush thotë se ai është i pafajshëm ndaj fesë islame, nëse është gënjeshtar, ai është siç tha. Në qoftë se është i vërtetë, nuk numërohet i plotësuar në Islam."

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "Kushdo prej nesh që betohet për pafajësi, i sinqertë ose gënjeshtar qoftë, në të vërtetë, ai mban përgjegjësi." Kërkoj vetëm mbrojtjen e Allahut dhe vetëm Atij i kërkoj të më falë mëkatet.

Shlyerja për thyerjen e betimit

Fukahatë janë bashkuar me dëshminë e autorit të librit "El Xhevahir" dhe të librit "El Mesalik" që thyerësi i betimit ka të drejtën të përzgjedhë mes lirimit të një robi, ose ushqimin e dhjetë të varfërve, ose veshjen e tyre. Nëse nuk ka mundësi për këto përzgjedhje, atëherë agjëron tri ditë, ashtu siç urdhëron Allahu i Lartësuar: "Allahu nuk ju dënon për betimet tuaja të paqëllimta, por ju dënon për betimet e qëllimta dhe shlyerja për betimin (e

shkelur) është të ushqeni dhjetë të varfër me ushqim mesatar siç ushqeni familjet tuaja, ose duke i veshur ata, ose duke liruar një rob dhe, kush nuk ka mundësi për këto, le të agjërojë tri ditë…" (Sure "El Maide", ajeti 89)

Prej Ehli Bejtit *(Paqja e Allahut qoftë mbi ta!)* kanë ardhur shumë transmetime për kuptimin e këtij ajeti të nderuar të Kuranit Famëlartë.

Besëdhënia

Fjala e tekstit "ahdun, nga ana gjuhësore, ka shumë kuptime, ndër të cilat edhe "inspektim" e "ruajtje".

Në terminologjinë e fukahave do të thotë: Dhënia e besës Allahut, për të bërë ose për të mos bërë një punë. Allahu i Lartësuar ka urdhëruar mbajtjen e besës së dhënë dhe i ka lavdëruar ata që mbajnë besën me fjalën e Tij të nderuar:

" وَالْمُوفُونَ بِعَهْدِهِمْ إِذَا عَاهَدُوا"

"…dhe ata që mbajmë besën e dhënë, kur premtojnë…" (Sure "El Bekare", ajeti 177)

Fjala tjetër e Allahut të Lartësuar:

"مِنَ الْمُؤْمِنِيْنَ رِجَالٌ صَدَقُوا مَا عَاهَدُوا اللَّهَ عَلَيْهِ "

"Prej besimtarëve kishte burra që e vërtetuan besën e dhënë Allahut…" (Sure "El Ahzab", ajeti 23)

Besa është e vlefshme të jepet e pakushtëzuar: "I jap besën Allahut, ta bëj këtë punë." Gjithashtu, besëdhënia është e vlefshme, edhe kur është e varur me ndonjë kusht, si për shembull, kur ti thua: "Nëse ti ushqen një fëmijë, unë i jap besën Allahut ta bëj atë punë." Në këtë rast, kemi kushtëzimin e besëdhënies, plotësisht siç e kishim kushtëzimin, edhe në rastin e betimit. Besëdhënia është e vlefshme si në punët farz, ashtu edhe në punët mustehab. Gjithashtu, besëdhënia është e vlefshme edhe për punët e lejuara e të barabarta në të dyja anët, domethënë që është e barabartë, qoftë kur bëhen, qoftë kur nuk bëhen. Besëdhënia nuk është e vlefshme për kryerjen e punëve haram ose të punëve të papëlqyeshme (mekruh). Në lidhje me thyerjen e besës së dhënë vihen në konsideratë të njëjtat kushte që ishin për thyerjen e betimit.

Kur kundërshtimi i besëdhënies ka përparësi dhe është më e mirë për besëdhënien se mbajtja e besës, kjo besëdhënie prishet dhe besëdhënësi bën atë punë që është më me interes për të. Për këtë shkelje të besëdhënies, ai nuk ka detyrim të bëjë shlyerjen.

Shlyerja për shkeljen e besëdhënies

Fukahatë me të dëgjuar kanë shkuar me dëshminë e autorit të librit "El Xheuahir"se shlyerja për shkeljen e besës së dhënë është: lirimi i një robi, ose agjërimi dy muaj rresht, ose dhënia ushqim gjashtëdhjetë të varfërve.

Ndërmjet premtuesit, betuesit e besëdhënësit

Nga sa u tha më sipër, bëhet e qartë se premtuesi, besëdhënësi dhe betuesi kanë të përbashkët, njëri me tjetrin, faktin se çdo njëri prej tyre ka marrë mbi vete detyrim të bëjë një punë ose të mos e bëjë atë punë. Shkelësi i premtimit, i besës së dhënë ose i betimit, kur i ka pasur mundësitë ta plotësojë detyrimin e marrë mbi vete, ka detyrim të bëjë shlyerjen që kemi përmendur më sipër.

Besëdhënia dallon prej betimit e premtimit, sepse besëdhënia është një kontratë, ose e ngjashme me kontratën dhe si kontratë është e përbërë prej ofertës dhe pranimit, prandaj besëdhënësi e ka detyrim të mbajë besën që i ka dhënë Allahut dhe Allahu e pranon prej tij.

Betimi dhe premtimi kanë më shumë ngjashmëri me detyrimet, pasi këtu kemi të bëjmë vetëm me një palë. Por edhe premtimi dallon prej betimit në faktin se premtimi bëhet vetëm me nijetin për afrim te Allahu i Gjithëpushtetshëm, domethënë se nijeti për afrim është kusht vetëm për premtimin dhe nuk është për betimin.

* * *

SHLYERJET (el kefaratu)

Në raport me shkaqet, shlyerjet ndahen në disa kategori, të cilat po i tregojmë në mënyrë të shkurtuar së bashku me shkaqet që i bëjnë detyrim këto shlyerje:

1- Shlyerja për vrasjen e gjahut prej atij që është në Ihram

Më sipër është trajtuar, në mënyrë të hollësishme dhe pikërisht në pjesën e dytë të këtij libri, në kapitullin "Lëniet për shkak të Ihramit", në paragrafin "Shlyerja për vrasjen e gjahut". Nëse dëshironi, mund t'i referoheni këtij kapitulli.

2- Shlyerja, kur burri i thotë gruas së tij: "Të kam në vend të nënës!" (edh dhihàr)

Burri i thotë gruas së tij: "Ti për mua je në vend të nënës." Edhe pse gruaja është në periudhën e pastërtisë së saj, burri nuk kryen marrëdhënie me të, domethënë që ai, me fjalën e tij, e ka bërë marrëdhënien bashkëshortore sikur për të janë mbledhur të gjitha kushtet për divorc. Pra, ai është në gjendjen që e ka haram

të shkojë te gruaja e tij. Vërtet, pas kësaj fjale, ai nuk e ka më hallall gruan e tij. Nëse ai pendohet dhe dëshiron të afrohet me gruan e tij, ai mund të kryejë marrëdhënie me gruan e tij, vetëm pasi të bëjë shlyerjen për fjalën që i tha asaj. Shlyerja për fjalën e thënë është njëri prej tri veprimeve sipas kësaj renditje: i jep lirinë një robi. Nëse nuk e ka këtë mundësi, agjëron dy muaj rresht dhe, nëse nuk e ka as këtë mundësi, atëherë ushqen gjashtëdhjetë të varfër, ashtu siç urdhëron Allahu i Lartësuar me fjalën e tij:

"وَالَّذِيْنَ يُظَاهِرُونَ مِن نِّسَائِهِمْ ثُمَّ يَعُودُونَ لِمَا قَالُوا فَتَحْرِيْرُ رَقَبَةٍ مِّنْ قَبْلِ أَنْ يَتَمَاسَّا ۚ ذَلِكُمْ تُوعَظُونَ بِهِ ۚ وَاللَّهُ بِمَا تَعْمَلُونَ خَبِيرٌ. فَمَن لَّمْ يَجِدْ فَصِيَامُ شَهْرَيْنِ مُتَتَابِعَيْنِ مِنْ قَبْلِ أَن يَتَمَاسَّا ۖ فَمَن لَّمْ يَسْتَطِعْ فَإِطْعَامُ سِتِّيْنَ مِسْكِيناً"

"Ata që i krahasojnë (gratë e veta me nënat) **dhe u largohen grave të veta, pastaj tërhiqen nga ajo që kanë thënë, ata kanë detyrim të lirojnë një rob para se të kontaktojnë me to. Kjo është një dispozitë me të cilën porositeni. Allahu di me hollësi veprimet që ju bëni. Dhe kush nuk gjen** (rob për t'i dhënë lirinë)**, le të agjërojë dy muaj rresht para se të kontaktojë me gruan dhe, ai që nuk mundet, le të ushqejë gjashtëdhjetë të varfër…"** (Sure "El Muxhadile", ajetet 3-4)

3- Shlyerja për vrasjen gabimisht

Kush vret gabimisht një mysliman, pra, jo me qëllim, ai ka detyrim t'i paguajë familjes së të vrarit shumën e caktuar për derdhjen e gjakut, njëkohësisht të bëjë edhe shlyerjen, duke i dhënë lirinë një robi besimtar. Në qoftë se nuk ka mundësi për të liruar robin, ai ka detyrim të agjërojë dy muaj rresht dhe ai që s'ka

mundësi të agjërojë, atëherë ushqen gjashtëdhjetë të varfër, plotësisht ashtu siç ishte dispozita për shlyerjen, kur burri i thotë gruas: "Të kam në vend të nënës!"

Për vrasjen gabimisht, Allahu i Lartësuar urdhëron e thotë:

"وَمَنْ قَتَلَ مُؤْمِناً خَطَئاً فَتَحْرِيْرُ رَقَبَةٍ مُّؤْمِنَةٍ وَدِيَةٌ مُّسَلَّمَةٌ إِلَى أَهْلِهِ"

"Dhe kush vret gabimisht një besimtar, ai është i obliguar të lirojë një rob besimtar dhe shumën e gjakut ia dorëzon familjes së të vrarit..."

Në vijim të ajetit, Allahu i Lartësuar urdhëron:

"فَمَن لَّمْ يَجِدْ فَصِيَامُ شَهْرَيْنِ مُتَتَابِعَيْنِ"

"...dhe kush nuk gjen (rob që të t'i japë lirinë)**, ai le të agjërojë dy muaj rresht..."** (Sure "En Nnisa", ajeti 92)

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "Kur ai vret gabimisht një njeri, shumën për shlyerjen e gjakut ia jep njerëzve të afërm të të vrarit, pastaj i jep lirinë një robi dhe, nëse nuk gjen, atëherë agjëron dy muaj rresht. Nëse nuk ka fuqi të agjërojë, atëherë i jep ushqim gjashtëdhjetë të varfërve."

4- Shlyerja për vrasjen me qëllim

Kush vret me qëllim një mysliman, ai ka detyrim të bëjë të tri llojet e shlyerjeve, domethënë i jep lirinë një robi besimtar, agjëron dy muaj rresht dhe ushqen gjashtëdhjetë të varfër.

Me lejen e Allahut, hollësitë në lidhje me këtë çështje do të jepen në kapitullin "El Kisàsu"-"Dënimi për krimin e vrasjes".

5- Shlyerja për prishjen e agjërimit kaza të Ramazanit

Ai që bën nijet të agjërojë kaza ditët që nuk ka agjëruar në Muajin e Ramazanit, por ai e prish këtë agjërim kaza, duke ngrënë para se dielli të fillojë animin në kupën e qiellit, ai nuk ka asnjë detyrim përveç përsëritjes së kësaj dite. Nëse ai e prish agjërimin, pasi dielli ka filluar animin kah perëndimi, ai ka detyrim të bëjë shlyerjen, duke i dhënë ushqim dhjetë të varfërve dhe, nëse nuk e ka këtë mundësi, atëherë agjëron tri ditë rresht.

Imam Bakiri *(Paqja qoftë mbi të!)* është pyetur për një burrë që kontakton me gruan e vet gjatë ditës që është duke agjëruar kaza ditët që nuk ka agjëruar prej Ramazanit. Si duhet të veprojë ky burrë?

Imam Bakiri *(Paqja qoftë mbi të!)* është përgjigjur: "Nëse kjo i ka ndodhur para se dielli të fillojë animin, mbi të s'ka asnjë detyrim, përveçse të agjërojë një ditë tjetër, por, nëse i ka ndodhur, pasi dielli ka filluar animin kah perëndimi, ai ka detyrim t'u japë sadaka dhjetë të varfërve, duke i dhënë nga një "med" çdo të varfri. Nëse nuk ka mundësi për këtë, agjëron një ditë tjetër në vend të ditës që e prishi agjërimin kaza, agjëron edhe tri ditë të tjera si shlyerje për veprimin që bëri."

6- Shlyerja për prishjen e Ramazanit

Për këtë çështje kemi folur në pjesën e dytë të këtij libri, në kapitullin "Prishja e agjërimit dhe detyrimi për të kryer shlyerjen", në paragrafin "Shlyerja për prishjen e agjërimit të Ramazanit".

7- Shlyerja për shkeljen e premtimit

Shiko kapitullin "Premtimi, betimi dhe besëdhënia" të kësaj pjese, në paragrafin "Shlyerja për mosmbajtjen e premtimit".

8- Shlyerja për thyerjen e betimit

Shiko kapitullin e lartpërmendur, në paragrafin "Shlyerja për thyerjen e betimit".

9- Shlyerja për shkeljen e besëdhënies

Shiko në të njëjtin kapitull, në paragrafin "Shlyerja për mosmbajtjen e besës së dhënë".

10- Betimi për mosmbajtjen e përgjegjësisë

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët për qenien haram të betimit, për mosmbajtje përgjegjësie, ashtu siç u shpjegua në kapitullin e mëparshëm. Por fukahatë kanë kundërshtime mes

tyre, nëse është apo jo detyrim të bëhet shlyerje për këtë betim. Një grup fukahash, ndër të cilët edhe autorët e librave "Esh Sheràiu", "El Xheuahir" dhe "El Mesalik", kanë thënë se për atë që betohet për mosmbajtje përgjegjësie, nuk ka asnjë detyrim përveç mëkatit.

11- Gruaja qeth flokët e saj deri në rrënjë

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se për gruan është haram të qethë flokët e saj deri në rrënjë, por ata kanë kundërshtime mes tyre, nëse është detyrim apo jo shlyerja për këtë veprim. Një grup fukahash janë shprehur se gruaja e bën shlyerjen për qethjen e flokëve deri në rrënjë, duke i dhënë lirinë një robi, ose duke agjëruar dy muaj rresht, ose duke i dhënë ushqim gjashtëdhjetë të varfërve, bazuar në një transmetim të ardhur prej Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*.

Por Dëshmori i dytë (Shehijdu Thanij)[1], në librin "El Mesalik" dhe në librin "El Lum'ah", ka thënë se ky transmetim është i gradës "Daijf"-"Dobët", prandaj më e fuqishme është mosbërja detyrim e shlyerjes për gruan që qeth flokët deri në rrënjë, për shkak të origjinës së mosmbajtjes përgjegjësi.

[1] Shejkh Zejnudijn ibn Ali El Xhubaij el Amilij i njohur si Shehijdu Thanij (911-965 hixhrij)

12- Gruaja shkul flokët deri në rrënjë

Shkulja (depilimi) nuk është as qethje e as prerje, prandaj fukahatë kanë mendime të ndryshme në lidhje me detyrimin për kryerjen e shlyerjes për qethjen. Asnjë prej fukahave nuk është shprehur kundër detyrimit për shlyerjen që gruaja ka detyrim të bëjë për depilimin. Te fukahatë, shlyerja për depilimin është si shlyerja për thyerjen e betimit, domethënë: lirimi i një robi, ose dhënia ushqim gjashtëdhjetë të varfërve, ose veshja e gjashtëdhjetë të varfërve. Nëse nuk ka mundësi, agjëron tri ditë, bazuar në transmetimin e lartpërmendur, për të cilin u tha më lart.

Dëshmori i dytë e ka vënë në gradën "Daijf" në librat "El Mesalik" dhe "El Lum'ah".

13- Burri gris rrobat e tij

Fukahatë kanë thënë se burri që gris rrobat e tij, kur i vdes gruaja, ose fëmija, mbi të bëhet detyrim shlyerja për betimin. Por mbi burrin nuk rëndon asnjë detyrim, nëse ai gris rrobat për vdekjen e ndonjërit prej të afërmve, përveç gruas e fëmijës dhe, kjo, bazuar në transmetimin e lartpërmendur, të cilin Dëshmori i dytë (Shehijdu Thanij) e ka klasifikuar në gradën "Daijf" në librin "El Lum'ah" dhe në librin "El Mesalik".

14- Kryerja e marrëdhënieve intime me gruan, në periudhën e menstruacioneve

Shiko pjesën e dytë të këtij libri, kapitullin "Menstruacionet, metrarogjia dhe hemorragjia e lehonisë".

15- Agjërimi në Itikaf

Shiko pjesën e dytë të këtij libri, kapitullin "Itikafi", pikën e dytë të paragrafit "Çështje".

Agjërimi

Agjërimi për shlyerje është detyrë të bëhet pa shkëputje. Kjo është e barabartë, qoftë kur detyrimi është të agjërohet tri ditë, qoftë kur detyrimi është të agjërohet dy muaj. Nëse prishet vijueshmëria e agjërimit, para se të plotësohet numri i ditëve, atëherë është detyrim të rifillohet agjërimi nga e para. Është e kuptueshme se, kur agjërimi prishet për ndonjë shkak të justifikuar, në ligjin e fesë, nuk sjell ndonjë dëm në agjërimin detyrë, kur është ai është i detyruar ta prishë agjërimin. Po japim një shembull: E prish agjërimin për shkak të sëmundjes, ose për shkak të menstruacioneve, ose për shkak të hemorragjisë së lehonisë, ose për shkak të udhëtimit, pasi në udhëtim merret parasysh dëmi që mund të sjellë agjërimi në shëndetin e njeriut.

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* është pyetur për një burrë që kishte detyrim të agjëronte dy muaj rresht dhe ai agjëroi një muaj dhe pastaj u sëmur. Si duhet të veprojë ky burrë? Imam

Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* është përgjigjur: "Ai e rifillon agjërimin aty ku e la, sepse atë e ndaloi Allahu."

Pyetësi tha: "Një grua ka detyrim të agjërojë dy muaj rresht dhe ajo nuk agjëron gjatë ditëve që është me menstruacione. Çfarë duhet të bëjë kjo grua?" Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* është përgjigjur: "Ajo vazhdon agjërimin aty ku e ndërpreu dhe nuk ka detyrë ta rifillojë agjërimin nga e para."

Vijueshmëria e agjërimit dy muaj rresht realizohet duke agjëruar një muaj të plotë pa shkëputje dhe, pasi agjëron edhe një ditë prej muajit të dytë, atij i lejohet ta prishë agjërimin. Pas kësaj, me tekst e me fjalën e përbashkët të fukahave, ai ndan ditët e agjërimit. Prej teksteve kemi fjalën e Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*, i cili ka thënë: "Vijueshmëria është të agjërojë një muaj të plotë dhe një ditë prej muajit tjetër, ose dhe disa ditë prej muajit të dytë."

Ushqyerja

Ushqyerja e të varfërve realizohet me njërën prej dy veprimeve. Veprimi i parë: Fton njëherësh gjashtëdhjetë të varfër, ose i fton ata pjesë-pjesë, ose i fton njëri pas tjetrit dhe i ushqen, derisa të ngopen. Nuk ka dallim nëse të varfrit janë meshkuj apo femra, janë të mëdhenj apo janë të vegjël.

Veprimi i dytë: Çdo të varfri i jep nga një "med" grurë ose ushqim tjetër kokërr, duke mos i dhënë asnjërit më shumë se një "med". Nëse i jep më shumë, kjo sasi më shumë është dhënie e pëlqyeshme mbi detyrën, por edhe kjo shtesë të llogaritet në

sasinë e ushqimit për një të varfër. Pa dyshim që atij i lejohet t'i japë shtesë më shumë se një të varfri. Që është e mjaftueshme dhënia e një "med", tregon fjala e Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*: "Shlyerja e betimit është lirimi i një robi, ose ushqyerja e dhjetë të varfërve."

Ushqimi mesatar është bukë e zezë me uthull e me vaj dhe ushqimi më i lartë është bukë e bardhë me mish. Edhe sadakaja është një "med"[1] për çdo të varfër, kurse veshja është dhënia e dy rrobave.

Vlen të theksohet se vaji dhe uthulla, në kohën e Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)* konsiderofshin dhënie ushqimi mesatar dhe ishte në përputhje me ajetin: "…me ushqim mesatar, siç ushqeni familjet tuaja…"

Në ditët e sotme, uthulla e vaji nuk janë më ushqim mesatar, por janë ushqime shtojcë në ushqimet e tjera, prandaj ai që sot ka detyrim të bëjë shlyerje, duke ushqyer të varfrit, ka detyrim t'i japë të varfrit, përveç vajit e uthullës edhe ushqime që përdorin njerëzit zakonisht e që konsiderohen ushqim mesatar. Ushqimi mesatar ndryshon sipas vendeve të ndryshme dhe sipas mjediseve shoqërore.

Veshja

Disa transmetime e kufizojnë veshjen e detyrueshme në një rrobë të vetme për të varfrin. Disa transmetime të tjera e kufizojnë në dy rroba, domethënë që fjalët e fukahave ndryshojnë sipas

[1] "med"-i ligjor është diçka më shumë se 800 gr.

transmetimeve. Dikush prej fukahave ka thënë se mjafton një rrobë, një tjetër ka bërë detyrim veshjen e dy rrobave, një i tretë ka thënë se dhënia e një rrobe është farz, kurse dhënia e rrobës së dytë është mustehab. Një i katërt ka thënë se është farz që i varfri të vishet me dy rroba, kur veshësi ka mundësi dhe është e mjaftueshme një rrobë, kur veshësi nuk ka mundësi të japë dy rroba.

E vërteta që mësohet me realizimin e veshjes rezulton se, kur rroba është e madhe dhe mbulon trupin, si për shembull, xhybja e kaftani, mjafton edhe një rrobë e vetme, por, nëse trupi nuk mbulohet dot pa dy rroba, si për shembull, këmisha dhe pantallonat, patjetër që duhet të jepen dy rroba.

Me këtë shpjegim mundësohet bashkimi mes transmetimit për veshjen e të varfrit me një rrobë dhe transmetimit për veshjen e të varfrit me dy rroba.

Çështje

1- Nuk është detyrim që shlyerja të fillohet menjëherë, por lejohet që shlyerja të shtyhet e të vonohet, me përjashtim të rastit kur është frikë se shlyerja mund të mbetet pa u kryer. Argument për kryerjen e shlyerjes menjëherë nuk ka, për rrjedhojë edhe për bazën nuk ka argument, derisa të vërtetohet e kundërta.

2- Shlyerjet që kryhen me pasuri, si ushqyerja e veshja e të varfërve, është detyrë të merret prej bazës së trashëgimisë, pavarësisht nëse ka lënë porosi ose jo i vdekuri për kryerjen e shlyerjes, për më tepër kur ne e dimë se ai ishte i shqetësuar për

kryerjen e shlyerjes, me qëllim që të dilte nga përgjegjësia, domethënë që shlyerja për të vdekurin është plotësisht si të gjitha borxhet e tjera.

Për sa i përket shlyerjeve që kryhen fizikisht, si agjërimi, nëse i vdekuri ka lënë porosi, shuma e duhur nxirret prej një të tretës së trashëgimisë që ai ka lënë. Nëse ai nuk ka lënë porosi, atëherë nuk është detyrë që kjo shumë të nxirret prej trashëgimisë, edhe nëse dihet që ai ishte i shqetësuar për kryerjen e shlyerjes që dilte nga përgjegjësia.

3- Shlyerja nuk i jepet fëmijës e të çmendurit, kur ajo është miell ose ushqime kokërr, ose fruta, si për shembull, stafidhe e të tjera të ngjashme, për shkak se as fëmija e as i çmenduri nuk kanë aftësinë të japin e të marrin në pronësi, prandaj shlyerja i jepet kujdestarit të tyre. Kështu veprohet edhe për shlyerjet e tjera.

4- Shlyerja nuk u jepet personave për të cilët dhënësi e ka detyrë të shpenzojë, si për shembull: babait, nënës, fëmijëve e bashkëshortes. Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "Pesë personave nuk u jepet asgjë prej zekatit: babait, nënës, fëmijëve, robërve dhe bashkëshortes, sepse këta janë pjesëtarë të familjes për të cilët ai është i detyruar të shpenzojë."

Fjala e Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*: "ata janë pjesëtarë të familjes" është argument që tregon se pjesëtarëve të familjes nuk u jepet asgjë prej sadakasë, zekatit ose çdo lloj sadakaje, sepse ajo që u jep pjesëtarëve të familjes, vetvetiu rikthehet te ai dhe rezulton që ai i jep sadaka vetvetes.

5- Autori i librit "Esh Sheraiu" dhe i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Shlyerja nuk kryhet duke paguar çmimin, por patjetër

duhet të bëhet ushqyerja. Gjithashtu, shlyerja nuk mund të bëhet duke paguar çmimin e drithit, sepse përgjegjësia është e reduktuar vetëm me atë çka është saktësuar të kryhet dhe jo me çmimin, i cili, në mënyrë absolute, nuk renditet ndër shlyesit, ose të shkëputet një pjesë për shlyerjen e zekatit, ose për të tjera shlyerje, për faktin e thjeshtë se argumenti e tregon qartë rrugën e plotësimit të shlyerjes.

Nisur nga ky shpjegim, te ne nuk ka asnjë mendim ndryshe në lidhje me këtë çështje, madje në librin "El Mesalik", thuhet se kjo çështje ka fjalën e përbashkët të fukahave."

Në të vërtetë, lejohet që të varfrit t'i jepet çmimi, duke i vënë detyrë që me ato para ai të blejë për veten e tij sendet që ka nevojë. Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* është pyetur për sadakanë e fitrit (sadakaja që jepet para Bajramit të Ramazanit), nëse lejohet që kjo sadaka të shlyhet me para argjendi në shumën e çmimit të ushqimeve që jepen për sadakanë e fitrit. Ai tha: "Po, sepse kjo është më e dobishme për të varfrin, pasi ai ble ushqimet që dëshiron."

Fjala e Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)* "është më e dobishme për të, pasi ai ble ushqimet që dëshiron", është argument përgjithësues që përfshin të gjitha shlyerjet dhe nuk është argument i veçantë vetëm për zekatin, ashtu siç ka thënë edhe autori i librit "El Xheuahir".

6- Kushdo që ka detyrim të agjërojë dy muaj rresht, por nuk ka fuqi për këtë, atëherë, në vend të dy muajve, ai agjëron tetëmbëdhjetë ditë dhe për ditët e tjera jep sadaka një "med" ushqim për çdo ditë. Nëse edhe për këtë nuk ka mundësi, atëherë

i kërkon Allahut të Plotpushtetshëm faljen e mëkatit. Pastaj ai s'ka më asnjë detyrim. Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Duket qartë se fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët për zëvendësimin, kur nuk është mundësia të plotësohen cilësitë e shlyerjes, me përjashtim të shlyerjes për "dhiharin", kur burri i thotë gruas: "Të kam në vend të nënës!".

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "Kushdo që s'ka fuqi e mundësi të bëjë shlyerjen që ka detyrim, domethënë: agjërim, ose lirimin e një robi, ose sadaka për thyerjen e betimit, ose për shkeljen e premtimit, ose për vrasje, ose për të tjera veprime, për të cilat shkelësi ka detyrim shlyerjen, edhe kërkimi i faljes prej Allahut të Lartësuar, për atë është shlyerje, me përjashtim të shlyerjes për "dhiharin".

Është veçuar "dhihari", sepse kryerja e marrëdhënieve intime është hallall për atë burrë, vetëm pasi ai të bëjë shlyerjen, plotësisht ashtu si gruaja e divorcuar që është hallall vetëm pas kthimit të vërtetë.

* * *

NGJALLJA E TOKAVE TË VDEKURA

Toka

Te fukahatë "toka" është katër kategorish:

1- Tokë që e kanë çliruar myslimanët me forcë, si rezultat i luftës në rrugën e Allahut, "xhihàd"–"luftë për të mbrojtur Islamin, luftë për të mbrojtur vendin islam dhe luftë për përhapjen e Islamit". Të tilla toka qenë tokat e Irakut, të Sirisë e të Iranit. Të gjithë banorët që gjendeshin në ato toka, në kohën e çlirimit, ishin pronë e myslimanëve dhe ishin nën kujdesin e Imamit, domethënë të shtetit islam, i cili pranonte që këto toka të punoheshin prej banorëve vendas kundrejt gjysmës së prodhimit, ose më pak ose më shumë dhe prodhimi shpenzohej për punë publike.

Fukahatë kanë thënë se kjo kategori toke, domethënë tokë e banuar në kohën e çlirimit, nuk lejohet as të shitet, as të dhurohet, as të lihet vakëf e as të trashëgohet, sepse ajo është pronë e të gjithëve. Argumentin për këtë kategori toke, fukahatë e kanë nxjerrë prej fjalës së Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*: "Ai që shet tokën prej së cilës merret taksa e tokës, ajo tokë është pronë e të gjithë myslimanëve."

Por kjo është vetëm sentencë (fetva) teorike dhe me kaq mjafton. Personalisht nuk di që dikush të ketë punuar me këtë fetva, sepse njerëzit, të gjithë njerëzit, madje edhe fukahatë e trajtojnë atë që ka tokën prej së cilës merret taksa e tokës, ashtu siç trajtohet ai që e merr në pronësi tokën me anë të blerjes, ose ngaqë toka është lënë vakëf, ose e merr në pronësi me anë të trashëgimisë, ose me forma të tjera ligjore.

Gjithashtu, ata i orientojnë punët e tyre me shpjegime që nuk kanë të bëjnë me prirjen e shpirtit. Prej këtyre shpjegimeve është se pronari që e ka në dorë, gëzon një lloj të drejte dhe një lloj veçorie. Pikërisht, kjo e drejtë transferohet te një tjetër, por nuk transferohet vetë toka. Prej këtyre shpjegimeve rezulton se baza është që toka të jetë tokë "e vdekur", derisa të vërtetohet e kundërta.

Për sa i përket tokës që ishte "tokë e vdekur" në kohën e çlirimit të saj, ajo tokë i takonte Imamit – shtetit. Ai që e ringjall këtë tokë, ai ka më të drejtë se kushdo tjetër të veprojë me atë tokë, sipas rregullit të përgjithshëm: "Kush gjallëron një tokë të vdekur, ajo tokë i takon atij dhe ai ka më shumë të drejtë mbi atë tokë se të tjerët, sepse toka është e Allahut dhe e atij që e popullon atë tokë."

Vlen të theksohet se toka e banuar, nga natyra e saj, është pronë e shtetit. Për këtë çështje, Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "Çdo tokë që s'ka pronar, ajo tokë i takon Imamit - shtetit."

2- Toka, banorët e të cilës pranuan vullnetarisht Islamin, siç qenë banorët e Medines së nderuar, të Bahrejnit, banorët e krahinave të Jemenit dhe të Indonezisë, këto toka u takojnë

banorëve vendas dhe ata nuk kanë asnjë detyrim tjetër përveç zekatit. Lejohet shitja e këtyre tokave dhe veprimi me këto toka, me të gjitha llojet e veprimit, kurse "tokat e vdekura" prej kësaj kategorie i takojnë shtetit dhe, ai që e ka gjallëruar i pari atë tokë, ai ka më shumë të drejtë se të tjerët për atë tokë. Pra, kjo e drejtë është e njëjtë me drejtën për "tokat e vdekura", të çliruara me forcë në kohën e çlirimit.

3- Tokë në paqe, është toka e çliruar prej myslimanëve, pa luftë, por me anë të paqes së nënshkruar mes myslimanëve dhe mes banorëve të këtyre tokave, me kusht që kjo tokë të mbetet në pronësi të banorëve vendas, të cilët marrin prodhimin e atyre tokave kundrejt shpenzimeve që kanë bërë për tokat. Është detyrim mbajtja e besës për këto toka sipas kushteve të paqes. Tokat e banuara të kësaj kategorie janë pronë e banorëve vendas, të cilët veprojnë me ato toka si të dëshirojnë. Për sa u përket "tokave të vdekura" të kësaj kategorie, ato i takojnë shtetit dhe ai që i ka rigjallëruar i pari këto toka, ka më shumë të drejtë se të tjerët mbi ato toka.

4- Toka të marra pa luftë, ku përfshihen tokat që myslimanët i morën në pronësi pa luftë. Kjo është e barabartë, qoftë kur ato toka ishin të banuara dhe banorët i braktisën, qoftë kur myslimanët vullnetarisht u mundësuan atyre banorëve të qëndrojnë në tokat e tyre. Gjithashtu, në këtë kategori tokash përfshihet çdo "tokë e vdekur", qoftë kur vendi është çliruar me luftë, qoftë kur vendi është çliruar me marrëveshje paqe, ose kur banorët kanë pranuar thirrjen islame. Gjithashtu, në këtë kategori tokash përfshihen edhe ato toka që kishin pronarë, por, për faktorë të ndryshëm, janë asgjësuar, ose janë toka që s'kanë pasur kurrë pronarë, siç janë shkretëtirat dhe brigjet e deteve. Në këtë

kategori përfshihen majat e maleve, fundet e luginave dhe shkurret.

Të gjitha këto toka i takojnë Imamit – shtetit. Ajo që është për Imamin, u takon ndjekësve të Imamit. Për këtë çështje, kemi fjalën e Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*: "Ajo që është për ne, ajo është për ndjekësit tanë, të cilët e kanë hallall të veprojnë në të gjitha tokat që janë në dorën e tyre." Kjo çështje është trajtuar në mënyrë të detajuar në pjesën e dytë të këtij libri, në kapitullin "Një e pesta (El Khums)", në paragrafin "Pasuritë e marra pa luftë".

Toka e vdekur dhe gjallërimi i saj

Koncepti "tokë e vdekur" nënkupton tokën që nuk e ka në pronësi kurrkush dhe askush nuk ka të drejtën mbi atë tokë. Gjithashtu, prej asaj toke nuk përfiton askush, sepse uji nuk arrin deri te ajo tokë, ose për shkak se toka është e përmbytur prej inondatave, ose për shkak se dheu i asaj toke është i papërshtatshëm për të mbjellat, ose për shkak të pengesave të tjera, si për shembull, është tokë gurishtë, ose në atë tokë ka shkëmbinj e ferra, ose edhe të tjera pengesa, që nuk lejojnë të përfitohet prej asaj toke.

Me këtë shpjegim gjejmë edhe komentin e fukahave: "Tokë e vdekur është toka e zhveshur prej veçantive të tokës, prej së cilës nuk mund të përfitohet, ose ajo tokë është e papërdorshme për shkak se i është ndërprerë uji, ose atë e ka përmbytur uji, ose toka është e mbuluar me kallama, ose me të tjera elemente që pengojnë të përfitohet prej saj.

Gjallërimi i tokave të kësaj kategorie kërkon punë e shpenzime, derisa të zhduket shkaku që nuk lejon të përfitohet prej saj, prandaj ai që e gjallëron këtë tokë, ka më të drejtë se të tjerët mbi të, sipas hadithit të të Dërguarit të Allahut *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)*, i cili ka thënë: "Kush ngjall një tokë të vdekur, ajo tokë i takon atij dhe ai ka më të drejtë për atë tokë."

Për këtë çështje kemi edhe fjalën e Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*: "Njerëzit që gjallërojnë një tokë, ose e popullojnë atë, kanë më të drejtë se kushdo tjetër për atë tokë dhe ajo është tokë e tyre."

Për këtë nuk ka dallim, nëse kjo "tokë e vdekur" është në kategorinë e tokave të çliruara me forcë, ose banorët e asaj toke kanë pranuar vullnetarisht Islamin, ose banorët e asaj toke kanë nënshkruar paqe me myslimanët, ose ajo është prej pasurive të marra pa luftë.

Gjithashtu, nuk ka dallim, nëse gjallëruesi i tokës është mysliman ose nuk është mysliman.

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* është pyetur për blerjen e një toke prej jomyslimanëve që jetojnë nën shtetin islam. A është veprim i gabuar blerja e kësaj toke?

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* është përgjigjur: "S'ka problem të blihet prej tyre, kur ata e popullojnë atë tokë dhe, kur ata e kanë gjallëruar atë tokë, ajo tokë u takon atyre."

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Në lidhje me ato që kemi përmendur për "tokat e vdekura", s'ka dallim, nëse ato janë

në vendet islame, ose në vende të tjera, sepse argumentet janë përgjithësuese. Gjithashtu, nuk ka dallim mes jomyslimanit që jeton nën shtetin islam dhe mes një tjetri prej llojeve të mohuesve.

Për sa i përket tokës së populluar, ajo tokë është pronë e atij që e ka në dorë, mysliman ose jomysliman qoftë ai dhe askujt nuk i lejohet ta kundërshtojë këtë pronar, me përjashtim të rastit kur mësohet se ai është rrëmbyes.

Kushtet

Asnjë nuk e zotëron të drejtën e veprimit me tokën me anë të ringjalljes, pa kushte, të cilat renditen pas qëllimit dhe nijetit për gjallërimin e saj:

1- Largimi i dorës së tjetrit prej asaj toke që ke qëllim të ringjallësh, sepse dora është shenjë e pronësisë, derisa të vërtetohet e kundërta, domethënë, kur mësohet dhe vërtetohet se ajo dorë e ka atë tokë në pronësi pa ndonjë shkak ligjor.

2- "Toka e vdekur" të mos jetë e ndaluar, domethënë të mos jetë aneks i një parcele, ose e një pusi, ose e të tjera gjërave. Për tokat e ndaluara do të flitet në një paragraf të veçantë, sepse toka e ndaluar është në dispozitën e tokave të banuara, për të cilat do të flitet në mënyrë të veçantë në një paragraf të veçantë.

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Këtë e gjej pa asnjë kundërshtim, ashtu siç kanë pohuar disa prej fukahave. Madje në librin "Et Tedhkireh", ne nuk njohim të ketë kundërshtim ndërmjet dijetarëve të vendeve të ndryshme se çdo tokë që ka lidhje me interesa publike, si rrugë, ose burim uji të pijshëm, ose

kanal i ujërave të zeza, ose vendi i caktuar për hedhjen e mbeturinave, ose vendi i caktuar për hedhjen e dherave, ose vendi i caktuar për parkimin e mjeteve, ose ajo tokë është vend i përbashkët për interesat e fshatit, si hapësira rreth pusit, ose kullota e përbashkët për kafshët e banorëve të fshatit, ose vendi ku ata presin dru fshatçe, ose rrjedha e ujit të fshatit, të gjitha këto, askujt nuk i lejohet t'i gjallërojë, domethënë t'i kthejë me punën e tij në tokë bujqësore e as nuk merren në pronësi nëpërmjet gjallërimit.

Po kështu, nuk preken as puset, as lumenjtë, as muri e as çdo tokë që merret në pronësi nga këto që u përmendën, nuk lejohet që ajo tokë të gjallërohet për interesat e gjallëruesit, domethënë se për këto lloje tokash që u thanë dhe që janë në pronësi të përbashkët, nuk ka vend të veprohet sipas hadithit: "Ai që gjallëron një tokë të vdekur, e cila nuk është e drejtë e ndonjë myslimani, ajo tokë i takon gjallëruesit."

3- Toka të mos jetë vend ku kryhet adhurim e as vend ku kryhen punët e Haxhit, si për shembull, Arafati, Mina, Muzdelife dhe vende të tjera të nderuara.

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Në të vërtetë, këto vende nuk janë prej tokave të vdekura, në kuptimin që nuk mundësojnë të përfitohet, pasi në ato vende kanë dorë të gjithë myslimanët dhe kanë lidhje me të drejtën e myslimanëve mbi ato vende, madje këto vende janë më të rëndësishme se vakëfi, i cili ka lidhje me të drejtën që fiton vendi i lënë vakëf pas shqiptimit të formulës prej lënësit të vakëfit."

4- "Tokën e vdekur" të mos e ketë bllokuar më përpara dikush tjetër, duke vënë kufij që tregojnë se deri ku mund të arrijë gjallërimi i asaj toke, si për shembull, shenjat tregojnë se vënësi i shenjave është më i përparshëm në rrethimin e asaj toke, ose ai e ka rrethuar tokën për të mbledhur dheun, ose për të hapur një kanal, ose për të tjera punë.

Bllokimi nuk tregon as pronësi e as ndonjë të drejtë mbi tokën e rrethuar, por tregon vetëm atë që bllokuesi, domethënë vënësi i gurëve, si shenja ka përparësi ndaj të tjerëve ta ringjallë atë "tokë të vdekur", me kusht që nuk e lë pas dore popullimin e asaj toke më shumë se sa është e zakonshme, ndryshe sundimtari e detyron bllokuesin ta ringjallë tokën, ose t'ia lërë atë tokë një tjetri që ta gjallërojë.

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Këtë unë e gjej pa asnjë kundërshtim në mesin e atyre fukahave që janë ndeshur me këtë dispozitë, të cilët e kanë shpjeguar këtë me të keqen që ka mosndërtimi mbi ato vende të vdekura, kur dihet që ndërtimi është në të mirën e Islamit."

Autori i librit "El Xheuahir" dhe autori i librit "Miftahul Kerameh" kanë pohuar mospasjen tekst që të tregojë se vënia e gurëve për shenjë, e bën të detyrueshme përparësinë për vënësin e gurëve, por fukahatë kanë dhënë fetva me këtë.

Ai e lë tokën pas dore, pasi e gjallëroi

Ai që ngjall një tokë dhe pastaj heq dorë prej saj, derisa ajo rikthehet në "tokë të vdekur", ashtu siç ishte, në këtë gjendje, a lejohet që dikush tjetër ta gjallërojë këtë tokë?

Një grup fukahash kanë thënë se nuk lejohet, sepse i pari e mori në pronësi atë tokë me anë të gjallërimit. Baza është mbetja e pronës, derisa të vërtetohet shkaku transferues, por lënia e tokës së shkretë nuk është prej shkaqeve që e bëjnë detyrim transferimin e pronësisë mbi tokën.

Fukaha të tjerë kanë thënë se lejohet për të dytin ta ringjallë atë tokë, sepse i pari nuk e merr tokën në pronësi me anë të ringjalljes, por ka marrë në pronësi vetëm të drejtën që të veprojë me atë tokë, kështu që i dyti, duke e gjallëruar tokën, ka më përparësi se të tjerët.

Këtë sentencë fukahatë e kanë nxjerrë duke u bazuar në transmetimin e ardhur prej Imam Bakirit *(Paqja qoftë mbi të!)*, babait të Imam Xhaferr Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)* dhe ky prej gjyshit të tij, Prijësit të besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*, i cili ka thënë: "Toka është e Allahut dhe Ai ia jep trashëgim cilit të dëshirojë prej robve të Vet dhe përfundimi është për të devotshmit. Myslimani që gjallëron një "tokë të vdekur", le ta popullojë atë dhe taksën e asaj toke le t'ia japë Imamit prej familjes sime. Gjallëruesi i tokës ka të drejtë të ushqehet prej asaj toke dhe, nëse ai e lë atë tokë, pas tij atë tokë e merr një mysliman tjetër, i cili ndërton mbi atë tokë, ose e mbjell atë, prandaj ky gjallërues ka më të drejtë se të tjerët mbi atë tokë."

Shehijdu Thanij (Dëshmori i dytë), në librin "El Mesalik", ka thënë: "Origjina e kësaj toke është tokë e lejuar dhe, kur ai e lë tokën, derisa ajo kthehet në "tokë të vdekur", ashtu siç qe më parë, ajo tokë bëhet përsëri tokë e lejuar, sepse shkaku i marrjes në pronësi të kësaj toke qëndronte në gjallërimin dhe në popullimin e saj. Kur shkaku nuk ekziston, nuk mund të flitet më për objektin

që solli shkaku dhe, kur tokën e gjallëron i dyti, në të vërtetë, është rikthyer shkaku i pronësisë. Për rrjedhojë, vërtetohet pronësia e gjallëruesit mbi atë tokë, plotësisht ashtu sikur ai të marrë një send të gjetur dhe pastaj ai send ka rënë prej dorës së tij, pra, ai e humbi, më pas atë send e gjen një i dytë, i cili, në saje të gjetjes, ka më shumë të drejtë për atë send se gjetësi i parë dhe se kushdo tjetër."

Kufizimi i tokës së paprekshme

Fjala "tokë e paprekshme" ka disa kuptime, kurse këtu qëllimi i përdorimit të kësaj fjalë është trualli që është puqur me shtëpinë, si pjesë e asaj shtëpie. Gjithashtu, "tokë e paprekshme" mund të jetë një arë, ose një pus, ose një mur, etj.

Më sipër treguam se nuk lejohet gjallërimi i tokës së paprekshme. Prej Ehli Bejtit *(Paqja e Allahut qoftë mbi ta!)* kanë ardhur transmetime që caktojnë paprekshmërinë e disa sendeve. Transmetohet se i Dërguari i Allahut (Paqja e shpëtimi Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!) ka thënë: "Kur keni mosmarrëveshje për rrugën, bëjeni atë shtatë krahë."

Prej Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)* transmetohet: "Trualli i zakonshëm rreth pusit është dyzet krahë, edhe trualli i paprekshëm i xhamisë është dyzet krahë për çdo anë."

Autori i librit "El Xheuahir ka thënë: "Pa asnjë kundërshtim, në mesin e fukahave, trualli i paprekshëm për murin është sa vendi që zë muri i shtrirë mbi tokë."

Fukahatë, pasi kanë dhënë fetva sipas teksteve, kanë thënë se kufizimi për këto objekte vërtetohet, kur ato ndërtohen në një "tokë të vdekur", kurse për pronat ekzistuese, të puqura njëra me tjetrën, faktikisht, asnjëri prej komshinjve nuk ka të drejtë të kërkojë truall të paprekshëm, domethënë respektimi i largësive mes dy ndërtimeve, por secili vepron me pronën e vet sipas dëshirës.

Ajo që ne shikojmë rezulton se trualli i paprekshëm vlerësohet sipas nevojës dhe sipas interesit dhe ndryshon sipas vendeve dhe sipas kohës. Për sa i përket tekstit që ka ardhur në lidhje me caktimin e gjerësisë së rrugës, ose të objekteve të tjera, duhet të shikohet se ashtu ishte nevoja e interesi në atë kohë.

Në librin "Usùlul Ithbàt", është vënë një kapitull i veçantë me titull "A ndryshojnë dispozitat sipas kohës?". Ndër të tjera, unë kam thënë: "Ka dispozita që janë ligjëruar në përputhje me natyrën e njeriut. Këto dispozita nuk ka mundësi të ndërrohen në asnjë gjendje, sido që të ndryshojnë kohët dhe, për këto dispozita janë sjellë edhe shembuj. Ka dispozita që janë ligjëruar për njeriun nga pikëpamja e shoqërisë në të cilën ai jeton dhe në përputhje me zakonet e traditat e asaj kohe.

Ky grup dispozitash ndryshon me ndryshimet që pëson shoqëria. Prej këtyre dispozitave pamë kufizimin e gjerësisë së rrugës në shtatë krahë, pasi në atë kohë nuk kërkohej që rruga të ishte më e gjerë se shtatë krahë, kurse sot, kur është qëllim ndërtimi i një fshati, ose i një qyteti, përcaktimi i rrugëve dhe i gjithë infrastrukturës lihet në dorën e inxhinierëve dhe rruga ndërtohet ashtu siç mendojnë specialistët, në përputhje me

kërkesat e interesat e kohës. Nuk ka dyshim që ligji pohon çdo gjë të mirë, ashtu siç e kërkon interesi publik.

Me fjalë të tjera, transmetimet që përcaktojnë anekset shoqëruese të objekteve, janë në përputhje me kërkesat e asaj kohe, kur nuk kishte as makina, as kamionë e as aeroporte. Në ditën tona, këto transmetime nuk mund të shërbejnë që, për problemet urbane, të veprohet sipas fjalëve të ardhura në transmetimet e lartpërmendura.

Pavarësisht nga dyshimet që mund të kesh, unë nuk kam asnjë dyshim se, sikur Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* të ishte i pranishëm dhe do të kishte qëllim të ndërtonte një fshat, ose një qytet, me siguri që këtë detyrë do t'ia ngarkonte urbanistëve dhe specialistëve që të përcaktonin të gjitha mjediset.

Dëmtimi i komshiut

A i lejohet pronarit të veprojë në pronën e tij në atë mënyrë që ky veprim i tij dëmton komshiun e tij, si për shembull: pronari hap në pronën e tij një gropë dhe për shkak të asaj grope çahet muri i komshiut; ose në pronën e tij grumbullohet ujë, për rrjedhojë, në shtëpinë e tjetrit depërton lagështira; ose burri, në pronën e tij, ndërton një mjedis për regjje lëkurësh dhe prej atij mjedisi përhapet vazhdimisht erë e rëndë shqetësuese, madje prej asaj ere mund të shkaktohen sëmundje e irritime të ndryshme.

Në përgjigje të këtyre pyetjeve, patjetër duhet të jepen disa hollësi si më poshtë:

1- Pronari ka qëllim dëmtimin e komshiut, pa përfituar asgjë për vete, ose ai vetë mund të pësojë dëmtim minimal, nëse nuk do ta bënte atë veprim në pronën e tij, por ai e bën atë veprim thjesht që të dëmtojë tjetrin. Nëse puna qëndron kështu siç u shtrua, pronari ndalohet të veprojë në pronën e tij dhe ai s'ka të drejtë të protestojë, duke u bazuar në hadithin: "Njerëzit janë sundues mbi pasuritë e veta.", sepse rregulli "nuk ka dëmtim", që kemi parë më sipër, mohon pushtetin e pronarit mbi pronën e tij, kur veprimi i këtij pronari mbi pronën e tij sjell dëmtimin e tjetrit.

Me fjalë të tjera, pushteti i njeriut mbi pasurinë e tij, është plotësisht si liria që kufizohet deri aty ku nuk dëmton tjetrin, domethënë, derisa liria e personit nuk prek lirinë e tjetrit.

2- Pronari nuk ka qëllim të dëmtojë komshiun, as edhe ndonjë njeri tjetër, megjithëkëtë ai vetë nuk përfiton prej hapjes së gropës, apo prej ndonjë veprimi tjetër që ai bën mbi pronën e tij. Gjithashtu, ai nuk dëmtohet, nëse ai e lë atë veprim, duke ditur që komshiu do të dëmtohet prej gropës, ose prej ndonjë veprimi tjetër që ai mund të bëjë në pronën e tij. Edhe në këtë rast, ashtu si në rastin e parë, pronari ndalohet të veprojë, sepse rregulli: "S'ka dëmtim" në këtë gjendje, ka më përparësi se rregulli: "Njeriu është sundues mbi pasurinë e tij.".

3- Pronari dëmtohet, nëse nuk vepron mbi pronën e tij, për shembull: nëse pronari nuk hap kanalin e ujërave të zeza në shtëpinë e tij, në atë shtëpi është e pamundur të banohet, por duke hapur këtë kanal dëmtohet komshiu. Në këtë gjendje, puna shtrohet mes dëmtimit të pronarit për shkak të mosveprimit mbi pronën e tij dhe mes dëmtimit të komshiut, kur pronari vepron mbi pronën e tij.

Nuk mund të ketë dyshim se, në një gjendje të tillë, pronari do të veprojë mbi pronën e tij, me qëllim që të sprapsë dëmtimin prej vetes, ose me qëllim që të ketë ndonjë dobi, qoftë edhe duke dëmtuar komshiun, madje edhe sikur dëmi që i shkaktohet komshiut, të jetë disa herë më shumë se dëmi që pëson pronari, kur nuk e bën atë veprim dhe, kjo sipas rregullit: "Njerëzit janë zotërues të pasurive të veta." Me këtë rregull bëhet edhe gjykimi, prandaj është detyrë që të veprohet sipas këtij rregulli, pa asnjë kundërshtim. Në një gjendje të tillë, nuk është veprues rregulli: "S'ka dëmtim…", me qëllim që dëmtimi të mos prekë komshiun, sepse, nëse ky rregull do të zbatohej dhe do të veprohej sipas këtij rregulli, vetë zbatimi i këtij rregulli kërkon dëmtimin e pronarit, domethënë që jemi përpara ekzistencës e mosekzistencës së një sendi, domethënë largimin e dëmtimit dhe vërtetimin e dëmtimit.

Thënë ndryshe, rregulli: "S'ka dëmtim…", është ligjëruar për lehtësim dhe për të ndaluar dëmtimin me aq sa është e mundur, domethënë që veprimi, në mënyrë absolute, të mos i sjellë dëmtimin askujt, as pronarit e as ndonjë tjetri, por, kur largimi i dëmtimit prej një personi sjell dëmtimin e një tjetri, në këtë rast, nuk mund të mbështetemi më mbi këtë rregull, sepse dëmtimi nuk zhduket me dëmtim.

Fukahatë kanë folur gjatë për këtë çështje në librat e bazave të fik'hut dhe, në mënyrë të veçantë, autori i librit "El Xheuahir" dhe autori i librit "Miftahu Kerameh", të cilët kanë cituar fjalën e përbashkët të fukahave dhe janë shprehur se pronari ka të drejtë të veprojë në pronën e tij, edhe nëse do të dëmtohet tjetri. Por fjala e përbashkët e fukahave duhet të mbartet në një formë të tretë dhe duhet thënë: "Kur pronari dëmtohet nga lënia e veprimit në pronën e tij."

Nga sa kam parë nëpër burimet që më kanë rënë në dorë, kam konstatuar se njëri flet për rregullin: "S'ka dëmtim…", në lidhje me këtë çështje në mënyrë të përgjithshme dhe në mënyrë të veçantë, siç ka thënë shejkh En Nàijnij, në librin "Takrijràtul Khauànsàrij", ku e trajton këtë rregull nga të gjitha anët, madje e ka tjerrë fjalën shumë gjatë, në raport me vërtetimin e veprimit që sjell dobi dhe dobisë që përfitohet.

Uji

Ujërat janë disa kategori:

1- Ujë i ruajtur në një enë, ose në një pellg, ose në sende të tjera. Ky ujë, me fjalën e përbashkët të fukahave, i takon atij që e ka mbledhur dhe askujt nuk i lejohet të veprojë me këtë ujë pa lejen e mbledhësit.

2- Burri hap një pus në pronën e tij, ose ai e hap pusin në një "tokë të vdekur", me qëllim që ta gjallërojë atë tokë dhe ta marrë atë në pronësi. Nëse uji del, ai ujë është pronë e tij dhe ai vepron me atë ujë si të dëshirojë.

Por është thënë se ai nuk e merr në pronësi këtë ujë e as ndonjërën prej kategorive të ujërave. Për këtë çështje kemi fjalën e të Dërguarit të Allahut: "Njerëzit janë ortakë në tri gjëra: te zjarri, te uji dhe te bari i kullotës."

Shejkh Et Tùsij ka thënë: "I zoti i pusit nuk ka në pronësi ujin e pusit, por ai ka përparësi mbi atë ujë në atë sasi që i duhet për të pirë ai dhe kafshët e tij, si dhe për të vaditur të mbjellat e veta, pastaj ujin që tepron, ka detyrim t'ia japë pa kompensim

kujtdo që ka nevojë për të pirë vetë nevojtari dhe kafshët e tij, por nuk ka detyrim që atë ujë t'ia japë komshiut për të vaditur të mbjellat, megjithëse dhënia e këtij uji për vaditje është "mustehab"-"veprim i pëlqyer".

Kur komshiu hap një pus në pronën e vet dhe i merr ujin ose i pakëson ujin pusit të parë, atëherë shikohet: Nëse pusi i dytë tërheq ujin që gjendet realisht në pusin e parë, i zoti i pusit të dytë ka detyrim ta korrigjojë e ta mënjanojë dëmtimin, sepse, në të vërtetë, ai merr ujin që është pronë e një tjetri, domethënë, është plotësisht si ai që merr gjahun prej rrjetës që ka vënë tjetri. Në qoftë se pusi i dytë e merr ujin që rrjedh nën tokë, para se uji të arrijë në pusin e parë, i zoti i pusit të dytë nuk ka detyrim ta mënjanojë e ta korrigjojë dëmtimin, sepse uji, në këtë gjendje, nuk është në pronësi të pusit të pare. Për ilustrim kjo çështje është e ngjashme me rastin e atij që vret gjahun që po shkonte në drejtim të rrjetës që kishte vënë një tjetër, në atë mënyrë sikur ai të mos e vriste atë gjah, patjetër që gjahu do të binte në rrjetë.

3- Ujërat e burimeve, të shirave dhe të puseve në tokë të lejuar. Këto ujëra i takojnë atij që arrin i pari te ato dhe nuk është se i takojnë një personi dhe nuk i takojnë një personi tjetër. Është e kuptueshme që, kur bie shi dhe uji i shiut mblidhet në një tokë që ka pronar dhe pronari ka qëllim ta marrë atë ujë në pronësi, uji i shiut i takon vetëm këtij pronari dhe askujt nuk i lejohet të veprojë më këtë ujë pa lejen e pronarit të asaj toke.

4- Ujë i një lumi të madh, si për shembull, uji i lumit Eufrat, ose i lumit Nil. Në këtë ujë, ligjërisht, të gjithë njerëzit janë të barabartë dhe çdo njeri ka të drejtë të marrë prej ujit të këtij lumi, sa të dëshirojë dhe kur të dëshirojë.

5- Ujë i një lumi të vogël që nuk është pronë e dikujt. Kur uji i këtij lumi nuk mjafton për të vaditur tokat që janë në afërsi të këtij lumi dhe pronarët e tokave kanë grindje mes tyre për punën e ujit, në këtë gjendje, fillohet me tokën që është më pranë lumit dhe i zoti i tokës merr aq ujë sa ka nevojë për vaditjen e të mbjellave dhe të pemëve të të gjitha llojeve. Pastaj e lëshon ujin në tokën që vjen pas tokës së tij. Kështu vazhdohet me vaditjen, derisa të mbarojë uji. Në rast se pas të parit, ose pas të dytit nuk tepron ujë për ata që vijnë pas tyre, nuk ka vend për konflikt, madje edhe sikur mungesa e ujit të çojë në tharjen e të mbjellave ose të pemëve të të tjerëve.

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Pa asnjë kundërshtim, këtë unë e gjej në bazën e gjykimit, mbështetur në tekstet e ardhura në lidhje me këtë çështje prej rrugëve të transmetimit të Ehli Sunetit dhe të rrugëve të transmetimit të shi'ave."

Prej teksteve kemi transmetimin që flet se i Dërguari i Allahut *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)* ka gjykuar në lidhje me pirjen e ujit të lumit në një luginë dhe urdhëroi që më parë të pijë ai që është më sipër dhe pastaj ai që është më poshtë dhe pastaj e dërgon te ai që është akoma më poshtë.

6- Burri hap një kanal në pronën e tij, ose në një "tokë të vdekur", me qëllim gjallërimin e asaj toke dhe ujin e merr prej ndonjë lumi të madh, si për shembull, prej lumit Eufrat. A e ka në pronësi ky burrë ujin e kanalit, apo ai ka përparësi ndaj të tjerëve mbi ujin e kanalit, pa e marrë në pronësi?

Fukahatë më të dëgjuar janë shprehur në mbështetje të dëshmisë së autorit të librit "El Xheuahir" dhe të autorit të librit "El Mesalik", të cilët kanë thënë se ai e merr ujin në pronësi. Autori i librit "El Mesalik" ka thënë: "Kur ai gërmon lumin dhe uji i lejuar i lumit hyn aty ku ai gërmoi, pa asnjë kundërshtim, gërmuesi ka përparësi në këtë ujë dhe askush nuk ka të drejtë të kundërshtojë që ai të vadisë i pari, ose ta përdorë këtë ujë i pari për ndonjë qëllim tjetër. Gjithashtu, askush nuk ka të drejtë të kundërshtojë gërmuesin në lidhje me pronësinë mbi vetë tokën e gërmuar, por kundërshtimi qëndron në pronësinë mbi ujin që hyn në pjesën që ai gërmoi.

Fukahatë më të dëgjuar dhe në veçanti fukahatë e mëvonshëm janë shprehur se ai e merr ujin në pronësi, ashtu siç merr në pronësi ujin, kur hap pusin, ose kur sistemon burimin, sepse, në të dy rastet, e përbashkëta është nxjerrja e ujit. Shehu është shprehur për mosmarrjen e ujit në pronësi, për shkak se ai ka hapur pusin, ose ka gërmuar lumin, sepse uji që ka hyrë në pronësi të tij, është ujë i lejuar, për rrjedhojë baza mbetet lejimi, por hapësi i pusit ka përparësi në këtë ujë, sepse mbi atë ujë është dora e tij, pra, është sikur rrjedha e ujit të kalojë nëpër pronën e një burri dhe në atë pronë të mblidhet, megjithëkëtë ai nuk e merr në pronësi këtë ujë.

Duke bërë konstatimet mes dy thënieve, rezulton se është e lejuar të pihet prej atij uji, gjithashtu, me atë ujë është e lejuar të merret abdes e të bëhet gusul, apo uji të përdoret për nevoja të tjera sipas asaj që është e zakonshme gjatë kohëve, përveçse kur dihet që të zotit të këtij uji nuk i vjen mirë që të tjerët të marrin ujin e tij dhe ai të mbetet pa ujë.

Mineralet

Fukahatë i kanë ndarë mineralet në dy lloje:

Lloji i parë: Të dukshme dhe në qarkullim në çdo dorë, domethënë se, që të nxirren ato, nuk kanë nevojë as për punë e as për gërmim dheu. Minerale të këtij lloji janë: kripa, zifti, kohli, perlat e gurët e çmuar (në tekst jàkùt), etj. Këto lloje mineralesh merren në pronësi, thjesht duke i marrë pa punë, me qëllim që toka ku ato janë, të gjallërohet, sepse gjallërimi realizohet vetëm me punë. Këto lloje mineralesh, nga natyra e tyre, janë të dukshme dhe nuk kërkojnë punë që të nxirren, domethënë janë plotësisht si uji i lumenjve.

Lloji i dytë: Minerale në brendësi të tokës, janë ato që kërkojnë punë e përpunim, si për shembull: hekuri, floriri, argjendi, bakri, plumbi, etj. Këto lloje mineralesh merren në pronësi me anë të gjallërimit të tyre, domethënë me atë punës për nxjerrjen e përpunimin.

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Te mineralet e dukshme, njerëzit janë të barabartë, ashtu siç ka qenë vazhdimisht në të gjitha kohët e vendet, kurse mineralet që janë në brendësi të tokës, merren në pronësi me anë të gjallërimit të tokës ku ato janë, domethënë me anë të punës që duhet të bëhet, derisa të arrihet marrja në formën e mineralit, ose në formën e metalit përkatës. Këtë unë e gjej pa asnjë kundërshtim në mesin atyre që e kanë trajtuar këtë çështje. E vërteta e punës që kërkohet për ato minerale, është shkaku i mirëfilltë që ligjëron marrjen e tyre në pronësi, që do të thotë se puna për çdo send është e veçantë për mineralin në fjalë. Nisur nga ky shpjegim, pusi merret në pronësi, nëse në atë pus del ujë, që do të thotë se uji, në këtë rast, është si

diamantet që gjenden në brendësi të tokës dhe që mund të merren vetëm duke gërmuar tokën."

Çështje

1- Ai që gjallëron një tokë të vdekur dhe më pas në atë tokë del në sipërfaqe një mineral, ai mineral i takon atij që gjallëroi "tokën e vdekur", sepse ai është pjesë e asaj toke. Kjo është e barabartë, qoftë kur ai kishte dijeni për ekzistencën e këtij minerali në kohën kur e gjallëroi "tokën e vdekur", qoftë kur nuk kishte dijeni për ekzistencën e atij minerali.

2- Kur burri punon për nxjerrjen e mineralit dhe pastaj e lë pas dore punën e këtij minerali, sundimtari e detyron të plotësojë punën e filluar, ose të heqë dorë prej asaj pune dhe të hapë rrugë që punën e tij ta vazhdojë një tjetër.

3- Pronarit të shtëpisë i lejohet të gërmojë një kanal për ujërat e zeza në rrugën publike dhe që kalon në një rrugë tjetër, ai vazhdon hapjen e kanalit për nevojat e veta, deri aty ku duhet, pasi në atë kanal do të derdhen ujërat e zeza të shtëpisë së tij, por me kusht që atë kanal ai e mbyll në mënyrën e duhur, derisa ky kanal të mos shkaktojë dëmtimin e kalimtarëve, ose të mjedisit.

Gjithashtu, pronarit të shtëpisë i lejohet të gërmojë bodrum poshtë shtëpisë, me kusht që gërmimi të mos shkaktojë vithisjen e tokës, ose nga gërmimi i bodrumit të shkaktohet rrëshqitja e rrugës dhe, për rrjedhojë, të dëmtohen kalimtarët, ose të dëmtohet komshiu. Në këtë gjendje, gërmuesi është garantues për dëmtimin që mund të ndodhë.

* * *

VAKËFI

Cili është kuptimi i fjalës "vakëf"?

Nga ana gjuhësore, fjala "vakëf" do të thotë "ndalim", "pengim", si për shembull: Ti mund të thuash: "Unë ndalova ecjen.", domethënë unë nuk eca.

Nga ana e ligjit të fesë, vakëfi është një lloj dhënie prone, e cila, pas dhënies, ndalohet pronësia mbi të. Gjithashtu, do të thotë që përfitimet prej pronës të lënë vakëf, janë të pakufizuara.

Pronë e ndaluar do të thotë që vakëfi është e ndaluar të trashëgohet, ose të shitet, ose të dhurohet, ose të lihet peng, ose të jepet me qera prej lënësit, ose të jepet kredi, etj. Fraza "përfitimet prej pronës së lënë vakëf janë të pakufizuara", do të thotë se dobitë që vijnë prej vakëfit janë vetëm për hir të Allahut dhe shpenzohen për ato qëllime që ka caktuar lënësi i vakëfit, pa kompensim.

Ligjërimi i vakëfit

Vakëfi është i ligjëruar me fjalën e përbashkët të fukahave dhe me tekst. Prej teksteve përmendim hadithin: "Pas vdekjes burri ka dobi me tri cilësi: ka lënë një dituri, sipas cilës punojnë njerëzit dhe i vdekuri ka shpërblimin e të gjithë atyre që punojnë sipas diturisë që ai la, pa i pakësuar asgjë nga shpërblimi i atyre që kanë punuar sipas asaj diturie; ka lënë një sadaka të vijueshme, ka lënë një djalë të mirë, i cili lutet për prindërit e tij pas vdekjes së tyre."

Vakëfi ka veprime të detyrueshme dhe kushte për të cilat do të flitet në paragrafët vijues.

Formula

Një grup studiuesish të dëgjuar në fushën e fik'hut (ligjit të fesë), ndër të cilët sej'jid El Jezdij, autor i librit "El Urvetul Vuthkà", sej'jid Ebul Hasan El Asfehànij dhe sej'jid El Hakijm janë shprehur se lënia vakëf realizohet me çdo fjalë që tregon lënien vakëf, qoftë edhe kur shqiptohet me gjuhë të tjera përveç arabishtes, sepse fjala, në vetvete, në rastin e lënies vakëf, është thjesht mjet për të shprehur qëllimin dhe nuk është qëllim në vetvete.

Sej'jid El Jezdij, në librin "Mulhakàtul Urveh", ka thënë: "Thënia më e fuqishme është: Mjafton çdo fjalë që tregon lënien vakëf, edhe sikur të jetë thënë me fjalë krahasuese, ashtu siç është për të gjitha kontratat, sepse nuk ka argument që tregon se për lënien vakëf duhet të merret në konsideratë një fjalë e veçantë, ose

që fjala për lënien vakëf të thuhet në gjuhën arabe, ose të shprehet me folje të kohës së shkuar, por mjafton edhe një fjali emërore, si për shembull, ai thotë: "Kjo është vakëf."

Këtë e tregon edhe fjala e Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*, kur te ai erdhi përgëzuesi që e njoftoi për daljen e një burimi uji në vendin e quajtur Jembe. Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* tha: "Ai ujë është sadaka për vizitorët e Shtëpisë së Allahut (Qabes) dhe për kalimtarët. Ai ujë nuk shitet, nuk dhurohet dhe nuk trashëgohet."

Sej'jid El Hakijm, në librin "El Mulhakàt" dhe sej'jid El Asfehànij, në librin "El Uesijleh", kanë thënë: "Lënia vakëf realizohet edhe me veprim, pa e shqiptuar me fjalë për xhaminë, varret, rrugët, urat, pemët e mbjella, me qëllim që prej atyre pemëve të kenë dobi kalimtarët. Të ngjashme me këto që u thanë, janë edhe shtrojat e ndriçimi për vendet e nderuara (mesh'hedet) dhe xhamitë, ose për të tjera vende e objekte. Të gjitha këto janë të ndaluara, domethënë nuk mund të merren në pronësi me rrugë ligjore, sepse ato janë shpallur të ndaluara, të bazuara mbi interesin e përgjithshëm.

Le ta ilustrojmë me një shembull: Dikush ngre një ndërtesë. Pastaj thotë se këtë e bëj xhami dhe aty lejon që të gjithë të falin namaz, madje edhe sikur në atë ndërtesë të falë namaz vetëm një njeri. Vetëm fakti që aty u fal namaz pas fjalës së lënësit, është i mjaftueshëm që xhamia është vakëf. E njëjta analogji është edhe për rast: Burri ndan një parcelë toke për varrezë myslimanësh dhe lejon që në atë parcelë të varrosen myslimanët. Edhe sikur në atë parcelë të varroset vetëm një njeri, është e mjaftueshme që ajo parcelë të jetë vakëf. Po kështu është kur burri ndërton një urë, ose

çan një rrugë dhe mbi atë urë ose rrugë kalon qoftë edhe vetëm një njeri.

A është e nevojshme që për vakëfin të ketë pranim, apo për lënien vakëf mjafton vetëm ofertë-deklarimi për lënien vakëf?

Për këtë çështje, fukahatë kanë thënë tri fjalë. Njëra fjalë e më kusht pranimin, në mënyrë absolute.

Fjala e dytë tregon se, në mënyrë absolute, pranimi nuk është kusht. Kështu është shprehur sej'jid El Hakjm, në librin "Minhàxhu Sàlihijn" dhe sej'jid El Jezdij në librin "El Mulhakat".

Ja edhe shprehja tekstualisht e të parit: "E dukshme është mosvënia në konsideratë e pranimit në vakëfin e të gjitha llojeve." E ngjashme është edhe fjala e të dytit: "Më e fuqishme është moskushtëzimi."

Fjala e tretë e ndan vakëfin e lënë për të gjithë, siç janë xhamitë, varreza dhe vakëfi i lënë për të varfrit. Për këto lloj vakëfi nuk është kusht pranimi, nga vakëfi i lënë për të veçantët, siç është lënia vakëf për fëmijët e të ngjashmit me ta, por në vakëfin për të veçantët është kusht pranimi. Për këtë dallim janë shprehur një grup prej fukahave të mëdhenj, si për shembull, autori i librit "Esh Sheràiu", dy Dëshmorët dhe poliedriku El Hil'lij. Bazuar mbi thëniet e këtyre fukahave, vakëfi është një kontratë që ka nevojë për ofertë-propozimin dhe për pranimin, kur është vakëf për të veçantët.

Është marrëveshje që s'ka nevojë për pranimin, kur vakëfi është lënë për të gjithë. Në të vërtetë, s'ka ndonjë pengesë ligjore ose logjike që vakëfi të jetë kontratë me mbikëqyrje, ose

marrëveshje me mbikëqyrje, edhe pse këtë e ndalon autori i librit "El Xheuahir".

Përheshmëria dhe vijimësia

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët me dëshminë e autorit të librit "El Xheuahir" se vakëfi nuk plotësohet, nëse kufizohet me kohë të përcaktuar, si për shembull, kur burri thotë: "Kjo është vakëf për këtë punë, deri për dhjetë vjet."

Fukahatë kanë mendime të ndryshme, nëse thuhet: A lejohet me ndalim, ose ai e prish vakëfin me ndalim? Vlefshmëria me fjalën "ndalim" do të thotë se qëllimi që ka specifikuar pronari i objektit të lënë vakëf për të marrë dobitë prej atij vakëfi, do të vazhdojë gjatë gjithë kohës së përcaktuar dhe pas kësaj kohe përftimi prej atij objekti i takon pronarit.

Një grup fukahash, ndër të cilët edhe autori i librit Mulhakàtul-Urveh", janë shprehur se është i vlefshëm, edhe kur thotë se e ka ndaluar, sepse qëllimi që ka specifikuar pronari i atij objekti mundëson përfitimin prej atij objekti gjatë gjithë kohës së përcaktuar.

Autori i librit "El Mulhakat" ka thënë: "Në të vërtetë, qëllimi me këtë kuptim, domethënë përfitimi prej objektit për një kohë të caktuar, është pikërisht qëllimi me fjalën "ndalim" dhe nuk sjell asnjë dëm që objekti, në të vërtetën e tij, të jetë vakëf, pasi më parë ishte i ndaluar."

Me lejen e Allahut, në kapitullin vijues do të flasim rreth ndalimit dhe dispozitave të tij.

Fukahatë më të dëgjuar kanë mbështetur dëshminë e autorit të librit "El Xheuahir" e të autorit të librit "Mulhakatul Urveh" dhe kanë thënë se, nëse burri e lë vakëfin për ata që zakonisht asgjësohen, si për shembull, vakëfi i lënë për fëmijët e tij vetëm në njërin bark dhe nuk ka përmendur vendet ku duhet të shpenzohen dobitë e atij vakëfi pas shuarjes së tyre, fukahatë janë shprehur se ai objekt nuk mbetet vakëf, por rikthehet në pasurinë e pronarit, edhe nëse atë e kanë marrë disa persona, domethënë se ky objekt i shpallur vakëf, nuk kalon te të tjerët. Kjo del shumë qartë prej fjalës së Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*: "Vakëfi është ashtu siç e kanë lënë vakëf pronarët e objektit."

Pyetje: Si është i vlefshëm të lihet vakëfi për atë që asgjësohet, kur dihet se vakëfi është kusht të jetë i përhershëm e i vijueshëm?

Përgjigje: Ata që e kanë vënë kusht përhershmërinë dhe vijueshmërinë e vakëfit, kanë pasur qëllim moskufizimin e tij me një kohë të përcaktuar. Por kjo nuk përfshin rastin për të cilin po flasim. Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Qëllimi me fjalën e përbashkët të fukahave për vënien në konsideratë vijueshmërinë, është moskufizimi i vakëfit me një kohë të përcaktuar." Vakëfi i lënë për ata që asgjësohen, quhet vakëf i ndërprerë.

Ne nuk e përjashtojmë këtë mendim, sepse ata që e kanë vënë kusht përhershmërinë, janë mbështetur në faktin se përhershmëria është e vetëkuptueshme në fjalën "vakëf". Ne kemi të drejtë të themi se vakëfi është dy kategorish: vakëf i përhershëm dhe vakëf i ndërprerë, domethënë i përkohshëm, megjithëse nuk ka argument që e kufizon si vakëf të përhershëm. Për sa u përket vakëfeve të Ehli Bejtit *(Paqja e Allahut qoftë mbi ta!)*, për të cilat

kanë nxjerrë argumente se ato janë vakëfe të përjetshme, janë nisur nga fakti se argumentet i përfshijnë edhe këto vakëfe, çka do të thotë se vakëfi është i vlefshëm, krahas përhershmërisë. Për këtë nuk ka argument tjetër që e mohon.

Duhet thënë se disa fukaha e mohojnë faktin që ka fjalë të përbashkët të fukahave për vënien kusht të përhershmërisë. Autori i librit "El Hadaik" ka cituar në librin "El Mesalik", prej Dëshmorit të dytë se për kushtin e përhershmërisë ka dyshime, madje për këtë kusht ka edhe mosmarrëveshje në mesin e fukahave.

Gjithashtu, prej autorit të librit "El Mefàtijh" është cituar se për këtë kusht nuk ka argument, njëkohësisht këtë kusht e mohojnë bazat dhe përfundimet e përgjithshme. Përveç këtyre, kjo çështje është cituar edhe prej autorit të librit "Miftahul Kerameh". Me këtë shpjegim, për ne bëhet e qartë se vakëfi, me të vërtetë, është dy kategorish, vakëf i përhershëm dhe vakëf i ndërprerë.

Marrja në dorë

Marrje në dorë do të thotë që pronarit i hiqet ai send prej pasurisë së tij dhe mbi atë send–objekt, zotërues bëhet enti ose personi për të cilin është lënë vakëfi. Marrja në dorë është kusht që kontrata të jetë e detyrueshme dhe nuk është kusht për vlefshmërinë e saj.

Kur burri lë vakëf, nuk ndodh marrje në dorë, për rrjedhojë, vakëflënësi ka të drejtë të kthejë mendim për lënien.

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Kontrata për vakëfin nuk është e domosdoshme, përveçse kur objekti i lënë vakëf merret në dorë, domethënë merret në pronësi me leje, por që në kohën e marrjes në dorë, qenia e atij objekti vakëf është prishur më përpara.

Bazuar mbi këtë shpjegim, kur burri e lë objektin e tij vakëf, që të jetë në shërbim të të gjithë myslimanëve, si xhami, ose varrezë, ose që të jetë në shërbim të të varfërve, ai nuk ka detyrim tjetër përveç detyrimit që xhamia të merret në dorëzim prej kujdestarit, ose prej gjykatësit ligjor, kurse për varrezën, detyrimi që ajo të bëhet vakëf, është që në atë parcelë të varroset një njeri, ose që në xhaminë të falet namaz, ose që i varfri të veprojë me vakëfin me lejen e vakëflënësit.

Në qoftë se nuk realizohet marrja në dorë prej atyre që kanë detyrim ta marrin në dorë, në këtë gjendje, për vakëflënësin lejohet që ai të kthejë mendje për lënien e atij objekti vakëf. Në qoftë se burri e ka lënë objektin vakëf për njerëz të veçantë, për shembull, për fëmijët e tij, nëse fëmijët janë të mëdhenj, vakëfi nuk është realizuar pa e marrë ata në dorë me lejen e tij. Nëse fëmijët janë të vegjël, nuk kërkohet që vakëfi të rimerret në dorëzim, sepse dora e vakëflënësit është edhe dora e fëmijëve të vegjël, për shkak se ai është kujdestar për ta.

Në rastin kur vakëflënësi vdes para marrjes në dorë të vakëfit, vakëfi prishet dhe bëhet trashëgimi. Një shembull: Burri ka lënë vakëf një dyqan për bamirësi dhe pastaj vdes, ndërkaq dyqani vazhdon të jetë nën menaxhimin e tij. Në këtë gjendje, dyqani i rikthehet trashëgimtarëve. Por nëse marrja në dorë është

realizuar, vakëfi është plotësuar dhe për vakëflënësin nuk lejohet që ai të kthejë mendje për të mos e lënë atë objekt vakëf.

Argument për këtë gjendje është përgjigjja që i ka dhënë Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* një burri, kur e pyeti në lidhje me vakëfin për Imamët e pastër: "Në lidhje me pyetjen që bëre për vakëfin për ne, domethënë për atë çka është hallall për ne dhe më pas vakëflënësi ka nevojë për atë vakëf, nëse vakëfi nuk është dhënë në dorëzim, për këtë vakëf, pronari ka të drejtën e përzgjedhjes, kurse për vakëfin e dhënë në dorëzim, pronari nuk ka të drejtën e përzgjedhjes, proteston apo nuk proteston, ka nevojë apo nuk ka nevojë për atë vakëf."

Gjithashtu, Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* është pyetur për një burrë që i jep sadaka njërit prej djemve të tij, megjithëse djali është në moshë madhore. A është i lejuar veprimi i këtij burri? A ndryshon vlera e kësaj sadakaje?

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* është përgjigjur: "Kur djali nuk e ka marrë në dorë, derisa ai vdes, atëherë ajo sadaka është trashëgimi. Nëse ai i jep sadaka fëmijës që akoma nuk ka arritur moshën madhore, kjo sadaka, nga ana e tij, është e lejueshme, sepse babai është kujdestari i punëve të fëmijës së tij."

Në vakëfin për të veçantët, është e mjaftueshme që atë ta marrë në dorë brezi i parë i pasardhësve.

Kush e merr në pronësi objektin e lënë vakëf?

Në paragrafin e mësipërm "Përhershmëria dhe vijimësia" u tha që vakëfi ishte dy kategorish: i përjetshëm dhe i ndërprerë. Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët që vakëfi i përhershëm del nga pronësia e vakëflënësit. Por fukahatë kanë mendime të ndryshme në lidhje me objektin e lënë vakëf, nëse prej atij objekti hiqet cilësia e pronës vetëm menjëherë, në atë mënyrë që ai objekt kurrë nuk është pronë e ndonjërit, ose siç thuhet në çmontimin e pronës, apo pronësia mbi objektin e shpallur vakëf transferohet për te institucioni ose te personi për të cilin ai objekt është lënë vakëf.

Një grup fukahash kanë bërë sqarime mes vakëfit të lënë në shërbim të të gjithëve, si: xhamitë, shkollat e klinikat dhe mes vakëfit të lënë për persona të veçantë, siç është vakëfi i lënë për pasardhësit, apo për të tjera qëllime. Ata kanë thënë se vakëfet e llojit të parë janë lirim nga e drejta e pronësisë mbi ato objekte. Nëse vakëfi është prej llojit të dytë, pronësia mbi objektin transferohet prej pasurisë së vakëflënësit në pronësi të atyre për të cilët objekti është lënë vakëf.

Shejkh El Ensarij, në librin "El Mekasib", ka thënë: "Në lidhje me vakëfin e përjetshëm, patjetër duhet të shpjegohet se edhe kjo kategori vakëfi, në vetvete, është dy llojesh. Lloji i parë është që vakëfi të jetë pasuri për ata që është lënë të zotërojnë dobitë e atij vakëfi.

Gjithashtu, ata kanë të drejtë ta lëshojnë me qera dhe të marrin shumën e qerasë për atë vakëf.

Lloji i dytë rezulton që të mos jetë pasuri për asnjërin, por është lënie e lirë e pasurisë. Për krahasim, kjo gjë është si dhënia e lirisë një robi, i cili më parë ishte pronë e pronarit, konkretisht si xhamitë e shkollat, të cilat, bazuar në rregullin e vakëfit për të gjithë, asnjëherë nuk hyjnë në pronësi personale të myslimanëve.

Ky është medh'hebi i bashkësisë së myslimanëve, të cilët prej këtij lloj vakëfi përfitojnë vetëm shërbimin që ofron objekti xhami, por dhe nuk marrin në zotërim vetë dobisjellësin."

Kryerja e punës

Shumica e fukahave janë shprehur për detyrimin për kryerjen e punës dhe moslënien e punës së varur në kohën. Burri thotë: "Nëse vdes, filan pronë e imja është vakëf." Ajo pronë nuk bëhet vakëf pas vdekjes së tij. Në qoftë se ai thotë: "Kur unë të vdes, këtë objekt bëjeni vakëf.", kjo fjalë e tij është testament që objekti për të cilin ai porositi, të lihet vakëf. Në këtë gjendje, porosimbajtësi ka detyrim të zbatojë porosinë dhe ta lërë vakëfin. Nëse testamentmbajtësi nuk e kryen porosinë, atë e detyron sundimtari. Nëse nuk është e mundur që testamentmbajtësi të detyrohet, punën e lënies vakëf, në vend të testamentmbajtësit, e merr përsipër vetë sundimtari.

Sej'jid El Jezdij, në librin "Mulhakàtul Urveh", ka thënë: "S'ka argument të veçantë për kushtin e kryerjes së punës për vakëfin, ashtu siç ka pohuar edhe autori i librit "El Mesalik", i cili ka thënë se, kur arrihet fjala e përbashkët e fukahave, atëherë veprohet sipas saj, ndryshe çështja është me problem."

Konstatohet që, edhe sikur të gjendet fjala e përbashkët e fukahave, këtu ajo fjalë është e pavlefshme për të argumentuar moskryerjen e punës. Është e padiskutueshme që fjala e përbashkët e fukahave, në të vërtetë, është argument, kur për kryerjen e punës për lënien vakëf nuk gjejmë argumente ku të mbështetemi. Në lidhje me këtë çështje, fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët, duke vënë në konsideratë se ndërtim vakëfi do të thotë se ai vakëf, faktikisht ekziston, kurse varësi do të thotë se ai vakëf nuk ekziston. Rezultati është konflikt e kontradiktë. Kjo gjendje shmanget me faktin që ndërtimi i vakëfit është realizuar me punën dhe ndikimet e tij janë ato që do të arrihen në të ardhmen, bazuar mbi vlerësimin e kushtit, për të cilin ne kemi folur hollësisht dhe gjatë në pjesën e tretë, në kapitullin "Kushtet e kontratës", në paragrafin "Varësia".

Vakëflënësi

Është kusht që vakëflënësi të ketë aftësi për të kryer marrëdhënie të ndërsjella, për rrjedhojë, nuk është i vlefshëm vakëfi i lënë prej të çmendurit, për shkak se do të mohohej mosobligimi i tij me kryerjen e detyrimeve të fesë. Gjithashtu, nuk është i vlefshëm as vakëfi i lënë prej fëmijës, edhe nëse është fëmijë që dallon.

Nuk është i vlefshëm as lënia vakëf prej të ngurtësuarit, sepse edhe i ngurtësuari është i ndaluar të kryejë marrëdhënie pasurore. Disa fukaha kanë thënë se është i vlefshëm vakëfi i lënë prej fëmijës që ka mbushur dhjetë vjeç.

Në të vërtetë, kjo fjala e fundit është thënie e deformuar dhe e lënë, domethënë që nuk punohet sipas kësaj fjale, sepse është në kundërshtim me bazat e medh'hebit dhe me fjalën e përbashkët të myslimanëve dhe me dëshminë e autorit të librit "El Mesalik", të cilën e ka cituar tekstualisht autori i librit "El Xhevahir", mbi të cilën ai ka komentuar se bashkimi i vakëfit, me porosinë, është analogji e ndaluar kategorish (haram).

Nijeti për afrim

Nuk ka dyshim se nijeti për vakëfin është kusht në realizimin e tij, prandaj, kur e shqipton fjalën për lënien vakëf një i dehur, ose një person që ka humbur vetëdijen, ose ai që është në gjumë, ose ai që dihet se flet mbroçkulla, ajo fjalë është pa asnjë vlerë.

Fukahatë kanë mendime të ndryshme në lidhje me nijetin për afrimin te Allahu i Lartësuar, nëse nijeti është kusht, si mendja e mosha madhore, në atë mënyrë që, sikur ai, me vakëfin, të ketë qëllim një punë të kësaj bote, vakëfi nuk realizohet.

Një grup fukahash, ndër të cilët edhe autori i librit "El Xheuahir" dhe autori i librit "Mulhakatul Urveh", kanë thënë se afrimi është kusht për vlefshmërinë e vakëfit dhe jo për marrjen e tij në dorë.

Es'sej'jidi, në librin "Mulhakàtul Urveh", ka thënë: "Më e fuqishme dhe me fjalën e përbashkët të një grupi fukahash, rezulton mosqenia kusht e nijetit për afrim, sepse argumentet janë të pakushtëzuara edhe për vlefshmërinë e vakëfit të lënë prej

jomyslimanit. Po, është e vërtetë që shpërblimi (theuabi) në vakëfin renditet i bazuar në qëllimin për afrim.", krahas faktit se për renditjen e shpërblimit mund të flitet edhe për punët e mira, nëse për ato puna nuk është vënë qëllim që të kryhen për hir të Allahut.[1]

Objekti vakëf

Objekti vakëf është kusht që të jetë objekt që është në pronësi dhe i përcaktuar, prej të cilit përfitohet një dobi hallall, ndërsa objekti vazhdon të mbetet. Gjithashtu, objekti vakëf është i mundur të merret në dorë dhe të jepet në dorëzim, prandaj nuk është e vlefshme të jetë objekt vakëf borxhi, ose ndonjë send i panjohur, si për shembull, burri thotë: "Jap vakëf një arë prej pasurisë sime, ose një pjesë të saj."

Gjithashtu, nuk është vakëf sendi që nuk mund të jetë pronë e myslimanit, si për shembull: derri, veglat muzikore. Nuk është objekt vakëf as sendi që nuk është e mundur të përfitohet prej tij veçse duke u konsumuar, si për shembull, gjellët e pijet; nuk është vakëf as objekti i lënë peng; nuk janë vakëf sendet që nuk mund të merren në dorë e të jepen në dorëzim, si për shembull, shpendi në ajër dhe peshku në ujë; nuk është objekt vakëf as kafsha e humbur, as sendi i rrëmbyer, të cilin nuk e ka

[1] Të gjithë fukahatë vërtetojnë varësinë mes shpërblimit të Allahut dhe qëllimit për afrim te i Gjithëpushtetshmi. Unë nuk kam parë ndonjë jurist të fesë, përveç këtij Es'she'jidit, i cili ka thënë: 'Allahu shpërblen për punën, edhe kur qëllimi i punuesit është punë e kësaj bote dhe jo punë fetare.' Ne jemi pro mendimit të Es'sej'jidit të madh, sepse kjo fjalë e tij nxit për punë të mirë dhe është në përputhje me mirësinë e bujarinë e Allahut.

nën zotërim as vakëflënësi e as ai për të cilin është lënë vakëfi, për shkak të pamundësisë për ta marrë atë send në dorë, por, kur objektin e rrëmbyer e lë vakëf vetë rrëmbyesi, vakëfi është i vlefshëm, sepse marrja në dorë praktikisht realizohet.

Është e vlefshme lënia vakëf e një pjese nga një objekt i përbashkët, si për shembull, një e katërta e atij objekti, ose gjysma e tij. Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Kjo çështje gëzon fjalën e përbashkët të fukahave. Veç kësaj, tekstet për dhënien sadaka me tokat e përbashkëta janë të shumta dhe me varg përcjellësish të pashkëputur, ku hyn edhe vakëfi, sepse marrja në dorë e pjesës prej objektit të përbashkët, këtu është si marrja në dorë për shitjen, ashtu siç është edhe qartë."

Personi për të cilin është lënë vakëfi

Personi për të cilin është lënë vakëfi ka të drejtë të marrë dobinë e vakëfit, ashtu siç e merr në vakëfet e lënë për njerëz të veçantë. Gjithashtu, atij i lejohet të përfitojë prej objektit vakëf të lënë vetëm për atë, ashtu siç përfitohet prej objektit vakëf të lënë për të gjithë. Por në lidhje me përfituesin prej vakëfit, ai duhet të plotësojë disa kushte:

1- Të ekzistojë fizikisht në kohën e lënies vakëf të objektit, që do të thotë se vakëfi i lënë për një person që nuk ekziston, nuk është i vlefshëm. Pra, është i vlefshëm vetëm për atë që ekziston në kohën e lënies vakëf, si për shembull, ai që lë vakëf për fëmijët e tij, domethënë të gjithë fëmijët e tij që ekzistojnë. Kjo do të thotë se vakëfi nuk është i vlefshëm për fëmijën që mban gruaja në bark.

Pyetje: Si mund të jetë i vlefshëm testamenti i lënë për fëmijën që mban gruaja në bark dhe të jetë i pavlefshëm vakëfi i lënë për të?

Përgjigje: Vakëfi është dhënie në pronësi në çast, por fëmija në barkun e nënës nuk ka mundësi ta marrë në pronësi, pa u ndarë i gjallë prej nënës, kurse testamenti është dhënie në pronësi në të ardhmen dhe marrja në pronësi, në rastin e testamentit, është e kushtëzuar me lindjen e fëmijës i gjallë. Nëse fëmija vdes në barkun e nënës, para se të dalë, testamenti prishet.

Personi për të cilin është lënë vakëfi, të ketë aftësi për të marrë në pronësi, prandaj nuk është i vlefshëm vakëfi i lënë për kafshën. Gjithashtu, nuk është i vlefshëm as testamenti i lënë për kafshën, ashtu siç veprojnë perëndimorët, ku lihet testament për qentë, sidomos "zonjat".

Për sa i përket vakëfit për xhamitë, shkollat e klinikat, e të ngjashme me këto, në të vërtetë, ai vakëf është lënë për ata njerëz që përfitojnë prej atyre vakëfeve. Autori i librit "El Hadaik" ka thënë: "Fukahatë kanë deklaruar se vakëfi i lartpërmendur, është vakëf i lënë për myslimanët, duke vënë në konsideratë disa interesa të tyre. Nuk ka dyshim që myslimanët kanë aftësi për të marrë në pronësi. Për më tepër, qëllimi më i lartë i këtij vakëfi qëndron në faktin se ai vakëf është lënë për ata, duke vënë në konsideratë një interes të caktuar prej interesave të tyre, domethënë që ai objekt është lënë vakëf për ata, me kusht që dobinë e përfituar prej këtij vakëfi ta konsumojnë në një vend të veçantë."

3- Vakëfi të mos jetë objekt në të cilin mëkatohet ndaj Allahut të Gjithëpushtetëshm, si për shembull, lënia vakëf e shtëpive të prostitucionit, ose klubet ku konsumohen pije alkoolike, etj.

Për sa i përket vakëfit të lënë për jomyslimanët, siç janë jomyslimanët që jetojnë në besën e shtetit islam, me fjalën e përbashkët të fukahave, ai vakëf është i vlefshëm. Për këtë çështje, Allahu i Lartësuar, thotë:

"لاَ يَنْهَاكُمُ اللَّهُ عَنِ الَّذِيْنَ لَمْ يُقَاتِلُوكُمْ فِي الدِّيْنِ وَلَمْ يُخْرِجُوكُم مِّنْ دِيَارِكُمْ أَنْ تَبَرُّوهُمْ وَتُقْسِطُوا إِلَيْهِمْ"

"Allahu nuk ju ndalon t'u bëni mirë dhe të mbani drejtësi ndaj atyre që nuk ju luftuan për shkak të fesë e as nuk ju dëbuan prej shtëpive tuaja; Allahu i do ata që mbajnë drejtësi…" (Sure "El Mumtehoneh", ajeti 8)

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Për vlefshmërinë e vakëfit të lënë për jomyslimanët mjafton fjala përgjithësuese: Urdhërim për punë të mirë, bamirësi dhe mirësi."

Autori i librit "Mulhakàtul Urveh", në kapitullin "Vakëfi", ka thënë: "Gjithashtu, vakëfi, mirësia dhe bamirësia lejohet edhe ndaj jomyslimanit që është banor i një vendi jomysliman, për faktin se urdhri për mirësi e bamirësi është i pakushtëzuar."

Dëshmori i dytë, në librin "El Lum'atu Dimeshkij'jeh", në pjesën e parë, në kapitullin "Vakëfi", tekstualisht ka thënë: "Lejohet vakëfi për jomyslimanët që janë nënshtetas të shtetit islam, sepse lënia vakëf për ata nuk është mëkat dhe ata janë rob të Allahut, janë bij të nderuar të bashkësisë njerëzore…"

Në vijim ai ka thënë: "Vakëfi nuk lejohet të lihet për kavarixhët e as për ekstremistët[1], sepse ata e kanë shpallur mohues Prijësin e besimtarëve, Imam Aliun *(Paqja qoftë mbi të!)*, kurse të tjerët e kanë hyjnizuar atë.

Patjetër që e mira është rruga e mesme, ashtu siç ka thënë Imami Aliu: "Dy kategori janë shkatërruar, ai që e shpreh urrejtjen hapur dhe një dashamirës ekstremist."

4- Personi për të cilin është lënë vakëfi, është person i caktuar dhe jo i panjohur. Në qoftë se vakëfi lihet për një burrë, ose për një grua, ose për një ent të papërcaktuar, vakëfi nuk është i vlefshëm.

5- Vakëfi nuk është i vlefshëm të lihet vakëf për vetë vakëfin, ose vakëfi të lihet për disa persona, sepse nuk është logjike që njeriu të marrë në pronësi vetveten. Është e kuptueshme se, kur vakëfi lihet për të varfrit dhe më pas ai vakëf varfërohet vetë, në këtë gjendje, vakëfi është si çdo njëri prej të varfërve. E njëjta gjë është edhe kur vakëfi lihet për studentët e fesë dhe më pas ai vakëf bëhet vetë kërkues, në këtë gjendje, vakëfi prishet.

[1] Nuk ka gjë më të besueshme te shprehja për doktrinën e pasuesve të medh'hebit se ato që shkruhen në librat e tyre fetare dhe në fjalët e Dëshmorit, librat e të cilit janë prej referencave më të mëdha fetare te shi'at. Kjo fjalë e tij është shumë e qartë se edhe jomyslimanët kanë më shumë fe se ekstremistët, atëherë, si është e mundur që ekstremistët dhe ekstremizmi t'i atribuohet shi'ave imamij?

Vakëfi i lënë për falje namazi

Nga pavlefshmëria e vakëfit për vete, bëhet e qartë edhe pavlefshmëria e vakëfeve të shumta që gjenden në fshatrat e malit Amil, vakëfe që i kanë lënë pronarët e atyre vendeve që ato të jenë vakëf pas vdekjes së tyre, madje edhe kur ne shprehemi për lejimin e faljes së namazit mustehab, përveç namazit farz për të vdekurin me bedel, të cilat, në të vërtetën e tyre, janë vakëf për veten.

Përngjasimi

Autori i librit "El Mukhakat" ka thënë: "Kur personi për të cilin është lënë vakëfi, përngjet me një person tjetër, ose përngjasimi ndodh mes dy enteve për të cilat është lënë vakëfi, si pikë referimi për caktimin se kujt i takon vakëfi, do të jetë hedhja e shortit, ose pajtimi i detyrueshëm, që, në këtë rast, do të thotë pjesëtimi i prodhimit ndërmjet atyre të dyve që përngjajnë me njëri-tjetrin.

Në qoftë se nuk e dimë qëllimin për të cilin është lënë vakëfi, është lënë për xhami, apo është vakëf i lënë për të varfrit, apo është lënë për ndonjë qëllim tjetër, në këtë gjendje, të ardhurat e vakëfit shpërndahen për punë të mira e për bamirësi.

Kemi dijeni për ekzistencën e vakëfit, por ngurrojmë të caktojmë se cili është vakëfi mes dy objekteve, për shembull, nuk e dimë, nëse vakëfi është shtëpi apo është dyqan, atëherë do të praktikojmë hedhjen e shortit, sepse, edhe në këtë rast, kemi të bëjmë me përngjasim.

Vullneti i vakëflënësit

Kur vakëfi është dhënie, ose bamirësi, ose sadaka, në këtë gjendje, vakëflënësi është dhënës, ose bamirës, ose njeri që jep sadaka. Është e kuptueshme që njeriu i mençur e në moshë madhore, di të orientohet drejt, nuk është i penguar për të vepruar me pasurinë e vet, për rrjedhojë, patjetër që ka të drejtë që, me pasurinë e tij, të bëjë bamirësi si të dëshirojë dhe t'i japë kujt të dëshirojë. Për këtë çështje kemi hadithin: "Njerëzit janë zotërues të pasurive të tyre", si dhe fjalën e Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)* "Vakëfet janë sipas qëllimit për të cilin i kanë lënë vakëflënësit".

Ky është edhe shkaku që fukahatë kanë thënë: "Kushtet e vakëflënësit janë si teksti i ligjvënësit, fjalët e vakëflënësit janë si fjalët e ligjvënësit në punën dhe në detyrimin për ndjekjen e fjalëve të tij, si shembulli i tij është premtuesi, ai që premton të bëjë një punë të mirë vullnetarisht, betuesi, testamentlënësi dhe ai që merr një vendim."

Bazuar mbi këtë shpjegim, nëse dihet qëllimi i vakëflënësit, atëherë veprohet sipas qëllimit që ai kishte, madje edhe kur qëllimi i tij është në kundërshtim me terminologjinë e traditës, si për shembull, kur ne dimë se ai, me fjalën "vëllai im" kishte qëllim mikun e tij, filanin, ne e shpenzojmë vakëfin për mikun dhe jo për vëllain e tij. Në qoftë se ne nuk e dimë qëllimin dhe vullnetin e vakëflënësit, tradita thotë se është ai që vjen pas tij dhe, nëse nuk ka tregues të veçantë për këtë, atëherë i referohemi kuptimit gjuhësor të fjalës, plotësisht ashtu siç vepron ligjvënësi me fjalët.

Kushti i lejuar

Më sipër u shpjegua se vakëflënësi vë kushtet që ai dëshiron, por prej kësaj tërësie kushtesh përjashtohen gjendjet e poshtëshënuara:

1- Kushti bëhet i detyrueshëm dhe zbatohet, kur është vënë njëkohësisht me lënien vakëf. Por, nëse lënia vakëf është plotësuar, përmendja e kushtit, pas plotësimit të lënies vakëf, është fjalë pa vlerë.

2- Vakëflënësi nuk përmend një fjalë që mohon kërkesën dhe karakterin e kontratës, si për shembull, kur ai vë kusht që objekti i lënë vakëf të mbetet pronë e tij dhe që ai objekt të trashëgohet, ose që atë objekt ai ta shesë, ta dhurojë, ta japë hua ose ta japë me qera, kur të dëshirojë. Një kusht i tillë, me fjalën e përbashkët të fukahave, është pa asnjë vlerë.

3- Kushti i vënë nuk është në kundërshtim me asnjë dispozitë prej dispozitave të ligjit të fesë, si për shembull, ai vë kusht bërjen e një pune haram, ose lënien e një punë farz. Në një hadith thuhet qartë: "Kush vë një kusht, përveç Librit të Allahut të Lartësuar, ai kusht nuk është i lejuar, as kur është në favorin e tij e as kur është kundër tij."

Edhe Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "Besimtarët janë në kushtet e tyre, përveç atij kushti që bën hallall haramin, ose atij kushti që bën haram hallallin."

Për kushtet e tjera, përveç këtyre kushteve që u thanë dhe që janë vënë në një kohë në bërjen e kontratës për lënien vakëf, me

fjalën e përbashkët të fukahave, është detyrim të mbahet besa për zbatimin e tyre.

Në pjesën e tretë të këtij libri, në kapitullin "Kushtet", ne kemi trajtuar gjatë e gjerë kushtet e vlefshme dhe kushtet e pavlefshme. Kemi trajtuar kushtim e gabuar dhe kushtin e saktë. Gjithashtu, kemi trajtuar kushtet në përgjithësi, si parim që përmbledh çdo kusht kudo që ai ndodh: në shitblerje, në qera, në martesë, në vakëf, etj, duke theksuar rëndësinë e kësaj çështjeje dhe nevojën e madhe që merr çështja e kushteve. Studimi për trajtimin e kësaj teme ka zënë afërsisht shtatëmbëdhjetë faqe.

Përzgjedhja

Fukahatë më të dëgjuar janë shprehur se vakëfi nuk pranon përzgjedhje. Kur vakëflënësi vë kusht që ai të ketë të drejtën e përzgjedhjes, kur firmos lënien vakëf, ndryshe ai heq dorë nga firmosja, është prishur njëkohësisht kushti dhe vakëfi. Thuhet se ky kusht kundërshton karakterin e kontratës.

Sigurimi i ushqimit dhe shlyerja e borxhit

Kur vakëflënësi lë vakëfin për një person tjetër dhe vë kusht që prej vakëfit të nxirret ushqimi i tij, në këtë gjendje, prishet kushti dhe vakëfi. Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Pa asnjë kundërshtim që mund të atakojë atë…"

Autori i librit "El Mesalik" ka thënë: "Rregulli te fukahatë është: Është kusht që vakëflënësi të nxjerrë veten e tij prej vakëfit,

në atë mënyrë që për atë nuk mbetet asnjë e drejtë mbi atë vakëf, domethënë që vakëfi kërkon që vakëflënësi të heqë dorë nga pronësia mbi vakëfin dhe mbi dobitë që vijnë prej vakëfit. Kur vakëflënësi vë kusht shlyerjen e borxhit të tij, ose sigurimin e ushqimit të tij, ose vë kushte të ngjashme më këto që u thanë, në të vërtetë, ai ka vënë kusht atë çka është në kundërshtim me kërkesën e vakëfit, prandaj njëherësh është prishur kushti dhe vakëfi."

Kushti për kthimin e vakëfit te vakëflënësi

Vakëflënësi vë kusht, në kontratën e vakëfit, kthimin e objektit të lënë vakëf, kur ai të ketë nevojë. A është apo nuk është i vlefshëm ky kusht? Nëse është i vlefshëm, a hyn kjo çështje në kapitullin "Vakëfi", apo është prej kapitullit "Ngurtësimi", për të cilin do të flasim shumë shpejt?

Fukahatë më të dëgjuar janë shprehur për vlefshmërinë e kushtit, por kontrata e formuluar për vakëfin, në këtë gjendje, është ngurtësim dhe jo vakëf, për rrjedhojë, objekti mbetet në pronësi të pronarit të parë, kurse përfitimi prej atij objekti i takon personit që ka zgjedhur me vullnetin e tij, derisa ai të ndërrojë mendim, ose të vdesë. Kur pronari i këtij objekti vdes, nëse ai nuk ka ndërruar mendim, vakëfi i takon trashëgimtarëve të tij, sepse kushti ishte që objekti të mbetej në pronësi të tij.

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* Është pyetur për një burrë që, për punë të ndryshme bamirësie, ka ndarë sadaka një pjesë të mirë prej pasurisë së tij gjatë gjithë jetës së tij dhe ky burrë që jep sadaka thotë: "Nëse unë kam nevojë për diçka prej kësaj pasurie

(të ndarë prej tij për sadaka), unë kam të drejtë për atë më shumë se kushdo tjetër për të marrë." Si mendoni, a është e lejueshme kjo, kur më parë ai kishte deklaruar që sadakanë me atë pjesë të pasurisë së tij do ta jepte gjatë gjithë jetës, për hir të Allahut. Kur ky burrë vdes, pjesa e pasurisë, e ndarë për sadaka, a kthehet në trashëgimi, apo vazhdon të jetë për sadaka?

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* është përgjigjur: "Kthehet trashëgimi e familjes së tij."

Në një transmetim të dytë, thuhet se Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "Kush lë vakëf një tokë dhe pastaj thotë: "Nëse unë kam nevojë për atë tokë, unë kam më të drejtë më shumë se kushdo mbi atë tokë." dhe më pas ai vdes, ajo tokë i kthehet trashëgimi familjes së tij."

Futja dhe nxjerrja

Kur vakëflënësi vë kusht të nxjerrë prej vakëfit personin që ai dëshiron prej personave për të cilët është lënë vakëfi, vakëfi është prishur. Autori i librit "El Mesalik" ka thënë: "Kjo çështje te ne është objekt konsensusi, sepse është lënie vakëf me detyrim dhe, kur vakëflënësi vë kusht nxjerrjen prej vakëfit personin që ai do ndër personat për të cilët është lënë vakëfi, kjo nxjerrje mohon kërkesën e vakëfit, sepse është në pozitën e përzgjedhjes, mirëpo përzgjedhja është prishës për vakëfin."

Kur vakëflënësi vë kusht të fusë në vakëfin e lënë prej tij edhe atë që do të lindë së afërmi, krahas personave të tjerë për të cilët është lënë vakëfi, ky kusht është i lejueshëm. Kjo është e

barabartë, qoftë kur vakëfi është lënë për fëmijët e tij, qoftë kur është lënë për fëmijët e një tjetri. Është e kuptueshme që ky kusht nuk bie në kundërshtim me karakterin e kontratës. Në të vërtetë, çfarë pengese ka nëse vakëflënësi thotë: "Lashë vakëf, me kusht që të hyjnë në këtë vakëf edhe pasardhësit e mi që do të lindin, ose pasardhësit e atyre të tjerëve për të cilët ai ka lënë vakëfin."? Por është kundërta, kur ai thotë: "Lashë vakëf për ata, me kusht që të nxjerr prej vakëfit cilin të dua prej tyre."

Fjalët e vakëflënësit

Kur ai e lë vakëfin për djemtë, në vakëf nuk hyjnë vajzat dhe, kur ai e lë vakëfin për vajzat, në vakëf nuk hyjnë djemtë. Kur ai e lë vakëfin për fëmijët e tij, në vakëf hyjnë djemtë dhe vajzat së bashku dhe pjesëtimi bëhet në mënyrë të barabartë, si për vajzat, ashtu edhe për djemtë.

Vakëflënësi thotë: "Lashë vakëf për fëmijët e mi." dhe hesht. A përfshihen në fjalën "fëmijët e mi", edhe fëmijët e fëmijëve, apo nuk përfshihen?

Fukahatë më të dëgjuar janë ndaluar vetën te fëmijët dhe jo te fëmijët e fëmijëve. Një grup fukahash kanë thënë se përfshihen edhe fëmijët e fëmijëve dhe kjo është e vërteta.

Vakëflënësi thotë: "Lashë vakëf për barkun tim." Në këtë fjalë hyjnë edhe vajzat, por nuk hyjnë fëmijët e vajzave.

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Kjo është thënia më e përhapur, madje mund të pretendohet se kjo thënie gëzon fjalën e përbashkët të fukahave."

Vakëflënësi thotë: "Lashë vakëf për pasardhësit e mi." Kjo fjalë i përfshin të gjithë, djemtë dhe fëmijët e djemve, si dhe vajzat e fëmijët e vajzave.

Vakëflënësi thotë: "E lashë vakëf për myslimanët." Kjo fjalë përfshin çdo njeri që ka pohuar dy dëshmitë (ka pohuar që Allahu është Zoti Një e i Vetëm dhe Muhamedi është rob e i Dërguar i Allahut).

Vakëflënësi thotë: "E lash vakëf për hir të Allahut." Ai vakëf është vetëm për punë bamirësie.

Kujdestaria mbi vakëfin

Kujdestaria mbi vakëfin është një pushtet i përcaktuar për kujdesin ndaj vakëfit, për mirëmbajtjen e tij, për shfrytëzimin e atij vakëfi dhe për shpenzimin e prodhimit që jep vakëfi aty ku shpenzohet e ardhura e vakëfit. Kujdestaria mbi vakëfin ndahet në dy lloje: kujdestari e përgjithshme dhe kujdestari e veçantë. Kujdestaria e përgjithshme i takon atij që ka punën në dorë, kurse kujdestaria e veçantë është kur vakëflënësi, në kohën e bërjes së kontratës për lënien vakëf, emëron një person që do të kujdeset për vakëfin, ose kujdestarin e cakton gjykatësi ligjor.

Është kusht që kujdestari të gëzojë shëndet mendor, të jetë në moshë madhore, të dijë të orientohet në punë, të jetë besnik. Madje një grup fukahash kanë venë kusht që, përveç këtyre kërkesave, të shtohet që kujdestari të jetë njeri i drejtë, të ketë aftësi për të mbajtur amanetin dhe të jetë njeri i besueshëm,

patjetër që të ketë aftësi e fuqi për të administruar ashtu siç duhet vakëfin.

Kujdestari është besnik dhe si i tillë, ai garanton vetëm kur vë dorë, ose kur lë pas dore detyrën, domethënë që për shkak të shkujdesjes së tij, vakëfi dëmtohet.

Vakëflënësit i lejohet të mbajë kujdestarinë e vakëfit, e mban për veten e tij, që në kohën që ai lë vakëfin, ose ai e mban kujdestarinë së bashku me një person tjetër gjatë gjithë jetës së tij, ose edhe për një kohë të përcaktuar. Gjithashtu, vakëflënësi ka të drejtë që kujdestarinë për vakëfin ta lërë mbi personat për të cilët ai ka lënë vakëfin, ose ai bën kujdestar një person që s'ka të bëjë me vakëfin.

Vakëflënësi hesht dhe në kohën e lënies së vakëfit nuk shprehet për kujdestarinë, në këtë gjendje, shikohet: Në qoftë se vakëfi është i përgjithshëm, si: xhami e varreza, ose për vakëfe të tjera të ngjashme, kujdestaria i takon drejtuesit ligjor të punëve të atij vendi. Në qoftë se vakëfi është lënë për persona të veçantë, si për shembull, ai e ka lënë vakëf për fëmijët e tij, në këtë gjendje, kujdestar i këtij vakëfi janë vetë personat për të cilët është lënë vakëfi.

Në lidhje me këtë çështje, autori i librit "El Mesalik", në mënyrë të përmbledhur, ka thënë: "Baza është që kujdestaria dhe kontrolli i takojnë vakëflënësit, sepse ai ka më shumë të drejtë se kushdo tjetër në shpenzimin e vakëfit për ata që kanë të drejtë të marrin përfitimet e vakëfit dhe, kur ai e emëron kujdestar të vakëfit të lënë prej tij vetveten, ky emërim është plotësisht i

vlefshëm. Nëse ai e vë kusht që kujdestar të jetë një person tjetër dhe jo ai vetë, është detyrim të veprohet sipas kërkesës së kushtit.

Fatimja *(Paqja qoftë mbi të!)* kishte shënuar që kontrollin për "Shtatë muret", që ajo kishte lënë për Prijësin e besimtarëve, ta kishte vetë në dorë. Pas vdekjes së saj, këtë detyrë e kreu Hasani, pas Hasanit Hyseni dhe pas Hysenit më i madhi prej fëmijëve të saj dhe kështu me radhë. Për këtë kusht nuk ka asnjë kundërshtim. Nëse vakëfi është lënë i pakushtëzuar dhe në tekstin e kontratës për lënien e vakëfit nuk është vënë kusht kontrolli mbi atë vakëf për asnjë person, më e fuqishme mbetet thënia që kontrollin për këtë vakëf ta ushtrojë sunduesi ligjor i vendit, kur vakëfi është lënë për të gjithë dhe, kur vakëfi është lënë për persona të veçantë, ata vetë janë kujdestarë të atij vakëfi.

Vakëflënësi emëron kujdestar veten e tij, por ai nuk është njeri i besueshëm, ose ai vë kusht që kujdestar të jetë një person për të cilin ai ka dijeni se është mëkatar. Në këtë gjendje, sunduesi ligjor i vendit nuk ka të drejtë t'i heqë kujdestarinë vakëflënësit ose personit që vakëflënësi ka emëruar kujdestar të atij vakëfi. Kështu thuhet në librin "Et Tdhkireh" të dijetarit El Hil'lij, të cilin e ka cituar autori i librit "El Xheuahir" prej librit "Es Seràir". Madje autori i librit "Mulhakàtul Urveh" ka thënë: "Sikur të vihet kusht që nga ana e sundimtarit ligjor të vendit të mos ketë asnjë ndërhyrje në çështjen e vakëfit të lënë prej tij, ky kusht është plotësisht i vlefshëm."

Kur vakëflënësi ose sundimtari ligjor emëron kujdestar, askush nuk ka pushtet mbi atë kujdestar, derisa ai të vazhdojë ta kryejë detyrën. Nëse ky kujdestar nuk e kryen detyrën ashtu siç duhet, ose tradhton, në atë mënyrë që dëmtimi i vakëfit ndodh

patjetër, nëse ai lihet të ushtrojë detyrën e kujdestarit, në këtë gjendje, sunduesi ligjor i atij vendi ka të drejtë të emërojë një kujdestar tjetër në vend të kujdestarit të parë. Më e mira është që bashkë me kujdestarin e parë, të atashojë një person aktiv të besueshëm.

Kur vdes kujdestari i emëruar prej vakëflënësit, ose kujdestari çmendet, ose pëson ndonjë gjë tjetër që e nxjerr atë prej aftësisë për të ushtruar kujdestarinë, kujdestaria nuk rikthehet te vakëflënësi, përveçse kur ai e ka vënë kusht këtë në kohën e bërjes së kontratës për lënien e vakëfit.

Vakëflënësi e ka lënë kujdestarinë mbi dy persona dhe ka deklaruar se çdo njëri prej dy të emëruarve gëzon pavarësi në punën e tij, kur njëri prej atyre të vdes, ose del prej aftësisë për të ushtruar detyrën e kujdestarisë, në këtë gjendje, detyrën e kujdestarisë e kryen vetëm tjetri. Në qoftë se vakëflënësi është deklaruar për bashkëpunim mes dy kujdestarëve dhe për mospasje pavarësie, asnjërit prej dy kujdestarëve nuk i lejohet të veprojë vetëm. Në këtë gjendje, sunduesi ligjor i vendit, ka detyrë të emërojë një tjetër dhe t'ia atashojë atë dy të parëve. Në rast se njëri prej atyre të dyve del jashtë aftësisë për të ushtruar detyrën e kujdestarit, nëse vakëflënësi nuk ka vënë kushte dhe nuk është shprehur qartë për pavarësinë në veprim për ndonjërin prej atyre të dyve, as për mungesën e tij, në këtë gjendje, fjala e tij mbartet në formë të bashkëngjitur, gjithnjë pa pasur të drejtën e pavarësisë në veprim.

Kur vakëflënësi cakton një sasi prej dobive të vakëfit për kujdestarin, pak ose shumë qoftë kjo sasi dobish, kjo sasi i takon kujdestarit, por, nëse ai nuk ka caktuar gjë për kujdestarin, ky i

fundit ka të drejtë të marrë një pagë të ngjashme që praktikohet zakonisht.

Kujdestari i posaçëm ka të drejtë të lëshojë prokurë për realizimin e çdo interesi prej interesave të vakëfit, përveçse kur është vënë kusht i drejtpërdrejtë për atë dhe nuk është i lejuar të lëshojë prokurë.

Kujdestari nuk ka të drejtë ta delegojë kujdestarinë te një person tjetër pas tij dhe, nëse ai e delegon kujdestarinë, ky delegim i tij është fjalë pa vlerë.

* * *

SHITJA E VAKËFIT

Pyetje:

Realisht,a ekzistojnë shkaqe që kërkojnë lejimin e shitjes së vakëfit? Nëse ato ekzistojnë, cilat janë këto? Si është dispozita e çmimit, kur shitja është e lejueshme dhe kur shitja ndodh? A mund të ndërrojmë një objekt vakëf, që të ketë qëllimin e vakëfit të parë, në atë mënyrë që objekti i ri të zërë vendin e objektit të vjetër dhe të marrë dispozitën e tij?

Librat "El Mekàsib" dhe "El Xheuahir"

Do të ekspozojmë në detaje thëniet e medh'hebeve, prej të cilave bëhen të qarta edhe përgjigjet jo vetëm për pyetjet e mësipërme, por edhe për shumë pyetje të tjera. Nuk kam gjetur ndonjë fakih prej fukahave të pesë medh'hebeve që të mos e ketë zgjatur fjalën në lidhje me këtë çështje, si për shembull, dy fukahatë imamij të dëgjuar, shejkh El Ensarij në librin e tij "El Mekasib" dhe shejkh Muham'med Hasan në librin e tij "El Xheuahir" në kapitullin "Tregtia". Të dy këta Imamë e kanë trajtuar këtë çështje nga të gjitha anët dhe, bazuar mbi trajtimin e

bërë, kanë nxjerrë shumë degë, krahas thjeshtësimit në ekspozimin e thënieve dhe shoshitjen e çdo thënie në veçanti. Ne do të paraqesim një përmbledhje të rëndësishme të asaj që na sjellin këta dy kolozë, mbi të cilët ne jemi mbështetur më shumë nga sa jemi mbështetur në ndonjë libër tjetër për të shpjeguar përfundimet ku kanë arritur Imamët.

Me këtë rast, shkurtimit theksoj se shejkh El Ensarij dhe autori i librit "El Xhevahir, kurrë nuk e kanë dhënë me aq bollëk për lexuesin e tyre mundin dhe kujdesin e tyre për çdo përfundim që ata kanë arritur, por e kanë lënë që ai të revoltohet, madje kanë kërkuar prej lexuesit punë të sforcuar, durim, zgjuarsi dhe aftësi të mëdha shkencore, prandaj është e pamundur për atë që i ka humbur këto aftësi, ose ai që nuk i ka fare këto aftësi, t'i ndjekë këta dy dijetarë gjigantë në ndonjë send, ose së paku të jetë puqur me pluhurin e atyre të dyve, madje ata të dy e konsiderojnë këtë person si njeri të humbur në shkretëtirë, që nuk e di ku gjendet bregu i shpëtimit.

Për sa i përket atij që e ka ndërtuar konstruktin e tij me një bazë prej diturisë, këta dy dijetarë i japin këtij personi diamantin më të çmuar dhe shpërblimin më të merituar, patjetër me kushtin e durimit dhe ndjekjen në vijimësi. Unë nuk di të ketë qoftë edhe fakih imamij prej të vjetërve e të rinjve, që t'i ketë dhënë fik'hut imamij e bazave të tij gjallërinë e origjinalitetit në atë masë sa i kanë dhënë pena e këtyre dy kolosëve.

Kërkoj ndjesë për këtë zgjatje, drejt së cilës mua më ka drejtuar studimi im, në dorën e këtyre dy të mëdhenjve, ose më saktë, studimi im i bazuar mbi gjurmët e këtyre të dyve.

Këto çështje

Janë jo vetëm të shumta thëniet e fukahave, por edhe tepër të gërshetuara në lidhje me çështjen e shitjes së vakëfit, saqë nuk janë për çështje të tjera të fik'hut, madje nuk janë as në vetë kapitullin "Vakëfi". Autori i librit "El Xheuahir" ka bërë studime të thella mbi këtë shumëllojshmëri e gërshetim thëniesh.

Ne, prej fjalës së tij, veçojmë vetëm këtë fragment të vogël: "Kundërshtimi në mesin e fukahave, në lidhje me shitjen e vakëfit, ka ardhur për shkak se në asnjë anë e, në mënyrë absolute, nuk kemi gjetur një çështje prej çështjeve të fik'hut, të ngjashme me çështjen që kemi në trajtim, prandaj fukahatë janë ndarë mes atyre që e ndalojnë kategorikisht shitjen e vakëfit dhe të atyre që e lejojnë shitjen e vakëfit në disa burime.

Gjithashtu, ka edhe fukaha që nuk kanë dhënë asnjë gjykim për këtë çështje dhe rezultati: Thënie të shumta, deri në atë kufi sa çdo fakih ka thënien e tij personale për këtë çështje, madje i njëjti fakih kundërshton vetveten në të njëjtin libër, ose filan fakih, për të njëjtën çështje, ndryshe është shprehur në kapitullin "Shitblerja" dhe ndryshe është shprehur në kapitullin "Vakëfi", madje shpeshherë ai kundërshton vetveten në një fjali të vetme dhe atë që pohon në fillim të fjalisë, e kundërshton në fundin e saj."

Më poshtë, autori i librit "El Xheuahir" i ka përfunduar këto thënie në dymbëdhjetë thënie. Me këto thënie, ose me thëniet më të rëndësishme, ti do të njihesh gjatë trajtimit të çështjeve në vijim.

Xhamia

Në të gjitha shkollat juridike (medh'hebet) islame për xhaminë ka një dispozitë të ndryshme nga dispozita që është për të gjitha llojet e tjera të vakëfit, prandaj fukahatë, me përjashtim të fukahave hanbelij, ndajnë një fjalë të përbashkët për moslejimin e shitjes së xhamisë në asnjë gjendje, sido që të jenë kushtet e shkaqet, madje edhe sikur xhamia të shembej, ose banorët e fshatit, apo banorët e lagjes të braktisnin vendin e tyre dhe askush të mos kalonte nëpër rrugën e xhamisë, në atë mënyrë që dihet me siguri të plotë që në atë xhami nuk është e mundur të falë namaz asnjë njeri. Pavarësisht të gjitha këtyre, është detyrim që xhamia të mbetet ashtu siç është, pa u tjetërsuar e pa u ndryshuar. Këtë dispozitë fukahatë e kanë shpjeguar me faktin se vakëfi xhami pret çdo lidhje mes xhamisë dhe vakëflënësit e mes personave të tjerë jo vakëflënës, përveç lidhjes së xhamisë me Allahun e Gjithëpushtetshëm. Nisur nga ky shpjegim, fukahatë herë janë shprehur me fjalën "shpërbërje e pasurisë" dhe herë tjetër janë shprehur me fjalën "lirim i pasurisë", domethënë se ajo pronë ishte vakëf i kushtëzuar dhe u bë vakëf i pakushtëzuar me asnjë kusht, por meqenëse xhamia nuk është pronë e asnjë njeriu, si mund të lejohet shitja e një prone që s'ka pronar të përcaktuar, kur dihet se shitja ndodh vetëm në pronën me pronar.

Bazuar mbi këto shpjegime, fukahatë kanë renditur edhe nënçështje të tjera, si për shembull, sikur xhaminë ta shfrytëzojë një rrëmbyes dhe ai banon në xhami, ose tokën e xhamisë rrëmbyesi e përdor për mbjellje, vetëkuptohet që ky rrëmbyes ka kryer mëkat, por ai as nuk garanton e as nuk paguan ndonjë gjobë, sepse xhamia nuk është pronë e dikujt.

Nga ky shembull konstatohet dalja e xhamisë prej pronësisë, domethënë se është e ndaluar që xhamia të merret në pronësi me shitblerje, por nuk ndalohet marrja e saj në pronësi për të qenë nën kontroll, ashtu si të gjitha vakëfet e lejuara publike.

Hanbelitë thonë se, kur njerëzit e fshatit shpërngulen dhe në xhami nuk falet më namaz, ose xhamia është tepër e ngushtë për banorët e fshatit dhe nuk ka mundësi as të zgjerohet e as të ndërtohet një pjesë e saj veçse duke shitur një pjesë të kësaj xhamie, në këtë gjendje, shitja lejohet, pasi kur nuk është e mundur të përfitohet prej një objekti, pa e shitur atë, atëherë ai objekt shitet. ("El Mugnij", vëllimi 5, kapitulli "Vakëfi")

Thënia e hanbelive në disa anë takohet me atë që ka thënë fakihu imamij sej'jid Kadhim, i cili, në librin "Mulhakàtul Urveh", është shprehur për mospasjen dallim mes xhamisë dhe vakëfeve të tjerë.

Shkatërrimi e shembja që justifikon shitjen e vakëfeve të tjera përveç xhamisë, justifikon edhe shitjen e xhamisë, ndërsa çlirimi dhe shpërbërja e pasurisë nuk e pengon shitjen në këndvështrimin e tij, derisa objekti vazhdon të cilësohet me para.

Në të vërtetë, ajo që ne thamë për moslejimin e marrjes në pronësi të xhamisë me anë të shitjes, është lejim për marrjen nën kontroll.

Ajo që përforcon fjalën e këtij fakihu të madh për mospasjen dallim se fakti që e bën të lejueshme shitjen e vakëfeve të tjera përveç xhamisë kur ato shemben, në të vërtetë, e lejon, sepse shembja e shkatërrimi mohon qëllimin për të cilin është lënë vakëfi, ose mohon prej vakëfit cilësinë për të cilin vakëflënësi ka

lënë vakëfin, ose i së kusht vakëfit, si për shembull, vakëflënësi ka lënë vakëf një pemishte, për faktin se ajo është pemishte.

Pikërisht kjo analogji është vepruese edhe për xhaminë, sepse falja e namazit në atë xhami ishte e kushtëzuar me faktin se ajo xhami ishte vakëf dhe, kur kushti për të cilin është lënë ai vakëf, nuk ekziston më, patjetër që nuk ekziston as vetë vakëfi, ose nuk ekziston më cilësia xhami që merret në konsideratë në fjalën xhami, atëherë mbi këtë vakëf-xhami bëhet veprues rregulli që vepron mbi vakëfet e tjera për lejimin e marrjes në pronësi edhe të xhamisë me njërin prej shkaqeve që lejon marrjen në pronësi të vakëfit jo xhami, qoftë edhe me anë të marrjes nën kontroll.

Pasuritë e xhamisë

Zakonisht xhamia disponon vakëfe, si: dyqan, pemë frutore ose ndonjë parcelë toke, etj. Të ardhurat prej këtyre vakëfeve të xhamisë shpenzohen për mirëmbajtjen e xhamisë, për shtrojat e xhamisë dhe për shërbyesin e xhamisë. Është e kuptueshme që mbi këtë lloj vakëfi nuk mund të renditen dispozitat e respektit të veçantë që gëzon xhamia, si dhe përparësia që ka xhamia, nga fakti se në xhami falet namaz. Këtu është edhe dallimi mes xhamisë dhe mes pasurive e pronave të lëna vakëf për xhaminë.

Gjithashtu, mes xhamisë dhe pronave e pasurive të lëna për xhaminë ka dallim edhe nga ana e shitjes. Ai që e ndalon shitjen e xhamisë për shkak të shembjes, ai ka të drejtë ta lejojë edhe shitjen e vakëfeve të lëna për xhaminë, kur nuk ka as lidhje ligjore e as lidhje jo ligjore mes xhamisë dhe vakëfeve të lëna për xhaminë, sepse xhamia është vakëf për adhurim, domethënë, xhamia është

për qëllime të pastra shpirtërore. Dyqani është vakëf për përfitimin material që ai sjell, kurse xhamia është vakëf i lënë për të gjithë, madje është vakëfi i vetëm në tërësinë e vakëfeve, ndërsa vakëfet e lëna për xhaminë janë prej llojit e vakëfit të lënë për persona të veçantë, domethënë që lejohet shitja e vakëfeve të lëna për xhaminë dhe pa dyshim lejohet shitja edhe për vakëfet e lënë për varrezën e shkollën, edhe pse ne jemi shprehur për moslejimin e shitjes së shkollës e të varrezës.

Shtrohet pyetja: A lejohet shitja e objekteve të lëna për të qenë në shërbim të vakëfeve të pakushtëzuara, edhe kur nuk ekziston ndonjë shkak që lejon shitjen, si për shembull, shembja e shkatërrimi i vakëfit, ose humbja e prodhimit, apo patjetër duhet të ekzistojë një justifikues për shitjen, pasi çështja në këtë vakëf është si vakëfi i lënë për pasardhësit, si dhe i vakëfeve të tjera të lëna për persona të veçantë?

Përgjigje:

Këto objekte janë dy llojesh: lloji i parë, objektet që bën vakëf kujdestari prej të ardhurave të vakëfit, si për shembull, xhamia ka një pemishte, të cilën kujdestari e jep me qera dhe me këtë qera kujdestari ndërton një dyqan që prej tij të përfitojë vakëfi, ose ai e ndërton dyqanin me donacionet e bamirësve. Nëse puna qëndron kështu siç u shtrua, lejohet shitja dhe ndërrimi i këtij vakëfi të bërë, patjetër kur e kërkon interesi. Kjo është e barabartë, qoftë kur ekziston njëri prej shkaqeve që kanë përmendur fukahatë që lejojnë shitjen, qoftë kur shkaku nuk ekziston, sepse këto objekte nuk janë vakëf, por, në të vërtetë, ato

janë produkt dhe pasuri për vakëfin, me të cilat kujdestari vepron në përputhje me interesin e vakëfit, plotësisht ashtu siç vepron me frutat dhe me pemishten e lënë vakëf për interesin e xhamisë.[1]

O Zoti im, vetëm nëse sundimtari ka bërë vakëf arën, të cilën e ka blerë kujdestari, atëherë ara nuk shitet, nëse nuk ekziston shkaku që justifikon shitjen. Vakëfi me administrator nuk ka asnjë efekt pa lejen e sundimtarit, sepse sundimtari është kujdestari për ruajtjen e atij vakëfi e për shfrytëzimin e tij, por ai nuk është kujdestar për lënie vakëfesh.

Lloji i dytë, objekte që bamirësit i lënë vakëf për interesin e xhamisë ose për interesin e shkollës, si për shembull, burri lë testament që shtëpia e tij, ose dyqani i tij, ose ara e tij të jetë vakëf për xhaminë ose për shkollën, ose ai vetë e lë vakëf njërin prej këtyre objekteve. Në këtë gjendje, objekti në fjalë hyn në dispozitën e vakëfeve të lëna për persona të veçantë, domethënë që këto objekte vakëf lejohen të shiten me njërin prej shkaqeve të lejimit, si për shembull, shembja, humbja e të ardhura të pronave të lëna për vakëfin. Në të gjitha librat e të katër shkollave juridike islame (medh'hebeve) që kam parë, nuk kam gjetur ndonjë fakih që të ketë shkuar deri në këtë ndarje subjektive.

Unë e kam theksuar atë që ka përmendur shejkh El Ensarij në librin "El Mekasib", ku ai flet për dispozitën e rrogozit të xhamisë. Tekstualisht ka thënë: "Ka një dallim në atë që është

[1] Duhet të tërheqim vëmendjen në lidhje me dallimin mes arës që ne e blejmë me produktin e vakëfit dhe mes shitjes së vakëfit të shembur me çmimin e të cilit ne blejmë një arë tjetër. Në këtë gjendje, objekti i dytë hyn në dispozitën e objektit të parë, kurse ara që ne blejmë me produktin e vakëfit, nuk hyn në dispozitën e vakëfit.

pasuri në përgjithësi, si për shembull, rrogozi i blerë me pasurinë e xhamisë.

Këtë rrogoz kujdestarit i lejohet ta shesë, nëse e kërkon interesi, edhe kur prej atij rrogozi akoma mund të përfitohet, madje edhe nëse nuk është përdorur, por ka dallim, nëse sendi është lënë vakëf për xhaminë, si për shembull, burri ble një rrogoz dhe e lë në xhami, ose mbulesa për Shtëpisë e Shenjtë (Qabenë), këto sende janë pronë e të gjithë myslimanëve, prandaj atyre nuk u lejohet as të ndërrojnë vendin e atij objekti, me përjashtim të vendeve në të cilat lejohet shitja e vakëfit."

Meqenëse për kujdestarin lejohet ta shesë rrogozin e ri që vetë e kishte blerë me paratë e xhamisë, padyshim që për atë lejohet edhe shitja e objekteve të tjera. Për mospasjen dallim tregon vetë fjala e shehut që ai ka shkruar disa rreshta më poshtë, se fjalia e mësipërme e tij: "Dispozita për banjat (për larje trupi) dhe dyqanet e ndërtuara për të pasur përfitime me anë të qerasë e me të tjera rrugë, nuk është dispozita për xhamitë, shkollat dhe vendet e mira."

Plotësisht si kjo thënie është edhe thënia e dijetarit En Nàijmij në librin "Takrijràtul Khauansàrij", ku ai ka thënë: "Kur xhamia shembet, ose braktiset, për rrjedhojë, ajo xhami s'ka më nevojë as për vakëfe e as për ndonjë gjë tjetër, në këtë gjendje, të ardhurat prej vakëfit të veçantë të shpenzohen për punë bamirësie. Por më e mira është që ato të ardhura të shpenzohen për një xhami tjetër."

E njëjta gjë është kur vakëfi është lënë për një shkollë ose për një klinikë të përcaktuar, por shkolla ose klinika shembet, atëherë të ardhurat e vakëfit shpenzohen për punë bamirësie.

Përveç xhamisë

Më sipër theksuam thëniet e medh'hebeve në lidhje me xhaminë. Gjithashtu, theksuam se imamitë, shafitë, hanefitë dhe malikitë, janë shprehur kundër hanbelive për shitjen e xhamisë.

Imamijtë, në lidhje me shitjen e vakëfeve të tjera, me përjashtim të xhamisë, kanë një rrugë tjetër, prandaj, në radhë të parë, do të theksojmë thëniet e katër medh'hebeve islame dhe më pas do të trajtojmë në veçanti thëniet e imamive.

Meqenëse hanbelitë lejojnë shitjen e xhamisë, kur ekziston shkaku, patjetër që te hanbelitë do të ketë më shumë përparësi shitja e vakëfeve të tjera përveç xhamisë, ose edhe ndërrimi i atyre vakëfeve, kur ekziston shkaku që e bën të detyrueshme shitjen e atij vakëfi.

Është fakt që shafitë ndalojnë në mënyrë kategorike shitjen dhe ndërrimin e vakëfeve, edhe kur vakëfi është vakëf i veçantë, si për shembull, vakëfi i lënë për pasardhësit. Për këtë ata kanë gjetur një mijë e një shkaqe dhe kanë lejuar për personat, për të cilët është lënë, që ata ta shfrytëzojnë vetë vakëfin e veçantë, kur ekziston shkaku, si për shembull, pema thahet dhe nuk mund të japë më fruta. Në këtë gjendje, personat për të cilët është lënë vakëfi kanë të drejtë ta marrim këtë pemë dhe ta përdorin për

lëndë djegëse, por atyre nuk u lejohet as ta shesin e as ta ndërrojnë atë pemë.

Në lidhje me qëndrimin e malikive për shitjen e vakëfit, në librin "Koment" të Ez Zerkànij Ali Ebij Dijaë thuhet se vakëfi lejohet të shitet vetëm në tri gjendje: e para, kur vakëflënësi ka vënë kusht shitjen e vakëfit në kohën e lënies së vakëfit, atëherë veprohet sipas kushtit të vënë prej vakëflënësit.

E dyta, vakëfi i lënë është prej llojit të objekteve të transportueshme, për rrjedhojë, prej atij vakëfi nuk mund të përfitohet, atëherë ai vakëf shitet dhe shuma e përfituar shpenzohet për vakëfe të tjera të ngjashme.

E treta, ara-vakëf shitet nga domosdoshmëria për të zgjeruar xhaminë, ose për të zgjeruar rrugën, ose për të zgjeruar varrezën. Përveç këtyre tri rasteve, shitja e vakëfit arë nuk lejohet, qoftë edhe kur ajo tokë është degraduar deri në atë shkallë sa nuk mund të shfrytëzohet për asgjë.

Hanefitë, nga ana e tyre, kanë cituar Ebu Zehren në librin "Vakëfi" dhe e kanë lejuar ndërrimin e vakëfit në të gjitha vakëfet e veçanta dhe të përgjithshme, me përjashtim të xhamisë dhe kanë lejuar shitjen e vakëfit vetëm në tri gjendje: Gjendja e parë: Vakëflënësi ka vënë kusht shitjen e vakëfit në kohën e lënies së vakëfit.

Gjendja e dytë: Vakëfi arrin në një gjendje, ku nuk mund të përfitohet më prej tij.

Gjendja e tretë: Prej ndërrimit ka më shumë dobi e më shumë prodhim dhe nuk është vënë kusht prej vakëflënësit që të ndalojë shitjen.

Shkurtimisht këto ishin thëniet e katër medh'hebeve në lidhje me shitjen e vakëfit me përjashtim të xhamisë dhe, ashtu siç e pe, për çështjen e shitjes së vakëfit në të katër medh'hebet, nuk ka asnjë dallim mes vakëfit të veçantë dhe vakëfit të përgjithshëm, përjashto xhaminë. Imamitë bëjnë dallim mes vakëfit të veçantë dhe vakëfit të përgjithshëm.

Vakëfi i përgjithshëm dhe vakëfi i veçantë

Imamitë e kanë ndarë vakëfin në dy lloje dhe për çdo njërin prej dy llojeve, jo vetëm që kanë vënë dispozitë të veçantë, por kanë dhënë edhe ndikimet që vijnë prej atij vakëfi.

Ndikimi i parë: Vakëfi i veçantë është pronë e personave për të cilët është lënë ai vakëf, domethënë atyre që kanë të drejtë ta shfrytëzojnë këtë vakëf dhe të përfitojnë prej tij. Prej vakëfit të veçantë kemi vakëfin e lënë për pasardhësit, vakëfin e lënë për dijetarët, vakëfin e lënë për të varfrit, vakëfin tokë të lënë për interesin e xhamisë, ose për varrezën, ose për shkollën, apo për të tjera institucione të kësaj kategorie. Ky është lloji i vakëfit për të cilin fukahatë kanë kundërshtime mes tyre, nëse lejohet shitja e këtij lloj vakëfi, kur ekzistojnë shkaqet që e bëjnë të detyrueshme shitjen e tij, apo në mënyrë absolute nuk lejohet shitja e këtij lloj vakëfi, edhe sikur të ekzistojnë një mijë e një shkaqe që e bëjnë të detyrueshme shitjen e tij.

Ndikimi i dytë: Vakëfi i përgjithshëm, është vakëf i lënë, që prej tij të përfitojnë njerëzit, të gjithë njerëzit dhe jo që të përfitojë prej atij vakëfi vetëm një shtresë e caktuar, apo vetën një kategori e caktuar njerëzish. Prej këtij lloj vakëfi janë shkollat, klinikat, xhamitë, objektet e shenjta, varrezat, urat, bujtinat që ishin në kohët e mëparshme, krojet e ujit të pijshëm, pemët e mbjella në rrugët ku kalojnë këmbësorët, të gjitha këto hyjnë në dispozitën e xhamive, varrezave dhe objekteve të shenjta, sepse ato nuk janë të veçanta për një mysliman dhe nuk janë për tjetrin, as nuk janë vetëm për një shtresë prej myslimanëve dhe nuk janë për një shtresë tjetër prej tyre.

Imamitë ndajnë një fjalë të përbashkët se vakëfet e përgjithshme nuk lejohen as të shiten e as të ndërrohen, qoftë edhe kur shemben, ose janë gati të shkatërrohen e të humbin, sepse këto vakëfe te imamaitë, ose më saktë te pjesa me e madhe e imamive, janë shpërbërje pasurie, domethënë nxjerrja e tyre prej pasurisë së pronarit të tyre të parë dhe bërja e tyre pa pronar, kështu që këto vakëfe, pas lënies së tyre vakëf, bëhen plotësisht si të gjitha objektet e lejuara publike.

Është e kuptueshme që shitje mund të ketë vetëm për pronën, në kundërshtim me vakëfet e veçanta, sepse ato janë shndërrim i pronësisë, nga pronë e vakëflënësit ato bëhen pronë e personave për të cilët është lënë ai vakëf, ose për njërin prej enteve për të cilat mund të jetë lënë vakëfi. Vetëkuptohet se, kur ndërpritet plotësisht ana për të cilën është lënë vakëfi, lejohet që ai vakëf të jepet vakëf në një anë tjetër të afërt me anën e parë, si për shembull, shkollën e braktisin nxënësit, në atë mënyrë sa është e pamundur që në atë shkollë të zhvillohet mësim. Në këtë gjendje,

lejohet që kjo shkollë të kthehet në bibliotekë publike ose në sallë leksionesh.

Në çështjen e xhamive kemi theksuar se, kur ndalohet marrja në pronësi me anë të shitjes, ndalohet marrja në pronësi edhe me anë të kujdestarisë. Gjithashtu, kemi theksuar se autori i librit "Mulhakàtul Urveh" i është përgjigjur fukahave për mospasjen dallim mes vakëfit të veçantë dhe vakëfit të përgjithshëm dhe se shkaku që justifikon shitjen e vakëfit të veçantë, justifikon edhe shitjen e vakëfit të përgjithshëm. Gjithashtu, ai nuk pohon se vakëfi i përgjithshëm është prej llojit të shpërbërjes së pronës dhe i çlirimit të saj dhe, kur supozohet se vakëfi i përgjithshëm është i tillë. Te ky autor, nuk ka ndonjë ndalues që pengon shitjen, sepse justifikuesi për shitjen e vakëfit, në këndvështrimin e tij, është i zhveshur prej cilësive të sendit pronë.

Në lidhje me fjalën e fukahave dhe me fjalën e sej'jidt, ne kemi konstatimet tona dhe fukahave u përgjigjemi se mosekzistenca e pronës, ndalon marrjen në pronësi me anë të shitjes, por ajo nuk e ndalon marrjen e asaj prone nën kontroll. Gjithashtu, edhe prona vetëm si pronë nuk e justifikon shitjen, kështu që objekti i lënë peng, padyshim që është pronë të cilën penglënësi e ka në pronësi, megjithëkëtë shitja e objektit të lënë peng nuk lejohet, përveçse me lejen e pengpranuesit.

Sej'jidit ne i përgjigjemi se vetëm cilësimi si pasuri nuk sjell asnjë dobi, sepse edhe peshqit në ujë e shpendët në ajër janë një lloj pasurie, megjithëkëtë shitja e tyre aty ku janë, nuk lejohet.

Si përfundim themi se rrugët e marrjes në pronësi reduktohen vetëm me marrjen nën kontroll.

Varreza

Më sipër u shpjegua se varreza është prej vakëfeve të përgjithshme, ashtu si xhamia. Gjithashtu, u shpjegua se imamitë nuk e lejojnë shitjen e vakëfit të përgjithshëm në asnjë gjendje, madje edhe kur objekti vakëf shembet ose degradohet. Prej Mufijdit kam parë që të veçojë varrezën në këtë paragraf për dy çështje:

Çështja e parë: Për shkak të nevojës, ka vend për të shpjeguar dispozitën, pasi shumë prej varrezave të myslimanëve janë braktisur dhe në vend të varrezave të braktisura janë bërë varrezë të reja.

Çështja e dytë: Varreza, në shumicën e rasteve, është një gjendje ndryshe prej vakëfeve të tjera dhe kjo gjendje ndryshe bëhet e qartë prej shpjegimeve vijuese:

Sikur ne të dimë që një njeri ka lënë tokën e vet vakëf për varrezë dhe ajo tokë është përdoruar për varrim, mbi atë tokë vepron dispozita e vakëfit të përgjithshëm, pra, është bërë prej vakëfeve që nuk lejohet të shitet, edhe sikur të jenë asgjësuar gjurmët e atij vakëfi dhe nga eshtrat e të vdekurve të mos ketë mbetur asnjë shenjë, pasi janë tretur në dheun e varrit.

Kur ne e dimë që një parcelë më përpara ka qenë varrezë, domethënë që askush nuk e ka pasur në pronësi dhe me pas atë banorët e fshatit e kanë bërë varrezë, ashtu siç është gjendja e

varrezave zakonisht, si bazë, ajo parcelë nuk është as vakëf i përgjithshëm e as vakëf i veçantë, por mbetet pronë e përbashkët, të cilën e merr nën kontroll ai që e merr i pari dhe, kur në një pjesë të asaj parcele varroset një i vdekur, nuk lejohet që në atë parcelë të varroset tjetër kush veç atij që u varros, ose që dikush ta përdorë si tokë të degraduar, por çdo njeri ka të drejtë të ringjallë prej asaj parcele cilën pjesë të saj që të dëshirojë, qoftë duke e ringjallur me ndërtime, qoftë duke e përdorur për bujqësi, me kusht që ajo pjesë të jetë pa varre, ose në atë pjesë të parcelës ishte një varr i vjetër, por tanimë kockat e atij të vdekuri janë bërë njësh me dheun, ose janë bërë pluhur, kjo pjesë e kësaj parcele për personin që e ringjall, është e lejuar, plotësisht ashtu siç lejohet për atë që ringjall një tokë më të gjerë se kjo pjesë e asaj parcele, ose këtë tokë e ka braktisur ai që e kishte ringjallur më parë, qoftë edhe nëse ringjallësi i parë rikthehet para ringjalljes prej të dytit.

Ne nuk e dimë gjendjen, gjithashtu, nuk dimë se kjo parcelë që është përdorur për varrezë, nëse ka pasur pronar dhe, nëse ka pasur pronar, ai e ka lënë atë vakëf dhe që të jetë vakëf në dispozitën e vakëfit, apo në origjinë ajo parcelë ka qenë tokë e vdekur dhe më pas banorët e fshatit e kanë përdorur për të varrosur aty të vdekurit e tyre. Nëse puna qëndron kështu siç u shtrua, kjo parcelë nuk hyn në dispozitën e vakëfit, sepse, në origjinë, ajo nuk ishte vakëf, derisa të vërtetohet e kundërta me argument ligjor.

Ti mund të thuash që vakëfi vërtetohet nga fakti që është pronë e përbashkët, përse me të njëjtin fakt të mos vërtetohet si vakëf edhe kjo varrezë?

Përgjigjja jonë për këtë pyetje është: Kur arrihet të vërtetohet qenia pronë e përbashkët, ajo varrezë është vakëf. Po japim një shembull: Është përcjellë brez pas brezi që filani e ka lënë atë parcelë vakëf për varrezë. Nëse puna qëndron kështu, patjetër dhe në mënyrë të prerë, edhe ne vërtetojmë që ajo parcelë është vakëf, por vetëm thjesht fakti që kjo varrezë është pronë e përbashkët, nuk shërben si fakt që të vërtetojë qenien vakëf, pasi kërkesa është që ne të dimë mirë që ajo parcelë është varrezë. Gjithashtu, të dimë se askush nuk ka ndonjë konflikt në lidhje me faktin që ajo parcelë është varrezë, megjithëkëtë, thjesht fakti që mësuam se ajo parcelë është varrezë, përsëri nuk vërteton që ajo është vakëf, pasi ajo parcelë, vërtet mund të ketë qenë varrezë, por mund të mos ketë qenë vakëf, por ka qenë pronë e përbashkët. Në këtë gjendje, dihet që vakëfi i veçantë nuk vërteton ekzistencën e vakëfit të përgjithshëm.

Nënçështje

Një njeri hap një varr, me qëllim që, kur të vdesë, ta varrosin në varrin e parapërgatitur prej tij, në këtë varr lejohet të varroset një tjetër, edhe sikur vendi të jetë i gjerë për të hapur një varr tjetër. Gjithsesi, me qëllim për të mënjanuar fyerjen e besimtarit, është më mirë dhe më e pëlqyeshme që ai varr të lihet për atë që e ka përgatitur.

Shkaqet justifikuese

Më sipër shpjeguam se fukahatë e imamive ndajnë një fjalë të përbashkët se vakëfet e përgjithshme, si xhamitë e varrezat, apo të tjera të ngjashme, nuk lejohet të shiten, por fukahatë kanë mendime të ndryshme në lidhje me shitjen e vakëfeve të veçanta, kur ekziston shkaku që justifikon shitjen, si për shembull, vakëfi i lënë për pasardhësit, ose për dijetarët, ose për të varfrit. Në vijim rendisim shkaqet që kanë përmendur fukahatë për justifikimin e shitjes së vakëfit të veçantë:

1- Objekti vakëf nuk sjell asnjë dobi për qëllimin për të cilin është lënë vakëf, si për shembull, trungu i pemës së tharë që nuk jep më fruta, ose rrogozi i grisur që vlen vetëm për zjarr, ose kafsha duhet të theret, pasi nuk shërben për gjë tjetër përveç që të përdoret për ngrënie, pa dyshim që në këto raste kemi të bëjmë me një shkak që justifikon shitjen.

2- Sej'jid Ebul Hasan El Asfehànij, në librin "Uesijletu Nexhàt", ka thënë: "Pajisjet, shtrojat, veshjet e vendeve të shenjta dhe të ngjashme me këto që u thanë, nëse është e mundur që prej këtyre gjërave të përfitohet, me kusht që ato të mbeten në gjendjen që janë, shitja e tyre nuk lejohet, por, nëse ai vend nuk ka nevojë për këto gjëra, në atë mënyrë që sikur ato të lihen aty, do të prishen, ose do të kalben, në të këtë gjendje, ato dërgohen në vend tjetër të ngjashëm. Nëse nuk gjendet një vend i ngjashëm, ose ai vend gjendet, por nuk ka nevojë për këto gjëra, atëherë ato shpenzohen për interesa të përgjithshme.

Në qoftë se prej këtyre gjërave mund të përfitohet vetëm duke i shitur, ose nëse do të mbaheshin, ato do humbnin, ose do të

asgjësoheshin, në këtë gjendje, ato shiten dhe çmimi i marrë shpenzohet në vendin për të cilin janë dhënë, nëse ai vend ka nevojë për ato gjëra. Nëse vendi nuk ka nevojë, shpenzohen për vende të ngjashme dhe, nëse edhe këto të fundit nuk kanë nevojë për këto gjëra, atëherë ato shpenzohen për interesin e përgjithshëm.

3- Vakëfi prishet, si për shembull, shtëpia shembet, prej kopshtit nuk mund të përfitohet më, ose përfitimi prej atij kopshti është aq i pakët, sa mund të thuhet se nuk jep asgjë, nëse është e mundur, në atë vakëf bëhen ndërtime, ose jepet me qera për disa vjet, ndryshe shitja e këtij vakëfi lejohet, me kusht që me çmimin e realizuar prej shitjes të blihet një objekt tjetër që të zëvendësojë objektin e parë, ashtu siç do të shikojmë më poshtë.

4- Kur vakëflënësi ka vënë kusht që objekti të shitet, nëse ndryshojnë personat për të cilët ai objekt është lënë vakëfi, ose kur ka vënë kusht për shitjen e objektit të lënë vakëf, nëse qeraja e marrë prej atij objekti është fare e paktë, ose vakëflënësi ka vënë kushte të atilla që nuk e bëjnë hallall haramin e nuk bëjnë haram hallallin, është detyrë të zbatohet kushti i vënë prej vakëflënësit.

5- Mes pronarëve të vakëfit ka mosmarrëveshje, nga të cilat është frikë se mund të ndodhë ndonjë humbje jete ose mund të pësojë humbje vetë vakëfi, domethënë jemi para një gjendjeje në të cilën konflikti për këtë vakëf mund të gjejë rrugën e zgjidhjes vetëm duke e shitur atë. Në këtë gjendje, shitja lejohet dhe shuma e mbledhur prej shitjes u ndahet personave për të cilët është lënë vakëfi. Theksojmë që shitja lejohet vetëm nëse konflikti do të marrë fund me anë të shitjes.

Kështu kanë thënë…unë nuk di të ketë ndonjë koncept tjetër përveç atij që kanë përmendur fukahatë, domethënë konceptit për të sprapsur dëmin me të madh dhe, dihet që dëmi nga vetvetja sprapset duke e kaluar dëmin te një tjetër, kurse me shitjen dëmi kalohet mbi brezat që do të vijnë.

6- Kur ka mundësi, shitet një pjesë e vakëfit të prishur dhe shuma e realizuar nga shitja, shpenzohet për të përmirësuar pjesën tjetër të atij vakëfi, kjo shitje lejohet.

7- Kur xhamia shembet, gurët e kësaj xhamie, dërrasat, dyert e të gjitha pajisjet e saj nuk hyjnë në dispozitën e xhamisë, as në dispozitën e tokës së lënë vakëf, që të jetë në shërbim të xhamisë, shitja e këtyre materialeve të xhamisë lejohet vetëm me një justifikues, sepse të gjitha këto hyjnë në dispozitën e pasurive të xhamisë, por prodhimi i vakëfeve të xhamisë është plotësisht si qeraja e dyqanit, për të cilën veprohet sipas mendimit të kujdestarit, i cili e di më mirë se ku është interesi i atij vakëfi.

Shuma e realizuar nga shitja e vakëfit

Kur vakëfi shitet për një shkak të justifikuar, ç'do të bëjmë me shumën e realizuar nga shitja? A duhet t'ia shpërndajmë atë shumë personave për të cilët është lënë vakëfi, plotësisht ashtu siç shpërndahet prodhimi, apo është detyrë që me atë shumë të blihet një objekt tjetër i ngjashëm, nëse kjo është e mundur, me kusht që objekti i dytë të zërë vendin e objektit të parë?

Fakiju El Ensarij dhe shumë juristë të tjerë të ligjit të fesë, (fukaha) prej atyre që kanë arritur gradën e interpretimit të

dispozitave, kanë thënë: "Çmimi ka të njëjtën dispozitë si dispozita e vakëfit të parë, për të cilin nuk dihet se kush është pronari i atij vakëfi. Në qoftë se si çmim për shitjen e atij vakëfi është marrë një arë, ara e marrë si çmim zë vendin e vakëfit të parë, në qoftë se shuma e realizuar nga shitja është para, me ato para blejmë sendin që është më i mirë. Për vakëfin zëvendësues nuk është e nevojshme formula e vakëfit, sepse vetë zëvendësimi, me natyrën e tij, kërkon që i dyti të jetë si i pari, pa asnjë dallim. Ky është edhe shkaku që autori i librit "Gajetul Murad", ka thënë: "Ai, zëvendësuesi, është objekt në pronësi, aq sa ishte në pronësi i pari, domethënë që është e pamundur marrja veç e atij objekti në pronësi."

Në librin "El Mekasib", nga fundi i fjalës rreth formës së parë prej formave të lejimit të shitjes së vakëfit, autori ka thënë: "Kur është e pamundur që me shumën e realizuar nga shitja të blejmë një arë, çmimi lihet te një njeri besnik në pritje të rastit dhe, kur nevoja kërkon që me këtë shumë të bëhet tregti, kjo është e lejueshme, por fitimi nuk u ndahet atyre që kanë të drejtë ta marrin, ashtu siç marrin prodhimin, pasi dispozita e kësaj shume është si dispozita për origjinën e vakëfit, sepse edhe çmimi është pjesë e objektit të vënë në shitje dhe nuk është si rritja e vërtetë e fitimit."

Kështu është shprehur studiuesi El Ensarij dhe vetëm ai e di qëllimin që kishte me ato fjalë. *(Pastë kënaqësinë e Allahut!)* Personalisht nuk kam arritur të kuptoj dallimin mes fitimit të tregtisë me pasurinë e vakëfit dhe mes frutave që jep objekti i lënë vakëf, të cilat u shpërndahen atyre që kanë të drejtë të marrin prej frutave të atij vakëfi, po ashtu duhet të shpërndahet edhe fitimi.

O Zoti im, vetëm nëse thuhet që prodhimi i tokës vakëf nuk është prej llojit të sendeve të lëna vakëf, madje është e kundërta e vakëfit, kurse fitimet e realizuara me tregti, janë prej llojit para, prandaj te ai ato nuk ndryshojnë aspak dhe, kur arrihet dallimi, dispozita ndryshon.

Sido që të jetë, kur mendimi sprapset, ai gjen zgjidhje për çdo problem e për çdo komplikim, por kjo është vetëm nga ana teorike dhe vetëkuptohet që mësimi e këshilla merret vetëm nga ana praktike.

Në realitetin që kapet me anë të shqisave, sipas traditës, nuk ka dallim mes dy gjendjeve dhe mbi këtë interpretim është bazuar shembulli që ne kemi në trajtim.

Shejhu En'nàijinij, në librin "Takrijràtul-Khavansàrij", ka thënë: "Kur me çmimin e marrë prej objektit të parë blihet një objekt i ri, objekti i dytë nuk merr dispozitën e të parit dhe nuk është vakëf siç ishte objekti i parë, por është plotësisht si prodhimi i vakëfit, domethënë, lejohet shitja e atij objekti pa sjellë justifikuesit, kur kujdestari i atij vakëfi mendon që shitja është me interes.

E vërteta është ashtu siç janë shprehur El Ensarij, Shehijdu Thanij dhe fukaha të tjerë përveç këtyre të dyve për mospasjen dallim mes zëvendësuesit e objektit që ai zëvendësoi.

* * *

EL-HABSU UES'SEKNÀ

El habsu

Zakonisht fukahatë, pasi kanë përfunduar fjalët e tyre rreth kapitullit "Vakëfi", kanë shkruar edhe një kapitull të veçantë, në të cilin flasin për "El habsu", "Es seknà", "El umrà" dhe "Err rrakbà".

Me fjalën "el habsu" ata kuptojnë: Njeriu të lejojë dobinë e një sendi që ai ka në pronësi për një drejtim prej drejtimeve për të cilin ai e ka lënë, me kusht që sendi të mbetet pronë e tij. Në qoftë se ai, atë send e ka lënë për punë bamirësie, atëherë shikohet: Nëse nuk e ka lënë për një kohë të përcaktuar, ai send nuk kthehet më as te pronari e as te trashëgimtarët e tij. Sendi i lënë bëhet plotësisht si vakëfi. Kjo është e barabartë, qoftë kur ai e ka shpallur të ndaluar për veten e tij përgjithmonë, qoftë kur lënien e ka kushtëzuar në kohë, por nuk e ka shprehur kushtëzimin. Në qoftë se ai e kufizon ndalimin me kohë të përcaktuar, ai s'ka të drejtë të kërkojë kthimin e atij sendi, pa përfunduar koha e përcaktuar prej atij vetë, domethënë që vetëm atëherë dobia e atij sendi do të jetë për pronarin.

Në qoftë se ai e ka ndaluar sendin për veten e tij dhe e ka lejuar për një person, nëse ka caktuar një kohë, dobia e atij sendi mbetet për personin që u lejua të përfitojë prej atij sendi dhe vetëm pas mbarimit të këtij afati, dobia kthehet te pronari, ose te trashëgimtarët e tij. Në qoftë se ai nuk ka e ka kufizuar dhënien në kohë të përcaktuar, ai send mbetet i ndaluar gjatë gjithë jetës së ndaluesit dhe pas vdekjes së tij bëhet trashëgimi.

Muham'med ibn Muslim ka transmetuar prej Imam Bakirit, babait të Imam Xhaferr Sadikut *(Paqja qoftë mbi ta!)* se Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* ka gjykuar për kthimin e sendit të ndaluar dhe lënien e atij sendi për trashëgimtarët.

Autori i librave "Esh Sheràiu" dhe "El Xheuàhiru" ka thënë: "Kur ai e jep kalin e tij në rrugën e Allahut, ose skllavin e tij në shërbim të Qabes, ose të xhamisë, kjo dhënie zbatohet dhe nuk lejohet ndërrimi për aq kohë sa ekziston sendi. Në lidhje me këtë çështje, nuk ka asnjë kundërshtim në mesin e dijetarëve të fesë, ashtu siç ka pohuar dijetari El-Halij dhe dijetarë të tjerë përveç këtij. Por, kur burri i jep një send një burri tjetër dhe nuk ka përcaktuar për sa kohë e lë sendin në dorën e tij, por më pas, ky dhënës vdes, në këtë gjendje, sendi i dhënë është trashëgimi. E njëjta gjë është edhe kur ai ka përcaktuar kohën dhe koha përfundon. Edhe për këtë çështje nuk ka asnjë mendim ndryshe ose komplikim në mesin e fukahave dhe as për detyrimin për respektimin e kësaj dhënie të kushtëzuar, sepse fjala "respektoni kontratat" është përgjithësuese, si dhe rregulli tjetër "Besimtarët janë në kushtet e tyre", duke shtuar edhe transmetimin e lartpërmendur, të përcjellë për Muham'med bin Muslimit.

Çdo send që lejohet të lihet vakëf, ai send lejohet edhe të jepet në përdorim, por dhënia bëhet e detyrueshme vetëm atëherë kur merret në dorë dhe, kur vdes dhënësi, para se ta marrë në dorë personi për të cilin u dha ai send, dhënia nuk është më e vlefshme.

"Es seknà", "el umrà" dhe "err rrakbà"

"Es seknà", "el umrà"dhe "err rrakbà" janë një lloj dhurimi e dhënie, prandaj çdo njëra prej këtyre tre lloj dhënieve ka nevojë për ofertën dhe pranimin. Gjithashtu, është detyrim marrja në dorë e sendit të dhënë.

Fjala "es seknà" është specifike për banesën dhe forma e këtij lloj dhurimi apo dhënie është kur pronari i shtëpisë i thotë një tjetri: "Ta lashë ty për banim këtë shtëpi.", ose i thotë: "Ti ke të drejtë të banosh në këtë shtëpi, ose kjo shtëpi është e jotja për kaq kohë.", ose i thotë atij të tjera shprehje të ngjashme. Pranimi realizohet me çdo fjalë që tregon miratimin nga ana e atij që do të banojë në atë shtëpi. Në qoftë se dhënësi e shoqëron dhënien me fjalën "jetë" dhe "sa të jetosh", për shembull ai thotë se të lë të banosh në atë shtëpi gjatë gjithë jetës sime, ose gjatë gjithë jetës tënde, ose sa të jem unë gjallë, ose sa të jesh ti gjallë, kjo lloj dhënie e shtëpisë quhet "es seknà" dhe "el umrà".

Kur dhënësi i shoqëron këto dy fjalë me një kohë të caktuar, si për shembull, një vit, ose më pak, ose më shumë, kjo dhënie quhet "es seknà" dhe "err rrakbà".

Në qoftë se dhënësi, kur ka bërë ofertën e dhënies nuk ka përcaktuar kohë, atëherë kjo dhënie quhet vetëm "es seknà",

domethënë që prona nuk transferohet prej pasurisë së dhënësit, por ai që do të banojë në atë shtëpi, përfiton dobinë e banimit në atë shtëpi gjatë gjithë kohës së përcaktuar. Pikërisht për këtë shkak pronarit i lejohet ta shesë sendin e dhënë prej tij, por dhënia për banim e shtëpisë nuk prishet për shkak të shitjes.

Imam Bakiri, baba i Imam Xhaferr Sadikut *(Paqja qoftë mbi ta!)*, ka thënë: "Shitjen nuk e prish qeradhënia e as "es seknà", por ai e shet dhe blerësi nuk merr në pronësi objektin që bleu, derisa të përfundojë marrëveshja "es seknà" sipas kushtit të vënë prej dhënësit."

Pronari nuk ka të drejtë të nxjerrë jashtë banuesin para përfundimit të afatit të caktuar. Në qoftë se dhënësi e ka vënë kusht kohën sa të jetë gjallë ai vetë dhe banuesi vdes para dhënësit, e drejta e banimit i takon trashëgimtarëve të banuesit, derisa të vdesë pronari. Kur dhënësi e ka caktuar kohën e banimit gjatë gjithë jetës së banuesit dhe pronari vdes para banuesit, askush nuk ka të drejtë të kundërshtojë banuesin.

Në qoftë se pronari nuk ka caktuar kohë për dhënie, pronari ka të drejtë ta kthejë kur të dëshirojë.

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* është pyetur për një burrë që ka vënë të banojë në shtëpinë e tij një burrë tjetër dhe nuk ka përcaktuar për sa kohë do të jetojë. Si duhet të veprohet në këtë rast? Ai *(Paqja qoftë mbi të!)* është përgjigjur: "I zoti i shtëpisë e nxjerr atë kur të dëshirojë."

Fjalët "el umrà" dhe "err rrakbà" nuk janë të veçanta vetëm për banesën, por përfshijnë dhënien e dhurimin e çdo sendi që lejohet të lihet vakëf, si: shtëpi, tokë, kafshë, mobilje, etj.

Autori i librit "E Xheuahir" ka thënë: "Me këtë janë shprehur shumë fukaha, madje unë për këtë çështje nuk gjej asnjë mendim ndryshe në mesin e fukahave. Gjithashtu, në librin "Et Tedhkireh" thuhet qartë se kjo çështje gëzon fjalën e përbashkët të fukahave, për shkak të argumenteve përgjithësuese.

Për këtë çështje është edhe transmetimi i ardhur në "Sahijhun" e Muham'med bin Muslimit, i cili ka thënë: "Pyeta Imam Bakirin, babain e Imam Xhaferr Sadikut *(Paqja qoftë mbi ta!)*, për një burrë që i kishte dhënë skllaven e vet një të afërmes së tij (me të cilën ai nuk ka të drejtë të martohet (dhàti mahrem"), derisa të ishte gjallë skllavja. Si duhet të veprojë ky burrë? I kujt është skllavja? Imam Bakiri *(Paqja qoftë mbi të!)* është përgjigjur: "Ajo, skllavja, është për të afërmen, ashtu siç e ka vënë kusht pronari i skllaves."

Fjala "el umrà" do të thotë: dhënësi e cakton kohën me jetën e njërit prej atyre të dyve, dhënësit e pranuesit. Forma e kësaj lloj dhënieje, apo dhurimi është që dhënësi të thotë: "Ta lashë këtë tokë, kafshë, makinë, sa ta kesh jetën, sa të rrosh, ose sa të rroj unë.", ose dhënia është e shoqëruar me të tjera fjalë të kësaj kategorie.

Fjala "err rrakbà" do të thotë që dhënësi e kufizon dhënien me kohë të përcaktuar, si një vit, ose më pak, ose më shumë dhe i thotë se këtë ta lashë për kaq kohë, ose ti do të marrësh dobinë e kësaj për kaq kohë, ose kjo është për ty për kaq kohë.

Në mënyrë të përmbledhur themi: Kur dhënia është thënë për banimin, quhet "es seknà"; kur dhënia është thënë duke

përmendur jetën, ajo quhet “el umrà” dhe, kur dhënia është thënë duke përmendur kohën, ajo quhet “err rrakbà”.

“es seknà” bashkohet me “el umrà”, kur dhënësi ka përmendur jetën e njërit prej atyre të dyve dhe “es seknà” bashkohet me “err rrakbà”, kur dhënësi ka përmendur kohën.

“el umrà” dhe “err rrakbà” ndahen prej “es seknà” për sendet e tjera, përveç lënies për banim.

* * *

NDALIMI (el haxhru)

Kuptimi i fjalës "ndalim"

Në tekstin arabisht, fjala "el haxhru", do të thotë ashtu siç është përkthyer, "ndalim". Në këtë kuptim është edhe fjala e Allahut të Lartësuar:

"وَيَقُولُونَ حِجْراً مَّحْجُوراً"

"...dhe ato u thonë: është e ndaluar çdo e mirë." (Sure "El Furkan", ajeti 22)

Te fukahatë, fjala "el haxhru" do të thotë: Njeriu ndalohet të veprojë në të gjitha pasuritë e tij, ose në disa prej pasurive të tij dhe për këtë ndalim ka shkaqe, si për shembull, penglënia, e cila e ndalon penglënësin të veprojë me pasurinë e tij të lënë peng. Gjithashtu, prej shkaqeve është edhe braktisja e fesë islame, domethënë renegati, pasuria e të cilit gjatë jetës së tij i kalon trashëgimtarëve të tij. Kështu është edhe blerësi, i cili ndalohet të veprojë me sendin që bleu, derisa të paguajë çmimin, ashtu siç ndalohet edhe shitësi të verojë me çmimin që mori për sendin e shitur, derisa ta dorëzojë sendin e vënë në shitje.

Shkaqet e ndalimit, për të cilat do të flasim në këtë kapitull, janë pesë: çmendja, mosha e vogël, sëmundja, mendjelehtësia dhe falimentimi. Ndalimi për të sëmurin është për sëmundjen nga e cila ai vdes. Ndalimi vjen kur veprimi i tij është më shumë se një e treta e pasurisë së tij, sepse mbi një të tretën, pasuria është për trashëgimtarët e tij. Ndalimi i të falimentuarit për të vepruar me pasurinë, është për borxhdhënësit dhe ndalimi i të çmendurit, i të voglit dhe i mendjelehtit, është për interesin e tyre.

Ligjërimi i ndalimit

Ndalimi është vërtetuar me fjalën e përbashkët të fukahave dhe me tekst. Prej teksteve kemi fjalën e Allahut të Lartësuar:

"وَلاَ تُؤْتُوا السُّفَهَآءَ أَمْوَالَكُمُ الَّتِي جَعَلَ اللَّهُ لَكُمْ قِيَاماً وَارْزُقُوهُمْ فِيْهَا وَاكْسُوهُمْ وَقُولُوا لَهُمْ قَوْلاً مَّعْرُوفاً. وَابْتَلُوا الْيَتَامَى حَتَّى إِذَا بَلَغُوا النِّكَاحَ فَإِنْ آنَسْتُم مِّنْهُمْ رُشْداً فَادْفَعُوا إِلَيْهِمْ أَمْوَالَهُمْ"

"Mendjelehtëve mos u jepni pasuritë tuaja, për të cilat Allahu ju ka bërë mëkëmbës, t'i ushqeni e t'i vishni ata me këtë pasuri dhe t'u thoni atyre fjalë të mira. Jetimët t'i provoni, derisa ata të bëhen për martesë dhe, nëse te ata shikoni maturi, atëherë u dorëzoni atyre pasurinë e tyre…" (Sure "En Nisa", ajetet 5-6)

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "Ndalimi për jetimin përfundon, kur ai arrin pjekurinë seksuale, domethënë kur arrin në moshën në të cilën ai di të orientohet. Në qoftë se fëmija arrin pjekurinë seksuale, por nuk është në gjendje të orientohet, ai është ose mendjelehtë, ose i sëmurë, prandaj, në këtë gjendje, pasurinë e tij e merr në dorëzim kujdestari i tij."

I çmenduri

I çmenduri, me fjalën e përbashkët të fukahave dhe me tekst, është i ndaluar në të gjitha veprimet e tij, qoftë kur çmendja është e përhershme, qoftë kur çmendja është me cikle. Nëse i çmenduri me cikle vepron në kohën, kur e ka ndërgjegjen të plotë, veprimi i tij zbatohet. Në qoftë se i çenduri bën një veprim dhe nuk e dimë, nëse ai ishte në gjendjen e çmendjes, apo ishte në gjendjen, kur ishte i ndërgjegjshëm, veprimi i tij nuk zbatohet, sepse mendja është kusht i domosdoshëm për vlefshmërinë e bashkëpunimit të ndërsjellë, kurse dyshimi është kusht për origjinën e ekzistencës së kontratës dhe jo për vlefshmërinë e saj dhe mohohet me origjinën.

Thënë ndryshe, dyshimi në vlefshmërinë e kontratës është i ardhur prej dyshimit në lidhje me ekzistencën e mendjes në kohën e lidhjes së kontratës, atëherë ne zbatojmë rregullin e shoqërimit për gjendjen e mëparshme dhe e lëmë ashtu siç ishte.

Ai që ka humbur vetëdijen, si dhe i dehuri, është në dispozitën e të çmendurit dhe asnjë veprim i dalë prej këtyre të dyve nuk është i vlefshëm, kur veprimi është bërë në gjendjen e humbjes së vetëdijes, ose në gjendjen kur ishte i dehur. Kur i çmenduri kryen marrëdhënie intime me një grua dhe ajo grua mbetet shtatzënë prej tij, i çmenduri ka të drejtën e atësisë mbi fëmijën, plotësisht siç është rasti i kryerjes së marrëdhënieve intime të dyshimtë.

I vogli dhe shenjat e pjekurisë seksuale

Fukahatë ndajnë një fjalë të vetme me dëshminë e autorit të librit "El Xheuahir" dhe me dëshminë e autorëve të tjerë, që i vogli ndalohet prej veprimeve pasurore dhe prej veprimeve të tjera, derisa te ai të arrihen dy cilësi: pjekuria seksuale dhe kur di të udhëzohet në rrugën e drejtë. Për pjekurinë seksuale ka disa shenja:

1- Dalja e spermës së vërtetë prej së cilës bëhet fëmija. Të gjitha medh'hebet islame, pa asnjë përjashtim, kanë një fjalë të përbashkët që puberteti është tregues i pjekurisë seksuale të mashkullit e të femrës në çdo moshë që të ndodhë dhe në çdo gjendje që ai të shikojë daljen e spermës, zgjuar ose në gjumë. Kjo nuk ka nevojë për argument ligjor, sepse pjekuria seksuale është dukuri e njohur natyrore, edhe nga pikëpamja gjuhësore dhe nga pikëpamja e traditës, domethënë që nuk është prej subjekteve ligjore. Tradita e shikon pjekurinë seksuale në gjendjen e pubertetit te mashkulli e te femra, por te femra e shikon akoma më qartë në ardhjen e menstruacioneve e te shtatzënia.

Autori i librit "El Xheuahir", në lidhje me këtë çështje, ka një thënie shumë të dobishme, të cilën do ta citojmë në numrat e mëposhtëm. Gjithsesi, Libri i Allahut dhe Suneti profetik tregojnë që puberteti është prej shenjave të pjekurisë seksuale. Prej Librit të Allahut, në lidhje me këtë çështje, kemi ajetin 5 të sures "En Nisa": "Jetimët t'i provoni, derisa ata të bëhen për martesë…", si dhe ajetin 59 të sures "En Nur":

"وَإِذَا بَلَغَ ٱلْأَطْفَالُ مِنكُمُ ٱلْحُلُمَ فَلْيَسْتَأْذِنُوا"

"dhe kur fëmijët tuaj të arrijnë moshën e pubertetit, le të kërkojnë lejë..."

Me rrugët e vërtetimit të transmetimit të Ehli Sunetit dhe të shi'ave është vërtetuar se i Dërguari i Allahut *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)* ka thënë: "Lapsi është ngritur për tre: për fëmijën, derisa të arrijë pjekurinë seksuale, për të çmendurin, derisa të ndërgjegjësohet dhe prej atij që është në gjumë, derisa të zgjohet."

Gjithashtu, kemi edhe fjalën e Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*: "...plotësohet vetëm pas arritjes së pjekurisë seksuale."

2- Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se menstruacionet dhe shtatzënia tregojnë pjekurinë seksuale të femrës. Autori i librit "El Mesalik" ka thënë: "Pa asnjë mendim ndryshe, që këto dy gjendje janë argumente që tregojnë se pjekuria seksuale është arritur. Për sa i përket shfaqjes së menstruacioneve, ligjvënësi ka vënë dispozita që e obligojnë femrën me detyrimet e fesë. Prej dispozitave kemi fjalën e të Dërguarit më të madh *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)*: "Nuk pranohet namazi i femrës që i kanë ardhur menstruacionet, përveçse me mbulesën e sipërme të kokës e të pjesës së sipërme të trupit." Gjithashtu, është edhe hadithi tjetër: "Femrës, kur i vijnë menstruacionet, i lejohet t'i shikohet vetëm kjo." (dhe bëri me shenjë fytyrën e pëllëmbët e dy duarve).

Për sa i përket shtatzënisë, ajo realizohet me anë të kryerjes së marrëdhënieve intime, sepse fëmija krijohet vetëm pas përzierjes së ujit të mashkullit me ujin e femrës, ashtu siç na tërheq vëmendjen Allahu i Lartësuar me fjalën e Tij:

"مِن نُّطْفَةٍ أَمْشَاجٍ"

"...prej një uji të dyzuar..." (Sure "El Insan", ajeti 2), domethënë përzierje prej ujit të burrit dhe të gruas dhe ky ujë është argument që pjekuria seksuale është arritur më përpara.

3- Dalja e qimeve të ashpra në regjionin e pubisit. Autori i librit "El Mesalik" ka thënë: "Nuk merren në konsideratë pushi i hollë e i rrallë që del para qimeve të ashpra dhe që më pas zhduket, ashtu siç mbeten disa fije floku të holla në kokën e atyre të moshuarve që u kanë rënë flokët." Daljen e qimeve të ashpra, fukahatë i kanë kufizuar vetëm për regjionin e pubisit, për shkak të mosmarrjes në konsideratë të qimeve të tjera të ashpra që dalin në trupin e burrit, si për shembull, qimet nën sqetulla, mustaqet dhe në mjekër. Por të gjitha këto te ne, domethënë te fukahatë e imamive, nuk merren në konsideratë, nëse nuk vërtetohet që këto janë argumente treguese për pjekurinë seksuale, sepse shpesh ndodh që këto dalin edhe me vonesë."

4- Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Arritja e pjekurisë seksuale është prej punëve natyrale të njohura nga ana gjuhësore dhe nga ana e traditës dhe nuk është prej subjekteve ligjore të cilat dihen vetëm prej ligjvënësit, siç janë fjalët që tregojnë adhurimet, sepse gjuhëtarët, në renditjen e gjendjeve të njeriut, kanë thënë se për çdo gjendje nëpër të cilën kalon njeriu, ka një emër të veçantë, për mashkullin e për femrën, duke filluar që me krijimin dhe deri në gjendjen e pleqërisë.

Në çdo gjendje nëpër të cilën kalon njeriu, nuk është e panjohur ajo që konstatohet në fjalët e gjuhëtarëve, sepse janë nga ato gjendje që njihen si fjalë gjuhe, prej të cilave zakonisht

kuptohet se djali, kur shikon dalje sperme, ka arritur pjekurinë seksuale, ai e kupton që ka dalë prej kufirit të fëmijërisë dhe ka hyrë në kufirin e burrërisë. Kështu është edhe femra, kur shikon shfaqjen e menstruacioneve, ajo e kupton se tanimë ajo bërë është grua si të gjitha gratë. Patjetër që duhet t'i referohemi ligjit në lidhje me parimin e moshës në të cilën arrihet pjekuria seksuale, për shembull, kur djali është në gjendje dyshimi, gjendje e cila është e kundërt me daljen realisht të spermës, ose me shfaqjen realisht të menstruacioneve dhe me ndodhjen e shtatzënisë, gjendje për të cilat nuk mund të ketë dyshim që me këto dukuri është arritur pjekuria seksuale, qoftë nga ana e kuptimit gjuhësor të fjalës, qoftë nga ana e të zakonshmes e jetës, madje edhe nga lidhjen që ka ndërmjet kuptimit gjuhësor dhe atij të zakonshëm që ka kjo gjendje e njeriut."

Ky shpjegim tregon sa thellë e kuptonte autori i librit "El Xheuahir" ligjin e fesë dhe sekretet e tij. Gjithashtu, tregon qartë se detyra e ligjvënësit nuk është që ai të merret me përkufizimin e gjendjeve të natyrshme, siç është pjekuria seksuale e të tjera gjendje në periudha të ndryshme të jetës së njeriut, pasi njohja me këto gjendje është detyrë e atyre që kanë përvojë dhe, kur ligjvënësi flet për këto gjendje, në të vërtetë, ai nuk flet me cilësinë e tij si ligjvënës, por flet si njëri prej atyre që ka përvojë, ose fjalën e tij ai e mbart në njerëzit me përvojë.

Për këtë çështje kemi folur në mënyrë të detajuar në librin "Gjendjet personale sipas pesë medh'hebeve", në kapitullin "Gjenealogjia". Pa dyshim që ligjvënësi i komenton dispozitat e tij bazuar mbi moshën që ai ka marrë në shqyrtim. Detyra jonë është të dëgjojmë e të bindemi, pikërisht për këtë autori i librit "El Xheuahir" ka thënë se, kur ka dyshime për arritjen e pjekurisë

seksuale dhe nuk është e mundur që ajo të mësohet, për njohjen e moshës në të cilën arrihet pjekuria seksuale, ai e referon çështjen te ligjvënësi.

Prej Ehli Bejtit *(Paqja e Allahut qoftë mbi ta!)* është vërtetuar që mosha e pjekurisë seksuale te mashkulli është pesëmbëdhjetë vjeç dhe te femra nëntë vjeç.

Imam Bakiri, babai i Imam Xhaferr Sadikut *(Paqja qoftë mbi ta!)*, është pyetur se, kur zbatohen të plota dënimet fizike që parashikon ligji i fesë mbi djalin. Ai është përgjigjur: "Kur ai sheh daljen e spermës, ose kur mbush pesëmbëdhjetë vjeç, ose atij i kanë dalë qimet para kësaj moshe."

Pyetësi tha: "Po për femrën, kur bëhet detyrim zbatimi i dënimeve fizike që parashikon ligji i fesë?" Ai *(Paqja qoftë mbi të!)* iu përgjigj: "Femra nuk është si mashkulli. Kur femra martohet dhe me të kryhen marrëdhëniet intime dhe ka mbushur nëntë vjeç, ajo nuk konsiderohet më jetime, për rrjedhojë asaj i jepet në dorëzim pasuria që ka trashëguar. Gjithashtu, ajo lejohet të shesë e të blejë."[1]

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Kjo është thënia më e përhapur, madje në këtë thënie është stabilizuar medh'hebi."

---

[1] Disa njerëz mund të mendojnë se çështja e arritjes së pjekurisë seksuale te femra në moshën nëntë vjeç, është e veçantë për fik'hun xhaferij, por në librin e Ibn Abidijnit, që është ndër librat më të rëndësishëm dhe pikë referimi për hanefitë, në pjesën e pestë të këtij libri, në faqen 100, botim i vitit 1326H, tekstualisht thuhet: "Mosha më e ulët e arritjes së pjekurisë seksuale te mashkulli është dymbëdhjetë vjeç dhe te femra nëntë vjeç. Kjo është thënia më e pëlqyer, ashtu siç thuhet në dispozitat për moshën e vogël."

Vërtetimi i arritjes së pjekurisë seksuale me pohim

Shumica e fukahave kanë thënë se arritja e pjekurisë seksuale te fëmija vërtetohet thjesht me pohimin e tij, pa kërkuar prej tij betim, kur pretendon se ka arritur pjekurinë seksuale me daljen e spermës në gjumë dhe është në moshën kur arrin të kuptojë pjekurinë seksuale. Por kur fëmija pretendon arritjen e pjekurisë seksuale, bazuar në moshën, ai duhet të vërtetojë pretendimin e tij me argument. Kështu kanë thënë fukahatë. Në kapitullin "Pohimi", në paragrafin "Pohuesi", në pikën 1, do të jepen shpjegimet për këtë çështje.

Në pjesën e tretë të këtij libri, në një kapitull të veçantë, që ka zënë 8 faqe, ne kemi folur për arritjen e pjekurisë seksuale te fëmija dhe kemi trajtuar besimin e tij islam, adhurimin e tij, testamentin që ai lë, sadakanë që ai jep, divorcin që ai bën, garantimin që paguan, objektin që merr nën kontroll, kontratën që ai lidh dhe veprimet e ndërsjella të tij, si kur është në gjendje të dallojë, ashtu edhe kur nuk është në gjendje të dallojë. Kush dëshiron të njihet me dispozitat e plota të fëmijës, le t'i referohet pjesës së tretë të këtij libri, si dhe asaj që kemi shkruar për këtë çështje në kapitullin "Ndalimi", si dhe atë që do të themi për këtë çështje në kapitullin vijues "Pohimi".

Mendjelehti

Mendjelehti dallon prej fëmijës, me arritjen e pjekurisë seksuale dhe prej të çmendurit me mendjen. Te mendjelehti janë së bashku kuptimi dhe dallimi, sepse mendjelehti është ai që vepron me pasuritë e veta për qëllime, të cilat te të mençurit nuk

janë veprime të vlefshme. Me një fjalë, mendjelehti, në këndvështrimin e traditës, konsiderohet shpërdorues, sepse ai është i shkujdesur me pasuritë e veta dhe i vë aty ku nuk duhen vënë, me kusht që kjo gjë te ai përsëritet shpesh.

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Studimi në lidhje me kuptimin e fjalës "mendjelehtë" nuk është prej detyrave të juristit të fesë, duke shtuar edhe fjalët e zgjatura." Pas një ndërprerjeje të gjatë të fjalës, në lidhje me këtë çështje, ai thotë: "Pikë referimi për shpjegimin e fjalës "mendjelehtë" është tradita."

Mendjelehtësi është edhe kur njeriu jep sadaka çdo gjë që ka, ose jep sadaka gjërat më me vlerë që ka, ose ai ndërton një xhami, ose ndërton një shkollë, ose një klinikë, në një kohë që askush që është në gjendjen e tij materiale, nuk do të rrezikonte për këto punë, pasi ky shpenzim i madh do ta dëmtojë atë vete dhe ata që ai ka në ngarkim. Këtë shpërdorues njerëzit e konsiderojnë jashtë rrugës së njerëzve të mençur dhe zakonit të tyre në lidhje me administrimin e pasurive që kanë.

Autori i librit "El Hadaik", prej komentimit (tefsirit) të El A'jàshij, ka citur fjalën e Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*: "Sikur një burrë të shpenzojë në rrugën e Allahut gjithçka që ka në dorë, ai nuk ka vepruar mirë dhe shpenzimi që ai bëri nuk shkon për punë të mirë. Allahu i Lartësuar thotë:

"...وَلاَ تُلْقُوا بِأَيْدِيْكُمْ إِلَى التَّهْلُكَةِ وَأَحْسِنُوا إِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ الْمُحْسِنِيْنَ "

"...mos e çoni veten në rrezik me duart tuaja dhe bëni mirë, sepse Allahu, me të vërtetë, i do bamirësit." (Sure "El Bekare", ajeti 19), domethënë ato që shpenzojnë me maturi.

Ngurtësimi

Mendjelehti ngurtësohet në veçanti për veprimet pasurore dhe në veprimet e tij me pasurinë, ai është si i fëmija dhe i çmenduri. Përjashtohet rasti kur atë e lejon kujdestari, por ai ka liri të plotë në të gjitha veprimet e tij, që nuk kanë lidhje as nga afër e as nga lag me pasurinë.

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Nuk mund të pranohet as shitja e as blerja e mendjelehtit e as veprimet e tjera të tij, si kontratat e bashkëpunimi i ndërsjellë, qoftë kur atë e ka ngurtësuar sundimtari, qoftë edhe kur nuk e ka ngurtësuar. Për këtë çështje ka mendime të ndryshme në mesin e fukahave, të cilat do t'i shikojmë më poshtë.

Gjithashtu, është pa vlerë dhurata që ai bën, ose kur pohon për një pasuri. Me fjalën e përbashkët të fukahave, rregulli është: Ndalim i plotë i mendjelehtit prej veprimeve pasurore dhe fjala e përbashkët e fukahave është argument pas atij ndalimi, për të cilin tregon Libri i Allahut dhe Suneti, pa bërë asnjë dallim mes veprimeve të tij pasurore, të cilat edhe mund të jenë vënë në vendin e duhur, ose mund të jenë në vend të gabuar. Gjithashtu, nuk ka asnjë dallim mes sendit konkret që ai ka në pronësi dhe sendit të marrë prej tij në ruajtje në mirëbesim, ashtu siç nuk ka asnjë dallim edhe mes mashkullit e femrës."

Vendimi i sundimtarit

A vërtetohet ndalimi për mendjelehtin, thjesht me shfaqjen e mendjelehtësisë, apo ndalimi është i varur prej vendimit të

sundimtarit? Sikur të supozojmë që sundimtari bëri ndalimin për mendjelehtin, pasi te ai u vërtetua mendjelehtësia, vallë a hiqet ky ndalim, sapo të kalojë mendjelehtësia, apo heqja e ndalimit për mendjelehtin është e varur prej vendimit të sundimtarit?

Fukahatë kanë mendime të ndryshme në lidhje me këtë çështje dhe studiuesit autoritarë, ndër të cilët autori i librit "El Xheuahir" dhe "El Mesalik", janë shprehur se pavlefshmëria e veprimeve të mendjelehtit është bazuar në shfaqjen e mendjelehtësisë dhe jo mbi vendimin e sundimtarit për ndalimin e tij, sepse çdo veprim që bën mendjelehti, në gjendjen e mendjelehtësisë, është pa vlerë, pavarësisht nëse ka vendosur, ose nuk ka vendosur sundimtari për ndalimin e tij dhe pavarësisht nëse mendjelehtësia ka lidhje, ose nuk ka lidhje me moshën e vogël. Nëse ai, nga mendjelehtë kalon në gjendje që dallon punët, ndalimi hiqet prej tij, por, nëse atij i rikthehet mendjelehtësia, rikthehet edhe ndalimi. Gjithashtu, nëse mendjelehtësia prej tij zhduket, vetvetiu bie edhe ndalimi i tij për të vepruar me pasurinë e vet. Pra, fakti që e bën të detyrueshme vendosjen e ndalimit, është mendjelehtësia, por ajo duhet të vërtetohet dhe, kur nuk ekziston më shkaku, patjetër që bëhet e detyrueshme heqja e pasojës, që në rastin tonë, është ndalimi. Në favor të vërtetimit të këtij problemi flet qartë fjala e Allahut të Lartësuar, që pamë në fillim të kapitullit: "…dhe nëse te ata shikoni maturi, atëherë u dorëzoni atyre pasurinë e tyre…"

Siç shihet, çështjen e kthimit të pasurisë në dorën e tyre, ajeti i nderuar e ka kushtëzuar me aftësinë për të drejtuar punët dhe jo me vendimin e sundimtarit.

Pohimi i mendjelehtit, martesa dhe divorci i tij

Me fjalën e përbashkët te fukahave, kur kujdestari e lejon mendjelehtin të veprojë me pasurinë e vet, veprimi i tij është i vlefshëm, kurse për veprimet që s'kanë të bëjnë me pasurinë, si për shembull, mendjelehti pohon trungun familjar, ose betohet, ose taks të bëjë një punë, ose të lërë një punë tjetër që s'ka lidhje me pasurinë, këto veprime të tij zbatohen, edhe nëse nuk ka lejen e kujdestarit, sepse mendjelehti ka arritur moshën e pjekurisë seksuale dhe është i mençur, si dhe për faktin se ai është i ndaluar vetëm me veprimet pasurore, kurse veprimet e tjera të tij nuk kanë asgjë të përbashkët me pasurinë.

Kur mendjelehti pohon për borxhin, ose për asgjësimin e një pasurie, ose padrejtësisht pretendon pasuri, ai nuk ndëshkohet për pohimin e tij, edhe nëse borxhin, ose deliktin e mbështesim në gjendjen e tij para shfaqjes së mendjelehtësisë, ose para ndalimit, sepse pohimi i tij është pohim për një gjë që ai e ka të ndaluar, prandaj veprimi i tij nuk zbatohet, domethënë që pohimi i mendjelehtit është plotësisht si pohimi i penglënësit për sendin që ai ka lënë peng.

Nëse mendjelehti kryen një veprim të dënueshëm, që detyrimisht shlyhet me pasuri, i dëmtuari ka të drejtë të falë mendjelehtin, sepse veprimi i tij nuk është as veprim për të futur në dorë pasuri e as veprim për të humbur pasuri dhe as që të veprojë me atë pasuri, sepse ai është i ndalur të veprojë me pasuri dhe të humbë pasuri, për rrjedhojë, nuk është detyrim që të merret pasuri prej tij.

Kur mendjelehti pohon vjedhjen dy herë, pohimi i tij merret në konsideratë për dënimin, jo për pasurinë, sepse ai është i ndaluar të kryejë veprime pasurore, por nuk është i ndaluar të kryejë veprime të tjera.

Kur një njeri lë një send në ruajtje, në mirëbesim, te një mendjelehtë, duke e ditur që ai është mendjelehtë dhe ky mendjelehtë fillon ta asgjësojë vetë sendin e lënë për ruajtje te ai me qëllim, ose edhe gabimisht, në këtë gjendje, mendjelehti është garantues, sipas rregullit: "Kush prish pasurinë e tjetrit, është garantues", por, kur sendi i lënë në ruajtje, nuk prishet drejtpërdrejt prej mendjelehtit, por prishet për shkak se ai nuk e ka ruajtur ashtu siç kërkon ai send të ruhet, në këtë gjendje, mendjelehti nuk garanton për sendin e prishur, sepse, në vërtetë, abuzues, në këtë rast, është vetë pronari i sendit, që kur e la atë send në ruajtje në dorën e këtij mendjelehti, duke e ditur që ai është mendjelehtë.

Një grup fukahash kanë thënë se mendjelehti, në mënyrë absolute, nuk garanton, madje edhe kur ka filluar vetë të prishë sendin e lënë në ruajtje te ai, sepse shkujdesja e abuzimi me atë send ka ndodhur prej vetë pronarit të sendit, që kur ia ka dhënë sendin mendjelehtit, në një kohë që Allahu i Madhëruar na e ka ndaluar këtë gjë me fjalën e Tij: "Mendjelehtëve mos u jepni pasuritë tuaja…" Ndryshe, ai që i jep pasurinë mendjelehtit, është si ai që e flak pasurinë e tij në det.

Nuk është e vlefshme martesa e mendjelehtit, pa lejen e kujdestarit të tij, sepse martesa kërkon veprim pasuror, domethënë shumën e parave të kurorës, si dhe shpenzimin për ushqimin e veshjen e gruas, por është i vlefshëm divorci i

mendjelehtit, sepse divorci është në dorën e vetë mendjelehtit dhe nuk është në dorën e kujdestarit të tij. Divorci falas i mendjelehtit është i vlefshëm dhe vetëkuptohet që është me më shumë përparësi të jetë i vlefshëm divorci i tij me pagesë, por shuma nuk i jepet në dorë mendjelehtit, por i jepet kujdestarit të tij. Gjithashtu, është i vlefshëm edhe kthimi i mendjelehtit pas divorcit, sepse, që në fillim, nuk ishte martesë, pasi në të vërtetë ishte kapje pas një kontrate të vlefshme të mëparshme.

Vërtetimi i inteligjencës

Kur ne mësojmë se ai është mendjelehtë, bazuar mbi këtë që dimë, rendisim ndikimet e mendjelehtësisë. E njëjta gjë është edhe kur ne dimë se ai është inteligjent. Por kur ne nuk e dimë gjendjen e tij, ç'do të bëjmë?

Përgjigje: Rruga në të cilën kanë ecur njerëzit, të gjithë njerëzit, madje edhe fukahatë, që në kohët më të vjetra, ka qenë që personin e rritur, për të cilin nuk e dinë gjendjen e tij, ta trajtojmë si njeri inteligjent, derisa të mësohet që ai është mendjelehtë, atëherë në marrëdhëniet e tyre me njëri-tjetrin, me mendjelehtin, ndërtohen pa bërë pyetje e pa shikuar në gjendjen e tij të mendjelehtësisë. Vetëkuptohet se kush ka në ruajtje pasuri të ndonjë jetimi, ai nuk ia kthen jetimit pasurinë e vet, derisa jetimi të arrijë moshën që të dijë të orientohet, sepse ai supozohet që deri në këtë moshë nuk di të orientohet. Kjo do të thotë se dorëzimi i pasurisë së jetimit është me kusht, prandaj kushti patjetër duhet të jetë arritur. Për këtë çështje flet ajeti i nderuar: "…dhe nëse te ata shikoni maturi…"

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* është pyetur për fjalën e Allahut të Lartësuar: " وَلاَ تُؤْتُوا السُّفَهَآءَ أَمْوَالَكُمُ" -"Mendjelehtëve mos u jepni pasuritë tuaja…", ai tha: "Ata janë jetimët, mos ua jepni atyre, derisa të mësoni që ata janë në gjendje të orientohen drejt."

Për sa i përket dallimit mes burrit të panjohur dhe mes jetimit, i pari trajtohet siç trajtohet njeriu i zakonshëm që di të orientohet drejt, derisa të vërtetohet e kundërta, kurse të dytit, domethënë jetimit, i ndalohet të veprojë me pasurinë e tij, derisa të vërtetohet që djali i vogël e vajza e vogël është në gjendje të orientohet drejt dhe vërtetimi bëhet me përzgjedhje, ose bazuar në transmetimet e njohura për saktësinë e tyre, ose me dëshminë e dy burrave të drejtë, qoftë për mashkullin, qoftë për femrën, sepse bazë është dëshmia e dy burrave, ose dëshmia e një burri dhe dy grave, ose dëshmia e katër grave për femrën, kurse gjendja e aftësisë për t'u orientuar drejt për mashkullin vërtetohet vetëm me dëshminë e burrave.

I njëjtë me jetimin është edhe mendjelehti dhe, kur ngrihet pretendimi se ajo femër është mendjelehtë, ky pretendim vërtetohet me dëshminë e përbashkët të katër grave, ose gratë dëshmojnë secila më vete. Mendjelehtësia për mashkullin vërtetohet vetëm ne dëshminë e burrave.

I sëmuri

Këtu qëllimi me të sëmurin është për atë të sëmurë, sëmundja e të cilit ka lidhje me vdekjen e tij, me kusht që sëmundja është frikësuese, në atë mënyrë që njerëzit mendojnë se jeta e të sëmurit është në rrezik, por jo kur ai sëmuret nga një

sëmundje frikësuese, nga e cila ai shërohet dhe më pas ai vdes jo prej sëmundjes që kishte.

Ai që sëmuret me një sëmundje prej së cilës ai vdes dhe vepron me pasurinë e tij në më shumë se një e treta e pasurisë së vet, me këtë pjesë të pasurisë ai vepron si të dëshirojë dhe askush nuk ka të drejtë ta kundërshtojë këtë të sëmurë për veprimin e kryer, por, nëse ai vepron me më shumë se sa një të tretën e pasurisë që ka, atëherë shikohet: Në qoftë se veprimi i tij sjell dëm për trashëgimtarin dhe konkurron të drejtën e trashëgimtarit, si për shembull, kur i sëmuri dhuron, ose nuk e administron drejt, për shembull, shet me çmim më të ulët se çmimi i zakonshëm, ose ble me çmim më të lartë, në këtë gjendje, kur bëhet fjalë për më shumë se një e treta e pasurisë së të sëmurit, veprimi i tij ndalohet. Nëse trashëgimtari e lejon, atëherë veprimi i të sëmurit ekzekutohet, por jo pa lejen e trashëgimtarit, ashtu siç thotë hadithi i nderuar: "Burrit në pragun e vdekjes së tij i takon një e treta dhe një e treta është shumë."

Në qoftë se veprimi i të sëmurit me pasurinë e tij nuk është dëmtues për trashëgimtarin e as konkurrues në asnjërën prej të drejtave të tij, si për shembull, i sëmuri shet e ble me çmimin e zakonshëm, veprimi i tij është i vlefshëm dhe i detyrueshëm të zbatohet, edhe sikur të kundërshtojë trashëgimtari.

Për këtë çështje kemi folur në mënyrë të detajuar në librin "Gjendjet personale sipas pesë medh'hebeve", në kapitullin "Veprimet e të sëmurit".

Kësaj çështjeje, me lejen e Allahut të Lartësuar, do t'i rikthehemi edhe një herë në kapitullin "Testamentet".

* * *

KUJDESTARI I TË VOGLIT, I TË ÇMENDURIT DHE I MENDJELEHTIT

I vogli dhe i çmenduri

Më sipër kemi folur për ndalimin e të voglit, të çmendurit dhe mendjelehtit. Është e vetëkuptueshme se çdo i ndaluar ka një kujdestar, ose dikë që merret me përkujdesjen e punëve të tij të pasurisë në vend të pronarit të pasurisë. Kush është ky kujdestar apo ai i porositur që merret me këto punë?

Kujdestaria vërtetohet, në radhë të parë, për babain dhe për gjyshin nga babai, që janë në shkallë të barabartë në lidhje me kujdestarinë për të voglin e për të çmendurin, kur çmenduria e të cilit ka lidhje që me moshën e vogël, në atë mënyrë që babai dhe gjyshi, në lidhje me punët e kujdestarisë, veprojnë në mënyrë të pavarur. Ai që vepron i pari, merret në konsideratë fjala e tij, krahas kujdesit për ruajtjen e asaj që është detyrë të ruhet. Në qoftë se babai e gjyshi kanë grindje mes tyre, merret në konsideratë veprimi i gjyshit. Kur veprimi i babait e i gjyshit është i atillë që kundërshton veprimin e tjetrit, merret në konsideratë veprimi që është bërë më përpara dhe anulohet veprimi i

mëvonshëm dhe duke bërë krahasimin me kohën, gjyshi ka përparësi. Në qoftë se babai dhe gjyshi vdesin të dy, kujdestar për të voglin e për të çmendurin do të jetë personi për të cilin ka porositur babai ose gjyshi. Gjyshi ka më përparësi se personi që ka porositur babai për të qenë kujdestar. Në qoftë se i vogli dhe i çmenduri nuk ka as gjysh e as baba, madje nuk ka asnjë person të porositur prej babait e prej gjyshit, në këtë gjendje, kujdestaria i takon sunduesit ligjor (el hakimu sher'i) الحاكم الشرعي.

Sej'jid Bahrul Ulùm, në librin "Bulgatul Fekijh", ka thënë: "Kujdestari vërtetohet për babain biologjik e për gjyshin nga babai. Nuk ka kujdestari as për babain prej qumështi e as për atë që e ka lindur atë në gjendje mendjelehtësie. Vërtetimi i kujdestarisë për babain e për gjyshin realizohet në bashkëpunim të ndërsjellë mes tyre. Ky rregull është në përputhje të plotë me tekstin dhe me sentencën e fukahave (fetvanë), pavarësisht që babai veçohet në shumicën e teksteve dhe s'ka dyshim që në kujdestari përfshihet edhe gjyshi, madje kontrata e gjyshit ka përparësi ndaj kontratës së babait, krahas kundërshtimit që ekziston në mesin e fukahave për këtë çështje.

Pas një shkëputje të gjatë, ky autor thotë: "Për sa i përket kujdestarisë së personit të porositur për të qenë ai kujdestar për fëmijët e tij, kjo kujdestari është e vërtetuar me tekst dhe me fjalën e përbashkët të fukahave, por duhet të shikohet, nëse i porosituri është bërë kujdestar prej porositësit, pa asnjë kusht.

Në qoftë se për kujdestarin nuk është vënë asnjë kusht, në këtë gjendje, nuk ka ndonjë problem për zbatimin, për caktimin e atij që do të jetë kujdestar për ruajtjen e interesave të atyre fëmijëve, të jetës e të pasurive të tyre, si dhe për marrjen e të

drejtave që duhet t'u kthehen atyre fëmijëve, përfshirë edhe veprime të tjera, si: shitje, qira, marrëveshje për shfrytëzimin e tokës, marrëveshje për drufrutorët dhe për punë të tjera, të cilat kanë lidhje me përmirësimin e pasurive të fëmijëve.

Gjithashtu, nuk ka asnjë problem për ndalimin e të porositurit prej disa punëve, të cilat për babain ishin të lejuara, me cilësinë e tij si baba i atyre fëmijëve, siç mund të jetë ndalimi për të martuar të voglin e të voglën nga ana e të porositurit."

Me lejen e Allahut, këtë çështje tepër të rëndësishme do ta trajtojmë në kapitullin "Martesa".

Çmendja e ardhur pas mendjes

Një grup fukahash kanë bërë dallim mes çmendjes që ka lidhje me fëmijërinë, kur çmendja ndodh pas arritjes së pjekurisë seksuale dhe në gjendjen që ai ishte i mençur dhe kanë thënë: "Kujdestaria për babain e për gjyshin vërtetohet për të çmendurin e parë, kurse kujdestaria për të çmendurin e dytë i takon sundimtarit ligjor (el hakimu esh sher'i), sepse kujdestaria për ata të dy ka rënë dhe i rëni mund të rikthehet vetëm me argument. Është shumë e bukur ajo që unë kam lexuar për argumentet në lidhje me këtë çështje, ashtu siç e ka cituar autori i librit "Miftàhul Keràmeh" prej disa dijetarëve, të cilët, padyshim, janë trashëgimtarë të profetëve dhe padyshim që kujdestaria ishte e vërtetuar për profetët dhe, sipas kërkesës së trashëgimisë, kujdestaria u takon dijetarëve që janë trashëgimtarë të profetëve."

Konstatohet se dijetarët trashëgojnë profetët vetëm për shpjegimin e dispozitave të ligjit të fesë, për dispozitat e thirrjes në fenë e Allahut, për dispozitat e urdhërimit për punë të mirë dhe për ndalimin e punës së keqe, ndarjen e armiqësive dhe ruajtjen e pasurive të atyre që janë të ndaluar të veprojnë me pasurinë e tyre, si dhe të atyre që nuk janë në gjendje t'i ruajnë pasuritë e veta, apo edhe të atyre që nuk janë të pranishëm.

Për sa u përket qenies së dijetarëve, zëvendës të profetëve në pushtet, megjithëse dijetarët janë njerëzit që meritojnë më shumë se kushdo tjetër të jenë në krye të pushtetit, madje edhe më shumë se ata që pretendojnë pushtetin, pra, dijetarët janë plotësisht në pozitën e atyre që kujdesen për të çmendurit e për jetimët.

Autori i librit "El Xheuahir" dhe autori i librit "Miftahul Kerameh", kanë thënë: "Më e pëlqyeshme është të përputhet kujdestaria e gjyshit dhe e babait me atë të sundimtarit (el hakimu sher'i), domethënë veprimi me pasurinë e të çmendurit që në vegjëli të jetë me mendimin e të gjithëve."

Sej'jid El Asfehànij, në librin "El Uesijleh", ka thënë: "Nuk lihet ky kujdes."

Padyshim që kujdesi është veprim i mirë, por veprimi këtu është në gradën veprim i pëlqyer dhe jo në gradën veprim i detyrueshëm, sepse argumentet që vërtetojnë kujdestarinë për babain e për gjyshin nuk janë të ndara në dy gjendje. Bazuar mbi këto argumente, babai e gjyshi kanë përparësi ndaj sundimtarit, sepse sundimi mund të ekzistojë dhe mund të mos ekzistojë.

Përveç kësaj, mëshira e dashuria e babait nuk mund të barazohet me mëshirën e me dashurinë e sundimtarit.

Cili është ai i mençur që do të miratonte që sundimtari të emërojë kujdestar një të huaj, i cili mund të linte mangët detyrën e kujdestarit, kur babai i të çmendurit jeton dhe plotëson të gjitha kushtet e ka të gjitha aftësitë?

Mendjelehti

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët me dëshminë e autorit të librit "El Xheuahir dhe të autorit të librit "Miftahul Kerameh", të cilët kanë thënë: "Kur fëmija arrin pjekurinë seksuale dhe është në gjendje të orientohet drejt dhe pas kësaj atij i ndodh mendjelehtësia, kujdestaria i takon sundimtarit ligjor dhe jo babait e gjyshit. Fukahatë kanë mendime të ndryshme mes tyre, në lidhje me faktin, kur gjendja e mendjelehtësisë ka lidhje me moshën e vogël, ose kur ai fëmijë arrin pjekurinë seksuale, duke qenë mendjelehtë. Ka fukaha që kanë thënë se edhe në këtë gjendje, kujdestaria i takon sundimtarit.

Një fakih tjetër ka thënë se kujdestaria për këtë fëmijë i takon babait e gjyshit. Kjo është e vërteta e mbështetur mbi rregullin e shoqërimit për mbetjen e kujdestarisë te babai e te gjyshi.

Në lidhje me këtë çështje, Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "Nëse arrin pjekurinë seksuale dhe nuk ka arritur në gjendjen që të orientohet drejt, pra, është mendjelehtë, veprimet me pasurinë e tij i kryen kujdestari i tij."

Padyshim që fjala "kujdestari i tij" këtu, është për atë person që ishte kujdestar për këtë fëmijë para se ai të arrinte moshën e pjekurisë seksuale dhe, ky kujdestar është vetëm babai e gjyshi.

Kushtet e kujdestarit

Kujdestari është në moshë madhore dhe gëzon shëndet të plotë mendor, të kombinuara me fenë, kurse drejtësia është kusht për sundimtarin ligjor, sepse kujdestaria e përgjithshme është në vendin e pozitës së Imamit të ruajtur prej mëkateve. Kjo pozitë nuk mund të jetë përveçse për atë që ka frikë Allahun. Për sa u përket kujdestarëve të tjerë përveç sundimtarit ligjor, fukahatë më të dëgjuar kanë shkuar me dëshminë e shejkhut El Ensarij, të shprehur prej tij në librin "El Mekasib", që drejtësia në origjinë nuk është kusht, për shkak se argumentet për kujdestarinë janë të pakushtëzuara, domethënë që kujdestaria nuk është e kushtëzuar me drejtësinë. Është e kuptueshme se drejtësia këtu është mjet për ruajtje dhe nuk është qëllim në vetvete. E rëndësishme është që veprimi me pasurinë e personit me mangësi të bëhet në bazë të interesit të këtij personi. Kjo është e barabartë, qoftë kur kjo bëhet prej një njeriu të drejtë, qoftë kur bëhet prej një njeriu mëkatar.

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët dhe kanë thënë se veprimet e kujdestarit që janë në të mirë e për dobi të personit të marrë nën kujdestari zbatohen, kurse veprimet dëmtuese të kujdestarit nuk zbatohen, për shkak se janë në kundërshtim me qëllimin për të cilin është ligjëruar kujdestaria. Fukahatë kanë

kundërshtime mes tyre për ato veprime të kujdestarit prej të cilave nuk vjen as dobi e as dëm.

Në grup fukahash kanë thënë se ato zbatohen kur bëhen prej babait e prej gjyshit, sepse kushti te babai e te gjyshi është që prej atyre të dyve nuk ka dëmtim të qëllimshëm, sepse mes tyre e fëmijës nuk ka konflikt interesi. Në lidhje me këtë çështje, Imam Bakiri, baba i Imam Xhaferr Sadikut *(Paqja qoftë mbi ta!)* tregon se i Dërguari i Allahut *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)* ka thënë: "Ti dhe pasuria jote janë të babait tënd…"

Më pas i Dërguari i Allahut *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)* tha: "Nuk duam që babai të marrë prej pasurisë së djalit të vet, përveç asaj që ai ka nevojë të domosdoshme, sepse Allahu nuk i do shkatërruesit."

Nga ky shpjegim kuptohet se, kur veprimi te pasuria e të voglit sjell dëmtim, veprimi me pasurinë e tij nuk lejohet në mënyrë absolute, madje as prej babait të atij fëmije. Kur kjo është kusht për babain e për gjyshin, është e qartë që për sundimtarin ligjor dhe për kujdestarin e emëruar, veprimet e tyre me pasurinë e fëmijës zbatohen vetëm kur janë në interes të fëmijës.

Fukaha të tjerë kanë thënë se nuk ka asnjë dallim mes babait e gjyshit, apo kujdestarit të emëruar, pasi të gjithë kanë detyrim të veprojnë me pasurinë e fëmijës dhe zbatohen vetëm ato veprime të tyre që janë në interesin e fëmijës dhe të ruajtjes së pasurisë së tij.

Argument për këtë është fjala e Allahut të Lartësuar:

"وَلاَ تَقْرَبُوا مَالَ الْيَتِيْمِ إِلاَّ بِالَّتِي هِيَ أَحْسَنُ"

"Mos iu afroni pasurisë së jetimit, veçse në mënyrën më të mirë…" (Sure "El En'àm" ajeti 152 dhe Sure "El Isra", ajeti 34)

Për sa i përket shejkhut ElEnsarij, ai ka zgjedhur të bëjë shpjegime të hollësishme dhe ka thënë: "Në të vërtetë, fakti që veprimi vjen prej babait ose prej gjyshit, është i mjaftueshëm për vlefshmërinë e veprimit, sepse, duke qenë veprim i bërë prej atyre të dyve, nuk ka mundësi të këtë abuzim, kurse në veprimin e të tjerëve, me pasurinë e atij që është marrë nën kujdestari, patjetër duhet të shikohet, nëse është ruajtur interesi i tij."

Më pas shejkhu i nderuar thotë: "Kjo është në marrëveshje të plotë me fjalën e dijetarëve autoritarë, bashkëkohësit tanë."

Ai e ka nxjerrë argumentin e pakushtëzuar që vërteton kujdestarinë e babait dhe të gjyshit, duke pasur në konsideratë se veprimi i tyre, në mënyrë absolute, e shikon interesin e fëmijës dhe aty ku s'ka konflikt interesi, s'ka as abuzim, për rrjedhojë, mungesa e abuzimit, e nxjerr babain e gjyshin jashtë abuzimit, patjetër me argument. Kështu që të dy ata mbeten të përfshirë në argumentin e pakushtëzuar.

Për sa i përket kujdestarisë së ndershme, që ka të bëjë me kuptimin e ajetit të nderuar: **"Mos iu afroni pasurisë së jetimit, veçse në mënyrën më të mirë…"** (Sure "El En'àm" ajeti 152 dhe Sure "El Isra", ajeti 34), ai i është përgjigjur se kjo është specifike si argument që tregon se gjyshi ka pushtet për të vepruar me pasurinë e fëmijës në ato punë ku nuk ka prishje të pasurisë së fëmijës.

Pavarësisht nga këto, kujdestari ka të drejtë që, me pasurinë e atij që ka nën kujdestari, të bëjë tregti vetë, ose ia jep

një tjetri që të bëjë tregti me atë pasuri. Ai ka të drejtë që, me pasurinë e fëmijës, të blejë tokë ose ta shesë pasurinë e tij. Gjithashtu, kujdestari ka të drejtë që pasurinë e atij që ka nën kujdestari, ta lërë peng, me kushtin e përfitimit dhe të këshillës, por nuk lejohet dhënia borxh ose kredi e pasurisë së fëmijës nga ana e kujdestarit, me përjashtim të gjendjes kur është frikë se ajo pasuri mund të humbë.

Një grup fukahash kanë thënë se kujdestari i fëmijës nuk ka të drejtë të kërkojë ekzekutimin e vendimit të gjyqit për dënim kapital, sepse fëmija, kur të arrijë moshën, mbase ka dëshirë ta falë. Gjithashtu, kujdestari nuk ka të drejtë as të falë personin që do të dënohet, sepse mbase fëmija kur të rritet, nuk dëshiron ta falë të dënuarin.

Një grup tjetër fukahash, ndër të cilët edhe dijetari i madh El-Halij, janë shprehur se kujdestari i fëmijës ka të drejtë të kërkojë dënimin kapital për të dënuarin dhe ta falë atë me një pjesë të pasurisë së fëmijës, duke ruajtur interesin e fëmijës. Kjo është e vërteta.

Babai e gjyshi kanë të drejtë të martojnë fëmijën e të çmendurin, por këtë të drejtë nuk e ka kujdestari i emëruar, kurse sundimtari ligjor e marton të çmendurin, krahas interesit për të çmendurin.

Babai e gjyshi kanë të drejtë të divorcojnë për të çmendurin, sepse për këtë ekziston teksti, por as babai e gjyshi e as dikush tjetër nuk kanë të drejtë të divorcojnë për fëmijën, sepse rregulli është: “Divorci është në dorën e atij që merr në kurorë.”

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* është pyetur: "A lejohet që babai të divorcojë për fëmijën e tij?" Ai *(Paqja qoftë mbi të!)* është përgjigjur: "Jo". Meqenëse nuk lejohet për babain që të divorcojë për fëmijën, vetëkuptohet që për të tjerët nuk lejohet në mënyrë të prerë.

Kujdestari ka të drejtë që, me fuqinë e ligjit, të blejë pjesën që me të drejtë i takon si komshi, kur këtë gjë e kërkon interesi i personit që ai ka nën kujdestari, ndryshe heq dorë prej asaj të drejte.

Autori i librit "Miftahul Kerameh" ka thënë: "Kujdestari ka të drejtë t'i japë mizorit ryshfet prej pasurisë së atij që ka nën kujdestari, me qëllim që ta shpëtojë pasurinë e tij, ose ta lirojë atë pasuri, madje, kur mizori e lakmon pasurinë e atij që është nën kujdestari, kujdestari ka detyrim t'i japë këtij mizori atë që çka nuk mund të sprapset prej dhunës së tij, vetëm se duke i dhënë gjënë që kërkon.

Kujdestari ka detyrë të shlyejë, me pasurinë e personit që ai ka kujdestari, detyrimet që duhet të shlyhen patjetër, si për shembull, borxhi dhe kompensimi për dëmin e shkaktuar, edhe pse këto nuk i kërkohet kujdestarit, kurse shpenzimin që bëjnë të afërmit për fëmijën, kujdestari ia paguan atij që ka të drejtë të kërkojë vetëm nëse ai e kërkon.

Kujdestari dhe i ngarkuari për të kontrolluar pasurinë e të marrit nën kujdestari kanë detyrim të shpenzojnë për atë në mënyrën më të mirë, pa i lënë gjë mangët, por pa e tepruar në shpenzim.

Nëse kujdestari është i varfër, ai ka të drejtë të hajë prej pasurisë së atij që ka nën kujdestari me mënyrën më të bukur, por, kur kujdestari është i pasur, ai s'ka të drejtë të hajë prej pasurisë së të marrit nën kujdestari. Për këtë çështje, Allahu i Lartësuar urdhëron:

" وَمَنْ كَانَ غَنِيّاً فَلْيَسْتَعْفِفْ ۖ وَمَنْ كَانَ فَقِيْراً فَلْيَأْكُلْ بِالْمَعْرُوفِ "

"Kush është i pasur, le të ruhet, dhe, kush është i varfër, le të hajë me maturi." (Sure "En Nisa", ajeti 6)

Kujdestari dhe i ngarkuari për të ruajtur pasurinë e të marrit nën kujdestari, është besnik dhe nuk garanton, me përjashtim të rastit kur vërtetohet se ai ka vënë dorë, ose ka neglizhuar në ruajtjen e pasurisë së të marrit nën kujdestari. Fjala e kujdestarit pranohet në lidhje me shpenzimin për punë të mirë. Gjithashtu, pranohet fjala e tij për shitjen, blerjen, kreditimin dhe të tjera veprime, kur është interesi i të marrit nën kujdestari. Gjithashtu, fjala e kujdestarit dhe i të ngarkuarit për ruajtjen e pasurisë së të marrit në kujdestari, pranohet në rastet e prishjes së pasurisë, me kusht kur është treguar i gjithë kujdesi i duhur për ruajtjen e asaj pasurie.

Kur fëmija arrin moshën madhore dhe pretendon që kujdestari ka vënë dorë mbi pasurinë e tij, ose pretendon që kujdestari ka qenë i shkujdesur për ruajtjen e pasurisë së tij, patjetër që duhet të sjellë argument, kurse kujdestari ose personi i ngarkuar për ruajtjen e pasurisë së fëmijës, do të betohet, sepse ai është besnik.

Kujdestarit i lejohet që, me pasurinë e të marrit nën kujdestari, të blejë për veten e tij. Gjithashtu, ai ka të drejtë ta

shesë pasurinë e të marrit në kujdestari, patjetër krahas interesit të fëmijës, ose mospasjes abuzim në blerjen e në shitjen, por kjo është e kundërta e asaj që theksuam.

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* është pyetur: "A ka të drejtë personi i ngarkuar për ruajtjen e pasurisë së atij që ka marrë në kujdestari, që të blejë prej pasurisë së të vdekurit, kur ajo vihet në shitje dhe tepricën e merr për veten e tij?" Ai *(Paqja qoftë mbi të!)* është përgjigjur: "Lejohet, nëse ka bërë blerje të vlefshme." Kur kjo gjë lejohet për personin e ngarkuar për të ruajtur pasurinë e të marrit nën kujdestari, vetëkuptohet që kujdestari ka më shumë përparësi.

Madje autori i librit "El Xheuahir", në kapitullin "Porositë", ka thënë: "Me fjalën e përbashkët të fukahave, lejohet që babai të blejë prej pasurisë së djalit të vogël."

Do të rikthemi të flasim për kujdestarin e për sundimtarin ligjor në kapitullin "Divorci dhe martesa", kurse për të porositurin e për veprimet e tij, me lejen e Allahut, do të flasim në kapitullin "Porositë".

* * *

I FALIMENTUARI

Kuptimi i fjalës "i falimentuar"

Më sipër trajtuam të çmendurin, të voglin, mendjelehtin e të sëmurin. Na ka mbetur vetëm "i falimentuari". Nga ana gjuhësore, "i falimentuar" është ai që s'ka as pasuri e as punë që të plotësojë nevojat e tij. Te fukahatë, "i falimentuar" është personi të cilit sundimtari ligjor i ka ngurtësuar pasuritë për shkak të borxheve që ai ka marrë. Borxhmarrësi nuk ndalohet të veprojë me pasuritë e veta, sado shumë që të jenë borxhet e tij, por ai ndalohet të veprojë me ato pasuri vetëm pasi atë e ka ngurtësuar sundimtari ligjor.

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "I falimentuari, ligjërisht është personi që i janë ngurtësuar pasuritë për shkak se pasuria e tij është më e vogël se borxhet që ai ka. Para ngurtësimit, borxhmarrësi, ligjërisht, nuk quhet i falimentuar, edhe nëse borxhet e tij janë të barabarta me pasuritë e tij, madje edhe kur borxhet janë më të mëdha. Për këtë dëshmon shikimi me kujdes në fjalët e fukahave."

Kushtet

Sundimtari e ngurtëson borxhmarrësin vetëm kur plotësohen kushtet e vijuese:

1- Kur borxhet vërtetohen te sundimtari, është e kuptueshme që ngurtësimi ndodh vetëm prej sundimtarit, prandaj është e domosdoshme që borxhet të vërtetohen te sundimtari me pohimin e borxhmarrësit, ose me argument, ose me rrugë të tjera të vërtetimit.

2- Pasuritë e borxhmarrësit nuk mbulojnë shlyerjen e borxheve që ai ka detyrim të shlyejë. Me fjalën e përbashkët të fukahave, kur pasuritë e borxhmarrësit janë më shumë se borxhi, ose janë të barabarta me borxhin, ai nuk ngurtësohet.

Autori i librit "El Mesalik" ka thënë: "Ky është gjykimi te të gjithë dijetarët tanë të fesë. Në këtë gjendje, borxhdhënësi i kërkon borxhmarrësit shlyerjen e borxhit. Nëse borxhmarrësi nuk e shlyen borxhin, borxhdhënësi e ngre çështjen te sundimtari ligjor, i cili ka të drejtë të përzgjedhë mes burgosjes së borxhmarrësit, derisa të shlyejë borxhin që ka detyrim të shlyejë dhe mes shitjes së mallrave të borxhmarrësit dhe me shumën e mbledhur shlyen borxhin e tij."

3- Borxhi të jetë aktual dhe jo i vonuar, për shkak të mosvërtetimit krahas vonimit. Veç kësaj, Allahu i Plotpushtetshëm e ka lehtësuar mbajtjen e besës për shlyerjen e borxhit me hyrjen e afatit. Kur një pjesë e borxhit është aktual dhe pjesa tjetër është borxh i vonuar, atëherë shikohet: Nëse pasuritë e borxhmarrësit shlyejnë borxhin aktual, në këtë gjendje, nuk ka

ngurtësim, por, nëse pasuritë e borxhmarrësit nuk mjaftojnë, atëherë ndodh ngurtësimi.

Kur ngurtësohen borxhet e përshpejtuara, borxhet e vonuara mbeten deri në afatin e vet. Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Sikur një pjesë e borxhit të jetë borxh aktual, ndodh ngurtësimi, kur nuk bëhet shlyerja e borxhit dhe, kur ngurtësimin e kërkojnë borxhdhënësit, në këtë gjendje, pasuria e borxhmarrësit pjesëtohet ndërmjet borxhdhënësve, kurse për borxhet e vonuara nuk depozitohet asnjë send."

4- Ngurtësimi të jetë me kërkesën e të gjithë borxhdhënësve, ose edhe të një pjese të tyre, sepse e drejta i takon borxhdhënësve dhe sundimtari, duke bërë ngurtësimin e pasurive të borxhmarrësit, nuk bën bamirësi për borxhdhënësit, me përjashtim të rastit kur borxhet janë për personat për të cilët sundimtari është kujdestar, si për shembull, jetimi, i çmenduri dhe mendjelehti.

Pas ngurtësimit

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se i falimentuari ndalohet të veprojë me pasuritë e veta, të cilat ekzistonin në kohën e ngurtësimit, por fukahatë kanë kundërshtime mes tyre, në lidhje me atë pasuri të tij që është ripërtërirë pas ngurtësimit. Shtrohet pyetja: A ndalohet apo nuk ndalohet ai prej kësaj pasurie, gjithnjë për interesin e borxhdhënësve?

Në lidhje me këtë çështje, fukahatë kanë dy thënie. Thënia më e saktë është se ai nuk ndalohet të veprojë në pasurinë që ai

arrin pas ngurtësimit, sepse ngurtësimi ka lidhje me atë pasuri të borxhmarrësit që ekzistonte në kohën e ngurtësimit dhe nuk hyjnë në ngurtësim pasuritë që ka arritur të vërë borxhmarrësi pas ngurtësimit. Përveç kësaj, ngurtësimi i pasurisë së re që ai ka arritur pas ngurtësimit, ka nevojë për një ngurtësim të dytë, me vendim të sundimtarit ligjor, sepse nuk ka ngurtësim pa vendim.

Gjithsesi, i falimentuari nuk ndalohet të veprojë në punët që s'kanë të bëjnë me pasurinë dhe që nuk dëmtojnë interesat e borxhdhënësve.

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Ai nuk ndalohet të martohet, të divorcojë, të kërkojë zbatimin e dënimit mbi të dënuarin me ekzekutim kapital, ose të falë të dënuarin, të pohojë përkatësinë atërore dhe të tjera veprime që s'kanë lidhje me pasurinë. Gjithashtu, ai nuk ndalohet nga veprimet që çojnë në arritjen e pasurisë, si për shembull, pret dru për shitje, ose shkon për gjah, pranon dhuratën dhe testamentin, ose ble e merr kredi në mirëbesim."

Sundimtari shet pasuritë e të falimentuarit dhe pastaj ua ndan ato borxhdhënësve, secilit sipas të drejtës që i takon.

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë se Prijësi i besimtarëve, Imami Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*, burgoste, kur borxhmarrësi vononte shlyerjen e borxhit dhe kështu i shkaktonte vështirësi borxhdhënësve të tij. Pastaj urdhëronte që pasuria e tij të pjesëtohej dhe të ndahej mes borxhdhënësve, sipas pjesëve që kishin dhënë.

Është e vërtetë se, kur borxhdhënësi gjen sendin e tij, që i falimentuari kishte blerë prej tij me pagesë të vonuar, ka të drejtë

më shumë se të gjithë borxhdhënësit e tjerë ta marrë sendin e tij, qoftë edhe sikur borxhmarrësi të mos ketë asgjë tjetër përveç atij sendi.

Gjithashtu, ai ka të drejtë ta lërë sendin e tij dhe të bëhet ortak me borxhdhënësit e tjerë, domethënë, që secili të marrë sipas pjesës që i takon.

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Kjo është praktika më e përhapur. Për këtë unë nuk gjej asnjë kundërshtim që ta atakojë këtë praktikë. Në hadithin e treguar në librat e fukahave, thuhet se i Dërguari i Allahut *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)*, kur burri falimenton dhe ai e gjen mallin e tij, ai është më i merituari për atë pasuri."

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* është pyetur për një burrë që e kanë mposhtur borxhet dhe te ai gjendet një send i një burri tjetër. I kujt është ky send? Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* është përgjigjur: "I pronarit të atij sendi. Askush prej borxhdhënësve të tjerë nuk i hyn në pjesë."

Në të vërtetë, kjo praktikë hyn në kapitullin e përzgjedhjes së falimentimit, domethënë që pronari i sendit ka të drejtë të përzgjedhë mes firmosjes së shitjes ose mosfirmosjes së shitjes dhe pëlqen marrjen e çmimit së bashku me borxhdhënësit e tjerë dhe mes prishjes së shitjes dhe kërkimit të sendit prej blerësit të falimentuar.

Pohimi i të falimentuarit

Kur i falimentuari, pas ngurtësimit, pohon se i ka borxh një personi, a pranohet pohimi prej tij dhe për rrjedhojë, personi për të cilin u pohua borxhi të jetë pjesëtar së bashku me borxhdhënësit e tjerë në pjesëtimin e mallit të gjendur?

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se borxhi vërtetohet, nëse është në mirëbesimin e të falimentuarit, kur ky i fundit pohon se i ka marrë borxh një person. Por fukahatë kanë mendime të ndryshme, nëse personi për të cilin u vërtetua se është borxhdhënës apo nuk është ortak me borxhdhënësit e tjerë në pasurinë ekzistuese të të falimentuarit. Dëshmori i dytë, në librin "El Mesalik", ka thënë: "Më e fuqishme është se ai nuk bëhet ortak me ta."

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Mosbërja ortak është shumë e fuqishme për shkak se pohimi në të drejtën e tjetrit është kategorikisht i ndaluar."

Me këtë shprehje ai ka qëllim të tregojë se pohimi i të falimentuarit nuk zbatohet në dëm të borxhdhënësve që kanë lidhje me pasurinë e ekzistuese të të falimentuarit.

Me fjalë të tjera, i falimentuari, ashtu siç nuk ka të drejtë të veprojë me pasurinë e tij, po ashtu nuk ka të drejtë të pohojë as në mënyrë të drejtpërdrejtë e as në mënyrë të tërthortë se mbi pasurinë e tij ka të drejtë edhe ndonjë tjetër.

Të përjashtuarat

Përjashtohen prej ngurtësimit të pasurive të të falimentuarit, shtëpia ku ai banon dhe të gjitha sendet e domosdoshme, si: rrobat, ushqimi për një ditë, për vetë të falimentuarin dhe për personat që ai ka në ngarkim; librat që ai nuk bën dot pa ato; veglat e mjeshtërisë, me të cilat ai siguron ushqimin; pajisjet e domosdoshme të shtëpisë, si: shtrojat e mbulesat, enë të ndryshme dhe të tjera pajisje pa të cilat askush nuk mund të bëjë në gjendjen e tij të tanishme.

Prej Ehli Bejtit *(Paqja e Allahut qoftë mbi ta!)* është vërtetuar se, krahas përjashtimit të banesës, përjashtohet edhe shërbyesi (skllavi).

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "Për shlyerjen e borxhit nuk shitet as shtëpia e as skllavja, sepse burri patjetër që ka nevojë për strehë ku të fusë kokën dhe për shërbyes, që t'i shërbejë atij."

Gjithashtu, ai ka thënë: "Për borxhin, burri nuk nxirret jashtë vendit ku i ka rënë koka (shtëpisë)."

Prej përjashtimit të shtëpisë dhe të shërbyesit, fukahatë kanë zbuluar përjashtimin e çdo gjëje që nevoja e bën të domosdoshme dhe kanë thënë se, përjashtimi i shtëpisë e i shërbyesit, tregon përparësi edhe për përjashtimin e veshjeve dhe të sendeve të tjera, që janë në pozitën e veshjeve. Kjo është ajo përparësi për të cilën fukahatë janë shprehur herë me fjalën e tyre të përbashkët dhe herë me përmbajtjen e tekstit dhe kanë thënë që me tekst përjashtohet qefini, pavarësisht se me përjashtimin e qefinit preket e drejta e borxhdhënësve.

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* tregon se i Dërguari i Allahut *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)* ka thënë: "Gjëja e parë me të cilën fillohet pasuria, është qefini, pastaj borxhi, pastaj testamenti dhe pastaj trashëgimia."

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Derisa prej ngurtësimit përjashtohet qefini, që është rroba e të vdekurit, patjetër që i gjalli është më shumë i paprekshëm se i vdekuri në veshjen e tij."

Burgosja e borxhmarrësit

Nga pikëpamja e gjendjes së vështirë ose të mirë, borxhmarrësi ndahet në kategoritë vijuese:

1- Borxhmarrësi ka pasuri të dukshme, në atë mënyrë që ndër të njohurit ai numërohet prej njerëzve që janë në gjendje të mirë. Nëse ky person nuk e mban besën për të shlyer borxhin e marrë, borxhdhënësi e ngre çështjen për mosshlyerjen e borxhit te sunduesi dhe sunduesi, nga ana e tij, ka të drejtë të përzgjedhë mes burgosjes së këtij borxhmarrësi, derisa të shlyejë borxhin që ka dhe mes shitjes së disa prej pasurive të këtij borxhmarrësi. Me shumën e mbledhur nga kjo shitje, sundimtari u shlyen borxhin borxhdhënësve.

Në lidhje për këtë çështje, në një hadith thuhet: "Borxhmarrësi në gjendje të mirë e ka hallall dënimin dhe qortimin e rëndë."

Me fjalën "dënim", është qëllim burgosja e tij, kurse me fjalën "qortim", është qëllim qortimi i borxhmarrësit me fjalë të

rënda, apo me të tjera veprime që i mendon sundimtari, si për shembull, ai i thotë këtij borxhmarrësi: "Ore zullumqar, që ha të drejtën e tjetrit!", ose e qorton me të tjera fjalë të kësaj kategorie.

Është vërtetuar se Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*, ka burgosur borxhmarrësin në gjendje të mirë, pasi ai, duke vonuar shlyerjen e borxhit, dëmtonte borxhdhënësit, prandaj ai urdhëroi pjesëtimin e pasurisë së këtij borxhmarrësi ndërmjet borxhdhënësve.

Kjo dispozitë përfshin çdo borxhmarrës për të cilin vërtetohet se është në gjendje të mirë dhe ka fuqi ta mbajë besën për shlyerjen e borxhit. Vërtetimi se borxhmarrësi është në gjendje të mirë bëhet me pohimin e vetë borxhmarrësit, ose me fjalët që qarkullojnë në lidhje me gjendjen e tij, ose me argument.

2- Borxhmarrësi nuk ka pasuri të dukshme, as pasuri të njohur më parë dhe ai thotë: "Nuk kam asgjë." Nëse borxhdhënësi e beson, atëherë ai ka detyrim ta presë borxhmarrësin, ndryshe borxhdhënësi sjell argumentin, kurse borxhmarrësi ka detyrim të betohet, sepse pasuria dhe gjendja e mirë janë gjendje kalimtare, por si bazë merret mospasja pasuri dhe, kur borxhmarrësi betohet, ai do të pritet, derisa të bëhet në gjendje të mirë. Për këtë çështje, Allahu i Lartësuar urdhëron në fjalën e Tij:

"وَإِنْ كَانَ ذُو عُسْرَةٍ فَنَظِرَةٌ إِلَى مَيْسَرَةٍ"

"Në qoftë se borxhmarrësi është në gjendje të vështirë, atëherë pritet, derisa ai të bëhet në gjendje të mirë..." (Sure "El Bekare", ajeti 280)

3- Borxhmarrësi nuk ka pasuri të dukshme, por borxhdhënësi i tij i ka kredituar atij mall, ose i ka shitur atij një send për të cilin nuk ka marrë akoma paratë, kurse borxhmarrësi pretendon se ai mall ose ai send nuk është prishur. Ky borxhmarrës burgoset, derisa të vërtetohet që ai është në gjendje të vështirë, sepse baza është mbetja e atij borxhi në dorën e tij, derisa të vërtetohet e kundërta.

4- Borxhmarrësi nuk ka pasuri të dukshme, por ka pasuri të njohur më përpara, megjithëkëtë ai pretendon se ajo pasuri është asgjësuar. Këtë borxhmarrës gjykatësi (el hakimu) sundimtari e burgos, derisa të vërtetohet që ai është në gjendje të vështirë. Ky vendim i sundimtarit, është i mbështetur në transmetimin e mësipërm që tregonte se Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* ka burgosur, derisa të vërtetohej gjendja e vështirë. Gjendja e vështirë vërtetohet, kur argumenti tregon se pasuria që kishte borxhmarrësi, u asgjësua dhe prej saj nuk ka mbetur asgjë. Kjo dëshmi pranohet, sepse vërtetim është vetë asgjësimi. Në qoftë se argumenti nuk dëshmon asgjësimin e pasurisë së borxhmarrësit, por dëshmon vetëm gjendjen e tij të vështirë, pa shpjeguar shkakun, ky argument nuk pranohet, kur ne dimë që ky argument përmban informacion të sigurt për gjendjet e borxhmarrësit që ai është pjesëtar i një tribuje, sepse dëshmia për gjendjen e vështirë është mohim dhe dëshmi që ai nuk ka pasuri. Vetëkuptohet që dëshmia që mohon, nuk dëgjohet, derisa ajo të vërtetohet. Por këtu nuk ka mundësi që vërtetimi të kushtëzohet, por ka dijeni që dëshmitarët janë në gjendjen e borxhmarrësit dhe mësohet me anë të shqisave se ai borxhmarrës nuk zotëron asnjë send.

Në qoftë se argumenti nuk ka informacion për të vërtetën e borxhmarrësit, borxhdhënësit kanë detyrim të betohen kundër

borxhmarrësit. Ky është shpjegimi që ka ardhur në librin "El Xhevahir" dhe në librin "El Mesalik", pa theksuar kundërshtimet në mesin e fukahave, kurse autori i librit "El Hadaik" e ka atribuuar këtë thënie si fjalë e përbashkët e të gjithë fukahave.

Çështje

1- Gjykatësi e pjesëton pasurinë e të falimentuarit ndërmjet borxhdhënësve dhe më pas del një borxhdhënës i ri, për të cilin nuk dihej gjë më parë dhe për atë nuk ka ndonjë send konkret prej pasurisë së borxhmarrësit që ai të përzgjedhë prishjen dhe të kërkojë kthimin e sendit për shkak të falimentimit. Në këtë gjendje, a prishet pjesëtimi që nga kreu, apo pjesëtimi mbetet dhe borxhdhënësi i ri kërkon prej secilit borxhdhënës një pjesë sipas kërkesave të llogarisë?

Për këtë çështje fukahatë kanë dy thënie dhe më e sakta prej këtyre dy thënieve është ajo që kanë thënë autorët e librave "Esh Sheràir", "El Xheuahir", "El Mesalik" e autorë të tjerë përveç këtyre: "Pavlefshmëria e pjesëtimit që nga kreu, për shkak se pjesëtimi ishte i ndërtuar mbi faktin që dihej se e drejta ishte e kufizuar vetëm te borxhdhënësit e njohur, por tani që u vërtetua e kundërta, rezulton se ajo që u ndërtua mbi një veprim të pavlefshëm, patjetër që është e pavlefshme, është plotësisht sikur ortakët të pjesëtojnë pasurinë e përbashkët që kanë në ortakëri mes tyre dhe pas pjesëtimit del një ortak tjetër.

2- Më sipër u tha se ai që gjen mallin e tij ndërmjet mallrave të të falimentuarit, ai ka përparësi ndaj të gjithë borxhdhënësve të tjerë, që ta marrë mallin e tij, sepse, në këtë gjendje, ai ka të drejtën

e përzgjedhjes për të prishur marrëveshjen. Shtrohet pyetja: A është vepruese kjo dispozitë për borxhdhënësit e të vdekurit, domethënë, kur vdes një njeri që ka borxhe për të shlyer dhe njëri prej borxhdhënësve gjen sendin e tij që nuk është asgjësuar ndër ato që ka lënë i vdekuri, a ka përparësi ta marrë atë send ndaj të gjithë borxhdhënësve të tjerëve?

Shumica e fukahave të dëgjuar kanë shkuar me dëshminë e autorëve të librave "El Xheuahir" dhe "EluHadaik", të cilët kanë thënë: "Nëse pasuria që ka lënë i vdekuri është e mjaftueshme për shlyerjen e të gjitha borxheve, pronari i atij sendi ka të drejtë ta marrë atë send, por, nëse ajo që ka lënë i vdekuri, nuk mjafton për të shlyer të gjitha borxhet e të vdekurit, pronari i atij sendi nuk e gëzon këtë të drejtë, pasi, në këtë gjendje, ai është i barabartë me borxhdhënësit e tjerë.

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* është pyetur për një burrë që i ka shitur një burri tjetër një mall, me kusht që të marrë paratë pas një viti, ndërkaq blerësi vdes para se të marrë mallin dhe shitësi e gjen pikërisht mallin e tij, a ka të drejtë ai ta marrë atë mall, nëse me të vërtetë e njeh mirë që është malli i tij? Ai *(Paqja qoftë mbi të!)* është përgjigjur: "Nëse ai ka borxh për të shlyer dhe ka lënë aq pasuri sa e mbulon borxhin që ai ka, le të marrë mallin e vet, nëse me të vërtetë i takon ta marrë atë mall, domethënë, nëse atë mall e ka hallall, por, nëse i vdekuri ka lënë aq sa mjafton për të shlyer borxhin, në këtë gjendje, pronari i atij malli është si çdo borxhdhënës tjetër, të cilit i vdekuri kishte detyrim të shlyente borxhin, domethënë që pronari i atij malli merr pjesën e tij dhe nuk ka asnjë rrugë ligjore që ai ta marrë mallin që kishte gjetur ndër mallrat që ka lënë i vdekuri.

3- Shumica e fukahave më të dëgjuar kanë shkuar me dëshminë e autorëve të librave "El Xheuahir" dhe "El Hadaik" se ai që ble një tokë dhe në atë tokë ai mbjell pemë, ose mbi atë tokë ai bën një ndërtim dhe më pas ai falimenton, pronari i tokës ka më shumë të drejtë ta marrë tokën e tij. Nëse ai përzgjedh ta marrë tokën, ai s'ka të drejtë të asgjësojë pemët ose ndërtimin, pasi është detyrë që ato të mbeten për llogari të të falimentuarit pa shpërblim, sepse i falimentuari ka mbjellë bimë bujqësore ose pemë në pronën e tij me të drejtën e pronarit dhe puna e tij është e respektuar.

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Asnjëri prej fukahave nuk e ka përmendur të drejtën e pronarit të tokës për qiranë e ndërtesës dhe të pemëve të mbjella."

4- Sapo të bëhet pjesëtimi i pasurive të të falimentuarit ndërmjet borxhdhënësve, ngurtësimi hiqet dhe kjo heqje e ngurtësimit nuk ka nevojë për lejen e sundimtarit. E njëjta gjë është edhe kur borxhdhënësit bien në një fjalë të përbashkët për heqjen e ngurtësimit prej borxhmarrësit, sepse kjo është një e drejtë që i takon borxhdhënësve. Përveç kësaj, borxhdhënësit, në raport me pasurinë e të falimentuarit, janë plotësisht si pengpranuesi me sendin e lënë peng.

5- Padyshim që borxhmarrësi që ka fuqi të shlyejë borxhin, por e vonon shlyerjen, lejohet që ky borxhmarrës të dënohet me burgim, vetëkuptohet që edhe ndalimi i tij për të mos udhëtuar është i lejueshëm, pasi ndalimi për të mos udhëtuar bëhet nga frika që të mos humbë e drejta e tjetrit për shkak të udhëtimit që bën borxhmarrësi, si për shembull, udhëtimi mund të jetë i largët, ose mendohet që udhëtimi është i rrezikshëm. Nëse borxhmarrësi

ka një garantues, domethënë, kur e drejta ligjërisht është e ruajtur, në asnjë rast, borxhmarrësi nuk lejohet të ndalohet për të udhëtuar.

Autori i librit "Miftahul Kerameh", në kapitullin "Ngurtësimi", ka thënë: "Shlyerja e borxhit, kur kërkohet dhe, kur është mundësia për ta shlyer atë borxh, borxhmarrësi ka detyrim ta shlyejë borxhin menjëherë dhe borxhdhënësi ka të drejtë të ndalojë çdo veprim të borxhmarrësit, që është në kundërshtim me marrjen e të drejtës që i takon atij. Për këtë gjykim nuk ka asnjë dyshim, pasi, në të vërtetë, këtu kemi thjesht ndalim për të mos udhëtuar, ashtu siç e ndalon pronari skllavin e vet, ose burri gruan e tij. Por në gjendjen që kemi në trajtim, kërkesa për ndalimin e borxhmarrësit është vetëm për shkak të borxhit që ai nuk e ka shlyer, prandaj edhe borxhdhënësi e ngre çështjen te sundimtari me kërkesën për ndalimin e borxhmarrësit, derisa kërkuesi borxhdhënës të marrë të drejtën e tij. Nëse borxhmarrësi e vonon shlyerjen e borxhit, atëherë sundimtari e burgos borxhmarrësin."

Me këtë shpjegim bëhet e qartë se vendimet që marrin gjykatat e ligjit të fesë islame (sheriatit) në Liban për të ndaluar nga udhëtimi personin e akuzuar, para se të bëhet gjykimi dhe, kur është vërtetuar se ai ka detyrim për të shlyer borxhin, të gjitha këto vendime nuk janë të mbështetura në bazën e ligjit të fesë islame, por janë të mbështetura vetëm në një nen të ligjit penal.

Falënderimi e Lavdimi janë vetëm për Allahun, që na ka ruajtur e na ka shpëtuar prej këtyre veprimeve të zeza.

* * *

POHIMI

Kuptimi i fjalës "pohim"

Kuptimi i fjalës "pohim", nga ana gjuhësore, nga ana e traditës dhe nga ana ligjore është i njëjtë, domethënë, pohim për një të drejtë të vërtetuar. Me fjalën "për një të drejtë" renditen të gjitha të drejtat. Kjo është e barabartë, kur e drejta është për Allahun, si për shembull, pohimi për një veprim që e bën të detyrueshëm zbatimin e dënimeve fizike që parashikon ligji, përfshirë edhe qortimet, qoftë kur e drejta u takon njerëzve, domethënë, kur pohimi ka lidhje me një të drejtë që njerëzit duhet të marrin, ose e drejta është send, ose dobi, ose zbatim i dënimit fizik.

Prej pohimit është edhe njohja e një të drejte të varur mbi një send, si për shembull, ai thotë: "Kam detyrim t'i jap filanit njëqind para, kur ai të arrijë në filan send, ose kur të hyjë filan muaj.", pra, e drejta është vërtetuar tani, por personi që i premtohet, ka të drejtë të kërkojë sendin e premtuar vetëm në të ardhmen.

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Mohimi i vërtetësisë së pohimit kundër tij, ose mosveprimi i dispozitës së pohimit për veprime të urryera, nuk dëgjohet prej atyre që i pretendojnë."

Pavarësisht nga sa u tha, fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se pohimi nuk ka asnjë send prej kontratave dhe rrëzimit të vendimeve, sepse pohimi nuk ka asnjë lidhje me lindjen e një shkaku.

Ligjshmëria e pohimit dhe argumentimi i tij

Nuk ka asnjë dyshim për ligjshmërinë e pohimit dhe që pohimi është argument i zbatueshëm në të drejtën e personit të të cilit është bërë pohimi. Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Bazë për ligjshmërinë e pohimit është fjala e përbashkët e myslimanëve, ose domosdoshmëria, domethënë, është e vetëkuptueshme.

Madje Libri i Allahut dhe Suneti janë të prerë në lidhje me pohimin."

Prej Librit të Allahut të Lartësuar kemi disa ajete:

"أَأَقْرَرْتُمْ وَأَخَذْتُمْ عَلَى ذَٰلِكُمْ إِصْرِي ۖ قَالُوا أَقْرَرْنَا"

"...a e pohuat, a e morët përsipër obligimin nga ana ime? Ata thanë: "Pohuam (pranuam)**..."** (Sure "Ali Imran", ajeti 81)

Ajeti tjetër:

"وَآخَرُونَ اعْتَرَفُوا بِذُنُوبِهِمْ"

"Dhe të tjerët pohuan mëkatet e veta..." (Sure "Et Teube," ajeti 102)

Prej Sunetit kemi hadithin e Profetit Muhamed *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)*, me varg përcjellësish të pashkëputur: "Pohimi i të mençurve kundër vetes së tyre është i lejuar.", domethënë i zbatueshëm.

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "Nuk e lejoj dëmin e mëkatarit, përveçse kur ai dëshmon kundër vetvetes." Në lidhje me këtë çështje kemi transmetime të shumta, të shpërndara në kapitujt e fik'hut, të përmendura sipas rastit.

Fukahatë kanë thënë: "Sikur argumenti të ishte kundër atij që pretendon për vetveten dhe më pas ai të pohojë të drejtën, gjykimi jepet sipas pohimit që ai bëri kundër vetvetes dhe jo sipas argumentit."

Pohimi qëndron mbi katër kolona-kushte: formula, pohuesi, personi në favor të të cilit pohohet dhe sendi për të cilin pohohet.

Në vijim po japim sqarimin për secilin kusht.

Formula

A është formula prej kategorive të fjalës, domethënë që nuk përfshin as shkrimin, as shenjën, as punën, apo pohimi është më përgjithësues e më përfshirës?

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Mbështetja e pohimit mbi traditën, në kuptimin e tij dhe në miratimin e tij, ka

më përparësi se të jetë subjekt për përcaktimin e tij." Pas një ndërprerjeje të gjatë, ai vazhdon: "Tradita është ajo që bën dallimin mes elementeve të pohimit, sepse është tradita ajo që edhe në një çështje të vetme, nga njëra anë, e bën thënësin e formulës pretendues dhe, nga ana tjetër, e bën atë pohues."

Kjo është e drejtë, sepse ligjvënësi nuk ka asnjë fjalë konkrete të veçantë në lidhje me kuptimin e pohimit dhe as pikë referimi për të mësuar kuptimin e pohimit e as dallimin e elementeve të pohimit prej elementeve e fjalëve të tjera që s'kanë të bëjnë me pohimin, përveç traditës. Tradita e shikon vërtetimin e pohimit në çdo fjalë, ose punë, ose shenjë, ose shkresë që tregon qëllimin e pohuesit.

Pohim me fjalë kemi kur pohuesi thotë: "Për ty, te unë, ose detyrim mbi mua", ose "Kjo është për ty.", ose të tjera fjalë të kësaj kategorie, në çdo gjuhë që të jenë thënë. Gjithashtu, pohim me fjalë është edhe kur pohuesi thotë "Po", ose, "Jo", në përgjigje të atij që thotë: "Për mua ti ke detyrim kaq."

Pohim me punë kemi, kur ti i thua një personi: "Për mua ke detyrim të më japësh njëqind." dhe ai menjëherë të jep ty shumën e pretenduar. Pohimi realizohet edhe me shenjë, ose me shkresë që shpreh qëllimin e atij që bëri shenjën, ose të atij që shkroi shkresën. Kjo është e barabartë, nëse pohimin e ke marrë prej atij që ka fuqi të shprehet me fjalë, ose prej një tjetri, qëllimi mbetet shprehja e qëllimit.

Autori i librit "El Mesalik" ka thënë: "Meqenëse qëllimi me pohimin është njoftimi për atë çka është në ruajtje, ose në

mirëbesim, ajo nuk ka të bëjë me një fjalë të përcaktuar, por edhe me çdo punë e me çdo veprim që tregon qëllimin."

Atëherë fjala është mjeti për të shprehur qëllimin dhe nuk është qëllim në vetvete. Bazuar mbi këtë shpjegim, çdo gjë që shpreh qëllimin, qoftë punë ose shenjë, ose shkresë, është pohim, ose i jepet dispozita e pohimit. Patjetër që dallimi mes fjalës dhe mes mjeteve të tjera të shprehjes, është e dukshme, që ana e jashtme e fjalës te racionalistët dhe te fukahatë është argument shprehës, edhe nëse njoftimi merret me hamendje, pa e ditur qëllimin, kurse mjetet e tjera të shprehjes, si: puna, shenja e shkresa, nuk janë argument, veçse kur prej atyre mësohet qëllimi. Bazuar mbi këtë rregull, rezulton se mësimi i qëllimit është vetë argumenti dhe jo puna si punë, ose shkresa si shkresë, ose shenja si shenjë.

Është rasti të citojmë atë që ka përmendur autori i librit "El Xheuahir" në fillim të kapitullit "Testamenti": "Domosdoshmëria e argumentit, e anës së jashtme të punëve, është si fjalët. Gjithashtu, edhe shkresa është motra e fjalëve, por shkresa është shkalla e dytë për të treguar gjendjen e asaj që është në shpirt, prandaj shkresa, në fushën e pohimit, ka më shumë përparësi se fjalët."

Pavarësisht nga dyshimet tona, ne nuk dyshojmë që juristët myslimanë dhe të tjerë, prej atyre që e kanë konsideruar shkrimin prej mjeteve për vërtetimin e të drejtës, të kenë menduar se me shkrimin mësohet qëllimi, kurse ata që nuk e kanë konsideruar shkrimin argument e mjet për të vërtetuar, mendojnë se me shkrimin nuk mësohet qëllimi.

Bazuar mbi këtë shpjegim, kundërshtimi mes atyre nuk është kundërshtim esencial, por është kundërshtim minimal që ka të bëjë me specifikim e me zbatimin.

Në formulën e pohimit është kusht që formula të shprehë realizimin dhe pohimi të mos jetë i varur me ndonjë veprim. Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Në mesin e fukahave nuk ka mendime të kundërta në lidhje me kushtin që formula e pohimit të shprehë realizimin, sepse realizimi është njoftim për një të drejtë të vërtetuar. Kurse varësi do të thotë që e drejta nuk vërtetohet dhe ajo e drejtë mund të vërtetohet vetëm pasi të ekzistojë sendi mbi të cilin është varur formula."

Kur ai thotë: "Me lejen e Allahut, kjo është për ty!", ose "Nëse do Zejdi...", këto thënie nuk janë pohim.

Gjithashtu, nuk është pohim, edhe kur ai thotë: "Nëse filani dëshmon, e drejta jote është vërtetuar në ruajtjen time.", ose "Ai është njeri i drejtë dhe nuk është nevoja të pohojë ndonjë gjë.", domethënë që është prej të lejuarave që ai të jetë i bindur që filani nuk dëshmon.

Autori i librit "El Mesalik" ka thënë: "Ky përdorim është shumë i përhapur te tradita dhe te njerëzit. Në bisedat e tyre, thonë se, nëse filani dëshmon, që nuk është babai im, unë do të vërtetoj dëshminë e tij, por ai s'mund të pohojë asnjë qëllim tjetër, veçse të mos e dëshmojë këtë në mënyrë absolute, sepse, në të vërtetë, edhe ai vetë nuk e vërteton atë që thotë, sikur atë do ta thoshte filani."

Përveç kësaj, çështja e rrugës me të cilën vërtetohet e drejta, është në dorën e ligjvënësit dhe jo në dorën e pretenduesve. Kur

njëri prej dy pretenduesve thotë: "Miratoj të vërtetohet që unë kam detyrim të plotësoj një të drejtë." dhe nuk kthen kokën të shikojë se ç'thotë ai, edhe atëherë kur për atë të drejtë ai mund të përputhet me kundërshtarin e tij.

Me një fjalë, këtu kemi të bëjmë me një dallim mes pohimit me të drejtën dhe mes pohimit ose miratimit me rrugën me të cilën vërtetohet e drejta, sepse, me të parin, është i detyruar pohuesi dhe puna e të dytit është në dorën e ligjvënësit.

Pohuesi

Për pohuesin kërkohen këto kushte:

1- Pohuesi është i mençur dhe në moshë madhore. Vetëkuptohet që fjala e të çmendurit nuk e detyron atë me asgjë, po kështu është edhe pohimi i fëmijës, edhe nëse fëmija është në gjendje të dallojë punët, por pohimi i fëmijës merret në konsideratë për një testament të njohur, nëse ai fëmijë ka mbushur dhjetë vjeç, sepse ai nuk ka mundësi ta bëjë këtë pohim nën këtë moshë. Rregulli është se ai që ka një send, ka edhe të drejtën të pohojë për atë send.

Por a merret në konsideratë pohimi i fëmijës, kur atë e lejon kujdestari të pohojë?

Në librin "El Xheuahir", cituar prej librit Et Tedhkireh", të autorit poliedrik El Hil'lij, thuhet: "Te dijetarët tanë të fesë nuk pranohet pohimi i fëmijës, qoftë edhe me lejen e kujdestarit, madje edhe nëse fëmija ka hyrë në moshën e adoleshencës dhe dallon, sepse ai është shprehjegrabitur si pohim dhe si ndërtim."

Për mosmarrjen në konsideratë të pohimit të fëmijës kanë përjashtuar pohimin e tij që ai ka arritur pjekurinë seksuale për shkak se është prishur në ëndërr, me kushte që ky pohim i tij bëhet në një kohë kur është e mundur që ai të ketë arritur pjekurinë seksuale, si për shembull, është dhjetë vjeç dhe fukahatë kanë thënë se pohimi i tij merret në konsideratë pa betim, sepse betimi është i vlefshëm vetëm prej një të rrituri që ka arritur pjekurinë seksuale. Mirëpo me këtë betim nuk mund të mendohet të vërtetohet arritja e pjekurisë seksuale.

Thënë ndryshe, arritja e pjekurisë seksuale qëndron kundrejt betimit, plotësisht sikur të thuhet që ekzistenca e lapsit qëndron kundrejt ekzistencës së shkrimit, në atë mënyrë që lapsi ekziston vetëm pas ekzistencës së shkrimi, kur dihet që shkrimi ka ekzistuar vetëm pas ekzistencës së lapsit, atëherë sendi duhet të qëndrojë në vetvete.

Ky rregull, te racionalistët njihet me termin "cikël i gabuar"[1]. Autori i librit "Miftahul Kerameh" ka thënë: "Ana e jashtme e fjalëve të fukahave rezulton pranimin e pretendimit të fëmijës pa betim, qoftë edhe kur është në pozitën e armiqësisë. Edhe femra e vogël është si djali, kur pretendon se në ëndërr e ka ndier veten seksualisht të pjekur."

---

[1] Disa poetë kanë shkruar vargje për ciklin:

"Çështja e ciklit rrjedh
mes meje e mes atij që unë dua.
Sikur thinjat e mia të mos ishin tharë,
unë nuk do të thinjesha."

Autori i librit "El Xheuahir", pasi ka cituar fjalët e mësipërme prej disa fukahave dhe asnjëri prej tyre nuk ka treguar ndonjë kundërshtim në lidhje me çështjen e pranimit, pa betim të pretendimit të djalit që ai ka rritur pjekurinë seksuale, në vijim, u përgjigjet fukahave me këto fjalë: "Vetëm mundësia e ndodhjes së pjekurisë seksuale është e pamjaftueshme për të vërtetuar saktësinë e fjalëve të fëmijës si domosdoshmëri e mospasjes mundësi për shkak të argumenteve."

Në fjalët e myslimanëve, në të vërtetë, ajo ndodh vetëm pas vërtetimit të pjekurisë së tyre seksuale.

Sej'jid Ebul Hasan El Asfehànij, në librin "El Uesijleh", ka thënë: "Në të vërtetë, pranimi i fjalës së fëmijës pa betim, ose edhe me betim, ka vend për meditim e për komplikim."

Edhe ne mbetemi me këtë opinion, pasi në tekstet e cituara nuk ka argument që të vërtetojë marrjen në konsideratë të fjalës së fëmijës, madje në të nuk ka as argument logjik. Ata fukaha që marrin në konsideratë fjalën e fëmijës, janë mbështetur mbi rregullin e pranimit në bazë të asaj që mësohet, që dihet vetëm prej vetë fëmijës, por s'ka argumente absolute dhe pa kushte që të vërtetojë vlefshmërinë e betimit të fëmijës, në atë mënyrë që të përfshijë edhe çështjen që jemi duke trajtuar.

Pavarësisht nga këto, fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se, kur fëmija pretendon që ka arritur pjekurinë seksuale për shkak se ka mbushur moshën, ose ngaqë i kanë mbirë qimet, ai ka detyrim të sjellë argument. Në këtë gjendje, shikimi në vendin e tij të turpit, në rast nevoje, është plotësisht si shikimi i mjekut.

2- Qëllimi: Nuk merret në konsideratë pohimi i atij që është në gjumë, të dehurit, të shkujdesurit, i atij që i ka rënë të fikët. Nuk merret në konsideratë as pohimi i atij që bën shaka, duke krahasuar fjalët e shakave. Nuk ka asnjë dallim mes të dehurit që e ka pirë pijen dehëse me dëshirën e vet dhe mes të dehurit që e ka marrë pijen dehëse nga domosdoshmëria, ose ngaqë është imponuar.

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Për këtë unë nuk gjej asnjë kundërshtim për asnjë send."

3- Pohuesi pohon me përzgjedhjen e vet, për rrjedhojë, nuk merret në konsideratë pohimi i të imponuarit dhe imponimi nuk është i veçantë vetëm me rrahjen ose me kërcënimin, pasi imponimi përmbledh të gjitha veprimet e rastet që e detyrojnë njeriun të pohojë kundër dëshirës së tij.

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Në këtë unë nuk gjej asnjë kundërshtim për asnjë send." Domosdoshmëria e marrjes së përzgjedhjes në konsideratë del qartë prej teksteve të shpërndara në kapitujt e librave të fikh'hut dhe në sentencat (fetvatë) që trajtojnë të gjitha shkaqet ligjore, prej të cilave edhe mundësitë, përveç atyre që dalin jashtë me argument, siç është garantimi i prishësit."

4- Pohuesi të kuptojë përmbajtjen e pohimit, sepse ndodh që, pas pohimit, ai thotë: "Nuk e kuptova atë që thashë."

Në qoftë se ka mundësi, që ai ka dijeni për të drejtën e tij, në këtë gjendje, fjala e tij vërtetohet me betimin e tij, ndryshe pretendimi i tij nuk pranohet.

Autori i librit "El Mesalik" ka thënë: "Kur mësohet që pohuesi ka dijeni për kuptimin e pohimit që bën, pretendimi i tij i kundërt nuk pranohet, edhe nëse janë të mundshme të dyja punët. Nëse pohuesi thotë: "Nuk e kuptova ç'kuptim kishte ajo që unë thashë, pasi mua më diktuan fjalët dhe unë i përsërita ato fjalë.", ky pohim i tij merret në konsideratë me betimin e tij, për shkak se ka mundësi të jetë edhe kështu siç pretendon ai, sepse baza është mospasja dijeni pa fjalën e tij. Kështu është edhe fjala në të gjitha kontratat e penalitetet."

5- Më sipër, në kapitullin "Ngurtësimi", në paragrafin "Pohimi i mendjelehtit dhe martesa e divorci i tij", është thënë që pohimi i tij pranohet në veprimet jo pasurore dhe refuzohet në veprimet pasurore. Gjithashtu, në kapitullin "I falimentuari", në paragrafin "Pohimi i të falimentuarit" është thënë që fukahatë kanë mendime të ndryshme, kur i falimentuari pohon pas ngurtësimit se i ka borxh edhe një personi tjetër.

Gjithashtu, fukahatë kanë mendime të ndryshme për pohimin e të sëmurit nga sëmundja nga e cila ai vdes, nëse ai ka borxh ose ka një send në ruajtje dhe ne nuk dimë, nëse sendi që ai pohoi, ishte detyrim të cilin ai duhet të shlyente, apo ai ishte thjesht një bamirës.

Në këtë gjendje, fukahatë kanë kundërshtime mes tyre, nëse ky pohim i të sëmurit duhet të zbatohet në të gjithë pasurinë e këtij të sëmuri, apo pohimi duhet të zbatohet vetëm në një të tretën e pasurisë së tij.

Ne kemi folur për këtë çështje në mënyrë të detajuar në librin "El Fusùlu Sher'ij'jeh" dhe në librin "Gjendjet personale

sipas pesë medh'hebeve" dhe kemi pëlqyer të themi: Kur i sëmuri është i akuzuar, në atë mënyrë që argumentet e ngjashme tregojnë se ai ka qëllim të favorizojë personin në favor të të cilit ai pohon, dispozita për këtë pohim është si dispozita e pohimit për testamentin dhe zbatohet në një të tretën e pasurisë së pohuesit, edhe nëse pohuesi është i besueshëm në pohimin e tij dhe nuk ka fakt që të tregojnë se me pohimin e tij, ai kishte qëllim favorizimin. Në këtë gjendje, pohimi zbatohet në bazën e pasurisë, domethënë mbi të gjithë pasurinë e tij. Me lejen e Allahut, për këtë çështje do të flasim në mënyrë të detajuar në kapitullin "Testamenti".

Pretendimi i pohuesit është prishje e pohimit

Pohuesi thotë se në kohën e pohimit ai ishte i vogël, ose i çmendur, ose i imponuar, ose bënte shaka, ose ishte i dehur, ndërsa personi në favor të të cilit pohohet, i thotë pohuesit: "Jo, ti ishte me mendje në kokë, ishte në moshë të rritur, veprove me dëshirën tënde dhe ishte serioz." Në këtë gjendje, kush është pretenduesi dhe kush është mohuesi?

Dëshmori i dytë ka thënë: "Më e fuqishme është që në të gjithë këtë problem të mos dëgjohet fjala e pohuesit."

Në të vërtetë, kur pohuesi dhe personi në favor të të cilit pohohet kanë kundërshtime në lidhje me aftësinë e pohuesit, ose që pohuesi, në kohën e pohimit, ishte i mençur, ose ishte në moshë të rritur, në këtë gjendje, merret në konsideratë fjala e atij që mohon mendjen dhe moshën e rritur, sepse baza e vlefshmërisë në këtë pohim mund të jetë vepruese vetëm pasi të vërtetojmë aftësinë e pohuesit, sepse pohimi i tij mund të jetë i saktë, por

mund të jetë edhe i pasaktë. Nëse nuk sigurohemi për aftësinë e pohuesit, kjo do të thotë se ne nuk jemi siguruar as për ekzistencën e pohimit, sepse dyshimi në aftësinë e pohuesit është dyshim në vetë pohimin që nga kreu, atëherë nuk ka më dyshim për pavlefshmërinë e pohimit e të prishjes së tij. Bazuar mbi këtë rregull, nuk ka më subjekt për bazën e vlefshmërisë, për rrjedhojë, merret në konsideratë fjala e pohuesit me betimin e tij.

Në rastin kur pohuesi dhe personi në favor të të cilit pohohet vërtetojnë te pohuesi në kohën e pohimin ekzistencën e aftësisë, moshën madhore dhe mendjen, por ata të dy kanë mosmarrëveshje në lidhje me vlefshmërinë e pohimit, jo për shkak të humbjes së aftësisë, por për shkak, nëse qëllimi dhe pohimi ishin ose jo me dëshirën e pohuesit, kur puna qëndron kështu siç u tha, atëherë vepruese është baza e vlefshmërisë, sepse pohimi ekziston me punë dhe është e mundur të cilësohet i vlefshëm ose të cilësohet i prishur. Në këtë gjendje, anojmë kah ana e vlefshmërisë në dëm të animit kah prishja, për rrjedhojë merret në konsideratë fjala e personit në favor të të cilët është bërë pohimi, por me betimin e tij.

Me një fjalë, dyshimi në ekzistencën e aftësisë është dyshim në ekzistencën e pohimit të vërtetë, është pohim i dalë krahas mosarritjes së aftësisë, pra, kemi të bëjmë me një shëmbëlltyrë pohimi dhe jo pohimi real, por, kur arrihet të vërtetohet aftësia, pohimi i dalë, në këtë gjendje, është pohim i vërtetë dhe real, megjithëkëtë përmban vlefshmërinë dhe prishjen, por ne e anulojmë mundësinë e prishjes me vlefshmërinë.

Personi në favor të të cilit pohohet

Personin në favor të të cilit pohohet, kërkohet të ketë aftësinë për të marrë në dorëzim pasuri dhe të vërtetojë të drejtën e tij. Sikur ai të thotë se për këtë mur përgjigjem unë, ose për këtë kafshë përgjigjem unë, kjo fjalë e tij është fjalë boshe, por pohimi i tij është i vlefshëm, kur është për shkollën, xhaminë, ose për klinikën, ose për të tjera objekte të ngjashme, sepse, në këtë rast, pohimi është për atë që përfiton dobinë e shkollës, të xhamisë e të klinikës. Është i vlefshëm edhe pohimi për një të panjohur, natyrisht kur mosnjohja nuk është mëkat, si për shembull, ai thotë: "Njërit prej ju të dyve, unë i kam detyrim t'i jap këtë shumë, por nuk e di se cili prej jush është ai.", në këtë gjendje, hidhet short mes atyre të dyve.

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët për vlefshmërinë e pohimit për shtatzëninë, nëse foshnja lind gjallë, kur është më pak se gjashtë muajsh, në atë mënyrë është mësuar që foshnja ekzistonte vetëm kur doli pohimi, sepse në barra më pak se gjashtë muaj, foshnja nuk lind i gjallë para kësaj kohe. Kur foshnja dështon, vdes, nëse pohuesi ka thënë: "Sendi për të cilin u pohua, është trashëgimi për barrën.", ai send u kthehet trashëgimtarëve të tjerë. Nëse ai ka thënë: "Ai send është testament.", sendi u kthehet trashëgimtarëve të testamentlënësit, pra, veprohet sipas kërkesave të pohimit.

Në qoftë se ai nuk përmend as trashëgimi e as testament, pohuesi lihet dhe me çështjen e tij ngarkohet një që është më i ditur se ai për çështjen e trashëgimisë e të testamentit dhe askush nuk ka të drejtë të kundërshtojë të ngarkuarin, sepse puna e pasurive i referohet atij që e ka në dorë, derisa të vërtetohet e

kundërta. Por këtu pasuria nuk është për barrën, sepse, në të vërtetë, foshnja lindi i vdekur, atëherë, në këtë gjendje, pasuria e pohuar mbetet në dorën e atij që e ka.

Gjithashtu, fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët për barrën, kur koha e lindjes së foshnjës është përtej kufirit më të largët kohor të barrës, sepse, në këtë gjendje, veprohet në kushtet e mosekzistencës së foshnjës në kohën e pohimit, por rregulli thotë se pohimi për atë që nuk ekziston, nuk është i vlefshëm.

Fukahatë kanë mendime të ndryshme për foshnjën që lind në fund të nëntë muajve prej kohës së pohimit, duke vënë në konsideratë se kjo është koha më e largët e barrës. Një grup fukahash kanë thënë se pohimi është i vlefshëm, duke punuar sipas asaj që duket, domethënë, në shumicën e rasteve, sepse shumica e grave lindin në muajin e nëntë. Për rrjedhojë, pohimi është me më shumë përparësi, kur bëhet para lindjes dhe pasi barra ka kaluar gjashtë muaj.

Fukaha të tjerë, ndër të cilët edhe autori i librit "El Xheuahir", janë shprehur për pavlefshmërinë e pohimit, sepse barra është ngjarje dhe, si bazë, është vonimi i ngjarjes. Bazuar mbi këtë rregull, barra nuk ekziston në kohën e pohimit dhe, për sa i përket anës së jashtme, ajo nuk del sipër bazës, për rrjedhojë, mbështetja mbi atë nuk është e vlefshme, përveçse kur ka argument ligjor që e vërteton atë, ose kur shkenca, me zbulimet e saj, njofton realitetin.

Sido që të jetë, në qoftë se barra e meriton sendin për të cilin u pohua për atë, i gjithë sendi i takon barrës, në qoftë se është vetëm një. Nëse lindin binjakë, femër e mashkull, pjesëtimi bëhet

në mënyrë të barabartë për të dy, përveçse kur është vërtetuar që pjesëtimi të jetë i diferencuar, siç është trashëgimia e fëmijëve dhe e vëllezërve prej një babe, sepse baza është mospasja përparësi e mashkullit ndaj femrës, derisa të vërtetohet e kundërta. Nisur nga rregull, fukahatë kanë rënë në një fjalë të përbashkët se, kur ai lë vakëf në kurriz të fëmijëve të tij, ose lë për ata testament, pjesëtimi mes meshkujve e femrave bëhet në mënyrë të barabartë.

Personi në favor të të cilit pohohet, nuk përgënjeshtron

A është kusht për vlefshmërinë e pohimit që personi në favor të të cilit pohohet, të mos përgënjeshtrojë pohuesin?

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Përgënjeshtrimi i pohuesit, nga ana e personit, në favor të të cilit bëhet pohimi, nuk e prish pohimin, sepse pranimi prej personit në favor të të cilit bëhet pohimi, nuk është kusht për vlefshmërinë e pohimit, pasi zbatimi i atij pohimi bëhet me të drejtën e pohuesit."

Bazuar mbi këtë rregull, kur një njeri pohon për një tjetër, një borxh, ose një send dhe personi në favor të të cilit pohohet e mohon, sendi për të cilin u pohua është në dispozitën e sendit që nuk i dihet pronari, domethënë që pohuesi mbetet në atë që thotë e në pohimin që bën. Nëse pohuesi kthen nga pohimi i tij, sepse i është kujtuar diçka logjike, si për shembull, ai ka dyshuar ose ai ka harruar, pasi dihet që të dyja gjendjet janë të mundshme, në lidhje me të drejtën e tij, në këtë gjendje, pranohet fjala e pohuesit.

Gjithashtu pranohet kthimi prej mohimit nga ana e personit në favor të të cilit është bërë pohimi dhe thotë: "Po, ajo më takon mua, sepse unë në atë kohë dyshoja, ose e kisha harruar."

Sendi i pohuar

Në sendin e pohuar është kusht:

1- Të jetë prej sendeve të natyrës që meritohen, si: borxh, send, shuma e martesës, e drejtë mbi pronën me ortakëri, ose e drejtë që e bën të detyrueshme zbatimin e dënimit, deri edhe ekzekutimin kapital, ose pohimi është shumë për shlyerjen e gjakut (ed dijetu) dhe të drejta të tjera të kësaj kategorie.

Sikur pohuesi të pohojë për një send që nuk është e mundur të plotësohet, si për shembull, myslimani pohon për një mysliman tjetër verën, ose derrin, pohimi i tij është fjalë boshe, por, nëse ai i pohon këto për jomyslimanin, atëherë pohimi i tij është i vlefshëm.

2- Sendi i pohuar të jetë në dorën e pohuesit dhe nën të drejtën e tij për të vepruar me atë send. Sikur pohuesi të thotë: "Sendi që gjendet te Zejdi është për Khalidin", kjo fjalë e tij nuk është pohim, por është dëshmi. Vetëkuptohet se, kur ndodh që ai send të jetë në dorën e pohuesit me njërën prej rrugëve, pohuesi është i detyruar t'ia dorëzojë atë send personit në favor të të cilit është bërë pohimi. Po japim një shembull: Ai thotë: "Sendi që ishte në dorën e babait tim, atë send babai ia kishte rrëmbyer Amrit." Më pas babai i pohuesit vdes, kështu që e gjithë pasuria e lënë prej babait të tij kalon te pohuesi së bashku me sendin e rrëmbyer prej

babait të pohuesit, në këtë gjendje, pohuesi është i detyruar t'ia kthejë atë send personit në favor të të cilit ai bëri pohimin, sepse pohimi është detyrim i plotë i dalë prej një njeriu të mençur, në moshë madhore dhe me dëshirën e tij.

Në këtë gjendje, është zhdukur pengesa që ndalonte zbatimin e këtij detyrimi dhe, për rrjedhojë, pohimi ka marrë rrugën e tij ligjore.

Sikur pohuesi të pranojë se borxhi që është në emrin e tij dhe që rëndon mbi Zejdin, borxh i takon filanit, në këtë gjendje, veprohet sipas pohimit të pohuesit, sepse është e lejueshme dhe e pranueshme që te personi në favor të të cilit bëhet pohimi, pohuesi mund të këtë depozituar një pasuri, ose mall dhe i ka dhënë leje që me atë mall, ose me atë pasuri, ai ka të drejtë të kreditojë kë të dëshirojë në emrin e tij dhe jo në emër të pronarit të atij malli, ose të asaj pasurie, sepse interesi i tij privat kërkon që ai të qëndrojë nën hije dhe i maskuar.

Kjo lloj veprimtarie ndodh shpeshherë.

Pohimi për një send të panjohur

Fukahatë janë në pajtim të plotë me dëshminë e autorit të librit "El Xheuahir" dhe janë shprehur se është i vlefshëm pohimi për një send të panjohur, si për shembull, kur ai thotë: "Kam detyrim të jap, ose të kthej një send.", pa bërë dallim, nëse pohimi është bërë në gjykatë krahas konfliktit, apo pohimi ka ndodhur që në fillim.

Autori i librit "El Mesalik" ka thënë: "Mbase në mirëbesim të një njeriu ka qenë në ruajtje një sasi malli, por nuk dihet sasia e tij, për rrjedhojë, patjetër që për këtë sasi malli duhet të kemi njoftime dhe pastaj ai dhe pronari i mallit të merren vesh mes tyre për pajtim për atë që kanë rënë dakord të dy. Në këtë gjendje, nevoja dhe urtësia kërkon të dëgjohet pohimi përmbledhës dhe pohimi i detajuar."

Pohuesi kërkon qartësi e shpjegim. Në qoftë se ai jep një shpjegim të saktë, si për shembull, me dirhemë, ose me kulaçe, shpjegimi i tij pranohet, nëse ai është në gjendje të mirë. Në qoftë se ai e shpjegon me sende që nuk janë të vlefshme të shpjegohen, për shembull, kur ai e shpjegon duke e qartësuar me lëvozhga arre, të cilat nuk kanë asnjë vlerë, ose e shpjegon me verën, apo me derrin, kur pohimi është për një mysliman, patjetër që ky shpjegim e qartësim nuk pranohet prej tij.

Fukahatë më të dëgjuar kanë shkuar me dëshminë e autorit të librit "El Xheuahir", i cili ka thënë: "Në qoftë se ai, edhe pse ka fuqi, nuk bën asnjë shpjegim, në këtë gjendje, ai burgoset, derisa ta bëjë të qartë problemin, sepse shpjegimi me qartësi i problemit është detyrim për atë dhe, nëse ai nuk e bën këtë shpjegim, për rrjedhojë, bëhet hallall dënimi i atij që nuk shlyen borxhin. Vetëkuptohet se, kur ai thotë: "Harrova.", ai nuk burgoset, por i rikthehet gjykimit me pajtim, ose borxhdhënësi bën durim, derisa ai të kujtohet që ka marrë borxh."

Mohimi pas pohimit

Kur ai pohon për një send dhe pas pohimit vjen një veprim që e mohon pohimin, për shembull, kur ai thotë se kisha borxh një mijë dirhemë, por e kam shlyer atë borxh, ose ai është borxh prej bixhozit, ose kjo shumë është prej verës, ose prej derrit, në këtë gjendje, a anulohet pohimi i tij në tërësi, apo ai, nga njëra anë, është pohues dhe, nga ana tjetër, është pretendues dhe dënohet me pohimin e tij dhe a ka ai detyrim të vërtetojë pretendimin e tij?

Fukahatë janë në pajtim të plotë me dëshminë e autorit të librit "El-Xhevahir" se ai është pohuesi dhe pretenduesi, sipas pohimit të tij, ai ka detyrim pasuror, për rrjedhojë, është i detyruar të vërtetojë pretendimin e tij. Në qoftë se ai thotë se këtë e kam blerë prej teje me përzgjedhje, ai dënohet për pohimin dhe ka detyrë të vërtetojë pretendimin e tij.

Në qoftë se ai thotë se këtë e kam blerë prej teje me përzgjedhje, ai dënohet për pohimin e tij dhe për blerjen, por jo për përzgjedhjen.

Në qoftë se ai thotë se kam detyrim minus kaq dirhemë, dëgjohet pohimi i tij, sepse ky pohim është sikur të thotë: "Ai ka për të marrë prej meje një mijë gine egjiptiane, ose një mijë lira siriane."

Fukahatë kanë thënë se, kur në dorën e tij është një send dhe ai e pohon që sendi i takon një personi dhe pastaj pohon se ai send i takon një tjetri, për shembull, ai thotë: "Ky send është i Zejdit, jo, është i Amrit.", gjykohet kundër pohuesit, duke i dhënë sendin Zejdit dhe gjobitet me vlerën e sendit duke ia dhënë çmimin Amrit.

Madje fukahatë kanë thënë se, sikur ai të vazhdojë të pohojë edhe një mijë herë dhe të thotë: "Jo, është i Khalidit.", "Jo, është i Seijdit.", etj, është detyrim që ky pohues të gjobitet për çdo person që përmend, me përjashtim të personit të parë, të cilit ai ka detyrim t'i kthejë sendin. Fukahatë kanë arritur në përfundimin se pohimi i tij për të mëparshmin ka ndodhur mes sendit e mes të dytit. Në këtë gjendje, ai është si prishësi.

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Pa asnjë kundërshtim, që të atakojë këtë, për shkak të përgjithësimit të pohimit të të urtëve dhe të ndalimit."

Konstatohet se pohimi, në të vërtetë, bëhet argument kundër pohuesit, derisa ne nuk dimë se ai gënjen dhe pohimi i tij është në kundërshtim me realitetin.

Një person pohon se ka shitur një send dhe sendi i shitur është marrë në dorë, madje është bërë edhe akti i shitjes, por për këtë shitje ai thotë se nuk ka marrë pagesën, në të vërtetë, unë isha dakord që ai ta merrte sendin në dorë, duke besuar që blerësi do ta paguante çmimin, ashtu siç veprohet zakonisht.

Kur pohuesi shtron këtë pretendim, pretendimi i tij dëgjohet, por ka detyrim të betohet kundër personit që është në konflikt me atë se blerësi nuk i ka dhënë atij çmimin e plotë të mallit apo të sendit që bleu prej tij.

Këtu nuk ka hapësirë për argument, sepse ai nuk e ka marrë çmimin në dorë dhe çështja paraqitet në një mohim të thjeshtë.

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Pranohet pretendimi i tij për mosmarrjen e çmimit pas pohimit të tij që nuk e ka marrë, sepse ai pretendon diçka të zakonshme dhe s'ka asnjë që të ketë thënë se pretendimi i tij nuk pranohet, sepse ai gënjen vetveten. Kështu kemi të bëjmë me mohim pas pohimit. Ne themi se ai nuk po gënjen vetveten, por ai pretendon një send krahas pohimit, për rrjedhojë, betimi i kërkohet blerësit.

Më poshtë, autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Kjo është e ngjashme me bazat e me rregullat e medh'hebit. Kuptohet se, kur për marrjen në dorë është dëshmia dhe jo pohimi se i ka marrë, pretendimi nuk pranohet që në fillim dhe betimi nuk i kërkohet blerësit."

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se ai që pohon një delikt që e bën të detyrueshëm ekzekutimin me gjuajtje me gur, si për shembull, kurvërimi dhe më pas e mohon që ka dëgjuar prej tij pohimin, dënimi mbi të akuzuarin nuk zbatohet, sepse zbatimi i dënimeve nuk zbatohet me dyshim. Këtë çështje, do ta trajtojmë në kapitullin "Dënimet".

Si përfundim, mohimi nuk refuzohet në të gjitha llojet e në të gjitha format e tij, por pranohet mohimi i ardhur pas pohimit për dënimin me ekzekutim me gjuajte me gur, kur nuk ngushton të drejtën e tjetrit dhe pranohet, kur është i lidhur me një pretendim logjik të mundshëm, si për shembull, mohimi i marrjes në dorë pas pohimit që është marrë në dorë. Pohuesi ka të drejtë të kërkojë betim prej personit në favor të të cilit pohohet, por mohimi pas pohimit nuk pranohet në asnjë rast për fëmijën, edhe sikur pohuesi të përmendë për mohimin e tij pas pohimi një mijë e një shkaqe.

Për këtë çështje, Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "Kur burri pohon për fëmijën një orë, nuk mund të largohet kurrë prej tij."

Pas pohimit vjen ajo, e kundërshton pohimin

Çështja përmbyset, kur ai pohon atë që kishte mohuar më parë, sepse pohimi pas mohimit nuk e ngushton të drejtën e pretenduesit, por përputhet plotësisht me të drejtën e tij dhe është e kundërta e mohimit pas pohimit, sepse mohimi e ngushton dhe e kundërshton të drejtën e tij. Në lidhje me këtë çështje, autori i librit "El Urvetul Vuthkà" thotë: "Sikur një grua të pretendojë për një burrë se ai është burri i saj, kurse burri e mohon dhe betohet sipas ligjit, por më pas heq dorë prej mohimit dhe pohon, pohimi i tij dëgjohet dhe merret vendim për martesën mes tyre, kur ai nxjerr në dritë një pengesë për mohimin e tij.

* * *

POHIMI I PËRKATËSISË FAMILJARE

(atësia)

Pohimi për fëmijën

Pohimi për fëmijën ndahet në dy kategori: pohim për birësinë e të voglit dhe pohim për birësinë e të madhit. Në vërtetimin e përkatësisë për të voglin, është kusht pohimi dhe lënia e fëmijës pohuesit si më poshtë:

1- Mes fëmijës dhe pohuesit ka aq diferencë moshe, në saje të së cilës zakonisht mund të ndodhë një lindje e ngjashme, ndryshe pohuesin e përgënjeshtrojnë shqisat dhe ndjenjat. Gjithashtu, kur nëna e fëmijës jeton në një vend të largët, ku as pohuesi nuk ka mundësi të shkojë e as nëna e fëmijës nuk ka mundësi të vijë te pohuesi.

2- Të voglit nuk i dihet atësia dhe ai pohon atësinë për një të vogël, ndërsa njerëzit thonë që babai i atij fëmije është dikush tjetër dhe jo pohuesi. Në këtë gjendje, fjala e pohuesit nuk dëgjohet, edhe sikur fëmija, pasi të arrijë moshën madhore, të vërtetojë fjalën e pohuesit, sepse atësia nuk transferohet prej një njeriu te një njeri tjetër.

3- Pohuesi nuk ka konflikt me ndonjë tjetër në lidhje me të voglin. Nëse do të gjendet ndonjë pretendues i dytë, gjykimi, në lidhje me këtë fëmijë, bëhet në favor të atij që sjell argument dhe, në mungesë të argumentit, ata të dy hedhin short dhe fëmija i lihet atij që i bie shorti.

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët për të marrë në konsideratë këto kushte, me dëshminë e autorit të librit "El Xheuahir" dhe të autorit të librit "Miftahul Kerameh", ashtu siç është vërtetuar prej Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*, i cili ka thënë: "Kur burri pohon atësinë e fëmijës, ai fëmijë nuk largohet më prej tij."

Gjithashtu, Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* është pyetur për një burrë, i cili pretendon djalin e një gruaje, por nuk dihet se cili është babai i fëmijës, megjithëkëtë, edhe pas kësaj, as nuk e mohon. A është ky fëmijë i këtij burri? Ai *(Paqja qoftë mbi të!)* është përgjigjur: "Ky nuk është për atë."

Fukahatë kanë mendime të ndryshme, kur gruaja pohon atësinë për të voglin, a i jepet apo nuk i jepet ky fëmijë asaj, krahas kushteve, plotësisht ashtu siç ishte gjendja për burrin, i cili e merrte fëmijën vetëm me pohimin e tij?

Në të vërtetë, në lidhje me këtë çështje, nuk ka dallim ndërmjet burrit e gruas, për faktin se shkaku është i njëjtë dhe për faktin se ata që pohojnë kundër vetvetes së tyre janë njerëz të mençur, duke shtuar edhe pyetjen që i është bërë Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)* për një grua e cila merret rob lufte prej vendit të saj së bashku me një djalë të vogël, për të cilin gruaja thotë se është i biri. Gjithashtu, edhe burri është marrë rob lufte, ndërkaq

djali i vogël takon vëllain e tij. Ata të dy njihen me njëri-tjetrin, por që të dy nuk kanë argumente për fjalën që thonë. Si duhet të veprohet në këtë situatë? Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* është përgjigjur: "Kur gruaja vjen me të birin, ose me të bijën dhe vazhdon të pohojë atësinë, kur djali njeh vëllain e tij dhe njohja ka ndodhur kur të dy gëzojnë mendje të shëndoshë e vazhdojnë të pohojnë që janë vëllezër, ata të dy trashëgojnë njëri-tjetrin."

Kur kushtet janë të plota, atëherë vërtetohet përkatësia familjare dhe mbi këtë përkatësi renditen të gjitha ndikimet, duke filluar me trashëgiminë, ndalimin e martesës mes tyre, detyrimin për të shpenzuar, ortakërinë në lënien vakëf dhe në testamentin, apo të tjera veprime në të cilat i pohuari është pjesëtar me të drejta të barabarta. Këto ndikime kalojnë te të gjithë të afërmit dhe te ata që janë prej një nëne, pa asnjë përjashtim. Nuk merret në konsideratë vërtetimi i të voglit, pasi ai arrin pjekurinë seksuale dhe arrin moshën në të cilën di të orientohet. Gjithashtu, nuk merret në konsideratë, kur ai mohon babain e nënën e tij biologjik dhe, kur prej pohuesit kërkohet betimi, ai nuk betohet, sepse pohuesi e di që me pohimin e tij, ai është i detyruar në të gjitha gjendjet, madje edhe kur heq dorë prej pohimit të tij. Atëherë këtu nuk ka më vend për betimin.

Kur burri pohon atësinë për një të rritur, patjetër kërkohet miratimi i vetë të rriturit, krahas tri kushteve që u thanë më sipër. Kur i rrituri e mohon, përkatësia familjare mes tyre nuk vërtetohet, përveçse kur pohuesi vjen me argument. Nëse ai nuk ka argument, mohuesi betohet dhe me betimin e tij rrëzohet pretendimi i pohuesit. Nëse ai nuk mohon, atëherë betohet pohuesi dhe vërtetohet përkatësia familjare. Kur dy të rriturit miqësohen për të vërtetuar përkatësinë familjare dhe më pas njëri

prej atyre të dyve, ose dhe të dy nuk e pranojnë njëri-tjetrin që ai është i të njëjtit shtrat, por, kur përkatësia familjare vërtetohet, atëherë vëllazëria vazhdon.

I çmenduri është si i vogli, sepse që të dy nuk kanë aftësi për të vepruar.

Pohimi për lindjen jashtë martese *(nga prostitucioni)*

Sikur burri të pohojë se ky është fëmija im jashtë martese, a dënohet ai për këtë fjalë që tha dhe a i mohohet fëmija, apo fëmija i jepet atij ligjërisht dhe nuk shikohet se ç'tha ai në lidhje me lindjen e fëmijës jashtë martese?

Këtë degë e ka përmendur autori i librit "El Xheuahir" në vijim të çështjes së parë prej çështjeve të pohimit të përkatësisë familjare. Ai nuk e gjykoi pohuesin as pozitivisht e as negativisht, sepse fjala e tij: "Ky është fëmija im.", kupton që fëmija duhet t'i jepet këtij pohuesi, kurse fjala e tij: "Jashtë martese" e bën të detyrueshme që fëmija t'i mohohet atij. Duke parë animin në favor të njërës anë, atëherë shikohet. Autori i librit "El Xheuahir", tekstualisht, ka thënë: "Sikur ai të thotë: 'Ky është fëmija im jashtë martese., ky është pohim pas mohimit."

Shtrohet pyetja: A dënohet për pjesën e parë të fjalës dhe fëmija i jepet atij, ose për fundin e fjalës së tij dhe nuk gjykohet në favor të tij, në lidhje me përkatësinë e fëmijës? Në këtë gjendje, shikohet ashtu siç ka ardhur në librin "Ed Durùs".

Thënia më e afërt është që atij i jepet fëmija dhe gjykohet se ai është fëmija i tij ligjor, sepse fjala e tij i ngjan fjalës së atij që thotë: "Unë kam detyrim t'i jap atij një mijë prej çmimit të verës."

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët, se vendoset, që ai të paguajë dhe nuk dëgjohet pjesa tjetër e pohimit të tij "prej çmimit të verës", sepse pas pohimit që ai bëri, nuk dëgjohet mohimi që ai i bën asaj që pohoi. Për këtë çështje, Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "Kur ai pohon për fëmijën, kurrë nuk mund të largohet prej tij."

Në qoftë se ai thotë që kjo fjalë nuk është pohim, ne i përgjigjemi se edhe fjala e tij: "Unë kam detyrim të paguaj një mijë prej çmimit të verës.", nuk duhet të jetë pohim, sepse që të dyja rastet janë prej të njëjtit kapitull dhe dallimi mes dy rasteve bëhet me arbitrim. Pavarësisht nga kjo, bazë për çdo të lindur është që ai fëmijë, ligjërisht i jepet atij që e lindi, derisa të vërtetohet e kundërta.

Ndërmjet përkatësisë familjare dhe martesës

Nuk ka lidhje mes përkatësisë familjare dhe martesës dhe, kur ai thotë: "Ky është djali i gruas sime, filanes.", fjala e tij nuk është as pohim që ai është i martuar me nënën e djalit dhe as pohim që ai është djali i tij, sepse djali mund të jetë vërtet djali i asaj gruaje, por me një baba tjetër. E njëjta gjë është edhe kur ai thotë: "Ky është djali im prej filanes." Në të vërtetë, fjala e tij është pohim për fëmijën, por nuk është pohim se ai është i martuar me nënën e atij djali, edhe në qoftë se ajo grua njihet si femër e ndershme, sepse është e pranueshme që ai të ketë kontaktuar me

atë me dyshim, ose ai kishte neveri të shkonte me atë, ose fëmija mund të jetë i ngjizur prej ujit të tij me rrugë jashtë kontaktit të drejtpërdrejtë.

Disa fukaha kanë thënë se nuk vërtetohet martesa e gruas, por për gruan vërtetohet e drejta e saj për shumën e parave të kurorës (mehr), sepse, nëse ajo është e martuar, ajo ka të drejtën e shumës së kurorës, ashtu siç e ka të drejtën e shumës së kurorës, edhe nëse është e kontaktuar me dyshim.

Autori i librit "El Xheuahir" kësaj fjale i është përgjigjur: "Lindja mund të jetë edhe pa kontakt, ose edhe me kontakt të imponuar. Të dyja rastet e bëjnë detyrim shumën e kurorës, sepse shuma e kurorës është një e drejtë, edhe pse e përgjithshmja nuk tregon të veçantën.

Pohimi i përkatësisë familjare për të vdekurin

Vdes një njeri, të cilit nuk i dihet përkatësia familjare dhe një person thotë: "Ky është djali im." Ndërkaq askush nuk e kundërshton atë në pohimin që bëri. Veç kësaj, është e mundur që ai të jetë lindur prej tij. Nëse çështja qëndron kështu siç u shtrua, vërtetohet përkatësia e fëmijës dhe ai fëmijë e trashëgon pohuesin, nëse pohuesi ka pasuri. Kjo është e barabartë, qoftë kur i vdekuri është i vogël, qoftë kur është i madh, sepse shkaku për vërtetimin e përkatësisë familjare, kur ai ishte gjallë, ishte pohimi dhe pohimi ekziston edhe pas vdekjes, për rrjedhojë, për atë vërtetohet përkatësia familjare, plotësisht ashtu siç vërtetohej kur ai ishte gjallë.

Dëshmori i dytë, në librin "Sherhu Lum'ah", ka thënë: "Nuk merret në konsideratë vërtetimi i fëmijës, i të çmendurit dhe i të vdekurit, por vërtetohet, me pohim, përkatësia e tyre familjare, sepse vërtetimi në të vërtetë merret në konsideratë krahas mundësisë për vërtetim, por vërtetimi është i ndaluar të dalë prej atyre të treve që u thanë.

Më pas këtë sentencë ai ia adreson fukahave. Autori i librit "El Xheuahir" ka cituar prej librave "Xhamiul Mekasid" dhe "Err Rrijàd" mospasjen kundërshtim në mesin e fukahave për këtë çështje.

Pohimi jo për fëmijën

Një grup i madh fukahash e kanë ndarë pohimin për përkatësinë familjare në dy pjesë, pohim kundër vetë pohuesit dhe pohim kundër një tjetri. Fukaha të tjerë e kanë pjesëtuar këtë ndarje në pohim për fëmijën dhe në pohim jo për fëmijën. Në të dyja ndarjet kuptimi është një dhe kundërshtimi qëndron vetëm në shprehjen, sepse pohimi për njeriun është i veçantë vetëm për fëmijën, sepse fëmija është prej veprimit të pohuesit, kurse pohimi jo për fëmijën, përfshin vëllanë, djalin e djalit, babain, ose nënën. Kur ai thotë: "Ky është vëllai im.", kuptimi i fjalës së tij është se ai, në të vërtetë, është djali i babait tim, ose djali i nënës sime, pikërisht ky është pohimi me të drejtën e tjetrit dhe bashkim me jo pohuesin.

E njëjta gjë është edhe kur ai thotë: "Ky është djali i djalit tim." Në të vërtetë, ky pohim është pretendim mbi djalin e vet, i cili e ka lindur këtë djalë. Po kështu është edhe kur ai thotë: "Ky

është babai im.", ose "Kjo është nëna ime." Ky është pohim për burrin që e ka lindur atë dhe pohim për gruan që e ka lindur atë dhe kështu me radhë, përveç pohimit për atësinë. Të gjitha këto pohime hyjnë në paragrafin "Pohim me të drejtën e tjetrit dhe pohim jo për fëmijën".

Autori i librit "Miftahul Kerameh" ka thënë: "Nuk ka dallim mes pohimit jo për fëmijën dhe pohimit për babain, ose nënën, ose vëllanë, ose për të tjerët."

Fukahatë kanë rënë në një fjalë të përbashkët se në pohimin për jo fëmijën, është kusht:

Së pari: Shoqërimi i dy palëve dhe, kur tjetri është i vogël, atëherë pritet, derisa i vogli të arrijë moshën e pjekurisë seksuale. Pastaj ai pyetet. Nëse ai mohon, pohimi prej palës tjetër është fjalë boshe.

Në lidhje me këtë çështje, autori i librit "El-Xhevahir" ka thënë: "Sikur dy të rritur të shoqërohen, bazuar mbi përkatësinë familjare, jo për birësi dhe pastaj ata të dy kthejnë nga shoqërimi, kjo pranohet prej të dyve. Nëse dy të shoqëruarit kthejnë në lidhje me birësinë, kjo nuk pranohet prej të dyve, sepse ai është si shtrati, madje edhe më i fortë.", domethënë që me pohimin për atësi vërtetohet përkatësia familjare. Kur ajo vërtetohet, nuk hiqet më, kurse me pohimin jo për atësi nuk vërtetohet përkatësia familjare. Në këtë gjendje, pohuesi me pohimin e tij merr të drejtat materiale që i takojnë sipas pohimit.

Së dyti: Për njërin prej dy të shoqëruarve që kanë rënë dakord, bazuar mbi vëllazërinë, apo për afërsi të tjera të mos ketë trashëgimtar ekzistues në kohën e pohimit, sepse një pohim i tillë

është pohim për përkatësinë familjare të tjetrit, për rrjedhojë, ndikimi i këtij pohimi nuk kalon te ai që s'ka pohuar.

Kur të dy kushtet realizohen, trashëgimia mes atyre të dyve është e lejuar, sepse pohimi e shoqërimi është prej kapitullit të pretendimit, pa kundërshtar.

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* është pyetur për dy burra që janë sjellë prej tokave të idhujtarëve. Njëri prej tyre i thotë shokut të tij: "Ti je vëllai im." Me këtë pohim ata të dy njihen me njëri-tjetrin, qëndrojnë bashkë dhe njihen në saje të vëllazërisë. Më pas, njëri prej atyre të dyve vdes. Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* është përgjigjur: "Trashëgimia i takon vëllait dhe të dy vërtetohen."

Më sipër, në paragrafin "Pohimi për fëmijën", kemi cituar fjalën e Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*: "Ata të dy vazhdojnë të pohojnë, ata trashëgojnë njëri-tjetrin."

Por trashëgimia nuk kalon te fëmijët e të dy palëve, por qëndron vetëm te dy të miqësuarit. Kur njërit prej tyre i vijnë fëmijë pas njohjes së ndërsjellë dhe pas mirëkuptimit, fëmijët e njërit prej atyre të dyve i trajtojnë fëmijët e tjetrit, ashtu siç trajtohen të huajt, jo të familjes.

Me këto shpjegime bëhet e qartë për ne se pohimi për fëmijën ka dallim prej pohimit për jo fëmijën nga disa anë:

1- Miqësia dhe njohja e ndërsjellë mes dy palëve është kusht në pohimin për çështje të tjerat por jo për fëmijën dhe është kusht në lidhje me pohimin për fëmijën, kur fëmija është i madh dhe jeton. Por nuk është kusht në pohimin për fëmijën e vogël, as

për të çmendurin, as për fëmijën e vdekur, i madh apo i vogël qoftë fëmija i vdekur.

2- Trashëgimia, ndalimi kategorik i martesës dhe të tjera ndikime të përkatësisë familjare, nuk kalojnë te të afërmit e te ata që kanë lidhje gjaku, kur pohimi nuk është për fëmijën. Nëse pohimi është për fëmijën, ndikimet e përkatësisë familjare kalojnë te ata, madje edhe nëse fëmija i pohuar është i madh.

Me fjalë të përmbledhura, përkatësia familjare vërtetohet në pohimin për fëmijën dhe nuk vërtetohet në pohimet e tjera që s'kanë të bëjnë me fëmijën.

3- Dy të miqësuarit jo për fëmijën e kthejnë pohimin e tyre, për shkak të mosvërtetimit të përkatësisë familjare, por ata të dy nuk kanë të drejtë të kthejnë pohimin për fëmijën, për shkak se pohimi për fëmijën vërteton përkatësinë familjare, e cila, pasi vërtetohet është e vazhdueshme.

Çështje

1- Kur pohon për një fëmijë të vdekur, si dhe për një tjetër, vërtetohet trashëgimia për atë, por nuk vërtetohet përkatësia familjare. Pjesëtimi bëhet në mënyrë të barabartë mes të dyve, nëse janë të dy meshkuj, ose janë të dy femra. Pjesëtimi bëhet me diferencë, nëse njëri prej dy pohuesve është mashkull dhe tjetri është femër.

Në qoftë se janë dy dhe ata pohojnë për një të tretë, nëse dy pohuesit janë burra të drejtë, për të tretin vërtetohet përkatësia familjare dhe trashëgimia, për shkak se ekziston argumenti. Në

qoftë se ata të dy nuk janë bura të drejtë, për të tretin vërtetohet trashëgimia dhe nuk vërtetohet për të përkatësia familjare dhe trashëgiminë e pjesëtojnë në tresh.

Kur njëri prej atyre të dyve pohon dhe tjetri nuk pohon, mohuesi merr gjysmën e trashëgimisë dhe pohuesi merr një të tretën e saj, kurse i treti, për të cilin pohoi njëri prej atyre të dyve, merr vetëm një të gjashtën, sepse trashëgimia është vërtetuar në të drejtën e pohuesit dhe jo në të drejtën e mohuesit. Në këtë gjendje, pohuesi ka detyrim të paguajë tepricën prej trashëgimisë së tij, e cila është një e gjashta dhe këtë shumë ai ia paguan personit për të cilin pohoi.

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Këtë e gjej pa asnjë kundërshtim. Në librin "Et Tedhkireh" thuhet se ky është medh'hebi i dijetarëve tanë të fesë."

Prej Ehli Bejtit *(Paqja qoftë mbi ta!)* ka ardhur se, kur njëri prej trashëgimtarëve pohon një borxh, ose për një trashëgimi, pohimi i tij është i lejuar në pjesën e tij, por, nëse pohojnë dy vetë dhe dy pohuesit janë njerëz të drejtë, pohimi i atyre të dyve shtrihet mbi të gjithë trashëgimtarët.

Akoma më i qartë se ky transmetim është transmetimi që tregon se Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* ka gjykuar për një burrë që ka vdekur dhe ka lënë trashëgimtarë, ndërkaq njëri prej trashëgimtarëve pohon se babai i tij kishte borxh. Pohimin ai duhet ta shlyejë prej pjesës së tij të trashëgimisë, në masën që ka trashëguar, domethënë që shlyerja do të jetë vetëm prej pasurisë së tij dhe prej askujt tjetër. Në qoftë se pohojnë dy prej trashëgimtarëve dhe janë njerëz të drejtë, pohimi i tyre e bën të

lejueshme që shlyerja të bëhet me pasurinë e të gjithë trashëgimtarëve.

Në qoftë se ata të dy nuk janë burra të drejtë, atëherë e drejta e pohuar do të shlyhet prej pjesë së atyre të dyve prej trashëgimisë, në atë masë që ata trashëgojnë. E njëjta gjë është edhe kur disa trashëgimtarë pohojnë se kanë një vëlla ose një motër, plotësimi i pohimit bëhet në pjesën e tij."

Prej këtij transmetimi arrihet në përfundim se, kur disa trashëgimtarë pohojnë një borxh që kishte i vdekuri, kurse disa prej trashëgimtarëve e mohojnë këtë borxh, atëherë shlyerja merret prej pjesës që i ka rënë pohuesit prej asaj që ka lënë i vdekuri. Kjo bëhet me qëllim që të mbahet besa për shlyerjen e borxhit, kurse prej atij që e mohon borxhin, nuk merret asgjë, me përjashtim të rastit kur plotësohet argumenti me dëshminë e trashëgimtarëve ose edhe prej të tjerëve. Në këtë gjendje, borxhi shlyhet i gjithi prej bazës së trashëgimisë. Kjo është fjala e përbashkët e fukahave.

2- I vdekuri ka grua e vëllezër dhe gruaja pohon një fëmijë për të vdekurin. Në këtë gjendje, shikohet: Nëse pohimin e gruas e vërtetojnë vëllezërit, madje pohojnë edhe borxhin, gruas i takon çmimi, kurse ajo që mbetet, i takon fëmijës dhe vëllezërit nuk marrin asgjë. Në qoftë se vëllezërit e mohojnë, përsëri gruaja merr çmimin, për shkak të pohimit të saj për ekzistencën e fëmijës për të vdekurin. Në këtë gjendje, vëllezërve u takon tre të katërtat, sepse ata mohojnë se i vdekuri ka një fëmijë, kurse fëmija për të cilin pohoi gruaja, merr çmimin, domethënë merr atë çka mbetet prej pjesës së saj, të bazuar mbi vlerësimin e mosekzistencës së fëmijës.

3- Nga sa u tha më sipër, bëhet e qartë se trashëgimia mund të vërtetohet edhe pa përkatësinë familjare, si për shembull, kur trashëguesi pohon se ka edhe një trashëgimtar tjetër, pohimi, në mënyrë të veçantë, zbatohet vetëm te paratë dhe shoqëron pohuesin në pasurinë që ka lënë.

Gjithashtu, u bë e qartë se, kur përkatësia familjare vërtetohet, atë nuk e mohon asnjë send. Vetëkuptohet se vërtetohet përkatësia familjare, por nuk vërtetohet trashëgimia, si për shembull, trashëgimtari vret me qëllim trashëgimlënësin e tij, ose pohimi nuk është për borxhin e një tjetri.

Me lejen e Allahut, hollësitë në lidhje me këtë çështje do të trajtohen në kapitullin "Trashëgimia".

* * *

DËSHMITË

Kuptimi i fjalës "dëshmi"

Në Kuranin Famëlartë fjala "dëshmi" ka ardhur në kuptimin e pranisë:

"فَمَنْ شَهِدَ مِنْكُمُ الشَّهْرَ فَلْيَصُمْهُ "

"...dhe ai prej jush që jeton në këtë muaj, le të agjërojë..." (Sure "El Bekare", ajeti 185)

Fjala "dëshmi", në Kuran, ka ardhur edhe në kuptimin e njoftimit e të vërtetimit të sigurt:

"وَاللَّهُ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ شَهِيْدٌ"

"...Allahu njofton saktësisht për çdo send." (Sure "El Muxhadele", ajeti 6) Ligjvënësi nuk ka ndonjë term të veçantë në lidhje me kuptimin e fjalës "dëshmi". Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Më e drejtë është mbështetja te tradita për njohjen e kuptimit të fjalës "dëshmi", sepse për fjalën "dëshmi" nuk ka kuptim të veçantë ligjor."

Është e kuptueshme që ligjvënësi e pranon kuptimin e fjalës "dëshmi" vetëm me kushtet që do të përmendim më poshtë.

Libri i Allahut dhe Suneti profetik e përmendin fjalën "dëshmi" në shumë ajete e në një numër të madh transmetimesh.

Prej Librit Famëlartë është fjala e Allahut të Lartësuar:

"وَاسْتَشْهِدُوا شَهِيْدَيْنِ من رِّجَالِكُمْ فَإِن لَّمْ يَكُونَا رَجُلَيْنِ فَرَجُلٌ وَامْرَأَتَانِ مِمَّنْ تَرْضَوْنَ مِنَ الشُّهَدَآءِ"

"...kërkoni të dëshmojnë dy dëshmitarë prej burrave tuaj dhe, nëse nuk janë dy burra, atëherë le të jetë një burrë dhe dy gra prej atyre me të cilët ju jeni të kënaqur..." (Sure "El Bekare", ajeti 282)

"وَأَشْهِدُوا ذَوَي عَدْلٍ مِّنْكُمْ"

"...dhe le të dëshmojnë dy burra të drejtë prej jush..." (Sure "Et Talàk", ajeti 2)

Prej Sunetit është transmetuar se Dërguari i Allahut *(Paqja e bekimi i Allahu qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)* është pyetur për dëshminë dhe ai i është përgjigjur pyetësit: "A e sheh diellin?" Ai tha: "Po."

Atëherë i Dërguari i Allahut *(Paqja e bekimi i Allahu qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)* vazhdoi përgjigjen: "Si dielli dëshmo, ose hiq dorë prej dëshmisë.", domethënë, nëse nuk do të dëshmosh qartë si dielli, hiq dorë prej dëshmisë.

Ndërmjet dëshmisë dhe transmetimit

Në terminologjinë e ligjvënësve, domethënë fukahave, dallimi ndërmjet dëshmisë dhe transmetimit është dallimi ndërmjet dispozitës dhe fetvsë, në atë mënyrë që fukahatë kanë qëllim prej transmetimit, në kapitujt e fik'hut, atë fjalë me të cilën bëjnë vërtetimin e dispozitave të përgjithshme ligjore, kurse me "dëshminë", ata kanë qëllim atë fjalë që ndan në mes dy kundërshtarë për një problem të veçantë. Fukahatë, në shumë burime të tyre, për dëshminë, kanë vënë kusht numrin e dëshmitarëve dhe gjininë mashkullore e femërore, por këtë kusht nuk e kanë vënë për transmetimin.

Marrja përsipër e dëshmisë dhe kryerja e saj

Marrje përsipër e dëshmisë do të thotë: Dikush të bën thirrje ty të dëshmosh në favor të tij për një send, apo çështje, duke ditur që është detyrim mbi ty të plotësosh kërkesën e thirrësit dhe nuk lejohet të refuzosh dëshminë, pa pasur ndonjë ndalim justifikues.

Allahu i Lartësuar, në fjalën e tij, thotë:

"وَلاَ يَأْبَ الشُّهَدَآءِ إِذَا مَا دُعُوا"

"...dëshmitarët të mos refuzojnë, kur u bëhet thirrje..." (Sure "El Bekare", ajeti 282)

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "Kur ty të bëhet thirrje të dëshmosh një borxh ose një të drejtë, ti nuk duhet ta refuzosh këtë thirrje."

Më pas ai tha: "Kur të bëhet thirrje për të dëshmuar, përgjigju thirrjes."

Gjithashtu, ai tha: "Askush nuk duhet të thotë: 'Nuk dëshmoj për ju.', kur i bëhet thirrje të dëshmojë.'"

Kryerje e dëshmisë, do të thotë deponimi para gjykatësit, kur të bëhet thirrje për të dëshmuar. Ky deponim është detyrim, plotësisht ashtu siç ishte detyrim marrja përsipër e dëshmisë.

Allahu i Plotpushtetshëm thotë:

"وَلاَ تَكْتُمُوا الشَّهَادَةَ وَمَنْ يَكْتُمْهَا فَإِنَّهُ آثِمٌ قَلْبُهُ "

"...dhe mos e fshihni dëshminë, ai që e fshejkh dëshminë, zemra e tij është mëkatare..." (Sure "El Bekare" ajeti 283)

"وَمَنْ أَظْلَمُ مِمَّنْ كَتَمَ شَهَادَةً عِنْدَهُ"

"...dhe kush është më mizor se ai që fshejkh dëshminë për të cilën ka dijeni..." (Sure "El Bekare", ajeti 140)

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "Ai që ka mbi qafën e tij një dëshmi, nuk duhet të refuzojë të dëshmojë, sepse e ka detyrim të dëshmojë atë që di. Me dëshminë e tij le të këshillojë dhe për dëshminë që bën, të mos frikësohet se mund ta njollosë një i njollosur, por le të urdhërojë për punë të mirë dhe të ndalojë punën e keqe."

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se kryerja e dëshmisë është farzi kifajeh dhe jo farzi ajn, domethënë, nëse disa e kryejnë dëshminë, shkarkohen prej përgjegjësisë për të

dëshmuar të gjithë ata që e kanë detyrë të dëshmojnë. Nëse të gjithë abstenojnë të dëshmojnë, të gjithë janë mëkatarë.

Për dëshmitarin lejohet të vonojë kryerjen e dëshmisë, kur ekziston frika e dëmtimit për veten e tij, ose mund të dëmtohet ndonjë tjetër i pafajshëm, pasi dihet që në Islam nuk ka dëmtim.

Për këtë çështje, Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "Dëshmo për hir të Allahut, qoftë edhe kundër vetes tënde, ose kundër prindërve të tu, ose edhe kundër të afërmve të tu, pa marrë parasysh lidhjen apo interesat që ti ke me ta. Nëse ke frikë që, për shkak të dëshmisë tënde do të hahet e drejta e vëllait tënd, ose ai do të poshtërohet, atëherë mos dëshmo."

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Këtë e gjej pa asnjë kundërshtim."

Dëshmia dhe kushtet e saj

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "Kur ke qëllim të dëshmosh, ndryshoje dëshminë si të duash, rendite e korrigjoje atë sipas mundësisë me ato fjalë e shpjegime që mundësojnë renditjen e korrigjimin e dëshmisë, derisa e drejta të shkojë te personi të cilit i takon, sepse ti dëshmon vetëm të drejtën dhe me dëshminë tënde të vërtetë nuk shton asgjë që nuk është e drejtë."

Në të vërtetë, dëshmitari bën të pavlefshme atë që nuk është e drejtë dhe vërteton vetëm të drejtën. Me dy dëshmitarë bëhet e detyrueshme dhënia e të drejtës, por e drejta jepet edhe me një dëshmitar.

Dëshmitari, kur dëshmon, ka të drejtë të sistemojë e të korrigjojë dëshminë dhe për këtë të përdorë të gjitha rrugët që atij i mundësojnë këtë sistemim e korrigjim të dëshmisë, duke filluar që me shtimin e fjalëve e të kuptimeve. Njëkohësisht ai bën edhe komentim që ndihmon për vërtetimin e të drejtës. Dëshmitari nuk dënohet për shtimin e fjalëve në dëshminë e tij për të drejtën, në të kundërt, për dëshminë e drejtë, ai ka shpërblimin e agjëruesit dhe të atij që lufton me armë në dorë në rrugën e Allahut.

Dhe tani kushtet e dëshmisë:

1- Qartësia

Dëshmia patjetër duhet të jetë e çiltër dhe e qartë. Mjafton edhe një fjalë e vetme që të tregojë dëshminë, si për shembull, dëshmitari thotë: "Unë dëshmoj", "Jam i bindur", "E di mirë", "Betohem në fenë time" dhe të tjera fjalë të kësaj kategorie.

2- Përputhja

Dëshmia e njërit dëshmitar duhet të përputhet me dëshminë e dëshmitarit tjetër në kuptim. Nëse dëshmitë kanë kundërshtime në kuptim, dëshmia e të dy dëshmitarëve nuk pranohet. Po japim një shembull për këtë çështje: Njëri dëshmitar dëshmon shitjen, kurse dëshmitari tjetër dëshmon qiramarrjen, ose të dy dëshmojnë shitjen, por njëri prej dy dëshmitarëve thotë se shitja është bërë ditën e xhuma, kurse tjetri thotë që shitja është bërë ditën e shtunë, ose ai dëshmon që shitja është bërë në treg, kurse dëshmitari tjetër dëshmon që shitja është bërë në shtëpi.

Kur njëri prej dy dëshmitarëve dëshmon për ndodhjen e një veprimi, si për shembull, dëshmon shitje dhe dëshmitari tjetër dëshmon se ka ndodhur vetëm pohim, në këtë gjendje, nuk vërtetohet asgjë, për shkak të mospërputhjes së dëshmisë së dy dëshmitarëve për të njëjtën gjë.

Kjo është ajo që kanë thënë autorët e librave "Esh Sheràiu", "El Xheuahir", "El Mesalik" dhe fukaha të tjerë. Më parë nuk isha i kënaqur dhe mendoja se çështja duhet të lihet në dorën e gjykatësit e në hulumtimin e tij, por më pas hoqa dorë prej këtij mendimi dhe konstatova se e drejta ishte në anën e fukahave dhe gjykatësi, në asnjë gjendje, nuk ka mundësi të marrë në konsideratë një dëshmi të tillë si argument të plotë, sepse nuk ka përputhje mes pohimit për sendin dhe mes ekzistencës reale të atij sendi. Njeriut i lejohet të pohojë në kundërshtim me realitetin, kur këtë e kërkon interesi i tij në kushte të veçanta.

Kur pohimi për sendin nuk është vetë sendi, është e vlefshme ajo që kanë thënë fukahatë për mospërputhjen e fjalëve të dy dëshmitarëve për të njëjtin send dhe jo për dy sende që realisht kanë lidhje me njëri-tjetrin. Është e kuptueshme që personi në favor të të cilit dëshmohet, me qëllim që të vërtetohet dëshmia e bërë, ka detyrim të betohet së bashku me njërin prej dy dëshmitarëve, në rastin kur e drejta është prej grupit të të drejtave që vërtetohet me një dëshmitar dhe me betim.

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Kur njëri dëshmon për një mijë dhe tjetri dëshmon për dy mijë, me dëshmi të plotë vërtetohet një mijë, kurse mijëshi i dytë, vërtetohet vetëm nëse betimi i bashkohet dëshmisë së atij që dëshmoi dy mijë. Kur njëri prej dy dëshmitarëve dëshmon shitjen për një mijë dhe dëshmitari

tjetër dëshmon shitjen me dy mijë, me këto dëshmi nuk vërtetohet asgjë, sepse kontrata me një mijë nuk është kontrata me dy mijë.

3- Dëshmi për mohim

Dëshmia nuk bëhet për të mohuar, domethënë të dëshmojë që nuk di gjë, sepse dëshmitari ka detyrim të ketë dijeni në lidhje me të drejtën për të cilën betohet. Është e ditur që mohimin e dëshmitarit nuk e di askush përveç Allahut të Lartësuar. Ai që dëshmon se Zejdi nuk ka marrë borxh prej Amrit, dëshmia e tij është për diçka që ai nuk ka dijeni, kur zakonisht është e mundur marrja e një borxhi të ngjashëm me borxhin për të cilin u dëshmua, sepse është e lejueshme që Zejdi të marrë borxh prej Amrit pa e ditur askush.

Fukahatë kanë veçuar prej këtij rregulli dëshminë për varfëri të madhe dhe kanë vënë kusht që dëshmitari të ketë dijeni për varfërinë e personit për të cilin ai dëshmon. Gjithashtu, të ketë dijeni edhe punët e tij të veçanta, si person që ka qëndruar gjithmonë pranë tij.

Në lidhje me këtë çështje, kemi folur në kapitullin "I falimentuari" të kësaj pjese, në paragrafin "Burgosja e borxhmarrësit", në pikën 4.

Gjithashtu, fukahatë kanë veçuar rastin kur dëshmohet që i vdekuri nuk ka lënë trashëgimtarë, por patjetër krahas kushteve të lartpërmendura.

Kuptohet se, kur dëshmia për mospasje dijeni kthehet në dëshmi për vërtetim, ajo merret në konsideratë. Po japim disa

shembuj: një person akuzon një tjetër se ai, në filan ditë e në filan vend, ka vrarë babain e tij, kurse i akuzuari sjell argument se pikërisht në atë ditë, ai nuk ishte aty, domethënë që në asnjë gjendje vrasja nuk është bërë prej tij; ose rasti kur një burrë pretendon se një grua është bashkëshortja e tij dhe ai ka vënë kurorë me atë grua në vitin gjashtëdhjetë, ndërkaq gruaja sjell argument që vërteton se burri gënjen dhe akti ligjor i martesës së saj është lidhur me një burrë tjetër në vitin pesëdhjetë e nëntë dhe ajo deri tani është nën kurorën e këtij burri.

4- Dituria

Dëshmia bëhet kur dëshmitari ka dijeni të plotë e të sigurt rreth dëshmisë që bën, për rrjedhojë, dëshmia nuk pranohet, kur si shkak për dëshminë është bazuar mbi supozimin.

Në lidhje me këtë çështje, Allahu i Lartësuar urdhëron në Librin e Tij Famëlartë:

"وَلاَ تَقْفُ مَا لَيْسَ لَكَ بِهِ عِلْمٌ "

"Mos u afro te ajo për të cilën nuk ke dijeni..." (sure "El Isrà", ajeti 36)

I Dërguari i Allahut *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)* ka thënë: "A e shikon diellin ashtu siç është? Atëherë dëshmo, ose hiq dorë prej dëshmisë."

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "Mos dëshmo, derisa ta njohësh mirë çështjen për të cilën dëshmon, ashtu siç njeh dorën tënde."

Fjala "dijeni" dhe "njohje", këtu përfshin diturinë e njohjen e marrë nga shikimi me sy, si për shembull, ti shikon një person që rreh, ose vret, ose vjedh, ose shet dhe ti dëshmon për atë që shikove. Gjithashtu, fjala "dijeni" përfshin diturinë e përfituar nga transmetimi brez pas brezi dhe është e përhapur në mesin e njerëzve se, për shembull, kjo parcelë toke është vakëf, ose kjo grua është bashkëshorte e filanit, ose ky djalë është djali i atij.

Me këtë lloj diturie që ke grumbulluar, ti mund të dëshmosh. Gjithashtu, fjala "dituri" përfshin diturinë e përftuar prej një diturie tjetër sipas zakonit, si për shembull, ti shejkh një burrë që vepron në një shtëpi, duke e shembur atë, ose duke e dhënë me qira dhe për veprimin që bën, atë nuk e kundërshton askush. Në këtë gjendje, ti mëson prej veprimit të tij se ajo shtëpi është pronë e tij, atëherë ti dëshmon se ajo shtëpi është pronë e tij.

Prej Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)* është transmetuar se një burrë i ka thënë atij: "Kur ti shikon një send në dorën e një burri, a është e lejueshme të dëshmosh se ai send është i atij që e ka në dorë?"Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* tha: "Po." Atëherë burri tha: "Dëshmoj se sendi ishte në dorën e tij dhe nuk dëshmoj se ai send është i atij, sepse mundet që sendi të jetë i ndonjë tjetri." Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* tha: "A është hallall të blesh prej atij?" Burri tha: "Po."

Atëherë Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* tha: "Ka mundësi që sendi të jetë i ndonjë tjetri. Atëherë prej nga do të jetë e lejuar për ty të blesh prej atij, që sendi i blerë të bëhet pronë e jotja? Pastaj ti thua se ky send është i imi, madje edhe betohesh se ai send është i yti, por nuk lejohet të pohosh për sendin që ti merr në pronësi se ai send ishte në pronësi të një tjetri…"

Më pas Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* tha: "Sikur kjo të mos ishte e lejuar, myslimanët nuk do të kishin treg."

Autori i librit "El Xhevahir" ka thënë: "Qëllimi me fjalën "dituri e marrë në konsideratë", në dëshminë, është dituria e arritur, në saje të shikimit me sy, ose me të tjera rrugë. Ne dëshmojmë se Profeti Muhamed *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)* e vuri Prijësin e besimtarëve, Imam Aliun *(Paqja qoftë mbi të!)*, Imam ditën e Gadijr Humit, megjithëse në atë kohë ne nuk ishim aty."

Më pas ai thotë: "Kur dituria për realitetin është ndërtuar jo në bazë të shikimit me sy, kjo dituri nuk e dëmton mundësinë reale, sepse ndodh që dituria për të vërtetën e realitetit vjen edhe pa shikim me sy, ose rreth atij realiteti mësojmë nëpërmjet shqisave."

* * *

KUSHTET E DËSHMITARIT

Për dëshmitarin janë kusht:

1- Mendja

Dëshmori i dytë, në librin "El Mesalik", ka thënë: "Është kusht që dëshmitari ta njohë mirë personin në favor të të cilit dëshmon, ose personin kundër të cilit dëshmon dhe patjetër duhet të jetë i pajisur me cilësinë e drejtësisë dhe të jetë i pranueshëm. Nisur nga këto cilësi, kushte që duhet të gëzojë dëshmitari, nuk është e vlefshme dëshmia e të çmendurit, qoftë kur çmendja e tij është e përhershme, qoftë kur ai kalon në gjendje çmendurie me periudha.

Allahu i Lartësuar thotë në librin e Tij Famëlartë:

"وَأَشْهِدُوا ذَوَي عَدْلٍ مِّنْكُمْ"

"...sillni të dëshmojnë dy dëshmitarë të drejtë nga mesi juaj..." (Sure "Et Talàk", ajeti 2)

"مِمَّنْ تَرْضَوْنَ مِنَ الشُّهَدَآءِ"

"...prej atyre dëshmitarëve me të cilët ju jeni të kënaqur..." (Sure "El Bekare", ajeti 282)

I çmenduri, në të dyja gjendjet, nuk është i pranueshëm për dëshmitar. Të gjithë myslimanët kanë një mendim të përbashkët për këtë rregull, por ky rregull nuk është i zbatueshëm, kur të çmendurit i kthehet mendja plotësisht jashtë periudhave të përmirësimit, domethënë kur mendja e tij është e plotë. Atëherë dëshmia e këtij të çmenduri pranohet, për shkak të largimit të pengesës, që ishte çmenduria."

Bazuar mbi këtë rregull, kur të çmendurit i rikthehet mendja në periudha kohe dhe ai dëshmon, kur është plotësisht i vetëdijshëm, gjykatësi ka detyrë të studiojë me hollësi gjendjen e tij, derisa të jetë plotësisht i sigurt se me të vërtetë ai kupton plotësisht, vetëm atëherë merret në konsideratë dëshmia e këtij të çmenduri.

2- Pjekuria seksuale

Fukahatë ndajnë një fjalë të vetme me autorin e librit "El Xheuahir" dhe me autorin e librit "El Mesalik", të cilët kanë thënë se dëshmia e fëmijës që nuk dallon, në mënyrë absolute, nuk pranohet për asnjë gjë, por fukakatë kanë mendime të ndryshme në lidhje me dëshminë e fëmijës që dallon.

Një grup fukahash kanë shkuar deri aty sa të thonë se dëshmia e fëmijës që dallon nuk pranohet, në mënyrë absolute,

plotësisht siç nuk pranohet dëshmia e fëmijës që nuk dallon, sepse fëmijës nuk i pranohet dëshmia, kur ai dëshmon kundër vetes së tij, për rrjedhojë është më me përparësi që dëshmia e tij të mos pranohet, kur ai dëshmon kundër të tjerëve, sepse dëshmia ka si kusht parësor drejtësinë. Por fëmija nuk mund të ketë drejtësi. Për këtë njofton Allahu i Lartësuar në fjalën e Tij:

" وَاسْتَشْهِدُوا شَهِيْدَيْنِ من رِّجَالِكُمْ "

"...sillni të dëshmojnë dy dëshmitarë burra prej mesit tuaj..." (Sure "El Bekare", ajeti 282)

Nga kjo kuptojmë që fjala "burra" nuk thuhet për fëmijët.

Fukahatë më të dëgjuar kanë shkuar me dëshminë e autorit të librit "El Xheuahir" dhe të autorit të librit "El Mesalik", të cilët kanë thënë se dëshmia e fëmijës që dallon pranohet vetëm për vrasjen e për plagosjen, me tri kushte.

Kushti i parë: Fëmija të ketë mbushur dhjetë vjeç.

Kushti i dytë: Fëmijët të jenë së bashku për një punë të lejueshme.

Kushti i tretë: Fëmija dëshmon para se të largohet nga vendi i ngjarjes për të cilën ai dëshmon, në atë mënyrë që mos të ketë asnjë mundësi që ai fëmijë të instruktohet, ose të manipulohet.

Prej këtyre transmetimeve fukahatë kanë arritur në përfundim: "Dëshmia e fëmijëve është e lejueshme në mesin e tyre, derisa ata nuk janë shpërndarë, ose nuk janë kthyer nëpër shtëpitë e tyre."

Në një transmetim të dytë, thuhet: "Është e lejueshme dëshmia e djalit të vogël, nëse ai ka mbushur dhjetë vjeç."

Në një transmetim të tretë thuhet: "Dëshmia e fëmijës nuk është e lejueshme veçse për vrasjen, por merret në konsideratë vetëm fjala e parë e fëmijës dhe nuk merret në konsideratë fjalë e dytë që ai thotë."

Kur ne i bashkojmë këto transmetime në një kuptim të vetëm dhe bëjmë lidhjen mes transmetimeve, rezulton që dëshmia e fëmijës për vrasjen pranohet, nëse fëmija ka mbushur dhjetë vjeç dhe, kur dëshmon, para se të kthehet në familjen e tij. Meqenëse dëshmia e fëmijës është e vlefshme për vrasjen, është akoma më e vlefshme për plagosjen, por patjetër që mbetet kushti që fëmijët të ishin së bashku për një punë të lejuar, ashtu siç ka pohuar autori i librit "El Xheuahir" dhe autori i librit "El Mesalik", të cilët kanë thënë se për këtë kusht nuk ka argument.

Fala e autorit të librit "El Xheuahir", është: "Në tekstet e në fetvatë është thënë prerë pranimi i dëshmisë së fëmijës në penalitetet si tërësi."

Megjithëkëtë, ne jemi me ata që janë shprehur për mospranimin kategorik të dëshmisë së fëmijëve për vrasje e për të tjera punë, pasi argumentet e thonë qartë që te dëshmitari është kusht mosha madhore dhe drejtësia. Por, meqenëse dëshmia e fëmijës nuk është e vlefshme as për lajthitje, akoma më shumë dëshmia e tij nuk mund të jetë e vlefshme për vrasjen.

3- Dëshmitari të jetë mysliman

Autori i librit "El Xheuahir" dhe autori i librit "El Mesalik" kanë cituar prej shejkhut Et Tùsij, të madhit, i njohur me epitetin Shejkhu i grupit: "Pranohet dëshmia e çdo grupi kundër grupit të tij, bazuar në faktin se Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* është pyetur për dëshminë e jomyslimanëve që jetojnë në besën e shtetit islam. Dhe ai është përgjigjur: "Dëshmia e tyre është e vlefshme, vetëm kur dëshmojnë për grupin e tyre."

Më pas autori i librit "El Xheuahir" citon prej autorit të librit "Keshful Lithàm", i cili, duke komentuar fjalën e shejkhut, ka thënë: "Fjala e tij është e fuqishme si detyrim për pjesëtarët e çdo grupi të të njëjtit besim."

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët mes tyre se, kur një burrë mysliman lë testament gjatë udhëtimit dhe pranë vetes nuk ka myslimanë që të dëshmojnë testamentin e tij, ai ka të drejtë që për testamentin e tij të dëshmojnë dy burra prej ithtarëve të Librave të mëparshëm (jehudij e kristianë).

Dëshmitarët, para dëshmisë, falin namaz dhe betohen para disa të tjerëve se ata të dy as nuk do të tradhtojnë, as nuk do ta fshejkhin testamentin dhe as nuk do të bëjnë pazar me përmbajtjen e testamentit për një grusht para, duke pasur parasysh porosinë e Allahut të Lartësuar:

"يَا أَيُّهَا الَّذِيْنَ آمَنُوا شَهَادَةُ بَيْنِكُمْ إِذَا حَضَرَ أَحَدَكُمُ الْمَوْتُ حِيْنَ الْوَصِيَّةِ اثْنَانِ ذَوَا عَدْلٍ مِّنْكُمْ أَوْ آخَرَانِ مِنْ غَيْرِكُمْ إِنْ أَنْتُمْ ضَرَبْتُمْ فِي الْأَرْضِ فَأَصَابَتْكُم مُّصِيبَةُ الْمَوْتِ ۚ تَحْبِسُونَهُمَا مِن بَعْدِ الصَّلَاةِ فَيُقْسِمَانِ بِاللَّهِ إِنِ ارْتَبْتُمْ لَا نَشْتَرِي بِهِ ثَمَناً وَلَوْ كَانَ ذَا قُرْبَى..."

"O ju që keni besuar! Kur t'ju afrohet vdekja, me rastin e lënies së testamentit, le të dëshmojnë dy të ndershëm prej jush ose dy të tjerë që nuk janë prej jush, nëse fatkeqësia e vdekjes ju zë, ndërsa jeni duke udhëtuar nëpër botë. Mbajini ata pas namazit dhe, nëse dyshoni në ndershmërinë e tyre, le të betohen në Allahun (duke thënë)**: "Ne nuk do ta shesim betimin me kurrfarë çmimi, edhe nëse është fjala për çfarëdo të afërmi dhe dëshminë që na urdhëron Allahu nuk do ta fshejkhim, sepse, atëherë do të ishim vërtet keqbërës".** (Sure "El Maideh", ajeti 106)

Fukahatë më të dëgjuar kanë shkuar me dëshminë e autorit të librit "El Xheuahir" dhe të autorit të librit "El Mesalik", të cilët janë shprehur se, kur njeriu është larg vendit të tij, nuk është kusht që dëshmitari të jetë mysliman, pasi në këtë gjendje lejohet që dëshmitarët, për testamentin, të jenë edhe jomyslimanë, jehudij ose kristianë, kur testamentlënësi nuk gjen dy dëshmitarë myslimanë, që të dëshmojnë për testamentin që ai lë. Kushtin e udhëtimit fukahatë, në shumicën e rasteve, e kanë bazuar në ajetin e mësipërm.

Imam Bakiri, babai i Imam Xhaferr Sadikut (Paqja qoftë mbi ta!), është pyetur, nëse lejohet që jomyslimanët të dëshmojnë për ata që nuk janë të fesë së tyre.

Imam Bakiri *(Paqja qoftë mbi të!)* është përgjigjur: "Jo, përveçse kur, në gjendjen konkrete, nuk gjenden të tjerë përveç tyre, në këtë gjendje, dëshmia e tyre për testamentin është e lejueshme, sepse nuk mund të lejohet të humbë e drejta e një myslimani e as të bëhet pa vlerë testamenti tij."

4- Drejtësia

Me fjalën e përbashkët të fukahave, me librin e Allahut dhe me Sunetin, drejtësia është kusht për dëshmitarin. Prej librit të Allahut kemi ajetin e nderuar:

"وَأَشْهِدُوا ذَوَيْ عَدْلٍ مِّنْكُمْ"

"...sillni të dëshmojnë dy dëshmitarë të drejtë nga mesi juaj..." (Sure "Et Talàk" ajeti 2)

Prej Sunetit kemi i transmetimin e përcjellë prej Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)* se i Dërguari i Allahut *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)* ka thënë: "Dëshmia e mëkatarit pranohet, vetëm kur ai dëshmon kundër vetvetes."

Këtu duhet të theksojmë dy çështje: kuptimin e fjalës "drejtësi" dhe rrugën e vërtetimit të drejtësisë e të njohjes me drejtësinë.

Në lidhje me kuptimin e fjalës "drejtësi", fukahatë kanë mendime të ndryshme dhe i kanë zgjeruar shumë mendimet e tyre për kuptimin e kësaj fjale.

Ka fukaha që kanë thënë se drejtësia është Islami, krahas mosbërjes së mëkateve.

Fukaha të tjerë kanë thënë se drejtësia është një pasuri e ngulur thellë në shpirt dhe lind e bazuar te devotshmëria.

Një i tretë ka thënë se drejtësia është mbulim dhe heqje dorë nga punët e nga fjalët jo hallall.

Një i katërt ka thënë që drejtësia realizohet me heqjen dorë prej mëkateve të mëdha, krahas mosngulmimit në mëkatet e vogla.

Në rezultatin përfundimtar, ne jemi me këtë mendim dhe argumenti për këtë do të dalë në fjalët vijuese.

Kur mendimi ndryshe i fukahave tregon kuptimin e fjalës "drejtësi", të bazuar mbi një send, në të vërtetë, mendimi i tyre tregon se ligjvënësi, kur e ka konsideruar drejtësinë kusht për dëshmitarin dhe për jodëshmitarin, në të vërtetë, e ka mbështetur njohjen me kuptimin që ka kjo fjalë zakonisht, pasi nuk është vërtetuar që tradita të ketë dhënë për fjalën "drejtësi" ndonjë përkufizim të veçantë, pavarësisht se një grup fukahash janë shprehur në favor të ekzistencës së një përkufizimi të veçantë për fjalën drejtësi.

Patjetër, në disa njoftime ka shenja që flasin për kuptimin e drejtësisë, por ato janë shenja në kuptimin që fjala drejtësi ka zakonisht dhe nuk është përkufizim për të vërtetën ligjore të ligjit të fesë që ne besojmë. Me këtë unë nuk dua të argumentoj se fukahatë kanë studiuar dhe kanë gjurmuar për kuptimin e fjalës "drejtësi" në librat e gjuhës dhe plotësimin e kuptimit që ka kjo fjalë te tradita, plotësisht ashtu sikur të studionin rreth kuptimit të kësaj fjale në librat e hadithit. Madje disa studiues kanë sjellë si dëshmi deri edhe fjalët e Platonit. Por është e kuptueshme se çdo referencë e fukahave në gjuhën e në traditën, ose në çdo burim jo ligjor për njohjen me kuptimin e fjalës "drejtësi", s'ka asgjë të përbashkët me të vërtetën ligjore.

Ajo që arrihet pas meditimit dhe ndjekjes së rrjedhës së traditës, ajeteve të Kuranit Famëlartë, transmetimeve dhe fjalëve të fukahave, rezulton se njeriu i drejtë është besnik e i angazhuar me dispozitat e fesë së tij praktikisht dhe jo teorikisht. Ai nuk i vë punët e tij të kësaj bote mbi fenë e tij për shkak të ndonjë të afërmi, ose të ndonjë shoku, ose për shkak të ndonjë qëllimi, pa asnjë dallim, nëse kjo drejtësi, nga ana e tij, është ose jo cilësi e rrënjosur në shpirt, pasi e rëndësishme është që drejtësia të jetë në përputhje të plotë me fjalën e Allahut të Lartësuar:

"وَلاَ تَشْتَرُوا بِعَهْدِ اللهِ ثَمَناً قَلِيْلاً ۚ إِنَّمَا عِنْدَ اللهِ هُوَ خَيْرٌ لَّكُمْ"

"...mos e shitni besën e dhënë Allahut me çmim të ulët, sepse ajo që është te Allahu është shumë e mirë për ju..." (Sure "En Nahl", ajeti 95)

Kjo kuptohet akoma më qartë në fjalët që kanë ardhur në disa njoftime e hadithe që tregojnë se besimtari fetar as nuk bën mëkate të mëdha e as nuk vazhdon në mëkatet e vogla. Prijësi i besimtarëve, Imami Aliu (Allahu i ndriçoftë fytyrën!) ka thënë: "Merrni dëshmitar personin me cilin jeni të kënaqur për fenë e tij, për drejtësinë e tij, për nderin e tij dhe për faktin se veprimi i tij është në përputhje me fjalën e Allahut të Lartësuar:

"اَلَّذِينَ يَجْتَنِبُونَ كَبَائِرَ ٱلإِثْمِ وَالْفَوَاحِشَ إِلاَّ اللَّمَمَ"

"Ata që largohen prej mëkateve të mëdha e prej punëve të ndyra, përveç ndonjë pune të imët..." (Sure "En Nexhm", ajeti 32)

Mëkate të mëdha janë lënia e shtyllave të Islamit, kryerja e mëkateve të rënda që e bëjnë detyrim dënimin, si: vrasja e vjedhja,

ngrënia e pasurisë padrejtësisht, apo të tjera punë për të cilat i Plotpushtetshmi kërcënon hapur në Librin e Tij Famëlartë cilindo që i kryen ato punë.

Autori i librit "El Xheuahir", në kapitullin "Dëshmitë", duke folur për drejtësinë, ka theksuar pastërtinë e krijimit të njeriut të drejtë, sjelljen e tij normale. Ne, prej këtij përshkrimi, po shkëpusim paragrafin vijues: "Pa dyshim që mëkatet e vogla janë të pandashme prej njeriut, por kryerja e adhurimeve të urdhëruara dhe qëndrimi sa më larg mëkateve të mëdha, shlyejnë mëkatet e vogla që kryen njeriu, domethënë që për këto mëkate të vogla nuk është e nevojshme të bëhet teubeh, por nuk ka diskutim që kurrë nuk duhet të hiqet dorë nga vendosmëria për të mos vazhduar as në mëkatet e vogla, ashtu siç porosit hadithi i nderuar: "S'ka mëkat të vogël krahas vazhdimit në kryerjen e mëkateve të vogla dhe s'ka mëkat të madh krahas kërkimit të faljes së mëkatit."

Ky hadith i nderuar na lë të kuptojmë se nuk është e nevojshme të kërkohet falje për mëkatin e vogël, kur nuk vazhdohet në atë mëkat, ashtu siç del qartë prej fjalës së hadithit."

Prej mëkateve të vogla janë: veshja e rrobave të mëndafshta, mbajtja e unazës prej floriri (për burrat), ngrënia e pirja në enë prej floriri e prej argjendi, ngrënia e prija e ushqimeve dhe pijeve të ndotura me papastërti, ulja në një tryezë në të cilën serviren ushqime e pije haram. Gjithashtu, prej mëkateve të vogla është edhe bërja me shenjë me vetull në mënyrë të ndaluar, shkarjet e gjuhës, mendjemadhësia e tangërllëku, kur këto shenja nuk janë përdoruar si mjete për të vënë në pozitë të vështirë e për të dëmtuar tjetrin.

Për sa i përket burrërisë, një grup fuakahash, ndër të cilët Shejkhu, Mufijd, El Hil'lij', El Kàdij'j, El Erdebijlij, El Mexhlisij, En Neràkij, autorët e librave "Esh Sheraiu", "El Medarik", "El Xheuahir" dhe fukaha të tjerë përveç këtyre, janë shprehur se burrëria nuk është prej kolonave (rukneve) të drejtësisë dhe as ndonjëri prej kushteve të saj.

Autori i librit "El Xhevahir e ka thënë këtë shumë bukur me fjalën e tij në kapitullin "Dëshmitë": "S'ka asnjë problem për mospranimin e dëshmisë, kur dëshmia është për një punë që nuk duhet bërë, ose kur bëhet krahas një pune të ndaluar, ose kur dëshmohet për një punë të kryer në bazë të lajthitjes, sepse e para është kundër devotshmërisë dhe e dyta nuk përputhet me mendjen e shëndoshë. Për sa u përket punëve të tjera që nuk u referohen punëve të lartpërmendura, është me komplikim marrja në konsideratë e atyre punëve në dëshminë, ose në drejtësinë."

Meqenëse burrëria nuk është as kolonë e as kusht për drejtësinë e për dëshminë, atëherë të flitet për burrërinë është e huaj në studimet e fik'hut dhe në kapitujt e çështjeve të fik'hut.

Në të vërtetë, rruga e vërtetimit të drejtësisë dhe njohja me drejtësinë është përvoja dhe mentaliteti, ose dëshmia e dy burrave të drejtë, ose, kur nga fjala që përdoret për drejtësinë, njofton marrjen dituri me anë të saj.

5- Saktësia

Nuk është e vlefshme dëshmia e atij që gabon në fjalë ose që harron. Gjithashtu, nuk ka dëshmi prej të shkujdesurit, në të

cilin mbizotëron mendjelehtësia, për shkak të mospasjes besim në fjalën e këtyre dy të fundit. Në këtë gjendje, gjykatësi ka detyrim të sigurohet për ndërgjegjësimin e dëshmitarit, para se të bazohet në dëshminë e tij, plotësisht ashtu siç sigurohet për drejtësinë e tij.

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "Thërrisni të dëshmojë personin me të cilin jeni të kënaqur me fenë e tij, me besnikërinë e tij, me moralin e tij, me drejtësinë e tij, me nderin e tij, me dijeninë që ai ka për atë çka dëshmon, me edukatën e tij e me aftësinë e tij për të dalluar punët, sepse jo çdo njeri i mirë di të dallojë punët dhe jo çdo njeri që di të dallojë punët, është njeri i mirë."

Disa dijetarë të fesë kanë thënë: "Refuzojmë dëshminë e atyre njerëzve prej të cilëve shpresojmë ndërmjetësim Ditën e Gjykimit."

Autori i librit "El Xhevahir" ka thënë: "Kam parë disa njerëz të mirë, te të cilët hynte fjala e gabuar dhe e pavërteta andej nga ata nuk e ndienin."

6- Armiqësia

Me fjalën e përbashkët të fukahave pranohet dëshmia e armikut në favor të armikut të tij dhe nuk pranohet dëshmia e armikut kundër armikut të tij. Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Me fjalën e përbashkët të fukahave dhe me tekst, armiqësia për punët e kësaj bote ndalon pranimin e dëshmisë."

Prej teksteve përmendim fjalën e Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*: "Nuk pranohet dëshmia e atyre që kanë armiqësi e urrejtje të ndërsjellë."

Është edhe fjala tjetër e Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*: "Nuk pranohet për dëshmitar, i akuzuari e i dyshuari, akuzuesi dhe armiku. Nuk është e vlefshme dëshmia e tradhtarit, e tradhtares dhe e atij që atakon vëllain e tij me atë të shenjave me sy."

Kur një grup njerëzish gjenden në rrugë, ose një hotel, ose në ndonjë vend tjetër, a pranohet dëshmia e disa prej tyre në favor të pjesës tjetër të tyre, që filani u ka prerë atyre rrugën për t'i vjedhur, ose ai ka sulmuar hotelin dhe ka rrëmbyer pasuritë e tyre?

Fukahatë më të dëgjuar kanë shkuar me dëshminë e autorit të librit "El Xheuahir" për mospranimin, për shkak se ka vend për armiqësi.

Imam Rizai *(Paqja qoftë mbi të!)*, nipi i Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*, është pyetur për një grup shokësh që ishin në rrugë dhe atyre u është prerë rruga prej kusarëve, të cilët u morën atyre gjërat që kishin, kështu që ata dëshmojnë në favor të njëri-tjetrit.

Ai *(Paqja qoftë mbi të!)* është përgjigjur: "Dëshmia e atyre nuk pranohet, vetëm nëse pohojnë vetë kusarët, ose të tjerë dëshmojnë kundër kusarëve."

Del detyrë që transmetimi dhe fjala e fukahave të mbartet në faktin se atij që nuk i pranohet dëshmia prej këtyre që u thanë, ishte prej atyre që u sulmuan për ta grabitur, ose për ta

poshtëruar. Nëse ai nuk është sulmuar në asgjë, atëherë dëshmia e tij pranohet, kur mblidhen të gjitha kushtet për mosakuzim.

7- Afërsia

Fukahatë ndajnë një mendim të përbashkët me dëshminë e autorit të librit "El Xheuahir" se përkatësia familjare, edhe nëse është i afërm, nuk e pengon pranimin e dëshmisë, prandaj pranohet dëshmia e babait në favor të djalit të tij dhe dëshmia e djalit në favor të babait të tij, ose dëshmia e vëllait në favor ose dhe kundër të vëllait të tij, ose dëshmia e njërit prej bashkëshortëve në favor ose kundër njëri-tjetrit.

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "Është e vlefshme dëshmia e babait në favor të djalit të tij dhe dëshmia e djalit në favor të babait të tij, pranohet edhe dëshmia e vëllait për vëllanë e tij, kur ai është njeri i pranueshëm."

Gjithashtu, Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "Është e vlefshme dëshmia e burrit në favor të gruas së tij dhe dëshmia e gruas në favor të burrit të saj, kur së bashku me burrin dhe gruan ndodhet edhe një tjetër."

Autori i librit "Esh Sheràiu" dhe autori i librit "El-Xhevahir" kanë thënë: "Në mesin tonë nuk ka mendime ndryshe në lidhje me pranimin e dëshmisë së mikut për mikun e tij, edhe nëse vërtetohet që mes tyre ka shoqëri, shkojnë mirë me njëri-tjetrin dhe të tjera dukuri të dashurisë së ndërsjellë."

Fukahatë më të dëgjuar, bazuar në dëshminë e autorit të librit "El Xheuahir" dhe librit "El Mesalik", prej dëshmisë së të

afërmit, kanë përjashtuar dëshminë e djalit kundër babait të tij dhe për mospranimin e kësaj dëshmie kanë thënë se këtu kemi të bëjmë me shkeljen e të drejtave prindërore nga ana e djalit.

Në grup fukahash kanë thënë se dëshmia e djalit kundër babait të tij pranohet ashtu siç pranohet kur ai dëshmon në favorin e tij në përputhje të plotë me fjalën e Allahut të Lartësuar:

"وَإِذَا قُلْتُمْ فَاعْدِلُوا وَلَوْ كَانَ ذَا قُرْبَى ۖ وَبِعَهْدِ اللهِ أَوْفُوا ۚ ذَٰلِكُمْ وَصَّاكُمْ بِهِ لَعَلَّكُمْ تَذَكَّرُونَ

"…dhe kur të flitni, thoni të drejtën, qoftë edhe për të afërmin dhe plotësoni besën që i keni dhënë Allahut. Kjo është porosi e Allahut për ju që të merrni kështillë." (Sure "El En'àm", ajeti 152)

"كُونُوا قَوَّامِيْنَ بِالْقِسْطِ شُهَدَآءَ لِلَّهِ وَلَوْ عَلَى أَنْفُسِكُمْ أَوِ الْوَالِدَيْنِ وَالْأَقْرَبِيْنَ"

"O besimtarë, gjithmonë të dëshmoni drejt për hir të Allahut, qoftë edhe kundër vetes suaj, ose prindërve e të afërmve…" (Sure "En Nisa", ajeti 135)

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "Dëshmoni të drejtën edhe kundër prindërve e fëmijës."

8- Tërheqja e dobisë dhe sprapsja e dëmit

Nuk pranohet asnjë dëshmi që sjell dobi për dëshmitarin, ose që spraps prej tij një dëm, si për shembull, dëshmia e ortakut në favor të ortakut të tij në aktivitetin e tyre të përbashkët, ose ortaku dëshmon në favor të ortakut të tij në shitjen e pjesës së tij, sepse dëshmia e tij përmban vërtetimin e pjesës së përbashkët në

favorin e tij, por, nëse pjesa nuk është në bashkëpronësi, atëherë dëshmia e tij pranohet.

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "Nuk lejohet dëshmia e ortakut në favor të ortakut të tij për atë aktivitet në të cilin ata të dy janë ortakë dhe është e lejueshme për punë të tjera që ata nuk janë ortakë."

Nuk pranohet dëshmia e kredituesit për pasurinë në favor të debitorit të tij të falimentuar dhe të ngurtësuar, sepse e drejta e tij ka lidhje me një pasuri të qëndrueshme, por pranohet dëshmia e kreditorit në favor të debitorit të tij në gjendje të mirë, si dhe në favor të debitorit që është në gjendje të shtrënguar para ngurtësimit, sepse e drejta, në këtë gjendje, është e varur në mbajtjen e besës nga ana e debitorit dhe nuk është e varur në pasurinë e debitorit.

Nuk pranohet dëshmia e të prokuruarit në favor të prokuruesit të tij, në lidhje me objektin për të cilin është lëshuar prokura. Nuk pranohet dëshmia e kujdestarit dhe e mbajtësit të testamentit për objektin e veprimit të tyre.

Pranohet dëshmia e të prokuruarit kundër prokuruesit dhe dëshmia e kujdestarit kundër personit për të cilin ai është kujdestar, po kështu qëndron puna edhe me mbajtësin e testamentit.

Dëshmia nuk pranohet kur ajo spraps një dëm prej dëshmitarit, si për shembull, ti dëshmon argumentin që filani e ka vrarë Zejdin gabimisht dhe jo me qëllim, por njëri prej të afërmve të vrasësit që mban detyrimin të paguajë shumën për shlyerjen e vrasjes gabimisht, dëshmon argumentin për plagosjen, në një kohë

që dëshmia e tij nuk është e drejtë. Kjo dëshmi nuk pranohet prej tij, sepse ajo heq prej tij pagesën, pasi supozohet që shuma për shlyerjen e vrasjes gabim është detyrim mbi të afërmit dhe jo mbi vrasësin.

Me këtë shpjegim, për ne bëhet e qartë se akuza nuk është pengesë për pranimin e dëshmisë, por akuza e ndalon pranimin e dëshmisë, kur dëshmia bëhet që të përfitojë dëshmitari, ose që prej tij të sprapset një dëm.

9- Dëshmia e lypësit

Autori i librit "El Mesalik" tekstualisht ka thënë: "Thënia më e përhapur në mesin e fukahave është mospranimi i dëshmisë së atij që shtrin dorën të lypë, ashtu siç ka ardhur në transmetimin e përcjellë prej Ali bin Xhaferrit, i cili e ka dëgjuar prej vëllait të tij, Imam Kadhimit *(Paqja qoftë mbi të!)* dhe ky i fundit e ka dëgjuar prej babait të tij, Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*, se ai nuk e pranonte dëshminë e atij që shtrin dorën të lypë.

Gjithashtu, transmetohet se Imam Bakiri *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "I Dërguari i Allahut *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)* nuk e pranonte dëshminë e atij që shtrin dorën për të lypur, sepse, kur lypësit i jep, ai mbetet i kënaqur dhe, kur nuk i jep, lypësi zemërohet, veprim që në komentet është shpjeguar si anim kah akuza dhe ai që shtrin dorën për të lypur, hyn në dispozitën e parazitit."

10- Dëshmia e atij që ka të drejtë të marrë zekat

Kur dëshmon një i varfër që ka të drejtë të marrë zekat, dëshmia e tij pranohet, sepse zekati që ai ka të drejtë të marrë, nuk është një e drejtë e veçantë vetëm për atë, por zekati është një e drejtë që u takon të varfërve në përgjithësi, plotësisht ashtu siç pranohet dëshmia që ky objekt, ose ky send është vakëf për interesat e të gjithëve, duke ditur se dëshmitari është njëri prej atyre që lejohet të përfitojnë prej objektit ose prej sendit për të cilin dëshmohet.

Kur gjykatësi është kujdestar për një të pamundur, lejohet që ai të gjykojë në favor të të pamundurit që ka nën kujdestari dhe kundër atij që është në konflikt me të pamundurin, sepse kujdestaria e tij është e përgjithshme dhe nuk është e veçantë, ashtu siç është gjendja në rastin e kujdestarisë së babait e të gjyshit.

Gjithashtu, për gjykatësin lejohet të gjykojë se filan objekt është vakëf i lënë për dijetarët, ose për gjykatësit, ose për parinë, edhe pse gjykatësi është njëri prej atyre që përfitojnë prej atij vakëfi.

11- Dëshmia e të verbrit dhe e memecit

Është e lejueshme dëshmia e të verbrit dhe e memecit për gjëra që atyre u mundësohet të kenë dijeni. Imam Bakiri *(Paqja qoftë mbi të!)*, babai i Imam Xhaferr Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*, është pyetur për të verbrin. A është e lejueshme dëshmia e të

verbrit? Ai *(Paqja qoftë mbi të!)* është përgjigjur: "Dëshmia e tij është e lejueshme, kur ajo vërtetohet."

Edhe memeci dëshmon për atë që ka parë, duke e shprehur dëshminë e tij me shenja, sepse shenja, në raport me memecin, është si fjala në raport me atë që flet dhe mjaftohet vetëm me anën e jashtme të shenjës, ashtu siç mjaftohet me anën e jashtme të fjalës, sipas shprehjes së autorit të librit "El Xheuahir".

Nëse gjykatësi e kupton shenjën e memecit dhe qëllimin e tij me shenjën, atëherë merret në konsideratë dëshmia e memecit, ndryshe, gjykatësit, shenjën ia përkthejnë dy burra të drejtë, të cilët dinë të përkthejnë shenjat, plotësisht si përkthimi prej një gjuhe të huaj.

12- Dëshmitari i paftuar të dëshmojë

Dëshmitar i paftuar të dëshmojë është ai që e shpall dëshminë në gjykatë para pyetjes së gjykatësit dhe para se gjykatësi t'i kërkojë atij të flasë. Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët me dëshminë e autorit të librit "El Xheuahir", i cili ka thënë se dëshmitarit të paftuar nuk i pranohet dëshmia, kur ai dëshmon një të drejtë prej të drejtave të njerëzve, si për shembull: borxh, dhurim, shitje apo një veprim që e bën të detyrueshëm pagimin e shumës për shlyerjen e gjakut, ose që bën të detyrueshëm dënimin sipas ligjit të fesë."

Më pas, autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Argumenti i kësaj dispozite është mbështetur në fjalën e përbashkët e fukahave, e bazuar në hadithin që tregon se i Dërguari i Allahut

(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!) i ka qortuar ata njerëz që dëshmojnë para se dëshmia të kërkohet prej tyre, me përjashtim të dëshmisë në raste pamundësie për të dëshmuar vetë personi dhe që dihet se është burim për të gëzuar fjalën e përbashkët të fukahave."

Dëshmitari që dëshmon pa i kërkuar të dëshmojë, nuk numërohet mëkatar, sepse vetë dëshmia e tij nuk është mëkat, por, kur dëshmitari që dëshmon pa i kërkuar të dëshmojë jo për ngjarjen konkrete dhe dëshmon, pasi gjykatësi e ka pyetur dhe i ka kërkuar të flasë, dëshmia e tij pranohet.

Fukahatë kanë mendime të ndryshme, nëse pranohet dëshmia e atij që dëshmon pa i kërkuar të dëshmojë për punë që kanë të bëjnë me të drejtën e Allahut, si për pirjen e verës, për kurvërinë, ose për probleme që kanë të bëjnë me interesat e përgjithshme, si xhamitë, shkollat e klinikat.

Fukahatë më të dëgjuar kanë shkuar me dëshminë e autorit të librit "El Xheuahir" për pranimin e asaj dëshmie, me qëllim që të formulohet akuza, si dhe për shkak se argumentet për pranimin e dëshmisë janë të pakushtëzuara. Me fjalën e përbashkët të fukahave, ka dalë jashtë këtij rregulli dëshmia e atij që dëshmon pa i kërkuar të dëshmojë për të drejtat e njerëzve, atëherë mbetet vetëm dëshmia e këtij dëshmitari që dëshmon, pa i kërkuar të dëshmojë në lidhje me të drejtat e Allahut, duke e konsideruar dëshminë e tij për këto të drejta si dëshmi për të rregulluar punët që është një lloj prej urdhërimit për punë të mirë e për ndalimin e punës së keqe, domethënë që kemi të bëjmë me një detyrë të cilën e kanë obligim të gjithë. Përveç kësaj, plotësimi i detyrës nuk

numërohet si diçka e dhënë jashtë detyrimit dhe kjo është më e fuqishme.

Paga e dëshmitarit

Me sipër u tha se plotësimi i detyrimit është në shkallën e farzit kifajeh, kur e plotëson një person ose disa persona, të tjerët janë të shkarkuar nga detyrimi për plotësimin e atij detyrimi. Në rast mosplotësimi të detyrimit prej askujt, të gjithë mbajnë përgjegjësi për mosplotësimin e detyrimit, me kusht që plotësimi i atij detyrimi nuk sjell dëm mbi dëshmitarin, ose mbi ndonjë besimtar.

Bazuar në këtë rregull, autori i librit "El Mesalik" ka nxjerrë një rregull dytësor, që thotë se, kur kryerja e dëshmisë nuk ka nevojë për shpenzime dhe dëshmitarin nuk e ngarkon me asgjë, në këtë gjendje, s'ka pagesë për dëshmitarin. Nëse dëshmia ka nevojë për shpenzim, si për shembull, shpenzime udhëtimi, shpenzime për mjete transporti e për shpenzime të tjera, dëshmitari nuk e ka detyrë të përballojë asnjë shpenzim dhe, nëse shpenzimet i bën personi në favor të të cilit dëshmohet, çështja mbetet ashtu siç është, ndryshe për dëshmitarin bie detyrimi për të kryer dëshminë, sepse ky detyrim është i kushtëzuar me mosardhjen e dëmit të merituar[1] mbi dëshmitarin.

---

[1] Dëmi është dy llojesh: dëm i merituar dhe që ti ke detyrim ta përballosh atë dëm, si për shembull, ti ke detyrim t'i shlyesh borxhin personit për të cilin ata dëshmojnë, edhe kur ti dëshmon kundër tij, sepse ai kërkon prej teje të drejtën e tij dhe për të marrë të drejtën e tij, ai edhe të shtrëngon. Në këtë gjendje, ti ke detyrë të dëshmosh dhe të përballosh dëmin, sepse ti e meriton këtë dëm. Kemi edhe dëmin e pamerituar, si për shembull, sikur ti të dëshmosh se ai të mundon

Dëshmia mbi dëshminë

Dëshmi mbi dëshminë do të thotë që të dëshmojnë dy burra të drejtë në prani të gjykatësit, që filani ka dëshmuar para atyre të dyve këtë e atë. Dëshmia e cituar quhet Dëshmi origjinale dhe dëshmia e transmetuar quhet Dëshmi degë, ose Dëshmi mbi dëshminë.

Dëshmia origjinale vërtetohet me kushtet vijuese:

1- Është e pamundur që dëshmitari bazë të jetë i pranishëm, për shkak sëmundjeje, ose nuk ndodhet në vendin e tij, ose është i burgosur, ose ai nuk mund të paraqitet për ndonjë shkak tjetër që nuk mundëson që ai të jetë i pranishëm.

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Kjo është thënia më e përhapur në mesin e fukahave, madje ka një përhapje të madhe."

Imam Bakiri *(Paqja qoftë mbi të!)*, babai i Imam Xhaferr Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*, është pyetur për Dëshminë mbi dëshminë e një burri që ishte i pranishëm në atë vend. A lejohet kjo gjë?

Imam Bakiri *(Paqja qoftë mbi të!)* është përgjigjur: "Po, nëse ai është në vendrojë, atëherë kjo lejohet dhe, kur ai nuk ka mundësi të dëshmojë vetë, për shkak të ndonjë pengese që e ndalon atë të jetë i pranishëm që bëjë dëshminë."

---

ose të fyen mizorisht e padrejtësisht, në këtë gjendje, ti nuk e detyrim të kryesh dëshminë.

2- Të mos jetë për zbatim dënimi, por pranohet për ekzekutimin kapital, për vërtetimin e përkatësisë familjare dhe për të gjitha kontratat, për të metat e grave e në lindje, për zekatin e për vakëfin, por nuk pranohet për punë që bëjnë detyrim zbatimin e dënimeve që parashikon ligji i fesë, si: për kurvërimin, për pirjen e verës e për vjedhjen, sepse këto dënime janë ndërtuar mbi bazën e lehtësimit dhe mospranimin e dëshmisë së dyshimtë për këto dënime.

Në lidhje me këtë çështje, Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "Nuk lejohet Dëshmia mbi dëshminë për dënimet fizike."

3- Dy vetë dëshmojnë dëshminë e një njeriu të vetëm, por lejohet që dy vetë të dëshmojnë dëshminë e dy të tjerëve, ose dëshmojnë dëshminë e një grupi. Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "Imam Aliu (Allahu i ndriçoftë fytyrën!) nuk lejonte dëshminë e një burri mbi dëshminë e një burri, përveçse kur dy burra dëshmojnë mbi dëshminë e një burri."

4- Dy dëshmitarët e Dëshmisë degë kanë detyrim të përcaktojnë me emër dëshmitarin origjinal në prani të gjykatësit. Nuk është e mjaftueshme që ata të dy të thonë: "Dëshmojmë, bazuar në dëshminë e një burri të drejtë ose të dy burrave të drejtë, sepse drejtësia e dëshmitarit mësohet vetëm te gjykatësi dhe jo te të tjerët, si dhe për faktin se kjo mënyrë veprimi mbyll derën e atakimit kundër dëshmitarit prej personit kundër të cilit dëshmohet.

Duhet të theksohet se dëshmia e tretë, në asnjë gjendje, nuk dëgjohet, domethënë së Dëshmia degë nuk mund të jetë dëshmi origjinale për një dëshmi tjetër.

Fukahatë më të dëgjuar kanë shkuar me dëshminë e autorit të librit "El Xheuahir", i cili ka thënë se dëshmia e grave mbi një dëshmi nuk pranohet në mënyrë absolute, madje as atëherë kur dëshmia e grave duhet të pranohet. Teksti e thotë qartë e prerë që, për Dëshminë mbi dëshminë, kërkohet vetëm dëshmia e dy burrave.

Kur dy dëshmitarët dëshmojnë Dëshminë degë dhe gjykatësi merr vendim, por më pas vjen dëshmitari bazë, në këtë gjendje, zbatohet vendimi, edhe sikur të jetë në kundërshtim me Dëshminë bazë. Nëse dëshmitari bazëvjen para marrjes së vendimit, Dëshmia degë rrëzohet dhe merret në konsideratë Dëshmia bazë, sepse puna me Dëshminë degë është e kushtëzuar me mospraninë e origjinalit.

* * *

KATEGORITË E TË DREJTAVE DHE NDODHIVE

Ndodhia që vërtetohet me dëshminë e dëshmitarëve, duke vënë në konsideratë numrin e dëshmitarëve dhe qenien e dëshmitarit mashkull ose femër, ndahet në disa kategori:

1- Kurvërimi

Me fjalën e përbashkët të fukahave, për kurvërimin nuk pranohet dëshmia vetëm e grave, por kurvërimi vërtetohet me dëshminë e katër burrave. Për këtë çështje, Allahu i Lartësuar, në Librin e Tij, thotë:

"وَالَّذِيْنَ يَرْمُونَ الْمُحْصَنَاتِ ثُمَّ لَمْ يَأْتُوابِأَرْبَعَةِ شُهَدَآءَ فَاجْلِدُوهُمْ ثَمَانِيْنَ جَلْدَةً"

"Ata që bëjnë shpifje për gratë e ndershme dhe nuk sjellin katër dëshmitarë, ata i dënoni me rrahje me tetëdhjetë kamxhikë..." (Sure "En Nùr", ajeti 4)

"لَوْلاَ جَآؤُوعَلَيْهِ بِأَرْبَعَةِ شُهَدَآءَ"

"Nëse për këtë ata nuk sjellin katër dëshmitarë..." (Sure "En Nùr", ajeti 13)

Autori i librit "El Xheuahir", autori i librit "El Mesalik" dhe fukaha të tjerë, përveç këtyre të dyve, kanë thënë: "Në ajetin e nderuar nuk ka asgjë që të tregojë se numri i dëshmitarëve është i kufizuar vetëm në katër burra, në atë mënyrë që dëshmia e grave nuk pranohet në mënyrë absolute, qoftë edhe kur gratë që janë, dëshmojnë së bashku me burrat, por, nëse vërtetohet me një argument tjetër që gratë dëshmojnë së bashku me burrat, atëherë veprohet sipas atij argumenti.

Prej Ehli Bejtit *(Paqja e Allahut qoftë mbi ta!)* është transmetuar se kurvërimi që bën detyrim ekzekutimin me gjuajtje me gur, ashtu siç vërtetohet me dëshminë e katër burrave, vërtetohet edhe me dëshminë e tre burrave dhe të një gruaje, ose me dëshminë e tre burrave e dy grave, por nuk vërtetohet me dëshminë e dy burrave e të tetë grave.

Gjithashtu, prej Ehli Bejtit *(Paqja e Allahut qoftë mbi ta!)* transmetohet se kurvërimi që bën detyrim dënimin me rrahje[1], vërtetohet me dëshminë e katër burrave, ose me dëshminë e tre burrave e të dy grave, ose me dëshminë e një burri dhe tri grave.

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "Nuk është e vlefshme dëshmia e grave për daljen e hënës së re. Gjithashtu, nuk është e vlefshme për dënimin me rrahje me kamxhik dëshmia e dy

[1] Ekzekutimi me gjuajtje me gur zbatohet, kur kurvari është i martuar dhe ka mundësi të shkojë të gruaja e tij në çdo kohë që dëshiron dhe dënohet me rrahje me njëqind kamxhikë, nëse kurvari është beqar, ose është i martuar, por s'ka mundësi të shkojë te gruaja e tij. Kështu është edhe për gruan. Hollësitë për këtë çështje do të jepen në kapitullin "Dënimet fizike".

burrave dhe katër grave, por për këtë dënim është e vlefshme dëshmia e tre burrave dhe dy grave."

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Në ekzekutimin me gjuajtje me gur dhe në rrahjen me kamxhik, kushtëzimi mund të mësohet prej një transmetim të dytë të ardhur prej Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*: "Ekzekutimi me gjuajtje me gur bëhet detyrim me dëshminë e tre burrave dhe të dy grave, por, nëse dëshmojnë dy burra dhe katër gra, dëshmia e tyre nuk pranohet, për rrjedhojë i dënuari nuk ekzekutohet me gjuajtje me gur, por ai dënohet me rrahje, ashtu siç është ligji i fesë për kurvërimin."

2- Pederastia e lezbizmi

Pederastia e lezbizmi vërtetohet vetëm me dëshminë e katër burrave dhe për këto dy faje të rënda, dëshmia e grave nuk pranohet në mënyrë absolute, sepse nuk ka argument që të tregojë se në këto dy faje duhet të merret në konsideratë dëshmia e grave, megjithëse nuk ka argument të qartë që të tregojë për katër burra.

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Në tekst nuk kemi gjetur ndonjë argument që të tregojë se duhet të merret në konsideratë dëshmia e katër burrave për këto dy lloje fajesh. Është e vërtetë që në tekst thuhet që pederastia vërtetohet duke e pohuar katër herë dhe lezbizmi te gratë është si pederastia te burrat."

Konstatohet se vërtetimi i pederastisë bëhet duke e pohuar katër herë dhe vërtetimi i këtij faji nuk nënkupton kufizimin e dëshmitarëve në katër burra. Në qoftë se supozojmë ekzistencën e

fjalës së përbashkët për katër dëshmitarë, kjo nuk është asgjë, kur është e lejueshme që burimi për këtë të jetë ajo që ka theksuar autori i librit "El Xheuahir", ku ai thotë se pederastia vërtetohet me pohim katër herë, domethënë bazuar mbi këtë kriter pederastia vërtetohet vetëm me dëshminë e katër burrave. Por ky miratim nuk vërtetohet në dispozitat e Allahut të Lartësuar.

3- E drejta e Allahut

E drejta e Allahut është dy llojesh: materiale, si një e pesta, zekati, premtimi (e taksura) dhe shlyerjet; jomateriale, dënimi për braktisjen e Islamit (renegati), dënimi për shpifjen, domethënë, kur një person akuzon një tjetër për kurvërim ose për pederasti, dënimi për vjedhjen, dënimi për kurvërimin, dënimi për pederastinë dhe për lezbizmin.

Më sipër është folur për tre të fundit. E drejta e Allahut në dy llojet e saj vërtetohet vetëm me dëshminë e dy burrave dhe për të drejtën e Allahut, dëshmia e grave nuk pranohet në mënyrë kategorike, as kur dëshmojnë veç burrave, as kur dëshmojnë së bashku me burrat. Gjithashtu, e drejta e Allahut nuk vërtetohet as me një dëshmitar krahas betimit.

Autori i librit "El Mesalik" ka thënë: "Në të drejtën e Allahut nuk ka dallim, nëse ajo është pasurore, si zekati, një e pesta dhe shuma për shlyerjet, ose nëse e drejta e Allahut është jopasurare, siç janë dënimet. Për mospranimin e dëshmisë së grave për dënimet kanë ardhur transmetime që nuk lejojnë dëshminë e grave për dënimet dhe ekzekutimet, me përjashtim të dënimeve që u përmendën më sipër, domethënë vërtetimi i

kurvërimit me dëshminë e grave, kur dëshmia e tyre bashkohet me dëshminë e burrave.

Për sa u përket të drejtave pasurore të Allahut, për ato nuk ka tekst të veçantë, por, meqenëse bazë për dëshminë është dëshmia e dy burrave dhe, kur ka vend për dëshminë e një dëshmitari krahas betimit, ose me dëshminë e një dëshmitari dhe të dy grave, kjo dëshmi është specifike për borxhet e të ngjashmet me borxhet, domethënë që kanë të bëjnë me të drejtat e njerëzve dhe që reduktohen vetëm në çështje të caktuara, kurse të drejtat e tjera mbeten të mbështetura në bazë."

Prej kësaj fjale mësojmë se fjala e Allahut të Lartësuar: "dhe sillni të dëshmojnë dy dëshmitarë prej burrave tuaj", është rregull i përgjithshëm për ndodhinë, për çdo ndodhi, e cila vërtetohet me dëshminë e dy burrave, me përjashtim të asaj ndodhie që del jashtë këtij rregulli me argument. Por s'ka argument që të tregojë se të drejtat e Allahut vërtetohen me dëshminë e grave, ose me betim, atëherë të drejtat e Allahut mbetet të përfshira në rregullin që është burim për të gjitha ato të drejta.

4- Të drejtat jopasurore të njerëzve

Një grup fukahash kanë thënë se çdo e drejtë prej të drejtave jopasurore të njerëzve (me pasuri nuk kemi qëllim paratë, por që në shumicën e rasteve burrat kanë mundësi të kenë dijeni rreth asaj të drejte, si për shembull, feja islame, rekomandimi ose atakimi i dëshmitarëve), vërtetohet vetëm me dëshminë e dy dëshmitarëve meshkuj. Në këto çështje nuk pranohet dëshmia e

grave, qoftë kur gratë nuk dëshmojnë së bashku me burrat, qoftë kur gratë dëshmojnë së bashku me burrat.

Autori i librit "El Xheuahir", pasi e ka cituar këtë sentencë, e ka komentuar me fjalën e tij: "Unë nuk kam hasur tekste që njoftojnë për këtë. E kundërta, në tekste ka material që e mohojnë këtë."

Ai që ka dijeni rreth teksteve që ne përmendëm në këtë kapitull, menjëherë për atë do të bëhet e qartë sa e qëlluar është fjala e autorit të librit "El Xheuahir.

Pavarësisht nga sa u tha, fukaha të dëgjuar, ndër të cilët edhe autori i librit "Esh Shseraiu" dhe i librit "El Mesalik" kanë thënë se divorci (elkhal'u), divorci me shlyerjen e shumës së kurorës prej gruas, kujdestaria, caktimi i testamentmbajtësit, përkatësia familjare, vërtetimi i daljes së hënës së re, të gjitha këto vërtetohen vetëm me dëshminë e dy burrave.

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "Nuk është e lejueshme dëshmia e grave as për divorcin e as për shikimin e hënës së re."

Në një transmetim të dytë, ai ka thënë: "Nuk vërtetohet shikimi i hënës së re veçse me dëshminë e dy burrave të drejtë. Gjithashtu, edhe divorci vërtetohet vetëm me dëshminë e dy burrave të drejtë."

Edhe divorci me shlyerjen e shumës së kurorës prej gruas, është prej kategorive të divorcit. Për sa i përket përkatësisë familjare, kujdestarisë, caktimit të testamentmbajtësit, unë nuk kam marrë dijeni për ekzistencën e ndonjë teksti të veçantë për

asnjërën prej problemeve që u përmendën, as në librat e hadithit e as në librat e fik'hut, ndër të cilat edhe librat "El Uesail" dhe "El Xheuahir".

Autori i librit "El Mesalik" ka thënë: "Këto çështje vërtetohen vetëm me dëshminë e dy dëshmitarëve burra dhe në origjinë nuk ka asnjë lidhje mes çështjeve të lartpërmendura dhe të pasurisë."

Gjithashtu, autori i librit të lartpërmendur "El Mesalik" ka thënë: "Fukahatë kanë mendime të ndryshme në lidhje me pranimin e dëshmisë së grave për martesën. Vetëkuptohet, sipas njoftimeve të ndryshme që ata kanë ndjekur, në të cilat nuk ka ndonjë njoftim plotësisht të qartë. Shumica e fukahave janë shprehur për pranimin e dëshmisë së dy dëshmitarëve për martesën. Por fukahatë kanë kundërshtime mes tyre në lidhje me pranimin e dy dëshmive për penalitetet që bëjnë detyrim ekzekutimin kapital, sipas ndryshueshmërisë së njoftimeve. Thënia më e saktë tregon më shumë për pranimin e dy dëshmive edhe për këto lloje penalitetesh."

Prej transmetimeve që tregojnë pranimin e dy dëshmive për martesën, kemi transmetimin që tregon se Imam Bakiri *(Paqja qoftë mbi të!)*, babai i Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*, është pyetur për dëshminë e grave, nëse është e vlefshme dëshmia e tyre për martesën. Ai është përgjigjur: "Po, por nuk është e vlefshme për divorcin."

Prej transmetime që tregojnë pranimin e dy dëshmive për penalitet që bëjnë të detyrueshme ekzekutimin kapital, është transmetimi që tregon se Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* është

pyetur: A lejohet dëshmia e grave për dënimet fizike për faje që e bëjnë të detyrueshëm atë lloj dënimi? Ai është përgjigjur: "Vetëm për vrasjen, sepse Imam Aliu *(Allahu i ndriçoftë fytyrën!)* thoshte: "Nuk derdhet gjaku i burrit mysliman."

Sqarim për këtë çështje do të jepet në kapitullin "Dënimet fizike dhe ekzekutimi kapital".

5- Të drejtat pasurore të njerëzve

Fukahatë janë bashkuar me dëshminë e autorit të librit "El Xheuahir", i cili ka thënë se të drejtat pasurore të njerëzve vërtetohen me dëshminë e dy burrave, ose me dëshminë e një burri dhe të dy grave, ose me dëshminë e një burri krahas betimit. Ndër të drejtat pasurore janë edhe ato që nuk janë pasuri në dorë, si për shembull, borxhi, sendi i rrëmbyer, kontratat e kompensimeve, sendi i lënë peng, testamenti për pasuri, si dhe shumat që jepen për shlyerjen e dënimit. Për fajet bëjnë të detyrueshëm shlyerjen e gjakut vetëm me para (ed dijetu), siç është vrasja gabimisht, ose vrasja me qëllim, por e dyshimtë.

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "Për borxhin lejohet dëshmia e grave së bashku me dëshmisë burrave."

Gjithashtu, ai ka thënë: "I Dërguari i Allahut *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)* ka gjykuar me një dëshmitar edhe me betim."

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Edhe argumente të tjera, të bazuara në sentencat e fukahave të kohëve të vjetra e të kohëve të reja."

Pyetje: A vërtetohet e drejta pasurore e njerëzve me dëshminë e dy grave dhe me betim, ashtu siç vërtetohet me dëshminë e një burri dhe me betim?

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Është i qartë vërtetimi i kësaj të drejte me dëshminë e dy grave, bazuar në fjalën e përbashkët të fukahave që gëzojnë autoritet të lartë. Madje prej shejkhut kemi se ai, në librin "El Khilàf", ka thënë që kjo thënie është e bazuar në fjalën e përbashkët të fukahave, bazuar në njoftimin e saktë, të transmetuar prej Mensur bin Hazimit, i cili tregon se Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "Kur dy gra betohen në favor të atij që i takon e drejta dhe ai vetë betohet, kjo është e lejueshme."

Në një transmetim të dytë, ai tregon se i Dërguari i Allahut *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)* ka lejuar dëshminë e grave, krahas betimit të kërkuesit të borxhit, i cili betohet te Allahu se ajo e drejtë, padyshim, që është e drejta që i takon atij.

Më poshtë autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Po, nuk pranohet dëshmia e grave kur dëshmojnë vetëm gratë, domethënë pa betim, krahas dëshmisë së atyre, kur gratë dëshmojnë për ndonjë të drejtë prej të drejtave pasurore, edhe nëse gratë që dëshmojnë janë shumë. Këtë unë e gjejë pa kundërshtimin e asnjërit prej studiuesve."

6- Çështje për të cilat burrat e kanë të vështirë të kenë dijeni

Fukahatë janë bashkuar me dëshminë e autorit të librit "El Xheuahir", i cili ka thënë se çështjet për të cilat burrat e kanë të vështirë të kenë dijeni, vërtetohen me dëshminë e burrave dhe me dëshminë e grave, kur gratë dëshmojnë së bashku me burrat ose edhe veç burrave, siç janë: lindja, virgjëria, jo virgjëria, të metat e brendshme të grave, si për shembull, në vaginën e asaj femre mungon kanali për depërtimin e penisit, ose në hyrje të vaginës së një femre ka një masë mishi që pengon kontaktin, ose kur gratë dëshmojnë për menstruacionet, ose për lindjen e fëmijës të gjallë që të trashëgojë.

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "Lejohet dëshmia e grave për çështje që burrat nuk kanë mundësi të shikojnë dhe që të dëshmojnë kundër."

Në një transmetim të dytë, ai ka thënë: "Lejohet dëshmia e grave për lindjen e fëmijës dhe për virgjërinë."

Në një transmetim të tretë, thuhet se te Prijësi i besimtarëve, te Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*, sollën një femër të cilën e akuzonin për kurvëri. Ai urdhëroi gratë që ta shikojnë atë femër. Gratë pohuan se ajo është e virgjër, atëherë ai tha: "Unë nuk do të dënoj me rrahje atë për të cilin ka vendosur vula e Allahut (Profeti)."

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Ka dhe tekste të tjera që mundësojnë dhënien e një vendimi të prerë, ose edhe transmetime me varg të pashkëputur përcjellësish."

Për sa i përket vërtetimit me dëshminë e grave së bashku me dëshminë e burrave, kjo është thënia më e përhapur, ashtu siç thuhet në librin "Keshful Lithàm", sepse argumentet janë përgjithësuese dhe tregojnë pranimin e dëshmisë së burrave, sepse dihet që burrat janë bazë për dëshminë."

Në librin "El Xheuahir" cituar prej shumicës së fukahave thuhet se dëshmia e grave nuk pranohet për ushqimin e foshnjës me qumësht gjiri, kur gruaja dëshmon se filanja i ka dhënë gji filanit, aq sa foshnja të quhet djali i saj prej qumësht.

Një grup fukahash, ndër të cilët edhe autorët e librave "Esh Sheràiu", "El Xhevahir" dhe "El Mesalik" kanë thënë se kjo dëshmi pranohet, nëse gratë nuk dëshmojnë së bashku me burrat, sepse ushqimi i foshnjës me qumësht gjiri është prej punëve të cilat, në shumicën e rasteve, kanë dijeni vetëm gratë, sepse nevoja e bën të detyrueshme pranimin e dëshmisë së grave për ushqimin e foshnjës me qumësht gjiri prej një gruaje tjetër dhe, sepse ushqimi i foshnjës me qumësht gjiri është njëra prej punëve të fshejkhta.

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* është pyetur për një grua e cila thotë: "Kam ushqyer me gjirin tim një djalë e një vajzë. Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* tha: "Këtë punë, a di ndonjë tjerë përveç asaj?"

Pyetësi tha: "Jo." Atëherë Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* tha: "Mos i beso asaj, nëse nuk ka dijeni edhe ndonjë tjetër veç asaj."

Prej kësaj përgjigjeje kuptohet se asaj gruaje i besohet për pohimin që bën, vetëm nëse pohon edhe një tjetër së bashku me të.

Fukahatë me të dëgjuar kanë shkuar me dëshminë e autorit të librit "El Xheuahir", i cili ka thënë: "Në çdo punë që pranohet vetëm dëshmia e grave, patjetër duhet të dëshmojnë katër gra, sepse për dëshminë, dy gra zënë vendin e një burri, në përputhje me argumentin e ardhur në fjalën e Allahut të Lartësuar:

" أَنْ تَضِلَّ إِحْدَاهُمَا فَتُذَكِّرَ إِحْدَاهُمَا ٱلْأُخْرَىٰ "

"...nëse njëra prej dy grave gabon, tjetra ia kujton asaj..." *(Sure "El Bekare", ajeti 282)*

Patjetër që fukahatë ndajnë në fjalë të përbashkët për të veçuar dëshminë e dy grave në lidhje me lindjen gjallë të fëmijës[1] dhe dëshminë në lidhje me testamentin për pasuri. Gjithashtu, fukahatë kanë pranuar dëshminë vetëm të një gruaje pa betim për një të katërtën e trashëgimisë, në lidhje me lindjen gjallë të fëmijës, si dhe në lidhje me një të katërtën e trashëgimisë testamentit për atë që është lënë testamenti.

Fukahatë kanë pranuar dëshminë e dy grave për gjysmën e trashëgimisë dhe kanë pranuar dëshminë e tri grave për dy të

[1] Në librin "Et Turukul Hakijmeh fis'sejàseti-sh'sher'ij'jeh" të autorit Ibn Kajim El Xheuzij'jeh, në faqen 80, botim i vitit 1952, tekstualisht thuhet: "Ahmed bin Hanbeli ka thënë: "Ebu Hanife ka thënë: "Lejohet dëshmia vetëm e mamisë, edhe nëse ajo është çifute ose kristiane." Në faqen 129 thuhet: "Në vendet që burrat nuk mund të marrin dijeni, si për lindjen e fëmijës, për ushqimin e foshnjës me gji dhe për të metat në organin gjenital të gruas, pranohet dëshmia vetëm e një gruaje, krahas drejtësisë. Bazë për këtë pranim është hadithi i të Dërguarit të Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!) dhe pastaj ai ka përmendur hadithin."

tretat e trashëgimisë dhe për trashëgiminë e plotë kanë pranuar dëshminë e katër grave.

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Këtë unë e gjej pa asnjë kundërshtim."

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* është pyetur për një burrë të vdekur, që ka lënë gruan e tij shtatzënë dhe, pas vdekjes së burrit, gruaja lindi djalë, por edhe djali vdes, pasi ra në tokë. Për këtë lindje mamia dëshmon se djali lindi i gjallë dhe ka qarë në kohën që ra në tokë, pastaj vdiq. Si duhet të veprohet në këtë situatë? Ai *(Paqja qoftë mbi të!)* është përgjigjur: "Gjykatësi ka detyrë të lejojë dëshminë e mamisë për një të katërtën e trashëgimisë së atij djali."

Në një transmetim të dytë, ai ka thënë: "Nëse janë dy gra, dëshmia e tyre lejohet për gjysmën e trashëgimisë, nëse janë tri gra, dëshmia e atyre lejohet për dy të tretat e trashëgimisë dhe, nëse janë katër gra, dëshmia e atyre katër grave, lejohet për gjithë trashëgiminë.

* * *

INCIDENTET PAS DËSHMISË

Heqja dorë nga dëshmia

Kur dëshmitari nuk paraqitet të dëshmojë para gjykatësit pa pasur ndonjë pengesë që e ndalon të dëshmojë, padyshim që ky njeri është mëkatar. Allahu i Lartësuar, në Librin e tij Famëlartë, thotë:

"وَمَنْ يَكْتُمْهَا فَإِنَّهُ آثِمٌ قَلْبُهُ"

"…dhe ai që e fshejkh dëshminë, është mëkatar me zemrën e vet…" (Sure "El Bekare", ajeti 283)

Në këtë gjendje shtrohet pyetja: Në qoftë se e drejta humb, a e garanton atë dëshmitari për shkak se dëshmia e tij është shkaku për humbjen e asaj të drejte?

Në ligjin islam, për këtë çështje nuk ka tekst, as pozitiv e as negativ, por rregullat e ligjit islam dhe bazat e këtij legjislacioni kërkojnë mosgarantimin, sepse shkaqet për garantimin janë vetëm tri:

Shkaku i parë: Veprimi i drejtpërdrejtë, si ai që prish mallin e tjetrit personalisht.

Shkaku i dytë: Bërja e shkakut, si ai që hap një gropë në rrugën publike dhe për shkak të asaj grope prishet një send.

Shkaku i tretë: Vënia dorë, si ai që rrëmben një send dhe më pas ai send prishet në dorën e tij, qoftë edhe kur sendi prishet prej ndonjë faktori atmosferik.

Në kapitullin "Uzurpimi" të kësaj pjese është folur në mënyrë të detajuar rreth shkaqeve që e bëjnë detyrim garantimin, por mosdhënia e dëshmisë nuk ka asgjë të përbashkët me tri shkaqet e mësipërme, sepse dëshmitari as nuk e ka bërë prishjen personalisht, as nuk ka vënë dorë mbi sendin dhe as nuk ka bërë ndonjë punë që sjell prishjen, siç ishte hapja e gropës dhe e punëve të tjera, por ai, duke mos dëshmuar, mban një qëndrim negativ.

Është e kuptueshme se qëndrimi negativ nuk mund të jetë arsye e plotë për të bërë detyrim garantimin, por s'ka dyshim se ai që nuk paraqitet të dëshmojë, meriton jo vetëm dënimin e Allahut të Gjithëpushtetshëm, por edhe qortimin e njerëzve, mirëpo dënimi e qortimi janë një gjë dhe detyrimi për të paguar financiarisht është një gjë tjetër.

Kjo është dispozita, kur dëshmitari e fshejkh dëshminë. Por kur ai dëshmon dhe pas dëshmisë vjen ndonjë ndodhi, si për shembull, dëshmitari vdes, ose ai tërhiqet prej dëshmisë që bëri, ose merret vesh se ai gënjeu, për këto gjendje, hollësitë që kanë dhënë fukahatë bëhen të qarta si më poshtë:

Vdekja pas bërjes së dëshmisë

Kur dy dëshmitarët dëshmojnë para gjykatësit dhe para vendimit vdesin të dy, ose vdes vetëm njëri prej dy dëshmitarëve, ose njëri prej atyre të dyve çmendet, ose humb vetëdijen, këto gjendje nuk sjellin asnjë dëm për dëshminë e atyre të dyve.

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Këtë e gjej pa asnjë kundërshtim, sepse në origjinë dëshmia është e qëndrueshme.", si dhe për faktin se vendimi është i bazuar në dëshminë e bërë, e cila, në të vërtetë, është bërë.

Kur dy dëshmitarëve, në kohën e dëshmisë, nuk u dihet identiteti dhe pas dëshmisë vdesin të dy, por pas vdekjes pastrohen prej kësaj të mete që kishin, pikërisht ky pastrim i tyre zbulon vërtetësinë e dëshmisë së tyre, për rrjedhojë bëhet e detyrueshme që vendimi të jepet sipas dëshmisë së atyre të dyve.

Mëkatimi pas dëshmisë dhe para vendimit

Kur të dy dëshmitarët, ose vetëm njëri prej tyre mëkaton pas dëshmisë dhe para vendimit, a lejohet të vendoset duke u bazuar në dëshminë e atyre të dyve?

Fukahatë ndajnë një mendim të përbashkët me dëshminë e autorit të librit "El Xheuahir" dhe të librit "El Mesalik" për moslejimin e marrjes së vendimit, kur dëshmia ka të bëjë me njërën prej të drejtave të Allahut, siç është zbatimi i dënimit për kurvërimin, pederastinë dhe përdorimin e pijeve dehëse, për shkak të dyshimit, i cili e bën të detyrueshëm moszbatimin e dënimit.

Por fukahatë kanë mendime të ndryshme, kur dëshmia bëhet për një të drejtë prej të drejtave të njerëzve, si për borxhin, apo të ngjashme me borxhin. Ne jemi bazuar në mendimin e autorit të librit "El-Mesalik" dhe të librit "El Xheuahir", te cilët janë shprehur për lejimin e vendimit, plotësisht si në gjendjen e mëparshme, sepse argumentet që ndalojnë vendimin për shkak të dëshmisë së mëkatarit, përfshijnë edhe këtë supozim dhe, nëse gjykatësi do të bazohej në dëshminë e atij mëkatari dhe do të besonte në dëshminë e tij, në të vërtetë, ai gjykatës ka gjykuar me dëshminë e mëkatarit.

Kur dëshmitari bëhet trashëgimtar

Më sipër është shpjeguar se lejohet që të afërmit të dëshmojnë për njëri-tjetrin dhe, kur një dëshmitar dëshmon në favor të të afërmit të vet për pasuri, por personi në favor të të cilit ai dëshmoi, vdes para vendimit, pasuria e personit për të cilin u dëshmua, transferohet te dëshmitari. Nëse gjendja është kështu siç u përshkrua, dëshmia rrëzohet dhe vendimi nuk lejohet.

Bazohemi në fjalën e përbashkët të fukahave e të dëshmisë së autorit të librit "El Xheuahir" dhe të librit "El Mesalik", të cilët theksojnë se prej kushteve për pranimin e dëshmisë, është që dëshmia të mos sjellë asnjë përfitim për dëshmitarin. Kjo çështje është shpjeguar më sipër. Nëse vendoset në favor të këtij dëshmitari, kjo do të thotë që për njeriun lejohet të dëshmojë në favor të vetes së tij.

Kur dëshmitari ka një ortak, për ortakun nuk vërtetohet pjesa e tij në dëshmi, sepse dëshmia nuk parcelizohet.

Dëshmia e falsifikuar

Falsifikimi i dëshmisë nuk realizohet ndryshe, veçse duke gënjyer me qëllim, sepse thjesht pavlefshmëria e dëshmisë nuk kërkon që ajo patjetër të jetë falsifikim, pasi dëshmia mund të jetë e gabuar dhe nuk është falsifikim. Falsifikimi për dëshminë nuk vërtetohet me argument, madje kjo është prej kontradiktave të argumenteve, për të cilat, me lejen e Allahut, do të flitet në kapitullin "Gjykimi".

Gjithashtu, gënjeshtra e falsifikimi nuk vërtetohet me pohimin e dy dëshmitarëve, sepse pohimi i atyre të dyve për gënjeshtrën, është heqje dorë prej dëshmisë. Dispozitën në lidhje me këtë çështje, do ta trajtojmë në paragrafin vijues.

Në fakt, falsifikimi në dëshmi vërtetohet me përfundimet që njoftojnë prerë dhe në atë mënyrë që gjykatësi e merr vesh mirë gënjeshtrën e dëshmitarit, sikur është duke e zbuluar vetë sendin për të cilin dëshmohet, ose për këtë send ai merr njoftim të saktë prej raportit të specialistëve.

Kur vërtetohet falsifikimi në dëshmi, vendimi prishet, qoftë kur vërtetimi ka ndodhur para zbatimit të vendimit, qoftë kur ka ndodhur pas zbatimit të vendimit, sepse vendimi i marrë, bazuar mbi një argument të falsifikuar, është fals si vetë argumenti mbi të cilin ai vendim është bazuar. Nisur nga ky rregull, del rregulli dytësor që thotë: Nëse sendi për të cilin u bë dëshmia vazhdon të ekzistojë, sendi në fjalë i kthehet atij që i takon me të drejtë. Nëse sendi është prishur, çdo dëshmitar do të garantojë sendin sipas masës që ka dëshmia e tij në shkakun e prishjes së sendit.

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* është pyetur për një burrë që falsifikon dëshminë. Ai ka thënë: "Në qoftë se sendi vazhdon të jetë ashtu siç ishte, sendi i kthehet të zotit dhe, nëse sendi nuk ekziston më, atëherë dëshmitari garanton në masën sa është prishur prej pasurisë së atij burri. Ky rregull është veprues, kur sendi për të cilin dëshmohet është pasuri. Nëse dëshmia është për vrasje, ose për prerjen e rrugës, me çdo dëshmitar veprohet ashtu siç u veprua me personin kundër të cilit u dëshmua."

Tërheqja prej dëshmisë

Kur dy dëshmitarët, ose edhe njëri prej tyre tërhiqet prej dëshmisë, pasi dëshmia është bërë, për këtë tërheqje prej dëshmisë konstatohen disa gjendje:

1- Dëshmitari tërhiqet para vendimit. Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët me dëshminë e autorit të librit "El Xheuahir" për anulimin e dëshmisë dhe mosgjykimin, bazuar mbi atë dëshmi, pavarësisht prej llojit të sendit për të cilin dëshmohet.

Gjithashtu, dëshmitari nuk garanton asgjë, kur pas dëshmisë ai pohon se me dëshminë e tij kishte qëllim të gënjente. Në këtë rast, ai është vetëm mëkatar, por, nëse ai thotë: "Gabova.", ose: "E thashë sa për të kaluar radhën.", në këtë gjendje, nuk kemi as mëkat. Nëse ai rikthehet dhe bën një dëshmi të dytë, patjetër që me dëshminë e këtij njeriu nuk gjykohet, sepse në dëshminë e tij ka vend për kontradiktë.

2- Tërheqja prej dëshmisë ndodh pas marrjes së vendimit, por para zbatimit të vendimit dhe objekti i gjykimit është një e

drejtë e Allahut të Plotpushtetshëm, si për shembull, dënimi për kurvëri, për pederasti, ose përdorim pijesh dehëse.

Fukahatë janë bashkuar me dëshminë e autorit të librit "El Xheuahir" për prishjen e vendimit, sepse dënimet fizike nuk mund të zbatohen me dyshime, as atëherë kur e drejta e Allahut është e pleksur me të drejtën e njerëzve, siç është dënimi për shpifjen në nderin e njeriut, ose dënimi për vjedhjen.

3- Tërheqja prej dëshmisë ndodh pas gjykimit e pas vendimit të marrë, bazuar mbi dëshminë, por objekti i dëshmisë është një e drejtë pasurore e njerëzve, si borxhi e të ngjashme me borxhin. Në këtë gjendje, vendimi mbetet ashtu siç është marrë dhe nuk prishet vetëm për shkak të tërheqjes prej dëshmisë, sepse e drejta e personit në favor të të cilit dëshmohet u vërtetua me gjykimin dhe nuk është prej të drejtave që rrëzohen për shkak të dyshimit, madje edhe nëse gjykimi mund të ndikohet prej tërheqjes së dëshmisë, ashtu siç është shprehur autori i librit "El Mesalik". Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Kjo është fjala më e fuqishme."

Mbase dikush mund të thotë se tërheqja e dëshmitarëve prej dëshmisë së tyre, është plotësisht si dëshmia e falsifikuar. Por dihet që vendimi i marrë, bazuar mbi dëshminë e falsifikuar, prishet, për rrjedhojë vendimi duhet të prishet, edhe kur dëshmitarët tërhiqen prej dëshmisë.

Përgjigjja jonë për këtë çështje është: Ndryshimi mes dy rasteve është shumë i madh. Në mënyrë të prerë ne themi se dëshmia e falsifikuar është në kundërshtim të plotë me realitetin, ashtu siç supozohet, kurse tërheqja prej dëshmisë, në asnjë rast,

nuk tregon që dëshmia është në kundërshtim me realitetin, sepse është prej veprimeve të lejuara që dëshmia të jetë e vërtetë dhe me tërheqjen prej dëshmisë, dëshmitari mund të jetë gënjeshtar.

Gjithashtu, është e lejueshme që tërheqja të jetë e vërtetë dhe dëshmia të jetë e rreme, por ne anojmë kah ana e vlefshmërisë së dëshmisë për shkak të ekzistencës së vendimit, i cili, me sa është mundësia, ruhet të mos anulohet, sepse tërheqja prej dëshmisë është veprim i ngjashëm me mohimin pas pohimit.

Nuk ka ndonjë dallim, nëse tërheqja prej dëshmisë bëhet para zbatimit dhe para marrjes së të drejtës, ose pas marrjes së të drejtës, edhe nëse sendin objekt gjykimi e ka marrë në dorë personi në favor të të cilit dëshmohet. Nëse ai nuk e ka marrë në dorë atë send, mbetet detyrim që sendi t'i jepet atij, kurse dëshmitarët garantojnë personin kundër të cilit ata dëshmuan, si kompensim për atë që është marrë prej tij. Për këtë jepet një shumë e zakonshme, ose çmimi i sendit.

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "Kur ata dëshmojnë kundër një burri dhe pastaj tërhiqen prej dëshmisë së tyre, ndërkaq gjykatësi ka marrë vendim kundër burrit që ata dëshmuan, dëshmitarët garantojnë dhe i paguajnë atij burri sendin për të cilin ata dëshmuan. Nëse vendimi nuk është zbatuar, dëshmitë e tyre tërhiqen dhe dëshmitarët nuk paguajnë asgjë."

4- Dëshmitarët tërhiqen prej dëshmisë, pas gjykimit e pas zbatimit të vendimit dhe objekti i dëshmisë është vrasje, ose plagosje, ose prerje e rrugës me qëllim grabitje, apo për veprime të ngjashme. Në këtë gjendje, pyeten dëshmitarët përse u tërhoqën

prej dëshmisë së tyre. Nëse dëshmitarët thonë se kishin qëllim gënjeshtrën, për secilin prej tyre zbatohet ligji i dënimeve dhe secilit prej tyre u bëhet ashtu siç u bë me personin kundër të cilit ata dëshmuan, qoftë për vrasje, qoftë për prerjen e rrugës me qëllim grabitje.

Nëse dëshmitarët thonë se gabuan në dëshminë e tyre, atëherë shuma për shlyerjen e gjakut pjesëtohet mbi dëshmitarët. Nëse disa prej dëshmitarëve thonë se kishin qëllim gënjeshtrën dhe disa të tjerë prej dëshmitarëve thonë se gabuan, mbi atë që pohoi se kishte qëllim të gënjente, zbatohet dënimi me prerjen e kokës dhe mbi atë që pohoi se gaboi në dëshminë e tij, ai do të paguajë pjesën që i takon prej shumës për shlyerjen e gjakut të derdhur, bazuar mbi dëshminë e tij.

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Në të gjitha këto nuk ka asnjë mendim ndryshe, për shkak të rregullit të fuqisë së shkakut kundër personit direkt, si dhe për shkak të argumenteve përgjithësuese që flasin për ekzekutimin me prerje të kokës, duke adresuar edhe tekstet që flasin për çështjen në fjalë."

Prej këtyre teksteve kemi njoftim se Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* është pyetur për katër dëshmitarë, të cilët dëshmojnë kundër një burri të martuar se ai ka kurvëruar dhe më pas njëri prej dëshmitarëve e tërheq dëshminë, por, pasi i akuzuari është ekzekutuar. Si duhet të veprohet?

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* është përgjigjur: "Në qoftë se ai që tërheq dëshminë, thotë: "Ashtu pandeha.", ai dënohet me rrahje sipas ligjit për shpifje dhe paguan shumën për shlyerjen e gjakut. Nëse ai thotë: "Kisha qëllim gënjeshtrën.", ai ekzekutohet.

Dëshmia për divorcin

Kur dy vetë dëshmojnë se filani ka divorcuar gruan e tij dhe gjykatësi vendos në bazë të dëshmisë së atyre të dyve, por më pas për gjykatësin bëhet e qartë gënjeshtra e atyre dy dëshmitarëve, vendimi prishet dhe lidhja martesore mbetet ashtu siç ishte, madje edhe sikur gruaja të jetë martuar me dikë tjetër, sepse ashtu siç është thënë më sipër, e ndërtuara mbi të gabuarën është gabim.

Nëse dy dëshmitarët tërhiqen prej dëshmisë së tyre, gruaja nuk i kthehet më burrit të saj, sepse tërheqja e atyre të dyve prej dëshmisë mund të përmbajë edhe të vërtetën edhe gënjeshtrën, por gjykimi i bërë, bazuar mbi një mundësi, nuk prishet, ashtu siç është shprehur autori i librit "El Mesalik", i cili për këtë fjalë ka thënë se ajo gëzon fjalën e fukahave më të dëgjuar.

Autori i librit "El Xhevahir" ka thënë: "S'ka asnjë komplikim në mosprishjen e gjykimit për divorcin, kur dy dëshmitarët tërhiqen prej dëshmisë së tyre."

Patjetër që në lidhje me këtë çështje shikohet: Nëse burri ka kryer marrëdhënie intime me gruan, dëshmitarët nuk garantojnë asgjë, sepse, në këtë gjendje, burri e ka marrë të drejtën e tij me martesën, por, nëse burri nuk ka kryer marrëdhënie intime me gruan, dy dëshmitarët garantojnë për atë gjysmën e shumës së parave të kurorës që ai i ka paguar gruas, ndërkaq nuk ka përfituar prej saj asnjë dobi. Për këtë çështje autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Këtë e gjej pa asnjë kundërshtim."

Dëshmia për testamentin

Dy vetë dëshmojnë se filani ka lënë testament për Zejdin këtë send prej pasurisë së tij. Më pas njëri dëshmitar dëshmon se ai ka hequr dorë prej testamentit që bëri për Zejdin dhe më pas bëri testament për Halitin. Në këtë gjendje, Haliti ka detyrim të betohet së bashku me dëshmitarin dhe vendimi merret në favor të Halitit, që sendi i lënë me testament t'i jepet atij. Këtu nuk ka kontradiktë mes dëshmisë së dy dëshmitarëve në favor të Zejdit dhe gjykimit në favor të Halitit me një dëshmitar e me betim, për shkak se lejohet heqja dorë prej testamentit.

* * *

UZURPIMI.....5
Kuptimi i fjalës "uzurpim".....5
Uzurpimi është haram.....6
Shkaqet e garantimit.....8
Garantimi për prishjen e sendit.....10
Garantimi për bërjen e shkakut.....11
Kalimi i zjarrit në pronën e fqinjit.....12
Ai që ndalon pronarin prej pronës së tij.....14
Më pak se vlera e tregut.....14
Tërheqja prej dëshmisë.....15
Bashkimi i shkakut dhe i prishjes së drejtpërdrejtë.....16
Çështje.....18
Garantimi për vënien dorë.....19
Dobitë e njeriut të lirë.....20
Qarkullimi në disa duar.....22
Kthimi i sendit të uzurpuar.....23
Humbja e sendit të uzurpuar.....25
Dobitë e sendit të uzurpuar.....26
I ngjashmi dhe i vlerësuari me çmim.....29
Çështje.....34
Konflikti.....36
PREMTIMI (nedhr), BETIMI DHE BESËDHËNIA.....38
Premtimi.....38
Kushtet.....39
Shlyerja për shkeljen e premtimit.....44
Betimi.....45
Kushtet.....47

Betimi i gabuar.....51
Betimi i pafajësisë.....52
Shlyerja për thyerjen e betimit.....52
Besëdhënia.....53
Shlyerja për shkeljen e besëdhënies.....54
Ndërmjet premtuesit, betuesit e besëdhënësit.....55
SHLYERJET.....56
1- Shlyerja për vrasjen e gjahut prej atij që është në Ihram.....56
2- Shlyerja kur burri i thotë gruas së tij: "Të kam në vend të nënës!" (edh dhihàr).....56
3- Shlyerja për vrasjen gabimisht.....57
4- Shlyerja për vrasjen me qëllim.....58
5- Shlyerja për prishjen e agjërimit kaza të Ramazanit.....59
6- Shlyerja për prishjen e Ramazanit.....60
7- Shlyerja për shkeljen e premtimit.....60
8- Shlyerja për thyerjen e betimit.....60
9- Shlyerja për shkeljen e besëdhënies.....60
10- Betimi për mosmbajtjen e përgjegjësisë.....60
11- Gruaja qeth flokët e saj deri në rrënjë.....61
12- Gruaja shkul flokët deri në rrënjë.....62
13- Burri gris rrobat e tij.....62
14- Kryerja e marrëdhënieve me gruan në periudhën e menstruacioneve.....63
15- Agjërimi në Itikaf.....63
Agjërimi.....63
Ushqyerja.....64
Veshja.....65
Çështje.....66
NGJALLJA E TOKAVE TË VDEKURA.....70
Toka.....70

Toka e vdekur dhe gjallërimi i saj.....73
Kushtet.....75
Ai e lë tokën pas dore, pasi e gjallëroi.....77
Kufizimi i tokës së paprekshme.....79
Dëmtimi i komshiut.....81
Uji.....84
Mineralet.....88
Çështje.....89
VAKËFI.....90
Cili është kuptimi i fjalës "vakëf"?.....90
Ligjërimi i vakëfit.....91
Formula.....91
Përheshmëria dhe vijimësia.....94
Marrja në dorë.....96
Kush e merr në pronësi objektin e lënë vakëf?.....99
Kryerja e punës.....100
Vakëflënësi.....101
Nijeti për afrim.....102
Objekti vakëf.....103
Personi për të cilin është lënë vakëfi.....104
Vakëfi i lënë për falje namazi.....108
Përngjasimi.....108
Vullneti i vakëflënësit.....109
Kushti i lejuar.....110
Përzgjedhja.....111
Sigurimi i ushqimit dhe shlyerja e borxhit.....111
Kushti për kthimin e vakëfit te vakëflënësi.....112
Futja dhe nxjerrja.....113
Fjalët e vakëflënësit.....114
Kujdestaria mbi vakëfin.....115

SHITJA E VAKËFIT.....120
Pyetje.....120
Librat "El Mekasib" dhe "El Xheuahir".....120
Këto çështje.....122
Xhamia.....123
Pasuritë e xhamisë.....125
Jo xhami.....129
Vakëfi i përgjithshëm dhe vakëfi i veçantë.....131
Varreza.....134
Nënçështje.....136
Shkaqet justifikuese.....137
Shuma e realizuar nga shitja e vakëfit.....139
(EL HABSU UES SEKNÀ).....142
El habsu.....142
"es seknà", "el umrà" dhe "err rrakbà".....144
NDALIMI.....148
Kuptimi i fjalës "ndalim".....148
Ligjërimi i ndalimit.....149
I çmenduri.....150
I vogli dhe shenjat e pjekurisë seksuale.....151
Vërtetimi me pohim i arritjes së pjekurisë seksuale.....156
Mendjelehti.....156
Ngurtësimi.....158
Vendimi i sundimtarit.....158
Pohimi i mendjelehtit, martesa dhe divorci i tij.....160
Vërtetimi i inteligjencës.....162
I sëmuri.....162
KUJDESTARI I TË VOGLIT, I TË ÇMENDURIT DHE I MENDJELEHTIT.....165
I vogli dhe i çmenduri.....165

Çmendja e ardhur pas mendjes.....167
Mendjelehti.....169
Kushtet e kujdestarit.....170
I FALIMENTUARI.....177
Kuptimi i fjalës "i falimentuar".....177
Kushtet.....178
Pas ngurtësimit.....179
Pohimi i të falimentuarit.....182
Të përjashtuarat.....183
Burgosja e borxhmarrësit.....184
Çështje.....187
POHIMI.....191
Kuptimi i fjalës "pohim".....191
Ligjshmëria e pohimit dhe argumentimi i tij.....192
Formula.....193
Pohuesi.....197
Pretendimi i pohuesit është prishje e pohimit.....202
Personi në favor të të cilit pohohet.....204
Personi në favor të të cilit pohohet, nuk përgënjeshtron.....206
Sendi i pohuar.....207
Pohimi për një send të panjohur.....208
Mohimi pas pohimit.....210
Pas pohimit vjen ajo e kundërshton pohimin.....213
POHIMI I PËRKATËSISË FAMILJARE (atësia).....214
Pohimi për fëmijën.....214
Pohimi për lindjen jashtë martese (nga prostitucioni).....217
Ndërmjet përkatësisë familjare dhe martesës.....218
Pohimi i përkatësisë familjare për të vdekurin.....219
Pohimi jo për fëmijën.....220
Çështje.....223

DËSHMITË.....227
Kuptimi i fjalës "dëshmi".....227
Ndërmjet dëshmisë dhe transmetimit.....229
Marrja përsipër e dëshmisë dhe kryerja e saj.....229
Dëshmia dhe kushtet e saj.....231
1- Qartësia.....232
2- Përputhja.....232
3- Dëshmi për mohim.....234
4- Dituria.....235
KUSHTET E DËSHMITARIT.....238
1- Mendja.....238
2- Pjekuria seksuale.....239
3- Dëshmitari të jetë mysliman.....242
4- Drejtësia.....244
5- Saktësia.....248
6- Armiqësia.....249
7- Afërsia.....251
8- Tërheqja e dobisë dhe sprapsja e dëmit.....252
9- Dëshmia e lypësit.....254
10- Dëshmia e atij që ka të drejtë të marrë zekat.....255
11- Dëshmia e të verbrit dhe e memecit.....255
12- Dëshmitari i paftuar të dëshmojë.....256
Paga e dëshmitarit.....258
Dëshmia mbi dëshminë.....259
KATEGORITË E TË DREJTAVE DHE NDODHIVE.....262
1- Kurvërimi.....262
2- Pederastia e lezbizmi.....264
3- E drejta e Allahut.....265
4- Të drejtat jo pasurore të njerëzve.....266
5- Të drejtat pasurore të njerëzve.....269

6- Çështje për të cilat burrat e kanë të vështirë të kenë dijeni.....271
INCIDENTET PAS DËSHMISË.....275
Heqja dorë nga dëshmia.....275
Vdekja pas bërjes së dëshmisë.....277
Mëkatimi pas dëshmisë dhe para vendimit.....277
Kur dëshmitari bëhet trashëgimtar.....278
Dëshmia e falsifikuar.....279
Tërheqja prej dëshmisë.....280
Dëshmia për divorcin.....284
Dëshmia për testamentin.....285

فقه الامام جعفر الصادق عليه السلام

مؤلف: محمد جواد مغنية

الجزء التاسع

الترجمة الى اللغة الألبانية: الشيخ الحاج سليم اصطفى

تيرانا: 2018

نام کتاب: فقه الامام جعفر الصادق عليه السلام – الجزء التاسع

مؤلف: محمد جواد مغنية

الترجمة الى اللغة الألبانية: الشيخ الحاج سليم اصطفى

زير نظر: وُلْنَتْ مِرْيَا

ويرايش: يريدا كولا

صفحه بندى و جلد: صبريه فزا

ناشر: جمعيت "نسيم"

چاپ: انتشارات "ليلو"

تيرانا: 2018